



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Nr. 125 Regj. Them.
Datë regjistrimi 08.12.2025

Nr. 125 Vendimi
Datë vendimi 15.12.2025

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”
“CAKTIM MASE SIGURIMI”

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga:

GJYQTARE – FLOJERA DAVIDHI

Në dhomë këshillimi, sot më datë 15.12.2025, ora 08:45, pasi mora në shqyrtim mbi aktet, çështjen penale me nr. 125 regj.them., datë regjistrimi 08.12.2025, që i përket:

Kërkes: Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori Bledar Maksuti.

Objekti: Caktim mase sigurimi personal.

Personat nën hetim: 1. Ergys Agasi i biri i Bardhyl dhe Besa, i datëlindjes 22.03.1987, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i martuar, me numër personal I70322075Q, me adresë banimi: Rruga “Abaz Çelkupa”, pallati nr. 28, Durrës dhe pranë “Panto Resort”, banesë 2-katëshe, Tiranë.
2. Ermal Beqiri i biri i Nexhmi dhe Mihal, i datëlindjes 23.01.1982, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, beqar, me numër personal I20123025V, me adresë banimi: Rruga “Hoxha Tasim” pallati 113, Tiranë.
3. Mirlinda Karçanaj, e bija e Agim dhe Gjinovefa, e datëlindjes 29.06.1973, me kombësi shqiptare dhe shtetësi shqiptare, e martuar, me numër personal H35629039A, me adresë banimi: Rruga e “Kavajës”, pallati nr. 3, hyrja 4, ap. 44, Tiranë.
4. Hava Delibashi, e bija e Novruz dhe Shpresa, e datëlindjes 17.01.1986, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, beqare, me numër personal I65117057T, me adresë banimi: Rruga “Komuna e Parisit”, pranë “Ola Fast”, pallati “Erald”, k.9, ap 22, Tiranë.

5. Erjon Ismaili, biri i Lulzim dhe Lulzime, i datëlindjes 11.10.1979, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i martuar me fëmijë, me numër personal H91011016N, me adresë banimi: Rruga "Konferenca e Pezës", nd. 12, hyrja 2, ap.18, Tiranë.

6. Rogers Rryta i biri i Bedri dhe i Meliha, i datëlindjes 03.03.1987, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i martuar, me numër personal I70303061U, me adresë banimi: Rruga "Fatmir Haxhiu", pallati te ETC, kati 11/4, Tiranë.

7. Andis Papa i biri i Spiro dhe Kristina, i datëlindjes 17.02.1975, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i martuar, me numër personal H50217056C, me adresë banimi: Rruga "Brigada e VIII", pallati nr. 8, hyrja 1, Tiranë.

8. Gëzim Hoxha i biri i Drahim dhe Xhefe, i datëlindjes 06.03.1978, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i martuar, me numër personal H80306088N, me adresë banimi: Rruga "Alla", pallati nr. 4, hyrja 7, ap. 17, Farkë, Tiranë.

Të dyshuar:

Për veprat penale të "*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*", "*Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës*", "*Heqja e paligjshme e lirisë*", e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal dhe "*Grupi i strukturuar kriminal*", "*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", si dhe "*Pastrimi i produkteve të veprës penale*" të parashikuara nga nenet, 258/2, 110, 170/b e 28/4 dhe 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

Baza ligjore:

Nenet 244, 230, 238, 242, 228, 229, të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e prokurorit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, i cili ka kërkuar ndaj personave nën hetim **Ergys Agasi, Ermal Beqiri**, caktimin si masë sigurimi personale shtrënguese atë të "*arrestit në burg*", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale; ndaj personave nën hetim **Mirlinda Karçanaj, Hava Delibashi**, caktimin si masë sigurimit personale shtrënguese atë të "*arrestit në shtëpi*", parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale; ndaj personit nën hetim **Erjon Ismaili**, caktimin si masë sigurimi personale shtrënguese "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*", parashikuar nga neni 233 të K.Pr.Penale dhe caktimin si masë sigurimi personale ndaluese "*Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik*", parashikuar nga neni 242 të K.Pr.Penale; si dhe ndaj personave nën hetim **Andis Papa, Gëzim Hoxha, Rogers Rryta**, caktimin si masë sigurimi personale shtrënguese "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*", parashikuar nga nenet 233 të K.Pr.Penale, të dyshuar për kryerjen e veprave penale respektive, si dhe mori në shqyrtim dhe administroi të gjitha provat shkresore të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme,

VËREN SE:

I. Procedura

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me vendimin e datës 05.12.2025, të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka bërë ndarjen e procedimit penal nr. 20, viti 2023 (të bashkuar me procedimin 36/4, viti 2025) si dhe veçimi i akteve që kanë të bëjnë me veprat penale "*Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës*", "*Heqja e*

paligjshme e lirisë", "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike" e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal dhe "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale" të parashikuara nga nenet 110, 170/b e 28/4 dhe 333/a dhe 334 të Kodit Penal, duke regjistruar një procedim të ri penal, atë me nr. 20/1, të vitit 2025.

Po në muajin dhjetor, në regjistrin e njoftimit të veprave penale janë regjistruar emrat e personave nën hetim, për të cilët kërkohet caktimi i masave të sigurimit personal, të dyshuar secili për veprat penale konkrete.

Në datën 08.12.2025, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në vijim referuar si Gjykata ose Gjykata e Posaçme) duke paraqitur kërkesën objekt gjykimi, sikurse është cituar në pjesën hyrëse të këtij vendimi gjyqësor.

Përpara shqyrtimit të çështjes, Gjykata analizoi kryesisht (*proprio motu*) nëse ka juridiksion për shqyrtimin e çështjes, si dhe nëse ka kompetencë lëndore për gjykimin e saj në referim të neneve 74¹ dhe 75/a² të K.Pr.Penale. Ky është një parakusht procedural, pasi nëse një gjykatë nuk ka juridiksion dhe kompetencë për të gjykuar të akuzuarin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është e "krijuar me ligj", sipas kuptimit të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane³.

Marrë në konsideratë përcaktimet e bëra nga neni 69⁴ i K.Pr.Penale, si dhe faktin se procedimi penal nr. 20/1 i vitit 2025 i Prokurorisë së Posaçme është regjistruar dhe po hetohet në vijim, ndër të tjera, edhe për veprat penale të parashikuara nga nenet 258 dhe 333/a të K.Penal, bazuar në nenin 75/a, shkronjat "a" dhe "b" të K.Pr.Penale që parashikon se: "Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet....258, paragrafi 2, ...të Kodit Penal; b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal", Gjykata e Posaçme është kompetente për gjykimin e çështjes objekt shqyrtimi.

Në zbatim të parimit themelor kushtetues për një gjykim të drejtë nga një gjykatë e krijuar me ligj⁵, kompetente, e pavarur dhe e paanshme (neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ) gjykimi i çështjes u

¹ Ky nen parashikon se: "1. Gjykata e rrethit gjyqësor është kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar".

² Ky nen parashikon se: "Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykon:

a) krimet e parashikuara nga nenet244, paragrafi 2, ...259, paragrafi 2...të Kodit Penal;

b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal...".

³ Vendimi nr.11, datë 23.04.2009 i Gjykatës Kushtetuese.

⁴ Ky nen parashikon se: "1. Juridiksioni penal ushtrohet nga gjykatat penale sipas rregullave të caktuara në këtë Kod. 2. Gjykata penale shqyrtton gjithçka që është e nevojshme për marrjen e vendimit dhe vendos sipas rregullave të caktuara me ligj".

⁵ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 18.05.2005; nr. 14, datë 17.04.2007 ka argumentuar ndër të tjera se: "...faza "gjykatë ... e caktuar me ligj" në nenin 42/2 të Kushtetutës mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështje konkrete".

ne me grup gjyqës të përbërë nga 1 (një) gjyqtar, pasi në zbatim të nenit 13, pika 2^a të K.Pr.Penale, aktet e palëve gjatë hetimeve paraprake gjykohen në shkallë të parë nga një gjyqtar, ndërsa gjyqtarja në këtë rezultat të jetë gjyqtare e hetimeve paraprake të procedimit penal nr. 20/1 të vitit 2025 të Prokurorisë së Posaçme, duke qenë se ky procedim është i ndarë nga ai 20 i vitit 2023 dhe gjyqtarja është gjyqtare e hetimeve paraprake në kuadër të këtij procedimi penal.

Gjyqtarja e çështjes, mori kërkesën penale në shqyrtim, në dhomë këshillimi, në referim të nenit 244, pika 1 të K.Pr.Penale, dhe duke qenë se vendimi jepet i arsyetuar, patur në konsideratë volumin e kërkesës, po ashtu të fashikujve hetimorë, dhe kompleksitetin e çështjes, gjykata disponoi përfundimisht më datë 15.12.2025, ora 08:45.

II. Rrethanat e faktit

Referuar kërkesës për gjykim si dhe akteve bashkëlidhur rezultoi se:

I. Rrethanat procedurale për regjistrimin e procedimit penal

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr. 20, viti 2023, për veprat penale “Kontrabanda me mallra për të cilat paguhet akcizë ose me pezullim të plotë apo të pjesshëm nga detyrimet doganore ose të akcizës”, e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal dhe “Grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 172 e 28/4 dhe 333/a të Kodit Penal.

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, mbi bazën e akteve të administruara nga ana e autoriteteve italiane të drejtësisë, të cilët kanë kërkuar ndihmë juridike me qëllim krijimin e një skuadre të përbashkët hetimore, ka regjistruar procedimin penal nr. 36 të vitit 2019 për veprat penale “Trafikimi i narkotikëve” e kryer në formën e posaçme, atë të grupit të strukturuar kriminal, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal” parashikuar nga neni 283/a, 287, 333/a dhe 334 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë hetimit ka rezultuar që në datë 12 Gusht 2025 është administruar informacion lidhur me faktin se disa persona të paidentifikuar dyshohet se i kanë hequr lirinë një shtetasi shqiptar. Shkaku i kësaj ngjarje dyshohet të jetë pjesëmarrja në procedurat e ndryshme të prokurimit apo tenderime publike nga ky shtetas.

Sa më sipër, ka dalë e nevojshme që aktet e administruara të veçohen nga ky procedim, duke regjistruar procedimin e ri penal nr. 36/4, viti 2025 për veprat penale “Heqja e paligjshme e lirisë” e kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera dhe ankande publike”, vepra penale të parashikuara nga nenet 110,

⁶ Neni 13/2 parashikon se: “Gjykatat e rretheve gjyqësore dhe Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykojnë me një gjyqtar: a) kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake;...”.



23.01 dhe 258 të Kodit Penal.

Me vendimin e datës 05.12.2025 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, procedimi penal nr. 36/4, viti 2025 është bashkuar me procedimin nr. 20, viti 2023 në një të vetëm, atë me nr. 20, viti 2023.

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, mbi bazën e kallëzimit penal nr. 17, datë 19.01.2024, ka regjistruar procedimin penal nr. 10, datë 19.01.2024 për veprat penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", "*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*", "*Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", "*Shpërdorimi i detyrës*", "*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", "*Fshehja e të ardhurave*", "*Falsifikimi i dokumenteve*" dhe "*Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve*" parashikuar nga nenet 259, 258, 287, 248, 244, 180, 186/3 dhe 190 i Kodit Penal.

Sipas kallëzimit penal, subjekte tregtare të lidhura me drejtues të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë dhe Informacionit kanë përfutur në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik fonde publike.

Me vendimin e datës 17.09.2025 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, procedimi penal nr. 10, viti 2024 është bashkuar me procedimin nr. 20, viti 2023 në një të vetëm, atë me nr. 20 viti, 2023.

Për sa më sipër, me vendimin e datës 05.12.2025, të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, është bërë ndarja e procedimit penal nr. 20, viti 2023 (të bashkuar me procedimin 36/4, viti 2025) si dhe veçimi i akteve që kanë të bëjnë me veprat penale "*Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës*", "*Heqja e paligjshme e lirisë*", "*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*" e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal dhe "*Grupi i strukturuar kriminal*", "*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", si dhe "*Pastrimi i produkteve të veprës penale*" të parashikuara nga nenet 110, 170/b e 28/4 dhe 333/a dhe 334 të Kodit Penal, duke regjistruar një procedim të ri penal, atë me nr. 20/1, të vitit 2025.

II. Rrethanat e faktit penal si edhe baza ligjore e përdorur për kërkesën për caktimin e masës së sigurisë

Prokuroria Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr. 20/1, viti 2025, për veprat penale *Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës*", "*Heqja e paligjshme e lirisë*", "*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*" e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal dhe "*Grupi i strukturuar kriminal*", "*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", si dhe "*Pastrimi i produkteve të veprës penale*" të parashikuara nga nenet 110, 170/b e 28/4 dhe 333/a dhe 334 të Kodit Penal, duke regjistruar një procedim të ri penal, atë me nr. 20/1, të vitit 2025.


Nga hetimet e kryera rezulton se shtetasit Ergys Agasi, Ermal Beqiri, Mirlinda Karçanaj, Hava Delibashi, Erjon Ismaili, Andis Papa, Gëzim Hoxha, si dhe persona të tjerë, në bashkëpunim me njëri-tjetrin në formën e grupit të strukturuar kriminal, kanë organizuar dhe implementuar një skemë për paracaktimin e fituesve në procedurat e prokurimit, të kryera në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), me qëllim përfitimin e paligjshëm të fondeve publike që rrjedhin nga pagesat lidhur me kontratat publike të prokuruar. Kjo skemë konsiston në përcaktimin e paligjshëm të kriterëve konkurrues për procedurat e prokurimit, të cilat vendosen me qëllim për përjashtimin nga gara të operatorëve ekonomikë ofertues dhe paracaktimin e fituesit duke nxjerrë arsye të ndryshme për skualifikim. Ndaj operatorëve ekonomik të skualifikuar, të cilët kanë kërkuar të drejtën e tyre nëpërmjet ankimit zyrtar pranë Autoritetit Kontraktor, por edhe në Komisionin e Prokurimit Publik, është përdorur dhuna, heqja e paligjshme e lirisë për t'i detyruar me forcë që të tërhiqen nga ankimimet, por edhe nga çdo procedurë ku kanë marrë pjesë me qëllim që të sigurohej vazhdueshmëria e kësaj skeme.

Konkretisht, në kuadër të këtij hetimi penal, në bazë të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 403, datë 18.06.2025, lejoi kontrollin personal dhe të vendeve të banimit e bizneseve në emër të shtetasit Ergys Agasi dhe bashkëshortes Megi Agasi.

Gjatë kontrollit të kryer, janë sekuestruar disa aparate celularë, kamera, kompjuter dhe dokumente fizike. Ndër to është sekuestruar dhe pajisja kompjuterike "4 – Smart battery camera" e cila është ekspertuar me Aktin e Ekspertimit Kompjuterik me nr.207, datë 17.07.2025. Nga ekspertimi kompjuterik janë ekstraktuar të dhëna kompjuterike. Nga këqyrja e këtyre të dhënave rezulton se në këtë pajisje gjendet dosje kompjuterike e emërtuar "DCIM". Brenda kësaj dosje ndodhen disa nëndosje elektronike të emërtuara me datë, muaj dhe vit. Secila nga këto nëndosje përmban të dhëna kompjuterike të formatit "MP4 Video File", me emërtime të veçanta.

Nga këqyrja e këtyre të dhënave kompjuterike janë konstatuar pamje filmike me interes për hetimin. Nëpërmjet aplikacionit VLC Media Player, pikërisht funksionit "Take Snapshot", u fiksuan imazhe fotografike të gjendura në filmimin video si dhe u transkriptuan komunikimet e kryera gjatë këtij momenti kohor. Ato paraqiten si më poshtë:


Data 25.09.2023



Ergys Agasi: Ku e kam vu më i q.. robt

Ermal Beqiri: Është problem o vlla. Kishe informacion brenda?

Ergys Agasi: Po




Ergys Agasi: Ça thoshte ai?


Ermal Beqiri: Si?

Ergys Agasi: Ça thoshte ai?

Ermal Beqiri: U ulëm i çik me ate, i thashë e di si është puna i thashë



Ernal Beqiri: ...japësh lekë, të bllokojmë i ktu



Ernal Beqiri: ..janë t'u q.. motrën...kte du ta shoh, ta marrin t'veten, tu them ça muhabeti të bëjmë. E dyta



Ermal Beqiri: të vijnë ata.... të firmosin nai...



Ergys Agasi: .. I thashë unë jo. Jo re i thashë, po ik i thashë, se kam i herë raportin e kazinosë o vlla. Po jo re kur ta thërras unë ai do vi




Ergys Agasi: ...Ktu forca është ajo që ... ne sot, që është e duhuri, nuk ka forcë tjetër ktu mo vlla, thrrit
 ça të dush ti. Ka pas dhe të tjerë ai



Ergys Agasi:.. ..merret me kokainë Gysi, ça po bo me kokainë....



Ermal Beqiri: ...e di sa përqind e xhiron, ku kam me ate unë, 30 – 33 përqind



Ermal Beqiri:.... si fytyrë është, deri sa pyta adela... mos del televizor dhe a nis një shkresë kshu...



Ernal Beqiri: Informacioni është gjë shumë më e madhe se sa numrat
 Ergys Agasi: Ue



Ernal Beqiri: Ça me i bo atit....
 Ergys Agasi: ..nuk e diskutoj fare o burrë, tashi jemi goxha shumë shumë më lart.

Data 30.10.2023



Ergys Agasi: Ky po na e dekonspiro..



Erjon Ismaili: O vlla si je...



Ermal Beqiri: ..deklaratë noteriale




Ergys Agasi: ...marrë shtesa
 Erjon Ismailaj: Te kush më?
 Ergys Agasi: I ka thënë ky i gjykatës
 Erjon Ismailaj: E shtyu ai..



Ermal Beqiri: Situatën në dorë, i ka thënë pa problem

Ergys Agasi: ..mirë mirë, ç'a ke?

Ermal Beqiri: Jo asigjo, Mondi...



Ergys Agasi: Po shum mirë ka bo

Ermal Beqiri: Jo unë kam hall që mos i prishet punë ktij

Ergys Agasi: Këtë i thashë dhe unë



Ergys Agasi: Tja them... ka një gjë që, i them kapos që e ka gjith një raport




Ergys Agasi: Tja boj m yzmetin iher
 Erjon Ismaili: Pavarësisht se nga ato të mirat
 Ergys Agasi: Po ku ka?



Ergys Agasi: Ai gati ti bënte ...

Erjon Ismaili: Në raport me këto të tjerat



Erjon Ismaili: Është dhe profesionist...i zoti edhe

Data 06.11.2023



Ergys Agasi: ...ta bëj Ministria e Financave. Se bo dot mër burrë



Ergys Agasi: Ose shofim dhe një që dhe të na ecë shpejt..


Ermal Beqiri: Me i llogjikë të ftohtë, po ta mendosh ... kshu është e drejta

Data 11.11.2023




Ergys Agasi: E ça pastaj, edhe i ke gjitha ti k.. edhe i menaxhojmë vetë ne, hajde këtu... kaq e ke dhe ik
 Ermal Beqiri: Aty mund ti çojmë gjysmat ne..

Datë 05.12.2023



Ergys Agasi: (Flet në telefon) O mo vlla, hë ça bën mirë je ti..mirë mirë. Shiko tashi, do të vi **Ervina** se
 do të bëhet një aksion për disa fallsifikime



Ergys Agasi: (Flet në telefon) Dhe që mos dali fjala, se dun që ti plasin mrena... kupto ti. Eee me kujdes

Data 17.01.2024




Mirlinda Karçanaj: ... ja se ta tregoj pse

Ergys Agasi: ...shkrujt më përpara të paktën, minimumi

Mirlinda Karçanaj:...do ta dërgoj dhe



Mirlinda Karçanaj: ..ke procedura SPA, që na çoj kjo Adela. Ja çojmë njëherë vjet, arsyeja ishte.



Ergys Agasi: Po ta fillosh ti e tja them unë në sy, do digjem unë




Mirlinda Karçanaj: (Flet ne telefon) *E kemi diskutuar ëë, do bëjmë një shkresë zyrtare*



Mirlinda Karçanaj: (Flet ne telefon) *AKSHI shkurt... si e ka Agjencia Inovacionit dhe Ekselencës A I E...*



Mirlinda Karçanaj: (Flet ne telefon) Që e kërkojnë dhe zyrtarisht...



Mirlinda Karçanaj: (Flet ne telefon) ..ekonomia.gov.al...



Ergys Agasi: ...Sa inot më vje se dalin fjalët e..





Ergys Agasi: Iku nga puna për t'i ruajtur reputacionin.... çkemi hequr
Mirlinda Karçanaj: ...Vetëm mos më të ofendu ty




Ergys Agasi: Ore dëshminë e tij do ..takoj dhe do tja thush nesër do ta shof vet ta zgjidh

Data 24.01.2024







Data 26.01.2024



Ergys Agasi: I sistemoj unë gjonat në.. po kshu pam pam pam..




Ergys Agasi: Për Ilir Beqajn ... për hesap të Spakut



Ergys Agasi: Do me i fut k.. atij plako se nuk i ruhet k... shumë
Ermal Beqiri: U dukte ma kollaj ajo
Ergys Agasi: Po pra se gjasme




Ergys Agasi: Pranej them mos i merr përsipër se ate e ndjekin gjona të tjera kur... ti, edhe ai mos...



Ergys Agasi: Se unë ja kam mbulu i çështje... jo o vllae kanë përgju vet ata



Ergys Agasi: Janë bo shumë, edhe... kte Marjanën




Ergys Agasi: Me qetësi, me qetësi, mos

Data 02.02.2024




Ergys Agasi:.... me pas nji program janë këto që përfaqësojnë pashaportat e arta



Ergys Agasi:çunin që kom ktu tashi, e kam çu te Nipti ore. Po më pret atje përpara




Ergys Agasi: Mndihmon ai...
 Ermal Beqiri: ..Kur t'thonë nesër?
 Ergys Agasi: Nesër
 Ermal Beqiri: (Qesh)



Ergys Agasi: ... edhe erdhën ato të ... me një copë letër




Ergys Agasi: *Deri tashi ëë, tshofi ofertës mo, i kput veshin*



Ergys Agasi: *Skemi nai urgjencë... ska gjo mo ditën e honë*



Ergys Agasi: *Ishin dy tendera për procedurë. Ishte nji A Bi Ese*



Ergys Agasi: *Shife deri tashi është plotësu... pastaj 4, 4.2*



Ergys Agasi: Kam hall se merr dy pikë shtatshin e ...



Ergys Agasi:.....tashti si shko në mend kujt o vlla....

Data 12.03.2024



Nga këqyrja konstatohet nëndosja me emërtimin “2024-03-16UTC”. Këto të dhëna shfaqen si më poshtë:

Pasi klikohet mbi këtë nëndosje në ekran shfaqen disa të dhëna kompjuterike të formatit “MP4 Video File”, të cilat paraqiten si më poshtë:




Pasi klikohet në këto të dhëna nëpërmjet programit kompjuterik “VLC Media Player” në ekran, shfaqen pamje audio dhe video të ruajtura në të. Nga këqyrja e pamjeve video dhe bisedave audio u përfutuan

pamjet fotografike dhe transkriptet e mëposhtme sipas periudhës kohore në kronologji. Në orën 19.07.45 në ambientet e zyrës së subjektit "EA Tobacco", shfaqet shtetasi Ermal Beqiri. Pamjet fotografike të këtij momenti shfaqen si më poshtë:



Shtetasi Ergys Agasi dhe Ermal Beqiri diskutojnë me njëri-tjetrin dhe në lëvizjet e shtetasit Ermal Beqiri vihet re sjellje padurimi e cila shfaqet si më poshtë:





Në orën 19.08.44 shtetasi Ergys Agasi i drejtohet shtetasit Ermal Beqiri duke i thënë: *99.9 do bohet.. ja me bast.* Ky moment pasqyrohet me pamjet e mëposhtme:





Në orën 19.11.21 në ambientet e subjektit "EA Tobacco" shfaqet shtetasja Mirlinda Karçanaj. Pamjet fotografike shfaqen si më poshtë:



Shtetasja Mirlinda Karçanaj, bisedon me shtetasin Ermal Beqiri. Pamjet shfaqen si më poshtë:



Afrohet shtetasi Ergys Agasi i cili i drejtohet shtetases Mirlinda Karçanaj duke i thënë: “*Hej ça bën ti zemra*”. Ky moment shfaqet me pamjen e mëposhtme:



Të tre kryejnë bisedën e mëposhtme:

Mirlinda: *Skam problem*

Ergysi: *Do ta them unë copë.. mbëdhjetë i kishte bo*

Ermali: *Sa?*


Ergysi: *13 copë*

Kjo bisedë pasqyrohet me pamjen fotografike si më poshtë:



Të tre shtetasit çohen dhe i drejtohen dalje. Në këtë moment shtetasja Mirlinda Karçanaj thotë: *Me izmitë testin.. atëherë Ermal*



moment pasq rohet me pamjen e mëposhtme:





Më pas shtetasi Ergys Agasi thotë: *..projekti bën 2 milion, ne do ta bëjmë 4.*

Kjo bisedë ilustrohet me pamjen e mëposhtme:




Më tej shtetasi Ergys Agasi thotë: *Shife ça do bëj unë tashi.. kemi punë për ..kë do tja japim projektin.*

Kjo bisedë ilustrohet me foton e mëposhtme:



Shtetasi Ergys Agasi thotë : ... *do çuditen fare*
 Shtetasja Mirlinda Karçanaj: *Kaq garanci...*

Kjo bisedë ilustrohet me pamjen e mëposhtme:




Shtetasja Mirlinda Karçanaj thotë: *Nuk futet as në eksperiencë*
 Kjo bisedë ilustrohet me pamjen e mëposhtme:



Shtetasi Ergys Agasi thotë: *E ke bërë gati kallzimin penal për Nardin se ka nxjerr sekretin shtetëror. Mirlinda qesh. Edhe filloi pastaj, e pa situatën si shkoi, filloi pastaj, jo po Nardi kshu, jo po Nardi ashtu, filloi tu shpjegu.*

Më pas shtetasja Mirlinda Karçanaj largohet.



Nga hetimet e kryera rezulton se shtetasja Mirlinda Karçanaj ka në përdorim numrin e telefonit 355692044142 ndërsa shtetasi Ergys Agasi ka në përdorim numrin e telefonit 355696016707. Të dhënat e regjistruara në bazë të komunikimeve në Internet nga numri telefonik 0696016707.

MSISDN	Start Time	Stop Time	Traffic name	IMEI	Cell ID	Cell Name	Cell Region Name
355696016707	17-01-2024 16:01:07	17-01-2024 16:27:41	Office365	351059895672550	25592118	VESA CENTER-NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:27:41	17-01-2024 16:39:03	Google-maps	351059895672550	25592098	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:27:41	17-01-2024 18:26:27	Gmail	351059895672550	25592098	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:27:41	17-01-2024 21:04:39	Generic internet traffic	351059895672550	25592098	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:27:41	17-01-2024 21:04:39	Generic internet traffic	351059895672550	25592098	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:27:41	17-01-2024 21:04:39	Generic internet traffic	351059895672550	25592098	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:27:41	17-01-2024 21:04:39	iCloud	351059895672550	25592098	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:27:41	17-01-2024 21:04:39	WhatsApp Messenger	351059895672550	25592098	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:27:41	17-01-2024 21:04:39	Whatsapp Calls	351059895672550	25592098	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:27:41	17-01-2024 21:04:39	Facebook	351059895672550	25592098	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:27:41	17-01-2024 21:04:39	Instagram	351059895672550	25592098	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:39:03	17-01-2024 16:47:30	Generic internet traffic	351059895672550	25592108	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:39:03	17-01-2024 16:47:30	Generic internet traffic	351059895672550	25592108	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:39:03	17-01-2024 16:47:30	Generic internet traffic	351059895672550	25592108	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:39:03	17-01-2024 16:47:30	Generic internet traffic	351059895672550	25592108	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:39:03	17-01-2024 16:47:30	Snapchat	351059895672550	25592108	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:39:03	17-01-2024 16:47:30	Facebook	351059895672550	25592108	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:39:03	17-01-2024 16:47:30	Instagram	351059895672550	25592108	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:39:03	17-01-2024 16:47:30	TikTok	351059895672550	25592108	VESA CENTER- NW	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:47:30	17-01-2024 17:33:10	Generic internet traffic	351059895672550	25493892	SAMI FRASHERI STR -SE	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:47:30	17-01-2024 17:33:10	Generic internet traffic	351059895672550	25493892	SAMI FRASHERI STR -SE	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:47:30	17-01-2024 17:33:10	Generic internet traffic	351059895672550	25493892	SAMI FRASHERI STR -SE	TIRANE
355696016707	17-01-2024 16:47:30	17-01-2024 17:33:10	Generic internet traffic	351059895672550	25493892	SAMI FRASHERI STR -SE	TIRANE

355696016 707	17-01-2024 16:47:30	17-01-2024 17:33:10	Gmail	35105989567 2550	254938 92	SAMI FRASHERI STR -SE	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 16:47:30	17-01-2024 17:33:10	Google-maps	35105989567 2550	254938 92	SAMI FRASHERI STR -SE	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 16:47:30	17-01-2024 17:33:10	Office365	35105989567 2550	254938 92	SAMI FRASHERI STR -SE	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 16:47:30	17-01-2024 17:33:10	Google-drive	35105989567 2550	254938 92	SAMI FRASHERI STR -SE	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 16:47:30	17-01-2024 17:33:10	iCloud	35105989567 2550	254938 92	SAMI FRASHERI STR -SE	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 16:47:30	17-01-2024 17:33:10	Youtube	35105989567 2550	254938 92	SAMI FRASHERI STR -SE	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 16:47:30	17-01-2024 17:33:10	WhatsApp Messenger	35105989567 2550	254938 92	SAMI FRASHERI STR -SE	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 16:47:30	17-01-2024 17:33:10	Whatsapp Calls	35105989567 2550	254938 92	SAMI FRASHERI STR -SE	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 16:47:30	17-01-2024 17:33:10	Facebook	35105989567 2550	254938 92	SAMI FRASHERI STR -SE	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 16:47:30	17-01-2024 17:33:10	Instagram	35105989567 2550	254938 92	SAMI FRASHERI STR -SE	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 16:47:30	17-01-2024 17:33:10	TikTok	35105989567 2550	254938 92	SAMI FRASHERI STR -SE	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 17:33:10	17-01-2024 17:43:20	Generic internet traffic	35105989567 2550	255921 98	VESA CENTER- NW	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 17:33:10	17-01-2024 17:43:20	Generic internet traffic	35105989567 2550	255921 98	VESA CENTER- NW	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 17:33:10	17-01-2024 17:43:20	Generic internet traffic	35105989567 2550	255921 98	VESA CENTER- NW	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 17:33:10	17-01-2024 17:43:20	iCloud	35105989567 2550	255921 98	VESA CENTER- NW	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 17:33:10	17-01-2024 17:43:20	WhatsApp Messenger	35105989567 2550	255921 98	VESA CENTER- NW	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 17:33:10	17-01-2024 17:43:20	Facebook	35105989567 2550	255921 98	VESA CENTER- NW	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 17:33:10	17-01-2024 17:43:20	Instagram	35105989567 2550	255921 98	VESA CENTER- NW	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 17:33:10	17-01-2024 17:43:20	TikTok	35105989567 2550	255921 98	VESA CENTER- NW	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 17:43:20	17-01-2024 18:07:19	Instagram	35105989567 2550	255921 98	VESA CENTER- NW	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 18:07:19	17-01-2024 18:26:27	Google-drive	35105989567 2550	255920 98	VESA CENTER- NW	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 18:07:19	17-01-2024 18:26:27	Youtube	35105989567 2550	255920 98	VESA CENTER- NW	TIRA NE
355696016 707	17-01-2024 18:07:19	17-01-2024 18:26:27	Instagram	35105989567 2550	255920 98	VESA CENTER- NW	TIRA NE


Të dhënat e regjistruara në bazë të komunikimeve në Internet nga numri telefonik 355692044142

MSISDN	Start Time	Stop Time	Traffic name	IMEI	Cell ID	Cell Name	Cell Region Name
355692044 142	17-01-2024 16:55:13	17-01-2024 17:55:13	Generic internet traffic	359779347902 550	25592 198	VESA CENTER- NW	TIRANE
355692044 142	17-01-2024 16:55:13	17-01-2024 17:55:13	Generic internet traffic	359779347902 550	25592 198	VESA CENTER- NW	TIRANE

355692044 142	17-01-2024 16:55:13	17-01-2024 17:55:13	Generic internet traffic	359779347902 550	25592 198	VESA CENTER- NW	TIRANE
355692044 142	17-01-2024 16:55:13	17-01-2024 17:55:13	Gmail	359779347902 550	25592 198	VESA CENTER- NW	TIRANE
355692044 142	17-01-2024 16:55:13	17-01-2024 17:55:13	Outlook	359779347902 550	25592 198	VESA CENTER- NW	TIRANE
355692044 142	17-01-2024 16:55:13	17-01-2024 17:55:13	Google-maps	359779347902 550	25592 198	VESA CENTER- NW	TIRANE
355692044 142	17-01-2024 16:55:13	17-01-2024 17:55:13	MS Teams Skype SkypeVoip	359779347902 550	25592 198	VESA CENTER- NW	TIRANE
355692044 142	17-01-2024 16:55:13	17-01-2024 17:55:13	Office365	359779347902 550	25592 198	VESA CENTER- NW	TIRANE
355692044 142	17-01-2024 16:55:13	17-01-2024 17:55:13	iCloud	359779347902 550	25592 198	VESA CENTER- NW	TIRANE
355692044 142	17-01-2024 16:55:13	17-01-2024 17:55:13	WhatsApp Messenger	359779347902 550	25592 198	VESA CENTER- NW	TIRANE
355692044 142	17-01-2024 16:55:13	17-01-2024 17:55:13	Whatsapp Calls	359779347902 550	25592 198	VESA CENTER- NW	TIRANE
355692044 142	17-01-2024 16:55:17	17-01-2024 17:55:17	Generic internet traffic	359779347902 550	25592 198	VESA CENTER- NW	TIRANE

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se më datë 17.01.2024, nga ora 16:55 deri në orën 17:55 numri telefonik 355692044142 regjistruar në emër të shtetases Mirlinda Karçanaj të ketë qenë fizikisht në hapësirën territoriale të mbuluar nga “qeliza” e emërtuar “Vesa Center – NW”. Gjithashtu, në të njëjtën datë nga ora 16:01 deri në orën 18:26 edhe numri telefonik 355696016707 regjistruar në emër të shtetasit Ergys Agasi ka qenë fizikisht në hapësirën territoriale të mbuluar nga e njëjta qelizë e emërtuar “Vesa Center – NW”. NW nënkupton Northwest që do të thotë Veri-Perëndim.

Nga këqyrja e hartës së Tiranës, e cila gjendet në Internet në adresën www.google.com/maps, rezulton se Vesa Center gjendet në rrugën “Abdyl Frashëri”, në afërsi të kryqëzimit me rrugën “Vaso Pasha”. Zyrat e subjektit “EA Tobacco” rezultojnë se ndodhen në Rr. “Ismail Qemali” në afërsi të bar restorant “ERA”. Këto vendndodhje paraqiten me pamjen e mëposhtme:



Pra rezultot se këto zyra ndodhen pikërisht në pjesën veri-perëndimore, marrë në raport me vendndodhjen e Vesa Center. Sa më sipër, konkludohet që shtetasi Ergys Agasi dhe Mirlinda Karçanaj brenda harkut kohor të orës 16:55 deri në orën 17:55 të datës 17.01.2024 kanë qenë në afërsi me njëri – tjetrin.

Nga analiza e të dhënave të qelizave të numrit 355699276247, regjistruar në emër të shtetases Mirlinda Karçanaj, rezulton se ky numër ka patur vendndodhje në hapësirën territoriale të qelizës me emërtimin "Vesa Center – NW" më datë 26.01.2024, në harkun kohor 14:56 deri në orën 15:01. Ndërkohë që numri 355696016707 në emër të shtetasis Ergys Agasi, rezulton në të njëjtën qelize më datë 26.01.2024, në periudhën kohore 14:27 deri në orën 15:27. Këto të dhëna janë të regjistruara në sistemet e "Vodafone Albania" sha, sipas tabelave të mëposhtme:

Numri 355699276247

MSISDN	Start Time	Stop Time	SID name	IMEI	Cell ID	Cell Name	Cell Region Name
355699276247	26-01-2024 14:56:12	26-01-2024 14:58:14	Facebook	354466596352480	25592098	VESA CENTER-NW	TIRANE
355699276247	26-01-2024 14:56:12	26-01-2024 14:58:14	Instagram	354466596352480	25592098	VESA CENTER- NW	TIRANE
355699276247	26-01-2024 14:56:12	26-01-2024 15:01:13	Generic internet traffic	354466596352480	25592098	VESA CENTER- NW	TIRANE
355699276247	26-01-2024 14:56:12	26-01-2024 15:01:13	Generic internet traffic	354466596352480	25592098	VESA CENTER- NW	TIRANE
355699276247	26-01-2024 14:56:12	26-01-2024 15:01:13	Generic internet traffic	354466596352480	25592098	VESA CENTER- NW	TIRANE
355699276247	26-01-2024 14:56:12	26-01-2024 15:01:13	WhatsApp Messenger	354466596352480	25592098	VESA CENTER- NW	TIRANE
355699276247	26-01-2024 14:58:14	26-01-2024 15:01:13	iMessage	354466596352480	25592098	VESA CENTER- NW	TIRANE

Numri 355696016707

3556960167 07	26-01-2024 14:27:41	26-01-2024 15:27:41	Generic internet traffic	351059895672 550	255920 98	VESA CENTER- NW	TIRAN E
3556960167 07	26-01-2024 14:27:41	26-01-2024 15:27:41	Generic internet traffic	351059895672 550	255920 98	VESA CENTER- NW	TIRAN E
3556960167 07	26-01-2024 14:27:41	26-01-2024 15:27:41	Generic internet traffic	351059895672 550	255920 98	VESA CENTER- NW	TIRAN E
3556960167 07	26-01-2024 14:27:41	26-01-2024 15:27:41	iMessage	351059895672 550	255920 98	VESA CENTER- NW	TIRAN E

Këto fakte dokumentohen me shkresën nr. 29508, datë 01.09.2025, drejtuar "Vodafone Albania" sha, përgjigjen e kthyer me shkresën nr. FRS/1986/NC, datë 09.09.2025 dhe procesverbalin e këqyrjes së

me datë 21.10.2025, sipas Vendimit të Këqyrjes me nr. 37056, datë 17.10.2025.

Nga këto mazhe video dhe audio konstatohet se, shtetasja Mirlinda Karçanaj shfaqet në zyrën e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, shtetasi Ergys Agasi më datë 17.01.2024 dhe 16.03.2024. Më datë 06.04.2025, në takim shfaqet dhe shtetasi Ermal Beqiri.

Nga këqytja e pamjeve filmike, arsyeshëm krijohet bindja mbi lidhjeve me interes që kanë këta shtetas me njëri-tjetrin, e cila, nga analizimi i përmbajtjes së bisedave të transkriptuara, krijon dyshimin e arsyeshëm mbi realizimin e një skemë kriminale në funksion të paracaktimit të procedurave të prokurimit, krijimit të avantazheve dhe përfitimit të paligjshëm prej tyre. Kjo vihet re dhe ne disa nga bisedat e kryera ku diskutohen çështje si *“projekti bën 2 milion, ne do ta bëjmë 4”* ose *“Nuk futet as në eksperiencë”* të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin e kriterëve të procedurave të prokurimit, vlerave të kontratave që do të publikohen, etj.

Gjithashtu, në vijim të kryerjes së veprimeve hetimore, më datë 22.09.2025 është paraqitur në ambientet e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, shtetasi Gerond Meçe, i cili ka deklaruar se:

“Ka profesionin inxhinier elektronik dhe aktualisht punon me biznes privat. Mamaja e tij në vitin 2002 ka hapur një kompani private të cilës i është bashkuar në korrik të vitit 2003. Nga viti 2006 e në vijim është bërë ortak i vetëm dhe administrator i kompanisë që është kompania “Advanced Business Solutions - ABS” me numër NIPT K21710002J. Nga viti 2020, për arsye shëndetsore u tërhoq nga administrimi dhe ka caktuar dy administratorë të tjerë, Eriksela Shuli dhe Shkëlqim Kërlluku, të cilët vijnë në të jenë edhe aktualisht. Nga muaji shkurt i vitit 2025 i ka kaluar aksionet e kompanisë “ABS” te mamaja e tij, për arsye që mos të kishte probleme apo pengesa në prokurime të ndryshme. Kompania “ABS” ka aktivitet kryesor ofrimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit, punon edhe me sektorin privat edhe me sektorin shtetëror. Që nga vitit 2016, pothuajse çdo tender në fushën e teknologjisë dhe informacionit zhvillohet nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) me pak përjashtime, si p.sh ato tenderime që kanë të bëjnë me fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, pra ato të Ministrisë së Mbrojtjes, SHISH, disa të Ministrisë së Brendshme, si dhe institucionet e pavarura.

Lidhur me këto tenderime apo procedura, bën me dije se së fundmi dhe konkretisht nga janari i vitit 2025 e deri në korrik 2025 kompania “ABS” është ankimuar në gati 20 procedura prokurimi në të cilat ka marrë pjesë, kryesisht AKSHI por edhe institucione të tjera si KLGJ, UKT etj. I kujtohet se disa nga këto procedura janë “Ndihma ekanomike”, që është procedurë për software dhe hardware për sigurimet shoqërore, “Biletimi/Ticket” që është sistemi i menaxhimit të biletave për muzetë, “Software për policinë” që ka të bëjë me menaxhimin ekonomik të programit për policinë e shtetit, “Update dhe mirëmbajtja e software të menaxhimit të thesarit të shtetit”, “Menaxhimi për çështjet gjyqësore”, dy procedura të Ministrisë së Brendshme, dy procedura të Ministrisë së Bujqësisë, dy procedura të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Këto procedura të ankimuara mund të aksesohen edhe në faqen e APP dhe të KPP, Komisionit të Prokurimeve Publike.

Lidhur me këto, deklaruesi pohon se me datë 12 gusht 2025 ka qenë në shtëpi deri rreth orës 10:30 paradite, për shkak të një bisede telefonike pune, më pas ka dalë nga banesa e tij, ka patur me vete çantën e punës e markës MontBlanc ngjyrë e zezë (pak e dëmtuar te doreza) me laptop Lenovo brenda ,

Si the një çantë dorë po e markës MantBlanc, ngjyrë e zezë, në të cilën kishte brenda dy palë çelësa makine, me titi Sange me targë AA695SF dhe mjetit Hyundai me targë AB028LB (makina në pronësi të personit të parë), çelësat e zyrës e të shtëpisë, një mbajtëse kartash krediti, si dhe aparatit celular me titi Samsung Galaxy, model S24, mbajtës i numrit 0682077717. Kur ka dalë nga pallati ku banon, ka hapur bagazhin e makinës së tij që ka qenë e parkuar në krah të pallatit, konkretisht përballë shënimeve "Marka KEN", makinë e tipit Hyundai me targë AB028LB. Në atë vend janë disa poste policie dhe ngjitur ndodhet muri rrethues i një biznesi, Autoservis Lavazh.

Ka hapur nga distanca bagazhin e makinës, ka vendosur çantën e shpinës dhe çantën e dorës në bagazh dhe në atë moment është afruar një automjet fuoristradë Range Defender, ngjyrë e zezë, me titi policie, me targa shqiptare, të cilat në ato momente nuk i ka fiksuar por më vonë ka parë që titi e këtij automjeti janë AC121JJ. Ndërkohë që makina ka lëvizur drejt tij, ai ka fiksuar një person kishte makinës i cili e ka thirrur në emër Geront Meçe. Ky person kishte këto karakteristika: i gjatë rreth 175cm, me trup mesatar, me flokë të zeza e të drejta të shtrira poshtë, pa mjekër, i veshur me uniformë ngjyrë blu me krah të gjatë, si dhe jelek ngjyrë e verdhe me mbishkrim BKH (Byroja Kombëtare e Hetimit). Nuk ka dalluar shenja të veçanta në pamjen vizuale të tij. Ky person i thotë: "Jemi SPAK-u, duhet të vish me ne, hyr në makinë". Në atë moment ka besuar që është SPAK dhe është bindur pa krijuar pakënaqësi apo rezistencë për shkak se ishte në oborrin e pallatit të tij. Në këtë moment nga dera mbrapa ka dalë një person i dytë i cili i ka hapur vendin për t'u futur brenda, nuk ka qenë as ky i maskuar në fytyrë por ishte pak si i shëndoshë, veshur me bluzë si ato të policisë, sipas perceptimit të deklartuesit. Më pas ka parë brenda në makinë që ky person ka patur të veshura xhinse të zeza. Në momentin kur e ka thirrur në emër personi i parë, deklartuesi ka shtypur butonin e bagazhit të makinës i cili automatikisht ka filluar të mbyllet. Në këtë kohë kur po mbyllej bagazhi, është futur te sedilja mbrapa në mes e automjetit Defender. Në atë moment ka hyrë edhe personi i tretë në makinë nga krah i majtë i tij, i cili kishte veshje të njëjtë me personin e dytë, me xhinse të zeza dhe me bluzë si ato të policisë, i shëndoshë por pa maskë, fytyrë e rrumbullakët, të cilin është në gjendje ta identifikojë lehtësisht. Dy personat që kanë qenë mbrapa me Gerondin (personi dy dhe personi tre) kanë qenë me tatuazhe, personi i dytë ka patur tatuazh në pjesën e jashtme të dorës së djathtë, midis gishtit të madh dhe gishtit tregues, tatuazh me formë si ajo e garmës "b" në krahun e kundërt, e pambyllur plotësisht dhe diku nga mesi kishte një pikë. Personi i tretë, në parakrahun e dorës së majtë ka komplet parakrahun tatuazh bardh e zi. Ka dëgjuar që shoferi, i cili ishte me maskë, i flet personit të parë duke i kërkuar që të merrte dy çantat e Gerondit nga bagazhi i makinës. Ky merr çantat e i fut në makinë. Pasi futen brenda, deklartuesi i ka pyetur: - Keni ndonjë letër, ju lutem ma jepni? Personi i parë që ishte në vendin e pasagjerit para, i thotë je është arrestuar dhe i thotë personit të dytë (në të djathtën e Gerondit) t'i vërë prangat. Deklartuesi i kërkon përsëri t'i japin letrat, dhe se duhet të telefonojë në familje. Personi i parë i thotë që letrat do ia japin në komisariat, ndërkohë që makina lëviz për të dalë nga oborri i pallatit. Personat mbrapa tentuan të vënë prangat, por fakti që personi i dytë nuk dinte t'i vinte prangat dhe ka ndërhyrë personi i tretë, ka bërë që deklartuesi të dyshojë që këta nuk ishin punonjës siç u prezantuan.

Në momentin që po vinin prangat deklartuesi u thotë "o çuna unë nuk jam kriminel". Personi i dytë thotë "Ça the ti, ça the, kush është kriminel?!!", ndërkohë që shoferi u thotë vini kapuçin. Kur po dilnin nga parkingu i oborrit ka parë babain e tij dhe në atë moment i kanë vënë kapuçin e zi në kokë. Ka kuptuar që personat nuk janë nga SPAK-u. Makina për punë sekondash ndalon në semafor, deklartuesi mendon që do ecte drejt, ndërkohë që makina devijon majtas i pyet se në cilin komisariat do më çonin. Personi i parë i thotë "në komisariat më të afër". Personat para kishin komunikime me zë të ulët mes

... pasi kupton që lëvizjet e makinës ishin për nga Durrësi duke krijuar bindjen që nuk ishin të vërteta. Ai thotë "Çuna, e mora vesh se çfarë jeni."

Marrin marrë në drejtim të Astirit dhe në ato momente u ka thënë "Çuna, unë jam në moshë dhe kam një krah me zmirrën, kapuçi që kam në kokë më pengon frymëmarrjen". Kur makina fulet në unazë të rrugës kapo kalon Astirin, i heqin kapuçin nga koka, por personi i tretë (në të majtën e tij) mundohet t'ia marrë këken poshtë dhe i mbulonte fytyrën me dorë, por pavarësisht kësaj ai ka parë gjithë itinerarin që kanë përshkruar. Personi i parë (pasagjeri para) i ka kërkuar password-in e telefonit. Gerondi i thotë që do ia japë në komisarariat. Personi i tretë filloi të ushtronte forcë te prangat duke i shtrënguar, pas refuzimit për t'i dhënë password-in. Ata i thonë "ta tregojmë ne, e dimë ne çfarë je ti, hajdut je ti".

Makina ka marrë drejtimin për nga Elbasani, pas unazës së madhe, më pas kanë bërë dalje për në fshatin Krrabë dhe makina ka vijuar rrugën e vjetër të Elbasanit. Gjatë kësaj kohe ata nuk kanë komunikuar. Kur kanë ndaluar, ora në automjet shënonte rreth 11:20, dhe janë gjendur në një vend si shesh i madh "ballkan" afër fshatit Gracen, me pamje nga fshati Papër, pasi deklaruesi pohon se në atë pozicion shikante gjurmën e rrugës së re që po hapet, "Elbasan- Durrës". Në krah të majtë ishte një godinë me tulla të bardha e braktisur, një katëshe, pa dritare, e cila dhe një pemë përtej murit rrethues të rrugës. I kërkojnë të dalë jashtë nga makina dhe vazhdojnë t'i kërkojnë password-in e telefonit. Fillimisht refuzoi t'ua japë dhe në këtë moment vjen shoferi dhe e gadet me shpullë. Marrin telefonin dhe e vendosin te gishti i deklaruesit pasi duart i kishte mbrapa. Personi i tretë i heq prangat nga mbrapa dhe ia vendos përpara. Aty arrijnë të hapin telefonin me gjurmën e gishtit të tij, dhe deklaruesi ka menduar që në atë moment ata e kaluan direkt në airplane mode. Në një moment të mëparshëm, pa u futur akoma në unazë ta madhe, kishte rënë telefoni pa pushim. Kjo i ka dhënë një shpresë që dikush po e kërkonte dhe prandaj nuk kishte pranuar t'u jepte password-in, pasi shpresonte se dikush do e gjente.

Personi i parë (pasagjeri para) thotë që "Po të kërkojmë të bashkëpunosh, jo si me password-in, se në të kundërt ke plumbin në kokë". Ky është edhe momenti ku të tre, përveç shoferit, demonstrojnë armët e shkurta që kishin në brez. Personi i dytë e nxjerr pistoletën nga brezi, e mban në dorë dhe bën veprime duke nxjerrë dhe futur karikatorin, ndërkohë që personi i parë po e mbante pistoletën në dorë duke e kërcënuar "Do bashkëpunosh apo si e ke?". Deklaruesi në këtë moment i thotë "Ore për çfarë të bashkëpunoj?". Personi i parë që ka qenë i veshur me jelek me mbishkrimin BKH (të cilin e ka hequr tashmë) shkon te makina dhe del me një zarf të bardhë në dorë, hap zarfin dhe i jep një letër që kishte një tabelë Excel e i thotë "E njeh këtë letër"?.. I treguan letrën, e cila ka një tabelë ku nga emërtimi kupton që janë të shkruar tenderat për të cilët kompania e tij i ka ankimuar dhe në një kolonë edhe gjendja, situata e tenderit në KPP (Komisioni I Prokurimit Publik). Gjithashtu ka evidentuar në këtë moment ndër të tjera një procedurë e cila ishte e shkruar Gjykata Administrative.

Ata e pyesin "a e kuptove"? Në momentin e parë i thotë jo por ka perceptuar që dikush këtë ngjarje e ka organizuar për shkak të ankimimeve të tij. Në perceptimin e tij në atë moment mund të ishin shtatë deri në nëntë procedura. Personi i parë e pyeti "E kuptove?", ndërkohë që deklaruesi i thotë "Çfarë duhet të kuptoj?". Personi i thotë "Janë tendera që ke ankimuar ti dhe duhet të tërhiqesh. Nuk kemi punë me lekët e tua, ne e dimë që ke lekë, i gëzofsh ato, por s'ke punë te këto procedura dhe do tërhiqesh nga këto procedura". I thotë "Çuna, nuk bëhet kështu kjo punë, sepse edhe po u bërë, u prish punë më shumë juve sesa mua". Ndërkohë Gerondi mundohet t'u mbushë mendjen që nuk bëhet në këtë moment tërheqja duke u sjellë në vëmendje se nuk është më administrator (të cilët i thonë që e dinin) por po u kërkonte kompromis që do ta bënte ditën në vijim nëse e lironin. I është dukur sikur situata po shkonte në favorin e tij, gjithashtu personi i parë i thotë që të tërhiqet edhe nga gjyqi në Gjykatën Administrative. Në këto

momento ndërkohësisht kur personi i parë fliste me deklaruesin, ka parë që shoferi, por dyshon se edhe mund të jetë person tjetër (i pestë) që mund të ketë ardhur aty pranë me makinë tjetër (dyshon makinë Volvo) ku ka komunikuar nga telefoni i tij me administratorin Shkëlqim Kërlluku, dhe i thotë "Po ti na the që nuk është ndërkohë administratori thotë bëhet". Nga ky moment ku Gerondi ka qenë i lidhur me pranga në makinë dhe jo me detyrë, personi dytë dhe tre rrinin roje me të, ndërkohë që shoferi dhe personi i parë kanë qenë diku te godina, dyshon se aty ka qenë një person i pestë i cili ka bashkëvepruar në këtë aktivitet. Gjatë kësaj kohe personi i tretë dhe personi i dytë i heqin rrobat e policisë, ku personi i dytë është me këmishë dhe personi i tretë me bluzë të bardhë. Ky i fundit hoqi edhe maskën.

Personi i tretë në një moment i thotë që "Po të të shoh në Elbasan unë do të të flas, nuk e di për ty por unë do të të flas". Për të arritur qëllimin që kishin, pra tërheqjen e kompanisë nga procedurat, grupi i rrëmbimit ka komunikuar me administratorin me telefonin e tij nëpërmjet aplikacionit whatsapp, si dhe duke ia dhënë edhe Gerondit telefonin here pas here që të komunikonte vetë me administratorin, për shkak se nuk po realizohej qëllimi i tyre për tërheqje. Gjatë kësaj kohe e kanë lejuar të flasë me gruan të cilës i ka thënë që "zemër jam mirë, kam ca punë, do të të marr më vonë". Ndërkohë që telefoni i tij binte pa pushim, afrohet personi numër një dhe i thotë "Fol dhe qetësoje pak këtë personin sepse vazhdon dhe i bie shumë telefonit". Ka parë që ishte numri i vëllait i tij dhe ka folur me të. Vëllai i thotë "Ku je, jam shumë i shqetësuar". Deklaruesi i thotë "Nuk ke pse të shqetësohesh për fol me administratorin, Mimin". Gjatë kohës që ka qëndruar me personin dytë dhe personin tre ka bërë biseda të ndryshme dhe ka mësuar se personi i tretë sapo ishte bërë baba me vajzë ndërkohë që kishin dialekt të theksuar Elbasani, gjë të cilën e kupton shumë mirë pasi është vetë nga Elbasani, pavarësisht faktit që ato mundoheshin ta fshihnin si fakt. Gjithashtu të njëjtën gjë ka konstatuar nga e folura edhe për personin një, që ishte nga Elbasani. Ndërkohë që po prisnim në automjet me personin dytë dhe personin tre ata e pyesin "Sa zgjat kjo procedurë?". Gjithashtu e pyesin edhe personin një "Çfarë po presim?". Personi një u thotë që "s'kemi konfirmim". Përballë ko orën e makinës dhe shënon në këtë moment rreth 15:10. Në një moment tjetër personi i tretë shkan drejt bagazhit të makinës, aty afrohet personi një i cili i thotë që "Në polici nuk ka denoncim".

Rreth orës 16:20 futen në makinë të gjithë në pozicionet siç ishin në fillim dhe marrin rrugën për t'u nisur drejt Elbasanit, në rrugën e vjetër. Këtu pasi i thotë shoferi, i kanë hequr prangat, dhe shoferi i thotë "Po hap sytë, pa shikan ku je". Deklaruesi i thotë "E di shumë mirë se ku jam, se jam nga Elbasani dhe këtu jemi në Gracen". Gjatë rrugës kanë përdorur sirenën e policisë për të parakaluar. Makina futet në drejtim të fshatit Shijon, ndërkohë që personi i parë është duke folur me telefon me dikë i cili i tha që të ndryshojë itinerar e ta kthejnë në rrugën nacionale. Makina u kthye dhe e lanë rreth 200 metra afër rrethrrrotullimit të parë, që futesh për në autostradën Elbasan-Tiranë. Në momentin që po e linin, shoferi i thotë "Nuk dua probleme nga ty, nuk dua denoncime nga ty, në të kundërt do të vrasim ty, grua, motër, nënë, se babë nuk ke ti". I japin mbajtësen e kortave të kreditit dhe syzet e diellit dhe i premtuan se do i sjellin gjërat e tjera te recepsioni i qendrës së biznesit ku ka zyrën, pra çantën e shpinës me laptop Lenovo, çantën e dorës dhe telefonin. Sqaron se këto sende nuk ia kanë sjellë akoma. Ka zbritur dhe ka dalë në rrugë nacionale, është drejtuar drejt rrethrrrotullimit tjetër të Bradasheshit, ku ndodhet karburanti. Rastësisht, duke pritur për makina të rastit apo autobus, ka kaluar një makinë e zyrës së tij me shofer inxhinierin Jorgis Sollaku, i cili kishte qenë për punë në Berat. Nuk i ka treguar asgjë, por e ka sjellë në Tiranë deri te Toptani, ku ka shkuar në zyrën e tij. Aty ka marrë vesh që familja kishte kuptuar që ai mund të ishte rrëmbyer dhe po prisnin orën 18:00 për të bërë denoncim, pasi kishin shkëputur kontaktet që nga ora 15:00.

... babai i tij ka shkuar në shtëpi dhe i ka thënë gruas dhe nënës "Më duket që Gerin e ka marrë". Grua ka filluar dhe ka tentuar që ta marrë në telefon. Pastaj babai ka njoftuar vëllain, i cili ka vërtetuar dhe ka parë pamjet filmike të ngjarjes, të cilat i ka marrë në USB dhe ka identifikuar llogarinë e mailit. Më pas vëllai ka shkuar në të gjitha komisarariatet e policisë për të pyetur nëse ishte i shqyrtuar. Ka shkuar edhe në SPAK për të pyetur për shqyrtimin apo ndalimin e tij, dhe për shkak se nuk ka marrë asnjë informacion ka dyshuar në rrëmbimin e Gerondit, duke i rënë telefonit të tij pa pushim.

Është kthyer në zyrë dhe ka mësuar se ishte bërë tërheqje për më shumë procedura se ato që i tregoi në tabelë Excel grupi që e mori në makinë. Administratori Shkëlqim Kërlluku ka hartuar dokumentet e tërheqjes dhe ka shkuar t'i çojë dorazi në KPP dhe në AKSHI, por nuk janë pranuar nga KPP sepse nuk është procedurë. Për këtë arsye është detyruar në vijim që të bëjë tërheqje nga sistemi e cila që ka përfunduar rreth orës 15:00 të datës 12.08.2025. Ka dyshime se grupi që e mori peng, e liroi rreth orës 16:20 të datës 12.08.2025 pasi mori kanfirmim për tërheqjet e depozituara nga kompania në sistem të KPP. Këtë dyshim e lidh me faktin se nga eksperiencia e tij në këtë fushë, ata duhet të kenë një autoritet apo lidhje brenda KPP i cili ka aftësinë dhe kompetencën për ta verifikuar. Dyshon se ky person quhet Kreshnik Tërnova, me detyrë anëtar i KPP. Këtë dyshim e lidh me faktin se Kreshnik Tërnova ka lidhje me shtetasin Ermal Beqiri dhe janë parë bashkë te restorant "Markata e Peshkut", te Pazarit i Ri. Ka shumë procedura që dhe kur KPP i ka dhënë të drejtë, anëtari i KPP Kreshnik Tërnova ka qënë kundër në minorancë. Thekson dhe një rast të një procedure lidhur me mirëmbajtjen e sistemit të kamerave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ku ky anëtar në mbledhjen ballafaquese midis KPP dhe kompanisë ankimuese, i është drejtuar Autoritetit Praturues që ta klasifikojë si tender i klasifikuar, gjë e cila ishte drejtpërdrejte me qëllim për të nxjerrë jashtë loje kompaninë e tyre.

Shton se të nesërmen e rrëmbimit shoqëria "ABS" ka bërë kërkesë për pezullimin e "njoftimit të tërheqjes" pranë KPP dhe AKSHI me argumentimin se janë hakëruar një ditë më parë. Pavarësisht se kanë kërkuar pezullimin e "njoftimit të tërheqjes", KPP në kundërshtim me ligjin ka marrë vendim po në datë 13 gusht 2025, për mospranimin e pezullimit "të njoftimit të tërheqjes", pavarësisht se nuk ka pasur kohë që ta fuste në rend dite, pra ta përgatisë 24 orë përpara. Më pas kompanisë i ka ardhur njoftimi, ku firma elektronike është bërë në datë 15 gusht dhe jo në datë 13 gusht, si dhe në bazë të ligjit KPP vihet në lëvizje me kërkesë për tërheqje dhe jo me njoftim për tërheqje, si në rastin e tyre. Çdo procedurë e tij e ankimuar në KPP, zgjat më shumë se dy muaj, dhe mendon se bëhet qëllimisht pasi asnjë procedurë nga aplikantët e tjerë nuk zgjat kaq shumë.

Dyshon se personi që ka organizuar rrëmbimin është shtetasi Ermal Beqiri. Arsyeja pse e thotë me bindje është sepse pas çdo procedure të tillë qëndron një nga kompanitë e tij ose kompani që janë të lidhura me të. Këtë bindje e forcon me faktin se diku nga periudha prill-qershor 2024, administratorja e firmës "Soft&Solution" e Ermal Beqirit i ka shkuar në ambientet e kompanisë dhe ka kërkuar të takohet me të. Pasi e njoftuan kush është, ka refuzuar ta takojë pasi ishte kompani e lakuar në treg për shumë procedura. Në dhjetor të 2023, shtetasi Gent Progni ka dalë në media duke e akuzuar se "ABS" bashkëpunon me "Soft&Solution", "Comunication progres", "Fastech" etj. Duke qënë se deri në atë moment s'ka patur asnjë lloj kontakti me këto kompani preferoi të mos e takonte administratorin. Në momentin që stafi i tij ka komunikuar që nuk do e takojë, ajo në dalje e sipër ka thënë që "kështu do të vazhdoni ju të bashkëpunoni me ne". Pas kësaj kanë filluar problematikat e kompanisë lidhur me bllokimin e procedurave me AKSHI. Këtu përmend një procedurë me Hardware e AKSHI, që është futur bashkë me kompaninë InfoSoft, e cila u zhvillua dy herë dhe u anulua pa shkaqe të arsyeshme. Kur

Sot u fut herës në këtë vetëm, u shpall fitues. Pas këtij momenti fillon edhe historia e ankimimeve që u bë edhe sipas rrëmbimit.

Në kohën e rrëmbimit ka dëgjuar nga rrëmbyesit që nuk është bërë denoncim në polici. Vendosi të bëjë rrëmbimin e njoftimit të tërheqjes nga ankimimet dhe arsyetja e mos bërjes së denoncimit në polici lidhet me faktin që nëndrejtori i Policisë së Tiranës, Erion Ismaili, kohë më parë nëpërmjet një personi që për momentin nuk i kujtohet, në janar-shkurt 2025 i kishte kërkuar që të qëndronte sa më larg nga AKSHI. Rastësisht, postieri i zonës në rrugën e RTSH rreth muajve prill-maj 2025, duhet të dërgonte një letër një kompanie sigurimesh të ABA Tower dhe ndërkohë që letrën ja refuzojnë atje, postieri e merr në telefon e i thotë që ka një letër për të. Zarfi ishte i hapur dhe kishte një letër brenda ku Prokuroria e Tiranës kërkonte informacion bankar dhe informacion nga sigurimet për të dhe familjen e tij. Kësaj shkresë i ka bërë një foto dhe ja ka kthyer postierit pasi letra i drejtohej një kompanie sigurimesh të ABA Tower. Më pas është interesuar dhe ka marrë vesh që kjo praktikë hetimore ishte iniciuar nga Erion Ismaili, që ishte nëndrejtor i Policisë së Tiranës. Është në dispozicion të hetimeve, gjithashtu do të sjellë të gjitha materialet që disponon, ndër të tjera pamjet filmike nga rrëmbimi i tij.

Në kuadër të hetimit me procesverbalin e sekuestrimit të datës 26.09.2025, u administruan pamjet filmike të regjistruara nga kamerat, të cilat janë ruajtur në një pajisje memorie të jashtme të vënë në dispozicion nga shtetasi Gerond Meçe. Nga këqyrja e tyre konstatohet se njëra nga kamerat regjistron pamje në një rrugë kalimi mjeteshe, një trotuar dhe në krahun tjetër disa automjete të parkuara. Pamjet video janë të shoqëruara dhe me datën dhe orën e regjistrimit të cilat janë të shfaqura në pjesën majtas lart të ekranit. Në momentin e fillimit të pamjeve video konstatohet data 08.12.2025 dhe ora 07:38:08. Në pjesën e poshtme të ekranit konstatohet numri i kamerës regjistruese e cila emërtohet "Camera 03". Të dhënat e këqyrura ilustrohen me pamjen si më poshtë:



Në orën 08:49:16 sipas kamerës, konstatohet duke u parkuar një automjet ngjyrë e zezë, i markës

Land Rover Defender me targë "AC121JF".

Pamja ilustruese:



Në orën 10:41:00 referuar kamerës, vijon të konstatohet i parkuar automjeti ngjyrë e zezë, i markës Land Rover Defender me targë "AC121JF". Pamja ilustruese:



Në orën 10:41:11 sipas kamerës, shfaqet një person i ngjashëm me shtetasin Gerond Meçe, i cili ka të veshur një bluzë me ngjyrë të kaltër, pantallona ngjyrë të zezë, mban një çantë të zezë në dorë dhe një çantë të zezë në shpinë, afrohet te një nga automjetet e parkuara dhe hap bagazhin nga distanca.

Pamja e kamerës



Në orën 10:41:47 sipas kamerës, automjeti i parkuar me targë "AC121JJ" lëviz dhe afrohet drejt personit të ngjashëm me shtetasin Gerond Meçe, i cili ka hapur bagazhin e mjetit të tij. Automjeti ndalon dhe zbresin katër persona.

Pamjet si më poshtë:




Nga pamjet filmike në orën 10:41:52 konstatohet që këta persona hipin përsëri në automjet.

Pamjet si më poshtë:



Në orën 10:42:05 automjeti me targë "AC121JJ" fillon të lëvizë dhe largohet pasi ka marrë me vete edhe shtetasin (person i ngjashëm me shtetasin Gerond Meçe).

Pamjet si më poshtë:



Nga pamjet filmike të kamerës së pozicionuar në një vendndodhje tjetër konstatohet një rrugë kalimi mjetesh, një trotuar dhe në krahun tjetër disa automjete të parkuara. Pamjet video janë të shoqëruara dhe me datën dhe orën e regjistrimit të cilat janë të shfaqura në pjesën majtas lart të ekranit. Në momentin e fillimit të pamjeve video konstatohet data 08.12.2025 dhe ora 07:30:02. Në pjesën e poshtme të ekranit konstatohet numri i kamerës regjistruese e cila emërtohet "Camera 08". Të dhënat e këqyrura ilustrohen me pamjen si më poshtë:



Në orën 10:41:23 sipas kamerës, shfaqet një person i ngjashëm me shtetasin Gerond Meçe, i cili ka të veshur një bluzë me ngjyrë të kaltër, pantallona ngjyrë të zezë, mban një çantë të zezë në dorë dhe një çantë të zezë në shpinë, i cili afrohet te një nga automjetet e parkuara dhe hap bagazhin nga distanca. Pamja ilustruese:



Në orën 10:41:38 sipas kamerës, afrohet një automjet ngjyrë e zezë, i markës Land Rover Defender me targë "AC121JJ". Në pjesën balllore sipër targës të automjetit dhe në pjesën e brendshme të xhamit të parë konstatohen drita ndriçuese urgjence sinjalizuese, në dukje si ato të policisë së shtetit. Pamja ilustruese si më poshtë:



Automjeti ndalon dhe nga ky mjet zbresin katër persona. Konkretisht:

Në orën 10:41:42 sipas kamerës, nga ana e pasagjerit përpara zbret fillimisht një person i cili mban kapele të zezë dhe një jelek fosforeshent me mbishkrim BKH. Pamja si më poshtë:




Nga dera e pasme e krahut të shoferit një person i dytë i cili mban kapele të zezë, bluzë me krahë të shkurtra me ngjyrë të bardhë dhe një jelek të ngjashëm me ato të policisë së shtetit, me mbishkrim POLICIA. Në këtë moment del dhe shoferi i cili mban maskë të zezë në fytyrë, syze të zeza, kapele të zezë, xhinse ngjyrë blu, atlete të zeza, si dhe një jelek të ngjashëm me ato të policisë së shtetit me mbishkrim POLICIA. Pamjet ilustruese si më poshtë:





Nga pamjet filmike konstatohet që këta persona hipin përsëri në automjet dhe konkretisht në orën 10:41:53, personi i dytë që doli nga dera prapa shoferit, futet në automjet. Pamjet ilustruese si më poshtë:



Në orën 10:41:55 konstatohet se nga dera e pasme nga krahu i pasagjerit, futet në makinë personi i ngjashëm me shtetasin Geront Meçe. Pamjet ilustruese si më poshtë:



Në orën 10:41:57 në automjet futet dhe shoferi. Pamjet ilustruese si më poshtë:



Personi i fundit që hipën në automjet në orën 10:41:58 mban një kapele të zezë dhe hipën në sediljen

e pasme të krahut të pasagjerit. Pamjet si më poshtë:



Në orën 10:42:13 automjeti me targë "AC121JJ" fillon të lëvizë ,pasi ka marrë me vete edhe shtetasin (i ngjashëm me shtetasin Gerond Meçe), i cili ka të veshur një bluzë me ngjyrë të kaltër dhe pantallona ngjyrë të zezë, sipas përshkrimit më lart.

Pamjet si më poshtë:



Në orën 10 e 42 minuta e 25 sekonda, automjeti largohet.



Nga një tjetër kamera, pozicionuar në një vendndodhje tjetër, konstatohet një rrugë kalimi mjetesh, një trotuar dhe në krahun tjetër disa automjete të parkuara. Pamjet video janë të shoqëruara dhe me datën dhe orën e regjistrimit të cilat janë të shfaqura në pjesën majtas lart të ekranit. Në momentin e fillimit të

pamjeve video konstatohet data 08.12.2025 dhe ora 08:37:21. Në pjesën e poshtme të ekranit konstatohet numri i kamerës regjistruese e cila emërohet "Camera 15".

Të dhënat e këqyrura ilustrohen me pamjen si më poshtë:



Në orën 10:41:24 sipas kamerës, shfaqet një person i ngjashëm me shtetasin Gerond Meçe, i cili ka të veshur një bluzë me ngjyrë të kaltër, pantallona ngjyrë të zezë, mban një çantë të zezë në dorë dhe një çantë të zezë në shpinë, i cili afrohet te një nga automjetet e parkuara dhe hap bagazhin nga distanca. Pamja ilustruese:



Në orën 10:41:39 sipas kamerës, afrohet një automjet ngjyrë e zezë, i markës Land Rover Defender me targë "AC121JJ". Në pjesën ballore sipër targës të automjetit dhe në pjesën e brendshme të xhamit të parë konstatohen drita ndriçuese urgjence sinjalizuese, në dukje si ato të policisë së shtetit. Pamja ilustruese si më poshtë:




Automjeti ndalon dhe në orën 10:41:44 sipas kamerës, nga ky mjet zbresin katër persona konkretisht: nga ana e pasagjerit përpara zbret fillimisht një person i cili mban kapele të zezë dhe një jelek fosforeshent me mbishkrim BKH.

Pamja si më poshtë:



Në orën 10:41:48 sipas kamerës, nga dera e pasme e krahut të shoferit zbret një person i dytë i cili ka kapele të zezë, bluzë me krahë të shkurtra me ngjyrë të bardhë dhe një jelek të ngjashëm me ato të policisë së shtetit, me mbishkrim POLICIA. Në këtë moment del dhe shoferi i cili mban maskë të zezë në fytyrë, syze të zeza, kapele të zezë si dhe një jelek të ngjashëm me ato të policisë së shtetit me mbishkrim POLICIA.

Pamjet ilustruese si më poshtë:



Në orën 10:41:55 konstatohet se nga dera e pasme nga krahu i pasagjerit, futet në makinë personi i ngjashëm me shtetasin Gerond Meçe.

Pamjet ilustruese si më poshtë:



Nga pamjet filmike konstatohet që këta persona hipin përsëri në automjet. Personi i fundit që hipën në automjet në orën 10:41:57, mban një kapele të zezë si dhe një jelek të ngjashëm me ato të policisë së shtetit, me mbishkrim POLICIA. Ai hipën në sediljen e pasme të krahut të pasagjerit. Pamjet ilustruese si më poshtë:



Në orën 10:42:13, automjeti me targë "AC121JJ" fillon të lëvizë, pasi ka marrë me vete edhe shtetasin (i ngjashëm me shtetasin Gerond Meçe).

Pamjet si më poshtë:




Gjithashtu me procesverbalin e sekuestrimit, u administrua aparati telefonik i administratorit të subjektit "ABS" sh.p.k, Shkëlqim Kërluku, i cili është vënë në dispozicion të hetimit nga shtetasi Gerond Meçe. Nga këqyrja e të dhënave të ruajtura evidentohet se ndër aplikacionet në këtë aparat konstatohet ai i "Whatsapp", i cili klikohet me prekje dhe në ekran shfaqen të dhënat e ruajtura brenda aplikacionit. Ndër këto të dhëna vihen re komunikime të kryera me kontaktin "Geri Abs". Në këto komunikime vihet re se

me datë 12.08.2025 nga ky përdorues vjen një foto e cila përmban një tabelë ku shënohen 7 procedura prokurimi si më poshtë:

1. Biletimi qendror Online për Muzetë dhe Sitet e Trashëgimisë Kulturore (Proces shqyrtimi)
2. Loti 6 – Kompjutera (Proces Shqyrtimi)
3. Përmirësimi dhe Integrimi i Sistemeve të Menaxhimit të Informacionit për Ndihmën Ekonomike, Personat me aftësi të kufizuar dhe Shërbimit Social (Proces Shqyrtimi)
4. Përmirësimi i sistemit financiar dhe inventarizues për Policinë e Shtetit – për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë. (Refuzuar – Ankim Gjykatë)
5. Përmirësimi i Sistemit të Thesarit. (Proces Shqyrtimi)
6. “Sistem Enterprise Service Bus (ESB)” (Proces Shqyrtimi)
7. Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) (Proces Shqyrtimi)

Kjo tabelë ilustronet me pamjet e mëposhtme, të përftuara nga ekrani i aparatit telefonik:



NR	Objekti i tenderit	Procesi / Veprimi
1	Elektronizimi Online për Muzetë dhe Sitet Historike Kulturore, Përmirësimi i Sistemit të Biletimit elektronik dhe platforma e shërbimit të biletave	Proces Shërbimi
2	Loti 8 - KOMPJUTERA	Proces Shërbimi
3	Përmirësimi dhe Integrimi i Sistemeve të Menaxhimit të Informacionit për Ndihmën Ekonomike, Personat me aftësi të Kufizuar dhe Shërbimi Social	Proces Shërbimi
4	Përmirësimi i sistemit financiar dhe modernizues për Policinë e Shtetit - për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së	Proces Shërbimi
5	Përmirësimi i Sistemit të Thesarit	Proces Shërbimi
6	Sistemi ENTERPRICE SERVICE BUS (ESB)	Proces Shërbimi
7	Sistemi i Integrimit të Menaxhimit të Shërbimeve Gjyqësore (RIMS)	Proces Shërbimi

Në orën 13.33, konstatohet një komunikim tjetër nga i njëjti përdorues me përmbajtjen si më poshtë:

"Duhet me u tërhek akshi

Hyrje dalje ievp

Infrastrukturat doganat


Menaxhimi proceseve

Shko kadastra vreshtit


Licenca azht




Duhet edhe nje leter, ku terhiqemi nga te gjitha per mungese kapacitetesh po ne aksh"



Ky komunikim ilustrohet me pamjen e mëposhtme, të përfutur nga ekrani i aparatit celular:








73
















Nga pamjet filmike dhe komunikimet e mësipërme rezulton se persona të paidentifikuar kanë detyruar me anë të dhunës dhe kanosjes me armë shtetasin Gerond Meçe në kundërshtim me dispozitat e tjt. të uptë në makinën e tyre duke i hequr në mënyrë të paligjshme lirinë. Më pas e kanë hequr dorë të dorëzimit aparatit telefonik të cilin e kanë përdorur për të komunikuar me administratorin shtetasin Shkelqim Kërlluku. Në këto komunikime janë paraqitur sikur është vetë shtetasi Gerond Meçe që i lërkon administratorit të veprorë shpejt për të hequr dorë nga ankimimet e kryera nga ky subjekt në institucionin e AKSHI dhe KPP. Administratori ka vepruar duke bërë veprime në platformën e "E-Albania" duke u tërhequr nga të gjitha procedurat. Ajo që bie në sy në këtë proces është fakti se në përfundim nuk është bërë tërheqje vetëm për procedurat në të cilat subjekti "ABS" sh.p.k është ankimues, por edhe në procedura të tjera në të cilat është pjesëmarrës. Kjo ngre dyshimin se këto informacione janë dhënë nga persona që janë në dijeni të tyre, që mund të jenë nga vetë institucioni i AKSHI por edhe nga KPP.

Veprimtarinë e KPP-së në lidhje me tërheqjen e ankimimeve dhe pranimin e tyre është shtjelluar më poshtë.

Në faqen 31 të këtij materiali, konstatohet biseda mes shtetasve Ergys Agasi dhe Ermal Beqiri ku diskutohet për dy tendera për procedurë si dhe përmendet kompania ABS. Nga kjo bisedë rezulton se të personat nga hetim janë shqetësuar për pranimin e kompanisë ABS me ortak Gerond Meçe.

Nga pyetja e personave që kanë dijeni për rrethanat e hetimit ka rezultuar se:

Gjatë kryerjes së veprimeve hetimore në kuadër të procedimit penal nr. 20/2023, për llogari të të cilit u kërkua kontrolli i vendeve të shoqërisë "EA Solution" sh.p.k, u ekzekutua vendimi i gjykatës për lejimin e kontrollit të vendeve në datën 19.06.2025 dhe konkretisht u ushtrua kontroll në subjektin "EA Solution", me Nipt M31516009A, me adresë: "Rruga "Hoxha Tasim", pallati 152, hyrja 1, kati 2, Tiranë".

Gjatë përgatitjes për ekzekutimin e kontrollit u bënë kërkime për saktësimin e adresës dhe evidentimin e saktë të zyrës ku do të kryhej kontrolli. Nga kërkimet rezultoi se të njëjtën adresë kishte të deklaruar edhe shoqëria "INGW-T" sh.p.k., me Nipt L71409033H.

Shoqëria "INGW-T" sh.p.k., përveç adresës së njëjtë "Hoxha Tasim", pallati 152, hyrja 1, kati 2", me shoqërinë "EA Solution" sh.p.k, kishte të evidentuar edhe numrin e pasurisë, dhe nëpërmjet kësaj të dhëne u evidentua saktë objekti i kontrollit.

Në datën 19.06.2025, rreth orës 14:00 shkuam në objekt. Zyrat e shoqërisë ndodheshin në katin e dytë të një pallati. Dera e zyrës ishte e hapur dhe aty gjendeshin rreth 10 të rinj, punonjës të shoqërisë. Këta punonjës nuk po punonin pasi nuk kishte energji elektrike.

Të gjithë punonjësit u pyetën dhe deklaruan se ishin punonjës të shoqërisë "Soft & Solution". Ata nuk kishin dijeni rreth shoqërisë "EA Solution". Punonjësit deklaruan se zyra ku ushtronin veprimtarinë ishte zyrë programimi e shoqërisë "Soft & Solution", se ata ishin rekrutuar nga zyra e burimeve njerëzore e kësaj shoqërie, kishin kryer trajnimin pranë zyrave të saj dhe prej rreth 1 viti punonin në zyrën ku ishin aktualisht, ku po zhvillonin sistemin e Çështjeve të Policisë së Shtetit.

Punonjësit deklaruan se nuk ka një person përgjegjës për zyrën dhe se ata futen në mëngjes në zyrë dhe shpesh shenja e gishtit në derën e zyrës. Lidhur me çdo problematikë punonjësit kontaktonin me personat e burimeve njerëzore të shoqërisë "Soft & Solution" apo me IT-në e saj. Lidhur me problematikën e rritjes së energjisë elektrike në zyrë erdhi një punonjës i cili u prezantua si teknik IT i shoqërisë "Soft & Solution", dhe po merrej me serverin e shoqërisë i cili ndodhej në një ambient tjetër brenda zyrës.

Punonjësit u pyetën dhe deklaruan se nuk e njohin administratoren e shoqërisë "EA Solution", shtetasen Ina Ciko. Nga ana e oficerëve u kontaktua shtetasja Ina Ciko, e cila në telefon deklaroi se adresa ku ne ishim, ishte adresa e saktë e shoqërisë. I kërkuam shtetases Ina Ciko se cilët janë punonjësit e shoqërisë "EA Solution" me të cilët mund të komunikojmë. Kjo shtetase na tregoi disa emra, por asnjëri nga punonjësit që ajo na tregoi nuk ndodhej në zyrë. Punonjësit që ndodheshin në zyrë deklaruan se nuk i njohnin emrat për të cilët ne i pyetëm.

Nga ana jonë u verifikuan në sistemin C@ts punonjësit që ndodheshin në zyrë dhe rezultoi se vetëm punonjësja Jonida Muçobega e cila ishte prezentë, ishte punonjëse e shoqërisë "EA Solution". Të gjithë punonjësit e tjerë ishin punonjës të shoqërisë "Soft & Solution". U pyet përsëri shtetasja Jonida Muçobega, e cila deklaroi sërish se ishte punonjëse e shoqërisë "Soft & Solution".

Pas rreth 1 ore, në ambientet e zyrës erdhi shtetasja Ina Ciko. Kjo shtetase deklaroi se nuk kishte qenë kurrë në këtë zyrë dhe se në këtë zyrë shoqëria "EA Solution" ishte zhvendosur para 4-5 muajsh. Lidhur me faktin se kjo shtetase nuk kishte dijeni rreth punonjësve të shoqërisë, ajo deklaroi se merret me pjesën financiare të shoqërisë, ndërsa me punonjësit dhe menaxhimin merret menaxheri i cili quhej Eno.

Nga kontrolli i ushtruar rezultoi se në zyrë ndodhej i afishuar Ekstrakti i shoqërisë "Soft & Solution". Në zyrë kishte disa kuti të cilat kishin të shënuar emrin e shoqërisë "Soft & Solution" dhe në dollapet e shoqërisë të gjitha dosjet dhe dokumentat ishin të kësaj shoqërie.

Lidhur me këtë fakt, shtetasja Ina Ciko deklaroi se shoqëria "EA Solution" e ka marrë ambientin me qira nga shoqëria "Soft & Solution" dhe se ndoshta kjo shoqëri ende nuk i ka marrë dokumentet e saj. Kjo shtetase nuk kishte dijeni se ku ishin punonjësit e shoqërisë "EA Solution", me çfarë projektesh merreshin ata dhe nuk kishte dijeni se të kujt ishin kompjuterët në të cilët po punonin punonjësit.

Shtetasja Jonida Muçobega deklaroi më pas se kishte dijeni që ishte punonjëse e shoqërisë "EA Solution". Kjo shtetase deklaroi se kishte kryer trajnimin pranë shoqërisë "Soft & Solution" dhe që kishte idenë se këto shoqëri janë bashkë.

Asnjë nga personat të cilët ishin prezent nuk kishte dijeni lidhur me shoqërinë "INGW-T" sh.p.k. Shoqëria "INGW-T" sh.p.k., e cila ka adresën në të njëjtin vend, është në pronësi të shtetaseve Arjola Koromani dhe Erisa Malellari. Shtetasja Arjola Koromani ka qenë ortakë dhe administratore e shoqërisë "Soft & Solution". Më pas kjo shtetase ka qenë ortakë apo administratore në disa shoqëri të lidhura me shoqërinë "Soft & Solution".

Nga verifikimi i librave të shitjes rezulton se shoqëria "EA Solution" ka realizuar shitje në vlerën 779,582,683 lekë. Thua se të gjitha shitjet kjo shoqëri i ka realizuar me shoqërinë "Soft & Solution" (*apo shoqëri të tjera të cilat kanë fituar tendera nga AKSH).

Nga verifikimi i librave të blerjes rezulton se shoqëria "EA Solution" ka realizuar blerje në vlerën 33,438,389 lekë, nga të cilat një faturë është e datës 13.04.2025, me shitës AZ Auto Zetrum (Gjermani), me përshkrimin Të përdorura, me sasi 1, me vlerë 28,035,524 lekë. Kjo faturë dyshohet se është për blerje automjeti, çka tregon se shoqëria "EA Solution" nuk ka fare fatura blerje.

Mungesa e faturave të blerjes mund të mos jetë problematike nisur nga lloji i veprimtarisë së shoqërisë, megjithatë për shkak të volumit të konsiderueshëm të shitjeve që kjo shoqëri ka, duhet të kishte disa zëra apo blerje pajisjesh elektronike, programe, etj.

Nga verifikimi në sistemin C@ts rezulton se shoqëria "EA Solution" ka një punësim prej 10-15 punonjësish, me paga të konsiderueshme, dhe disa prej tyre janë të punësuar që nga krijimi i shoqërisë.

Nisur nga të dhënat më sipër krijohet dyshimi se shoqëria "EA Solution" është themeluar fiktivisht, me qëllim kalimin e pagesave të përfituara nga shoqëria "Soft & Solution" drejt shtetasit Ergys Agasi.

Në vijim, me qëllim verifikimin e të dhënave të konstatuara, të cilat rezultuan nga ushtrimi i këtij kontrolli, u procedua me marrjen në pyetje të disa punonjësve të shoqërisë "EA Solution" sh.p.k., dhe konkretisht nga ana jonë u pyetën shtetasit si më poshtë:

Fillimisht, më datë 23.09.2025 u pyet shtetasja Ina Ciko, me detyrë administratore e shoqërisë "EA Solution" sh.p.k., e cila deklaroi se: *"...Aktualisht jam e dypunësuar pranë shoqërive "EA logistics" sh.p.k si financiere dhe pranë shoqërisë "EA Solution" sh.p.k si administratore. Jam e punësuar prej 2019 tek "EA logistics" sh.p.k dhe prej vitit 2023 tek "EA Solution" sh.p.k. Shoqëria "EA logistics" ka për objekt aktivitetin tregtar të distribucionit të produkteve të duhanit, ndërsa shoqëria "EA Solution" ka për objekt aktiviteti programim dhe implementim sistemesh IT, zhvillim software-sh etj. Shoqëria "EA Solutions" e ka selinë tek rruga Hoxha Tasim, në kat të dytë, por nuk kam shkuar shpesh ndoshta 3 herë gjithsej. Zyrat kanë qenë në bllok ndërsa tani janë atje. Lidhur me shoqërinë "EA logistics", ajo e ka selinë tek Komuna e Parisit, përballë Hemera Medical Center, në kat të parë ose zero. Në këto zyra shkoj shpesh pasi punoj përditë atje."*

Lidhur me stafin dhe aktivitetin e shoqërisë "EA Solution", kjo shtetase shpjegoi se: *"..Kompania ka qenë e krijuar kur unë kam filluar punë. Në fillim zyrat e saj kanë qenë tek rruga Ismail Qemali, tek zyrat e shoqërisë "EA Tobacco" sh.p.k., dhe besoj se shoqëria "EA Solution" është krijuar në muajin Mars të vitit 2023, ndërsa unë kam filluar punë në muajin shtator-tetor të vitit 2023. Kur kam filluar unë punë, nuk e mbaj mend se sa veta staf kam patur, ndoshta katër ose pesë veta të punësuar, emrat e të cilëve nuk i mbaj mend. Sot janë rreth 15 të punësuar. Unë nuk i di as emrat e të gjithë punonjësve të cilët janë aktualisht në punë. Emrat që di nga punonjësit janë Jorgena, Erigena, Malvina."*

Konkretisht, lidhur me punët/programet e zhvilluara nga shoqëria, ajo shpjegoi se: *"Shoqëria ka zhvilluar programe të ndryshme, por kryesisht ka qenë e nënkontraktuar nga shoqëria "Soft Solution", për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e programeve të ndryshme. Nuk di t'ju them se çfarë programesh konkretisht kanë zhvilluar sepse jam marrë kryesisht me pjesën financiare. Pikë kontakti për çështjet teknike dhe të burimeve njerëzore kam patur shtetasen Arjola Koromani, e cila është administratore e shoqërisë "Soft Solution" sh.p.k. Ky kontakt dhe kjo përfshirje e shtetases Arjola Koromani dhe e shoqërisë Soft & Solution me shoqërinë "EA Solution" është vendosur nga shtetasi Ergys Agasi, në cilësinë e ortakut të "EA Solution" dhe shtetasi Ermal Beqiri në cilësinë e ortakut të "Soft Solution". Ky i fundit, ka një departament shumë të zhvilluar për burimet njerëzore. Punonjësit e shoqërisë tonë "EA Solution" rekrutohen, trajnohen dhe testohen pranë "Soft & Solution" dhe më pas vijnë të përgatitur në punë. Lidhur me kërkesën për të punësuar punonjës të rinj, apo inxhinierë me një specialitet të caktuar që na duhet për t'u punësuar, mua më komunikohet nga ortaku Ergys Agasi dhe më pas unë komunikoj me Arjolën për këtë gjë, pra për punonjësit që do të vijnë."*

Më tej, shtetasja Ina Ciko u pyet për faktin se gjatë zhvillimit të kontrollit të vendeve pranë selisë së shoqërisë "EA Solution", nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë së Posaçme, nuk është gjetur asnjë punonjës i kësaj shoqërie, por vetëm shtetasja Jonida Muçobega, e cila deklaroi se ishte e punësuar pranë shoqërisë "Soft Solution" dhe nuk e njohte fare shoqërinë "EA Solution". Pyetjes ajo iu përgjigj duke sqaruar se: *"Lidhur me këto konstatime ditën e kontrollit, dua të sqaroj se ne kemi një kontratë qiraje me shoqërinë "Soft Solution" sh.p.k. Ne kemi marrë me qira nga kjo shoqëri ambientin dhe të gjithë infrastrukturën, si kompjuterët, programet, postet e punës. Lidhur me punonjësit nuk di t'ju them pasi infrastruktura që ne kemi pra kompjuterët etj., si dhe stafi, menaxhohen nga shoqëria "Soft Solution". Pra stafi ynë, menaxhohet nga departamenti i burimeve njerëzore të "Soft Solution", konkretisht nga shtetasja Arjola Koromani, të cilën unë e kam pikë kontakti. Edhe për punën që bën stafi ynë, nuk mund t'ju them pasi ata raportojnë dhe kontrollohen nga departamenti i burimeve njerëzore të shoqërisë "Soft Solution". Unë si administratore e shoqërisë nuk kontrolloj stafin dhe nuk raportoj për këto gjëra, pasi unë merrem kryesisht me pjesën e financës, por stafi ynë përgjigjet pranë departamentit të burimeve njerëzore të shoqërisë "Soft Solution". Për shembull, unë nuk mund të verifikoj vetë volumin e punës që bëjnë punonjësit tanë, por në momentin që kjo punë pranohet nga kontraktuesi, dhe faturimi bëhet pasi pala që menaxhon punën dhe stafin, pra shoqëria "Soft Solution" jep ok, në këtë moment bëhet faturimi nga ana jonë. Edhe suportit teknik në lidhje me mirëmbajtjen e rrjetit, kompjuterëve dhe sistemeve, bëhet nga punonjës të shoqërisë "Soft Solution". Gjithashtu, edhe lidhur me faktin nëse punonjësit punojnë nga zyra apo nga shtëpia, apo nëse ata marrin raporte apo mungojnë në punë, këta punonjës raportojnë pranë zyrës së burimeve njerëzore të shoqërisë "Soft & Solution".*

Gjithashtu, lidhur me aktivitetet dhe bashkëpunimet me shoqëri të tjera tregtare, shtetasja Ina Ciko deklaroi se: *"...Po, kemi patur marrëdhënie financiare dhe kemi bashkëpunuar me shoqëritë "AESS" sh.p.k., "First" sh.p.k., "Fastech" sh.p.k. dhe "Soft & Solution" sh.p.k., me të cilat kemi filluar bashkëpunimin qysh nga viti 2023. Këta nënkontraktorë janë gjetur nga ortoku Ergys Agasi. Kontratat e bashkëpunimit gjithashtu janë të bëra nga ortaku Ergys Agasi."*

Më tej, nga pyetja e disa prej punonjësve të shoqërisë "EA Solution" sh.p.k. rezultuan me interes të

Më datë 30.09.2025, u bë marrja në pyetje në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethana të hetimit, e shtetases Keli Muçaj, e cila deklaroi se: "...Në Dhjetor të vitit 2022, kam përfunduar studimet e larta, dega Informata Ekonomike dhe më pas fillova direkt master, pra në muajin Nëntor të vitit 2022, për inxhinieri software. Gjatë kohës që kam qenë në master, kërkoja të punësohesha dhe të punoja në programim. Pashë në LinkedIn, pra në internet, që kompania "Soft & Solution" punësonte njerëz. Ata në fakt nxirrnin vazhdimisht njoftime për punësim. Pasi i kontaktova, më thirrën dhe fillimisht duhet të bëja një intervistë pune, me shtetasen Xhenila Tamizi. Pas intervistës, kam bërë dhe një provim të shkurtër dhe pas përfundimit të këtyre procedurave, më ka ardhur një përgjigje nga ana e tyre, por nuk e mbaj mend me sms ose me email. Më thanë që mund të paroqitesha pasi i kisha kaluar të gjitha fazat. Në fazën tjetër të intervistës, e cila është bërë në selinë e tyre, në rrugën Hoxha Tasim, më thanë që fillimisht do të filloja një trajnim në zyrat e tyre dhe më pas do të punësohesha. Periudha e trajnimit ka zgjatur rreth dy muaj dhe në fund të Qershorit të vitit 2023 jam punësuar zyrtarisht. Pozicioni i punës sipas kontratës që më dha Xhenila, që ishte e burimeve njerëzore dhe më bëri një sqarim, nuk ishte pranë shoqërisë "Soft & Solution", por ka qenë një shoqëri tjetër, po me emrin Solution por nuk më kujtohet mirë për momentin, nuk mund t'jua them emrin e saktë. Detyra ose pozicioni im i punës ka qenë software developer, ose zhvilluese programesh."

Lidhur me punët dhe/apo shërbimet e kryera për llogari të shoqërisë "EA Solution", kjo shtetase deklaroi se: "Siç shpjegova më sipër, puna ime ka qenë në programim, për llogari të shoqërisë "Soft & Solution", dhe nuk di të kem kryer ndonjë shërbim apo punë për këtë shoqërinë që ju përmendni!"

Ndërsa lidhur me momentin e nënshkrimit të kontratës së punës ajo shpjegoi se: "Po siç ju shpjegova dhe më sipër, e mbaj mend që nënshkrova kontratë pune me një shoqëri me emër të ngjashëm me "Soft & Solution", por nuk e mbaj mend emrin. Besoj se ma kanë dhënë një mendim ligjor se pse u bë procedura në këtë formë, por mesa mbaj mend, më është dukur e rregullt dhe nuk e kam kundërshtuar si proces..."

Lidhur me njohjen e saj me shtetasen Ina Ciko, e cila është administratorja e shoqërisë "EA Solution" sh.p.k, apo dhe njohja e saj me shtetasin Ergys Agasi, shtetasja Keli Muçaj deklaroi se nuk i njohte si emra. Ndërsa në lidhje me shtetasin Ermal Beqiri, ajo shpjegoi se: "Po e njoh sepse e dija që ishte pronari, e kam parë dhe nëpër zyrat ku kam shkuar dhe kam bërë intervistën. Pra, aty ku ishin burimet njerëzore kam parë dhe personin në fjalë."

Po më datë 30.09.2025 u bë marrja në pyetje e shtetasit Endri Gremi, i cili shpjegoi se: "...Unë kam mbaruar shkollën tek Fakulteti i Shkencave të Natyrës në vitin 2020. Pas shkollës kam punuar në punë të ndryshme që lidhen me profesionin tim dhe në vitin 2023, nëpërmjet faqes online LinkedIn, kam gjetur një pozicion pune si QA Automation, që do të thotë testues i programeve, platformave software. Këtë pozicion pune e kishte publikuar shoqëria "Soft & Solution", por nuk më kujtohet mirë. Pas aplikimit, më ka marrë në telefon për të kryer intervistën shtetasja Xhenila Tamizi. Pas intervistës të cilën e kemi bërë tek një vilë në pazarin e ri, më është thënë që duhej të zhvilloja dhe një test inteligjence përpara se

...kam shkuar tek rruga Hoxha Tasim, tek një zyrë me xhama në krahun e rrugës, me një zyrë me muret afër semaforit në drejtim të Brrylit, përballë një banke Raiffeisen dhe aty kam zhvilluar testin e inteligjencës. Ditën që është zhvilluar testi kishte dhe punëtorë në ato ambiente dhe gjithashtu persona të tjerë që po zhvillonin të njëjtin testim. Atë ditë kanë qenë ndoshta 3 ose 4 persona, nuk e mbaj mend mirë. Testi ishte një test i thjeshtë inteligjence, në kompjuter, ku testoheshim për aftësi të ndryshme, nëpërmjet pyetjeve të thjeshta logjike, ushtrime të thjeshta matematikore etj. Pas kryerjes së testit, doli rezultati dhe më thanë që do të më njoftonin nëse do të pranohesha apo jo. Brenda një jave mesa mbaj mend, shtetasja Xhenila Tamizi më njoftoi që isha shpallur fitues dhe do të bëja edhe një stazh një muor që më pas të filloja punë. Më tha që do të filloja trajnimin një ditë të mërkurë dhe pas trajnimit do të përcaktohej nëse do të merresha në punë. Shkova bëra trajnimin, i cili zgjati pak më tepër dhe më pas kam filluar punë. Paga ka qenë rreth një milion bruto dhe diku rreth 700 mijë lekë neto. Siç thashë, pas trajnimit, kam nënshkruar dhe kontratën e punës, të cilën ma ka dhënë shtetasja Xhenila Tamizi."

Përsa i përket detajeve lidhur me procesin e nënshkrimit të kontratës së punës, shtetasi Endri Gremi deklaroi se: "Mbas mbaroi trajnimi dhe mora konfirmimin që do të filloja punë nga shtetasja Xhenila Tamizi, jam paraqitur për të nënshkruar kontratën po me këtë shtetase. Gjatë nënshkrimit të kontratës, pashë që punëdhënësi nuk ishte shoqëria "Soft & Solution" por shoqëria "EA Solution", të cilën unë nuk e kisha dëgjuar më parë. E pyeta Xhenilën për këtë fakt, se përse po nënshkruaja kontratë me këtë shoqëri dhe përgjigja ishte që "EA Solution" ishte pjesë e grupit të shoqërive "Soft & Solution" dhe se "Soft & Solution" do të bëhej grup shoqëriash, dhe do të kishte në varësinë e saj edhe shoqërinë "EA Solution."

Lidhur me njohjen e tij me shtetasen Ina Ciko, e cila është administratorja e shoqërisë "EA Solution" sh.p.k, apo dhe njohja e tij me shtetasin Ergys Agasi, shtetasi Endri Gremi deklaroi se nuk i njohte si emra, ndërsa lidhur me shtetasin Ermal Beqiri, ai shpjegoi se: "Po e njoh dhe e dija që ishte pronar i firmës, pasi e kam njohur fillimisht gjatë trajnimit, dhe ka rastisur që ekipi im, në fazat e para të trajnimit, i prezantonim projektet tona në zyrën e tij. E dija dhe që ishte pronar i shoqërisë "Soft & Solution". Më pas ai nuk u mor më me fazat e trajnimit tonë, por mund t'iu them që kjo punë iu la më pas një vajze, emri i të cilës nuk më kujtohet pasi ka kaluar dhe një kohë e gjatë. Ermali është marrë pjesërisht edhe me mbarëvajtjen e punëve që bëheshin nga ne, pasi kemi bërë dhe mbledhje ekipi me të, ku mund të diskutoheshin problematiko të ndryshme që hasnim gjatë punës..."

Më datë 1.10.2025 u bë marrja në pyetje e shtetases Malvina Kryemadhi, e cila deklaroi se në muajin Maj të vitit 2023, kishte aplikuar për punë pranë shoqërisë "Soft&Solution" sh.p.k., dhe më pas është paraqitur për intervistë pune pranë zyrave të kësaj shoqërie, pranë ambjenteve të një vile në zonën e pazarit të ri, ku është intervistuar nga shtetasja Xhenila Tamizi. Kontratën e punës e ka nënshkruar me shoqërinë "EA Solutions", dhe se shtetasja Xhenila Tamizi nuk i bëri ndonjë sqarim shtesë lidhur me shoqërinë pranë së cilës ajo do të punësohej. Gjithashtu, edhe shtetasja Malvina Kryemadhi deklaroi se ka qenë gjithnjë me vend pune pranë ambienteve të shoqërisë "Soft&Solution", pavarësisht se kontratën e kishte nënshkruar me shoqërinë "EA Solution". Në përfundim, edhe kjo shtetase deklaroi se nuk i njohte shtetasit Ina Ciko dhe Ergys Agasi.

Nga tërësin e shpjegimeve të dhëna nga punonjësit e shoqërisë "EA Solution", arsyeshëm krijohet bindja se kjo shoqëri ekziston në mënyrë krejtësisht fiktive dhe se nuk ka realizuar asnjë punë apo shërbim konkret, por se në realitet, të gjitha punët dhe/apo shërbimet e kryera prej saj, janë kryer nga punonjës të shoqërisë "Soft&Solution". Në këtë kontekst, edhe faturimet e shoqërive të tjera dhe/apo blerja e shërbimeve nga palë të treta, nga shoqëria "EA Solutions" sh.p.k., dyshohet se janë fiktive.

Për sa më sipër, nga analiza financiare e veprimeve/transaksioneve të subjektit "EA Solution" kanë rezultuar me interes për hetimit të dhënat si më poshtë:

1. Llogaria me nr. 402010926CLPRCFEURTX pranë Bankës Kombëtare Tregtare në monedhën ALL në të cilën vihen re veprimet e mëposhtme:

Kreditim në cash nga shtetasja Arjola Koromani sipas datave dhe vlerave të mëposhtme:

- 100 000 ALL datë 25.04.2023, me përshkrimin "ARJOLA KOROMANI P DERDHJE NE LLOGARI"
- 300 000 ALL datë 08.05.2023, me përshkrimin "ARJOLA KOROMANI DERDH NE LLOG TE EA SOLUTION ME PROK"
- 100 000 ALL datë 19.05.2023, me përshkrimin "ARJOLA KOROMANI DERDH NE LLOG"
- 500 000 ALL datë 05.06.2023, me përshkrimin "ARJOLA KOROMANI DERDH NE LLOG TE EA SOLUTION ME PROK"
- 200 000 ALL datë 13.06.2023, me përshkrimin "ARJOLA KOROMANI DERDH NE LLOG"
- 600 000 ALL datë 06.07.2023, me përshkrimin "ARJOLA KOROMANI DERDH NE LLOG TE EA SOLUTION ME PROK"

Kreditime me transfertë udhëruar nga llogaria "Soft&Solution" sh.p.k si më poshtë:

- 2 000 000 ALL datë 13.07.2023, me përshkrimin "Likujdim I pjesshem I Fatures Nr. 2 Date 12/07/2023"
- 1 056 000 ALL datë 06.09.2023, me përshkrimin "Likujdim fature Nr. 5 Date 21/08/2023"
- 2 524 000 ALL datë 05.10.2023, me përshkrimin "Likujdim I plot I fatures Nr. 2 Date 12/07/2023"
- 1 056 000 ALL datë 06.11.2023, me përshkrimin "Likujdim I plot I fatures Nr. 10, Date 16/10/2023"
- 1 056 000 ALL datë 14.11.2023, me përshkrimin "E-Invoice: E FAT 12/2023"
- 5 540 000 ALL datë 05.12.2023, me përshkrimin "Likujdim I pjesshem I fatures Nr. 13/2023, Date 04/12/2023". Ky kreditim është kthyer me debitimin me transfertë me datë 51.03.2024 me përshkrimin "Kthim Shume e kaluar gabim per Faturen Nr. 13, Date 04/12/2023"
- 1 056 000 ALL datë 15.01.2024, me përshkrimin "E-Invoice: E FAT 3/2024"
- 31 440 000 ALL datë 15.01.2024, me përshkrimin "E-Invoice: E FAT"
- 9 312 000 ALL datë 15.03.2024, me përshkrimin "E-Invoice: E FAT 7/2024 DHE 6/2024"
- 1 056 000 ALL datë 15.04.2024 me përshkrimin "Likujdim Fature Date 15 Prill 2024"
- 2 556 000 ALL datë 07.05.2024, me përshkrimin "E-Invoice: Likudjim fature date 06 Maj 2024"
- 1 056 000 ALL datë 03.06.2024, me përshkrimin "E-Invoice: Likujdim fature Date 15 Maj 2024"

- 1 056 000 ALL datë 19.06.2024, me përshkrimin "E-Invoice: Likujdim Fature date 14 Qershor 2024"
- 1 376 000 ALL datë 03.07.2024, me përshkrimin "E-Invoice: Likujdim Fature date 3 Korrik 2024"
- 1 056 000 ALL datë 02.08.2024, me përshkrimin "E-Invoice: Likujdim Fature date 15 Korrik 2024"
- 1 056 000 ALL datë 04.09.2024, me përshkrimin "E-Invoice: Likujdim fature"
- 1 056 000 ALL datë 16.09.2024, me përshkrimin "E-Invoice: Likujdim Fature Nr 15"
- 6 264 000 ALL datë 03.10.2024, me përshkrimin "E-Invoice: Likujdim fature Nr 16"
- 10 500 000 ALL datë 16.10.2024, me përshkrimin "E-Invoice: E FAT 22 2024 PJESORE"
- 7 000 000 ALL datë 26.12.2024, me përshkrimin "Likujdim Fature Nr 25/2024"
- 2 112 000 ALL datë 20.01.2025, me përshkrimin "Likujdim I pjesshem I fatures Nr. 1, 7 dhe 19"
- 2 000 000 ALL datë 19.02.2025, me përshkrimin "Likujdim Detyrimi"
- 1 056 000 ALL datë 04.03.2025, me përshkrimin "Likujdim Fat 4"
- 1 440 000 ALL datë 04.03.2025, me përshkrimin "Likujdim Detyrimi"
- 3 468 000 ALL datë 07.04.2025, me përshkrimin "E-Invoice: Likujdim fature nr 8"

Në total është kredituar shuma prej 100 148 000 ALL.

Kreditime me transfertë udhëruar nga llogaria "First" sh.p.k. me numër llogarie AL04202112570000000002974956 si më poshtë:

- 1 784 496 ALL datë 14.02.2025, me përshkrimin "FATURA 2/2025"

Kreditime me transfertë udhëruar nga llogaria "Fastech" sh.p.k. me numër llogarie si më poshtë:

- AL41202110130000000100003774, në vlerën 3 189 631 ALL më datë 06.05.2025, me përshkrimin "SHLYER FATURE"
- AL07214111060111101461020211, në vlerën 800 000 ALL më datë 09.06.2025, me përshkrimin "Shlyer detyrime"

Debitime page më datë 07.07.2025 për klientët e mëposhtëm:

- Jonida Muçobega – 125 180 ALL
- Erigena Bosi – 140 680 ALL
- Malvina Kryemadhi – 117 600 ALL
- Edisa Nushi – 125 180 ALL
- Ersi Hoxha – 125 180 ALL
- Marineo Hoxhaj – 117 600 ALL
- Frensi Musai – 125 180 ALL
- Resardo Ramollari – 117 600 ALL
- Kejdi Hasanllari – 117 600 ALL
- Desart Gecaj – 117 600 ALL
- Jorgen Gorica – 117 600 ALL

Debitim me transfertë më datë 15.03.2024 në shumën 84 033 533 ALL në drejtim të llogarisë

- AL08212110090000000001856790 EA SOLUTION me përshkrimin "KALIM FONDI BRENDA LLOG".

2. Subjekti "EA Solution" sh.p.k. disponon llogarinë me nr. 00001856790 pranë Credins Bank në monedhën ALL, në të cilën vihen re veprimet e mëposhtme:

Kreditime nga llogaria "Soft&Solution" sh.p.k. sipas datave dhe përshkrimeve të mëposhtme:

- 66 480 000 ALL më datë 7.12.2023, "E-Invoice: E FAT 13/2023 000000234283913"
- 40 470 000 ALL më datë 28.12.2023, "2023-12-23-18.46.36.000000 1cd37f8-f2bc-4b2c-83b6-cac0c255c13 Envoice: 17/2023"
- 30 000 000 ALL më datë 29.12.2023, "Likujdim Fature Nr 18 Date 28/12/223 b62c0a77-8a93-472c-a54d-beedba925d3 Envoice: 18/2023"
- 83 881 200 ALL më datë 16.01.2025 "E-Invoice: PAGESE FATURE 1 2025 000000271718889"

Në total është kredituar shuma prej 220 831 200 ALL.

Debitim me transfertë në shumën 170 000 000 ALL më datë 12.04.2024, në drejtim të llogarisë "Ergys Agasi" me përshkrimin "PAGESE DIVIDENTI VITI 2023 EA SOLUTION SH.P.K. 000000245268211"

Kreditime nga llogaria "First" sh.p.k. sipas datave dhe përshkrimeve të mëposhtme.:

- 63 389 664 ALL më datë 27.12.2024, "FATURA 20/2024"
- 60 240 000 ALL më datë 27.12.2024 "LIK FT NR 18/2024"

Kreditime nga llogaria "Fastech" sh.p.k. sipas datave dhe përshkrimeve të mëposhtme:

- 174 834 120 ALL më datë 28.01.2025 "Shlyer Detyrim Fature e30b0273-a384ae4-9a4c-aa2523072604"

Veprime të tjera në llogarinë bankare:

- ✓ Debitim me "Kalim në llogari" me përfitues "EA Solution" sh.p.k, në shumën 91 300 000 ALL më datë 25.02.2025 me përshkrimin "KALIM NE DEPOZITE". Kjo shumë është kredituar në llogarinë me nr. 00002210492, e cila në momentin e dërgimit të përgjigjes gjendet në llogari.
- Kreditim "Këmbim në llogari" më datë 04.03.2025 në shumën 23 408 700 ALL me përshkrimin "KONVERTIM, KURS 99.4 IMP.ORIG. EUR 235.500,000- CAMBIO 99,4000000000"
- ✓ Debitim me transfertë në shumën 18 000 000 ALL më datë 11.03.2025 në drejtim të llogarisë "Futboll Club Dinamo" sh.a., me përshkrimin "KALIM SIPAS KONTRATES SPONSORIZIMI DATE 11.03.2025 EA SOLUTION SH.P.K."
- Kreditim "Internet Banking/Transfertë nga Jashtë" më datë 09.07.2025 në shumën 27 000 000 ALL me përshkrimin "KALIM HUA SIPAS KONTRATES DATE 07.7.2025".

Kjo llogari më datën e dërgimit të shkresës ka balancën 136 697 617 ALL.

3. Llogaria me nr. 00001856791 pranë Credins Bank në monedhën EUR në të cilën vihen re veprimet si vijon:

Kreditime nga llogaria "Soft&Solution" sh.p.k. sipas datave dhe përshkrimeve të mëposhtme:

- 70 000 EUR më datë 06.07.2023, "LIK FAT NR 1/2023 DT.29.06.2023 000000221055313"
- 55 800 EUR më datë 07.08.2023 "2023-08-07-10.43.44.000000 90e3b04-2bd1-406b-a152-bffcbf43f01 Invoice: 4/2023"
- 70 000 EUR më datë 06.09.2023, "Likujdim Fature Nr. 6 Date 04/09/223 43402038-995f-49f2-acc6-84c1fadf1e1 Invoice: 6/2023"
- 70 000 EUR më datë 31.10.2023, "LIKUJDIM FATURE NR 9/2023 000000229062212"
- 64 641 EUR më datë 06.11.2023 "Likujdim fature Nr. 11/2023, Date 6/11/2023 000000231740536"
- 70 000 EUR më datë 06.12.2023, "2023-12-05-00.05.38.000000 a0ac95b-ed85-43a6-9ae0-11f877081dd Invoice: 14/2023"
- 70 000 EUR më datë 05.1.2024, "Likujdim Fature Nr. 1/2024 Date 05/01/2024 54d4ba79-f473-4d54-8696-93f95fa743b Invoice: 1/2024"
- 70 000 EUR më datë 06.02.2024, "Likujdim Fature Nr. 4/2024 Date 06/02/2024 b5ef4828-aebf-4d9b-89b4-dafe0597a67 Invoice: 4/2024 000000239478480"

Në total janë kredituar 540 441 EUR

Veprime të tjera në llogari:

- Kreditim "KEMBIM NE LLOGARI" më datë 18.07.2024 në shumën 109 000 EUR, me urdhërues "EA SOLUTION SH.P.K" me përshkrimin "KONVERTIM KURSI 100.6 000000254461566"
- Kreditim "KEMBIM NE LLOGARI" më datë 04.03.2025 në shumën 235 500 EUR, me urdhërues "EA SOLUTION SH.P.K" me përshkrimin "KONVERTIM, KURS 99.4 000000276471495". Kjo shumë është debituar me transfertë "TRANFERTE ME/NGA BANKA TE TJERA" po këtë datë në drejtim të llogarisë "AZ AUTO ZENTRUM QUAKENBRUCK GM" me përshkrimin "PAYMENT PROFORMA INV DATE 03.03.205 NR 67/201/266 000000276488805"
- ✓ Debitim me transfertë "Pagesë për të tretë" më datë 05.12.2023 në shumën 86 000 EUR, në drejtim të llogarisë "Agasi Ergys" me përshkrimin "KALIM SIPAS KONTRATES SE HUASE 718 REP 4865KOL DT05.12.2023"
- ✓ Debitim me transfertë "Pagesë për të tretë" më datë 08.01.2024 në shumën 50 000 EUR, në drejtim të llogarisë "Agasi Ergys" me përshkrimin "KALIM SIPAS KONTR REP 38 KOL 27 DT 08.01.2024 000000236984938"
- ✓ Debitim me transfertë "Transfertë me/nga banka të tjera" më datë 21.02.2024 në shumën 400 000 EUR, në drejtim të llogarisë "BSK MARINE P.C" me përshkrimin "PARTIAL PAYMENT INV 482 DT 20.02.2 000000240646206"
- ✓ Debitim me transfertë "Transfertë me/nga banka të tjera" më datë 18.07.2024 në shumën 77 500 EUR, në drejtim të llogarisë "BSK MARINE P.C" me përshkrimin "PARTIAL PAYMENT INV 482 DT 20.02.2000000254461717"

- ✓ Debitum me transfertë "Transfertë me/nga banka të tjera" më datë 18.07.2024 në shumën 34 000 ALL, në drejtim të llogarisë "BSK MARINE P.C" me përshkrimin "INV 483 DT 17.07.2024 000000254-1n2612"

Nga hetimet e mësipërme rezultoi se subjektet "Soft & Solution" sh.p.k., "First" sh.p.k. dhe "Fastech" sh.p.k. kanë kaluar fonde në llogarinë e subjektit "EA Solution" sh.p.k. në pronësi të shtetasit Ergys Agasi. Subjekti "Soft & Solution" sh.p.k. është në pronësi të shtetasit Ermal Beqiri. Subjekti "First" sh.p.k. rezulton me NIPT K82020002A dhe është në pronësi të shtetasit Gëzim Hoxha. Subjekti "Fastech" sh.p.k. rezulton me NIPT J81609010U dhe është në pronësi të shtetasit Andis Papa.

Hetimet tregojnë se në sistemin "@CATS" të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve rezulton se subjekti "EA Solution" ka faturuar shitje në drejtim të subjektit "Fastech" sh.p.k. për periudhën 11.12.2024 – 26.09.2025 shumën prej 2 235 761 543 ALL. Në drejtim të subjektit "First" sh.p.k. shumën prej 139 317 172 ALL. Në drejtim të subjektit "Soft & Solution" sh.p.k. shumën prej 527 765 506 ALL.

Si konkluzion, rezulton se faturimet e kryera nga "EA Solution" sh.p.k. në drejtim të tre subjekteve të tjera të përshkruara më sipër janë fiktive dhe me qëllim përfitimin e parave që rrjedhin nga procedurat e prokurimeve të paracaktuara nga grupi kriminal. Ky fiktivitet konstatohet në faktin që subjekti "EA Solution" sh.p.k. nuk ka ambiente për realizimin e aktivitetit të biznesit por përdor ambientet e "Soft & Solution" sh.p.k., punonjësit e deklaruar në emër të këtij subjekti janë rekrutuar nga punonjës të burimeve njerëzore të subjektit "Soft & Solution" sh.p.k. dhe nuk kanë patur asnjëherë kontakt me administratorin e subjektit "EA Solution" sh.p.k., shtetasen Ina Ciko. Nga ana tjetër kjo e fundit nuk ka kryer asnjë veprimtari dhe nuk ka asnjë dijeni lidhur me kontraktimin e punëve që merret nga subjektet e tjera. Gjithashtu, në deklaratimet e shtetasit Andis Papa dhe Gëzim Hoxha thuhet se ata kanë kontraktuar shërbimet në "EA Solution" nëpërmjet shtetasit Ermal Beqiri i cili i ka drejtuar te ky subjekt. Pra, të gjitha aktivitetet drejtohen nga shtetasit Ermal Beqiri dhe Ergys Agasi me qëllimin përfundimtar përfitimin e paligjshëm të fondeve të marra nga kontratat publike me institucionin e AKSHI.

Nga hetimet rezulton gjithashtu se, subjekti "Soft & Solution" sh.p.k. dhe "Fastech" sh.p.k., për periudhën 2018 - 2021 kanë blerë produkte nga subjekti "Mega Distribution" sh.p.k. regjistruar me NIPT L02302016U. Ky subjekt aktualisht rezulton në pronësi dhe administrim të shtetasit Bedri Rryta. Në periudhën e mësipërme ky subjekt ka qenë në pronësinë e shtetasit Rogers Rryta, i cili është pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit. Ai deklaroi se "është punësuar pranë subjektit "Mega Distribution" sh.p.k me NIPT L02302016U, me aktivitet në fushën e importit. Shesin produkte ushqimore dhe veshje. Kanë disa dyqane ku shiten mallra të quajtura Rogers. Nuk e mban mend fiks se si quhet pozicioni i tij i punës, por mbulon detyrat e një drejtori ekzekutiv. Subjekti është krijuar diku nga viti 2010 – 2011, nga babai i tij. Boboi është marrë me aktivitet tregtie produkte ushqimore dhe më pas në 2010 – 2011 është shtuar dhe aktiviteti me produkte veshjesh, ku në atë kohë është hapur dhe dyqani i porë në City Park. Produktet i blejnë në Turqi, Greqi, Danimarkë, Itali, Kinë, Brazil. Lidhur me produktet ushqimore konfirmon se bën distribucionin e produkteve të brandit "Ulker" në të cilën përfshihen çokollata, biskota, akullore, çibuk, kryesisht produkte të konsumit të ëmbla, të thata dhe

shumë. Per produktet e veshjeve sqaron se tregtojnë veshje të ndryshme nga marka ndërkombëtare të dat shiten në dyqanet me emrin Rogers.

Deri para dy vjetësh ka qenë administrator i kësaj kompanie. Është bërë administrator diku nga viti 2014 ose 2015, nuk i kujtohet saktë. Në këtë periudhë është bërë dhe ortak i vetëm i kësaj kompanie duke blerë të gjitha aksionet babait të tij. Më pas ia ka shitur përsëri babait, i cili është ribërë administrator i kompanisë. Kjo ka ndodhur për arsye se donte të provonte administrimin në një kompani dhe më pas ia ka kthyer përsëri babait meqë është me eksperiencë.

Deklaron se nuk tregtojnë asnjë lloj malli tjetër përveçse veshje dhe produkte ushqimore. Këtë e thotë me siguri dhe bindje të plotë.

Deklaron se nuk tregon produkte që lidhen me fushën e teknologjisë së informacionit si hardware apo software.

Gjatë kohës që ka qenë administrator i kompanisë ka patur marrëdhënie tregtare me kompanitë "Fastech" sh.p.k. dhe "Soft & Solution" sh.p.k. për tregtimin e çokollatave dhe biskotave. Nuk e mban mend si ka filluar konkretisht kjo marrëdhënie tregtare. Nuk ka patur kontrata me këto kompani dhe nuk i kujtohet se çfarë produkti kanë blerë ato, si janë transportuar, ku kanë qenë të magazinuara etj.

Lidhur me kreditimet me fonde të vazhdueshme gjatë viteve 2018, 2020 dhe 2021, në shumë totale mbi 10 milion Euro në llogaritë bankare të subjektit të tij, në bankat BKT dhe Credins në monedhat Euro, USD dhe ALL, deklaron se janë pagesa ndaj faturave që bëhen për shitjet. Këto fatura lidhen me shitjen e çokollatave dhe biskotave. Këto fonde janë përdorur për të vazhduar aktivitetin tregtar që ai ka. Nuk ka dijeni për aktivitetin tregtar që kryejnë subjektet "Fastech" sh.p.k. dhe "Soft & Solution" sh.p.k. Nuk njih shtetasin Ermal Beqiri, nuk ka patur ndonjëherë marrëdhënie me të. Nuk njih shtetasin Andis Papa, nuk ka patur ndonjëherë marrëdhënie me të. Të njëjtin qëndrim deklaron edhe lidhur me shtetasit Ergys Agasi dhe Mirlinda Karçanaj.

Nga pyetja e administratorëve të shoqërive "First" dhe "Fastech" sh.p.k., rezultuan me interes të dhënat si më poshtë:

Konkretisht, më datë 18.11.2025, u bë marrja në pyetje e shtetasit Gëzim Hoxha, me detyrë administrator dhe ortak i shoqërisë "First" sh.p.k., i cili shpjegoi se: "...Aktualisht jam administrator i shoqërisë "First" sh.p.k. dhe gjithashtu ortak i vetëm i kësaj shoqërie qysh prej vitit 2008. Shoqëria ka si aktivitet ofrimin e shërbimeve të integritetit të sistemeve të nivelit të lartë, ose "shërbim me çelësa në dorë", në fushën e teknologjisë dhe informacionit, specifikisht në fushën e sigurisë kibernetike, por kemi dhe objekt konsulence dhe shërbime të tjera."

Më tej, lidhur me shërbimet dhe bashkëpunimet e shoqërisë me operatorë të tjerë ekonomik, shtetasi Gëzim Hoxha deklaroi se: "...Më pas AKSHI, ka prokuruar një procedurë tjetër, që kishte të bënte me fushën e sigurisë kibernetike me AKSIK, pra menaxhimin e rrezikut të institucioneve shtetërore, procedurë në të cilën ne kemi marrë pjesë dhe jemi shpallur fitues si operator ekonomik i vetëm. Ajo që kompania ime ofronte në kontratë, ishte pjesa e integritetit dhe arkitekturës së sistemit, që e bënim me punonjësit tanë, ndërsa lidhur me pjesën e "software-it", pjesa e moduleve do të nënkontraktohej nga shoqëria "Soft & Solution" sh.p.k., pasi ne përzgjedhëm të bashkëpunonim me këtë shoqëri. Ajo kishte tashmë eksperiencë në kontratat me nënshkrim elektronik, e cila ishte një kërkesë specifike për

...zgjidhjen që do të jepej Autoritetit Kontraktor. Pasi përfundoi procedura dhe ne u shpallëm fitues, u ulëm me shtetasin Ermal Beqiri dhe Arjola Koromanin, si përfaqësues të shoqërisë "Soft & Solution" sh.p.k., për të bërë ndarjen e moduleve që ata do të bënin. Duke qenë që deklaruar se ishin të zënë dhe nuk kishin mundësi, më thanë që këto module do të bënte një kompani tjetër, me reputacion dhe staf të kualifikuar që mund ta bënte këtë punë, konkretisht shoqëria "EA Solution". E pyeta Ermalin nëse kjo shoqëri ishte në rregull me punët, taksat dhe ligjet e vendit dhe më ka thënë që ishin të rregullt dhe kishte staf shumë të kualifikuar. Nga stafi i kësaj shoqërie më pas, kam kontaktuar shtetasen Ina, mbiemrin nuk ia mbaj mend, Poga më duket, e cila ishte dhe administratorja e shoqërisë. Më të jam takuar në ambientet e shoqërisë "Soft & Solution". Nuk kam pyetur dhe nuk kam kërkuar informacion shtesë mbi stafin apo selinë e shoqërisë, pasi dhe në kontratë ishte e parashikuar që unë nuk do të bëja asnjë pagesë nëse nuk do të kryhej shërbimi sipas parashikimeve kontraktore. Nuk kam patur ndonjë arsye për t'i pyetur rreth zyrave ose punonjësve pasi interesi ishte që produkti të dorëzohej sipas parashikimeve kontraktore dhe plus faktit që kjo shoqëri m'u prezantua nga "Soft & Solution", e cila më duhet të them, kishte një reputacion të mirë dhe kishte përvojë në punët që kishin bërë. Ata më dhanë dhe sigurinë që kompania "EA Solution" mund ta dorëzonte produktin dhe se mund ta bënte punën...".

Lidhur me vlerën e produktit të moduleve, të cilat ishin blerë nga shoqëria "EA Solution" sh.p.k., shtetasi Gëzim Hoxha deklaroi se: "...Përpara se të dorëzohej oferta, sigurisht që është bërë një përlllogaritje rreth vlerës së këtyre moduleve, dhe konkretisht kam biseduar me një kompani sllovene, një kompani të vogël shqiptare, por zgjidhja e plotë dhe që unë të isha dhe brenda fondit limit, m'u dha nga shoqëria "Soft & Solution", e cila pasi më tha që nuk mund ta bënte dot si shërbim, më sugjeroi që të bashkëpunoja me shoqërinë "EA Solution" sh.p.k. Pra përcaktimin e vlerave të moduleve, e kam bërë me administratoren e kësaj shoqërie, me shtetasen Ina, mbiemrin e të cilës nuk e mbaj mend...".

Përsa i përket përlllogaritjes së fitimit në këtë procedurë prokurimi, shtetasi Gëzim Hoxha deklaroi se: "...Zakonisht përlllogaritet nga 7-12%, duke mbajtur dhe një normë deri në 5% për riskun, por kjo kontratë nuk ka përfunduar ende dhe nuk di të them ekzaktesisht se sa do të jetë vlera e fitimit në përfundim. Lidhur me shpenzimet, mund t'ju them se ato arrijnë nivele të larta, pasi janë blerë ato module që ju shpjegova. Duke u nisur nga vlera e fondit limit dhe shpenzimeve të mia, mund të them se kanë qenë rreth 50% e vlerës, për blerjen e këtyre moduleve ose si shpenzime në tërësi..."

Përsa i përket rasteve të tjera të bashkëpunimit me shoqërinë "EA Solution" sh.p.k., shtetasi Gëzim Hoxha deklaroi se: "...Kemi patur dhe një bashkëpunim tjetër, për shkak se vitin e kaluar, ndoshta në muajin Tetor të vitit 2024, ne kemi fituar një procedurë tjetër prokurimi me AKSHI-n dhe AKSIK, me një vlerë të lartë prej rreth 60 milion euro. Ky tender është sekret dhe aty kemi nënkontraktuar disa shërbime nga shoqëria "EA Solution" sh.p.k., të cilat kanë një vlerë prej rreth 60.000.000 lekë (të reja), më duhet të shoh faturat që t'iu jap një shifër të saktë..."

Më datë 21.11.2025 është bërë marrja në pyetje e shtetasit Andis Papa, administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë "Fastech" sh.p.k., nga pyetja e të cilit rezultuan me interes të dhënat si më poshtë:

Fillimisht, shtetasi Andis Papa shpjegoi se: "...Aktualisht jam administrator i shoqërisë "Fastech" sh.p.k. Kjo është një kompani e re, e cila është krijuar në vitin 1998. Shoqëria ka si aktivitet ofrimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë dhe informacionit, gjithashtu kemi dhe si objekt aktiviteti dhe krijimin e hardware-eve dhe software-eve. Fillimisht kemi ofruar më tepër shërbime sepse nuk kishim kapacitete. Rreth vitit 2000 kemi patur tenderin e parë, për shitje kompjuterësh, ndoshta deri në vitin 2012, periudhë në të cilën u bë shumë e vështirë edhe puna. Në këto vite kam bashkëpunuar më tepër me sektorin privat, në mirëmbajtje dhe shitje kompjuterësh etj. Kam patur ekskluzivitetin e ACER-it si kompjuter. Kjo punë nuk garantonte fitime të mjaftueshme dhe madje kam dashur ta shes pasi marzhet e fitimit ishin shumë të vogla. Më pas erdhi dhe zhvillimi i departamentit të zhvillimeve të software-eve, gjë e cila filloi të funksiononte. Në fillim arrita të gjej staf të kualifikuar, nëpërmjet të cilëve, diku në vitin 2016 arrita të krijoj një strukturë të plotë. Me tendera kemi punuar gjithmonë, kryesisht me Ministrinë e Brendshme, pasi aty ka patur më shumë punë, deri në vitin 2016. Më mbaj mend që Ministria e Brendshme ka qenë dhe klienti ynë më i rëndësishëm, për shkak të xhiros. Më pas kemi marrë pjesë dhe në procedura prokurimi me zyrën e Hipotekës, lidhur me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të tyre, që akoma funksionon dhe sot. Ky tender ka qenë i zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Hipotekës, nga një shtetas me emrin Ilirjan, nuk e mbaj mend saktë. Ka qenë drejtor shtetasi Ermal Beqiri, me të cilin kemi bashkëpunuar për shkak se ai punonte aty. Këtë shtetas e kam njohur përpara pasi kemi dhe një lloj njohje farefisnore me këtë shtetas. Për këtë arsye ishte më e lehtë implementimi i sistemeve, pasi e kishim më të thjeshtë për të trokitur, meqë kishim një lloj njohje. Ai ka qenë drejtori i IT-së në atë kohë, dhe kontrata e asaj kohe darëzohej në drejtorinë e tij. Dua të them se ky ka qenë një tender me vlerë të madhe dhe këtu kam qenë së bashku me një operator tjetër ekonomik. Më tej, në vitin 2018 e në vijim, kemi bashkëpunuar edhe më shumë me AKSHI-n si institucion, përveç se sigurisht edhe me institucione të tjera. Pra, pas vitit 2019 për të qenë më të saktë, ky institucion ka qenë dhe porta kryesore për ne, ku duhej të shihnim gjithmonë për punë. Në këtë institucion kam fituar shumë procedura, nuk arrij t'i mbaj mend të gjitha. Në këtë institucion kam aplikuar dhe si operator i vetëm por edhe si bashkim operatorësh. Në disa raste kemi bashkëpunuar dhe me shoqërinë "Soft & Solution" sh.p.k, me të cilën kemi aplikuar në disa procedura të mëdha prokurimi. Njëra prej tyre është një tender për E-Albania dhe një tjetër.

Madje jemi ja vetëm ne të dyja si shoqëri, por rreth 4 operatorë ekonomikë që pa bashkëpunim për këto procedura prokurimi pasi janë goxha të mëdha. Me shoqërinë "Soft & Solution" sh.p.k, kemi krijuar bashkëpunim sepse administratori i saj, shtetasi Ermal Beqiri, krijoi një shoqëri që kishte goxha sukses dhe për këtë arsye ishte e nevojshme dhe gjithashtu e leverdisshme për të bashkëpunuar me këtë shoqëri. Pra, bashkëpunimi ka qenë dhe për arsye sepse kompanitë e tjera të mëdha i e kishin shumë të vështirë të na jepnin çmime të leverdishme. Prandaj ne, qysh në vitin 2015 afërsisht, kemi filluar bashkëpunimin. Në atë kohë, ka qenë administratore shtetasja Arjola Koromani, me të cilën kam edhe sot marrëdhënie shumë të mirë. Më duhet të them se aftësia e Ermalit në ato vite ka qenë shumë e madhe, pasi ai ishte shumë fleksibël dhe për këtë arsye mendoj se pati dhe sukses. Në shumicën e rasteve, bashkëpunimet e mia me shoqëri të ndryshme, kanë qenë kryesisht në fushën e teknologjisë dhe informacionit."

Ndërsa, lidhur me njohjen dhe bashkëpunimin me shoqërinë "EA Solution" sh.p.k., shtetasi Andis Papa deklaroi se: "...Po, së fundini, kam bashkëpunuar me këtë shoqëri. Me këtë shoqëri më ka prezantuar shtetasi Ermal Beqiri. Ai ma ka prezantuar si një shoqëri të re, kjo ka ndodhur rreth vitit të kaluar,

pasi kishim disa projekte në plan për t'i realizuar. Ermali më tha që është kompania e shtetasit Ergys Agasi dhe madje e dija pasi ai kishte punuar më herët në Ministrinë e Mjedisit dhe unë aty kisha bërë një taniç, pra e njihja si figurë por nuk e njihja personalisht. Ai nuk arriti të m'i marrë disa projekte personale dhe më ka thënë që është një kompani e re, pra ajo e shtetasit Ergys Agasi, e cila kishte kosto me të ulëta dhe mund t'i dorëzonte shërbimet. Bëhet fjalë gjithnjë për module, të cilat unë duhet t'i bleja, me qëllim për të aplikuar në procedura prokurimi, pra module zgjidhje si crm, erp, front-ende, databaza të ndryshme etj. Më duhet të them se unë personalisht nuk kam marrë kurrë kontakt me shoqërinë "EA Solution" sh.p.k., apo me përfaqësues të saj. Edhe zyrat më duket se i kanë aty, pra tek selia e shoqërisë "Soft & Solution". Edhe kur kam nënshkruar kontrata me ta, nuk kam marrë kurrë kontakt personalisht me asnjë përfaqësues të kësaj shoqërie, madje dhe kontratat e nënshkruara m'i ka sjellë shtetasja Arjola Koromani, si përfaqësuese e "Soft & Solution" sh.p.k. Edhe unë nuk jam interesuar ndonjëherë, pasi garancia për mua ka qenë gjithnjë ekzistenca e shoqërisë "Soft & Solution" sh.p.k, pasi ata ma prezantuan si shoqëri..." "...Me këtë shoqëri kam bërë 2 ose 3 kontrata, në vlerën ndoshta mbi 1.5 milionë euro..".

Për sa më sipër, shtetasi Andis Papa u pyet për faktin se ka bashkëpunuar me një shoqëri, të cilës i ka bërë pagesa mbi vlerën 1.5 milionë euro, përfaqësues të së cilës, nuk i kishte takuar kurrë, pyetje së cilës ai ju përgjigj duke deklaruar se: "...Po, e saktë...."

Më tej, shtetasi Andis Papa u pyet edhe lidhur me bashkëpunimet me shoqërinë "Mega Distribution" sh.p.k., për të cilën ai deklaroi se: "...Po, kam bashkëpunuar përpara vitit 2020, kam bashkëpunuar me këtë shoqëri, gjithnjë në fushën e teknologjisë dhe informacionit..." "...Kryesisht, zgjidhje teknologjike, për aplikacione kompjuterike. Mesa mbaj mend ato kanë patur dhe tregti të tjera..."

Në vijim, shtetasi Andis Papa u pyet lidhur me faktin se nga të dhënat e verifikuara, rezultonte se Subjekti "Mega Distribution" ka bërë shitje tek subjekti "Fastech" me NIPT J81609010U nga periudha nëntor 2015 deri në dhjetor 2021, gjithsej 175 fatura shitjeje, me një total prej 1.020.358.146 lekësh, për të cilat ai deklaroi se: "...Po, këto fatura përfaqësojnë shërbime në fushën e teknologjisë së informacionit..."

Lidhur me kontaktin e tij me përfaqësues të kësaj shoqërie, shtetasi Andis Papa shpjegoi se: "...Jam takuar me shtetasin Rogers Rryta, i cili është djali i shtetasit Bedri Rryta, dhe merrej me administrimin e shoqërisë. Kam shkuar dhe tek ambientet e tyre, të cilat i kanë diku në autostradë në rrugë dytësore, sa kalon shoqërinë "Digitalb". Kam qenë ndoshta 2 ose 3 herë aty..."

Nisur nga të dhënat e mësipërme, shtetasit Andis Papa iu vu në dispozicion objekti i aktivitetit të veprimtarisë shoqërisë "Mega Distribution", me nipt L02302016U, me administrator shtetasin Bedri Rryta, nga e cili rezulton se ajo ka për objekt veprimtarie: Import eksport, tregtim me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshme, ushqimore, industriale, elektroshtepiake, konfeksione, materiale ndërtimi dhe inertesh, hekur scrape, metale me ngjyrë, industriale, makineri, pajisje druri, dyer, dritare, pajisje hidraulike e hidrosanitare si dhe aksesoret e tyre, pllaka, vegla pune, bujqesore, blegtorale, plehra kimike, bimë medicinale, medikamente mjekësore, pajisje, aparatura dhe materiale ndihmëse për ekzaminim mjekësor, pajisje elektronike, elektrike, informatike, artikuj galanterie, artikuj të ndryshëm

masinerie, punëve zyre, kanceleri, pajisje ventilimi dhe kondicionimi, Prodhim, Ambalazhim, Etiketim, Shpërndarje, Lëng Frutash, Biskota, Çokollata dhe produktet e Sheqerit, Internet, bar kafe etj. Lidhur me sa më sipër, shtetasi Andis Papa deklaroi se: *"...Siç ju thashë, nuk e di mirë çfarë kemi blerë. Kemi bërë dhe kontrata me këtë shoqëri. Mbaj mend që ata sillnin produkte edhe nga Turqia...."*

Në zbatim të vendimit të këqyrjes dhe marrjes së dokumenteve, nëpërmjet procesverbalit të këqyrjes së datës 03.11.2025 janë administruar disa praktika të procedurave të prokurimit publik. Këto prokurime për qëllime të hetimit janë ndarë në tre kategori:

- (i) Prokurime të realizuara në periudhën kur dokumentohen takimet midis shtetasve Ergys Agasi, Mirlinda Karçanaj dhe Ermal Beqiri;
- (ii) Prokurime të lidhura me subjektin "ABS" sh.p.k. ku përfshihen tërheqjet nga ankimimet por jo vetëm, si dhe,
- (iii) Prokurime që lidhen me aktivitete fiktive të kryera nga "EA Solution" në favor të "Soft & Solution" sh.p.k etj.

- Procedurat e prokurimit të zhvilluara në AKSHI, gjatë periudhës së zhvillimit të takimeve midis shtetasve Mirlinda Karçanaj, Ergys Agasi dhe Ermal Beqiri.

Procedura e prokurimit me objekt *"Mirëmbajtja e sistemit të ATP-WEB-GIS për Agjencinë e Trajtimin të Pronave, Procedurë e Hapur"* me fond limit në total 39 528 000 ALL pa TVSH. Nga këqyrja e dokumenteve të kësaj procedure evidentohen se veprimet e kryera nga shtetasja Mirlinda Karçanaj në rolin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, janë si vijon:

- "Kërkesë për caktim përfaqësuesi" datë 06.09.2023 drejtuar "Agjencisë së Trajtimin të Pronave" në të cilën kërkohet caktimi i një përfaqësuesi për hartimin e termave të referencës, me qëllim vijim e mëtejshëm të procedurës.
- Ka miratuar "Raport përmbledhës" me nr. 1358, datë 20.03.2024, në të cilën pasqyrohet se më datë 08.01.2024 janë hapur ofertat e tre operatorëve; - "Communication Progress" sh.p.k. me NIPT K01625001C me vlerë oferte 37 440 000 ALL pa TVSH; - "Fastech" sh.p.k. me NIPT J81609010U me vlerë oferte 38 520 000 ALL pa TVSH dhe "AIR" sh.p.k. me NIPT L51702008C, e cila nuk ka paraqitur ofertë. Nga këto oferta vetëm ajo e subjektit të parë është klasifikuar si e vlefshme dhe për këtë arsye është klasifikuar si oferta fituese.
- "Formular i njoftimit të fituesit" me nr. 1359, datë 20.03.2024 drejtuar operatorit ekonomik "Communication Progress" sh.p.k, si fitues me çmimin më të ulët.
- "Kërkesë për caktim përfaqësuesit" me nr. 1410, datë 25.03.2024 drejtuar Agjencisë së Trajtimin të Pronave, për të vendosur në dispozicion personin e autorizuar për ndjekjen e kontratës.
- "Formular i njoftimit të nënshkrimit të kontratës" me nr. 1447, datë 27.03.2024, kontratë e cila është lidhur më datë 26.03.2024.
- "Kontratë" nr. 91, datë 26.03.2024, në të cilën në nenin 4, vihet re se person i autorizuar për ndjekjen e kontratës për subjektin "Communication Progress" sh.p.k., është shtetasja Blerta Beqiri me adresë email b.beqiri@commprog.com

Procedura e prokurimit me objekt *“Përmirësimi i sistemit të lejeve, zhvillimi i modulit të monitorimit të impaktit në mjedis dhe monitorimit në zbatim”* për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me vlerë limit të kontratës 314 961 948 ALL pa TVSH. Nga këqyrja e dokumenteve të kësaj procedure evidentohen se veprimet e kryera nga shtetasja Mirlinda Karçanaj në rolin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, janë si vijon:

- “Urdhër nr. 394” datë 14.10.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e termave të referencës”, protokolluar me nr. 6932, datë 14.10.2021.
- “Urdhër nr. 408” datë 04.10.2022 “Për shtimin e anëtarëve të grupit të punës për hartimin e termave të referencës”, protokolluar me nr. 6167, datë 04.10.2022.
- “Urdhër 362” datë 04.08.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e termave të referencës”, protokolluar me nr. 4104, datë 04.08.2023
- “Urdhër prokurimi” me nr. 7, datë 13.03.2024 ku lloji i procedurës së prokurimit do jetë “Procedura e hapur mbi vlerën e lartë monetare” (Elektronike), protokolluar me nr. 1281 datë 13.03.2023
- “Formulari i njoftimit të kontratës” me nr. 1331, datë 19.03.2023
- “Urdhër” me nr. 148, datë 17.04.2024 “Për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave” protokolluar me nr. 1788, datë 17.04.2024
- Miraton “Raport përmbledhës” me nr. 2576, datë 27.05.2024, në të cilën pasqyrohet se operatorët pjesëmarrës në procedurë janë; - “Soft Solution” sh.p.k. me NIPT L11328009F me vlerë oferte 279 999 999 ALL pa TVSH; - “3i Solution” sh.p.k. me NIPT L52305007S me vlerë oferte 299 213 850 ALL pa TVSH. Oferta e parë është konsideruar si oferta e vetme e vlefshme dhe ekonomikisht e favorshme dhe shpallet fituese.
- “Formular i njoftimit të fituesit” nr. 2577, datë 27.05.2024 drejtuar subjektit “Soft & Solution” sh.p.k
- “Formular i njoftimit të nënshkrimit të kontratës” me nr. 3179, datë 02.07.2024, lidhur më datë 01.07.2024.
- “Kërkesë për caktim personi ndjekës kontrate” me nr. 2820, datë 06.06.2024 drejtuar Ministrisë së Turizmit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore
- Kontratë nr. 99 datë 01.07.2024.

Procedura e prokurimit me objekt *“Përmirësim dhe shtim i funksionaliteteve të sistemit të menaxhimit dhe raportimit të incidenteve kibernetike”*, në cilën evidentohen dokumentet e mëposhtme:

- Urdhër me nr. 87, datë 24.02.2023 protokolluar me numër 1086 datë 24.02.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e termave të referencës, testimin e tregut, përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit” nënshkruar nga Drejtoresha e Përgjithshme e AKSHI Mirlinda Karçanaj.

- Urdhri me nr. 92, datë 02.05.2023 protokolluar me numër 2117, datë 02.05.2023 “Për ndryshimin e objektit të procedurës së prokurimit ngritur me Urdhrin 87 datë 24.02.2023”.
- Shkresë nr. 5413, datë 03.10.2023 “Për hartimin e kriterëve të veçanta” në të cilën informohet Zëvendësudrejtori i Përgjithshëm Daniel Shima, në të cilën janë propozuar si kriterë të veçanta të kualifikimit: – Kapaciteti ekonomik dhe financiar (Vlera e xhiros për të paktën një nga tre vitet e fundit financiar nga data e publikimit duhet të jetë më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet. – Kapaciteti teknik (Dëshmi të shërbimeve të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit financiar nga data e publikimit duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet. – Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikimet ISO (ISO 9001 për menaxhimin e cilësisë; ISO 27001 për menaxhimin e sigurisë së informacionit; ISO 20000-1 për menaxhimin e shërbimeve IT ku janë parashikuar dhe punonjës të pajisur me Certifikatë Sigurie CSP).
- Procesverbal i grupit të punës i përbërë nga Franc Zylyfeari, Rinols Gjinaj dhe Ilir Daka në të cilin janë propozuar kriteret e veçanta për kualifikim duke dhënë dhe argumentet përkatëse.
- Formular i njoftimit të kontratës me nr. 5629, datë 11.10.2023, lloji i procedurës “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” për fondin limit 134 355 812 ALL, me kohëzgjatje 6 muaj implementim dhe 24 muaj mirëmbajtje nga nënshkrimi i kontratës, ku afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje më datë 13.11.2023, ora 13.00.
- Procesverbal për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave e datës 07.12.2023, në të cilën konstatohet se oferta e subjektit “Soft & Solution” sh.p.k është e vlefshme. Oferta e subjektit “Fastech” sh.p.k. nuk plotëson kriteret për kërkesat si vijon: Dëshmi e shërbimeve të mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë 3 viteve të fundit financiare, me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përilogarit të kontratës që prokurohet; Certifikatë Sigurie për punonjësit (CSP) dhe Sigurimit e Ofertës, sipas Shtojcës 3. Oferta e subjektit “iCom” sh.p.k. nuk plotëson kriteret për kërkesat si vijon: Operatori ekonomik nuk plotëson asnjë kriter të Autoritetit Kontraktor të kërkuar në DST; Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, Sigurimin e Ofertës, Vlerën e xhiros për të paktën një nga tre vitet e fundit financiar nga data e publikimit jo më e vogël 40% të vlerës së llogarit, etj. Për këtë arsye komisioni ka vendosur të klasifikojë në emrin e parë të paraqitur nga “Soft & Solution” sh.p.k.
- Formular i njoftimit të fituesit me nr. 7378, datë 26.12.2023, nënshkruar nga Zëvendësudrejtori i Përgjithshëm Daniel Shima.

Procedura e prokurimit “Mirëmbajtja e sistemit të depove farmaceutike (eDepo) për FSDKSH”,
në të cilën evidentohen këto dokumente:

- Shkresa me nr. 6956, datë 04.12.2023 “Për hartimin e kriterëve të veçanta” nënshkruar nga shtetasit Arjana Demiri, Sidorel Hoxhaj dhe Florida Belulli, në të cilën specifikohet se punonjësit e operatorit ekonomik që do të kenë akses në zonat e sigurisë së klasit të parë dhe/ose të dytë duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie (CSP) të lëshuar nga AKSIK.
- Termat e referencës, Aneksi 2 – Mirëmbajtje për projektet TIK, HARDUARE DHE SOFTUARE, në të cilën evidentohet se pikën 7.3 janë përshkruar specifikimet teknike për përditësim, përmirësim apo modifikim të aplikacionit apo infrastrukturës (nëse aplikohet).

- Procesverbalet "Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave" datë 15.04.2024 në të cilën thuhet se nga procesverbalet e hapjes së ofertave të datës 25.01.2024 në orën 13.00 ka rezultuar se u paraqitën tre oferta: BOE "Datalog sh.p.k" & "Infosoft Systems" me vlerë të ofertës 40 620 000 ALL; - "Fastech" sh.p.k. me vlerë të ofertës 42 303 600 ALL dhe "Icom" me vlerë të ofertës 39 000 000 ALL pa TVSH. Nga shqyrtimi i ofertave rezulton se vetëm oferta e "Fastech" sh.p.k është e vlefshme. Oferta e "I-Com" është e pavlefshme pasi oferta nuk është e nënshkruar dhe nuk ka vull të subjektit apo administratorit. Oferta e BOE "Datalog sh.p.k" & "Infosoft Systems", ishte në kundërshtim me vetëdeklarimin në pikën: pjesa III Germa A ku deklarohet që përmbush specifikimet teknike ndërkohë që në zgjidhjen teknike të paraqitur OE nuk pranon të realizojë projektin në përputhje me termat e referencës pjesë e DST. Në termat e referencës kërkohet që të realizohen (nëse aplikohet) përmirësime të sistemit/aplikacionit/modulit. Pavarësisht se kjo kontratë në thelb synon procesin e mirëmbajtjes së sistemit eDepo AK, përfituesit mund t'i lindë nevoja që herë pas here të kërkojnë azhromimin, përmirësimin, modifikimin apo optimizimin e sistemit eDepo dhe ndërveprimeve mes databazave të regjistruara. Këto përmirësime do të diskutohen/realizohen hap pas hapi mes grupeve të punës gjatë zbatimit të kontratës. Me qëllim ngritjen e nivelit të sigurisë së informacionit, sistemi që do të ndërtohet/përmirësohet nevojitet që baza e të dhënave të administruar në këtë të fundit të jetë e enkriptuar. Enkriptimi i bazës së të dhënave të jetë i specifikimit AES (Advanced Encryption Standart) 256 bit. Baza e të dhënave duhet të jetë e enkriptuar edhe përgjatë komunikimit me përdoruesit. Gjithashtu dhe transmetimi i të dhënave duhet të jetë i enkriptuar. Operatori në ofertën e tij ka deklaruar se enkriptimi i bazës së të dhënave dhe komunikimeve nuk është e aplikueshëm. Enkriptimi kërkon ri-instalim, ri-implementim, ri-parametrizim dhe ri-konfigurim nga e para e të gjitha moduleve software të sistemit eDepo, në një infrastrukturë të re hardware, me komponentë software shtesë për enkriptimin e bazës së të dhënave në mënyrë që të mos afektohet operimi i sistemit ekzistues. Për këtë arsye, operatori skualifikohet për mosplotësimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë sipas Shtojcës 9.
- Oferta teknike datë 25.01.2024 e ofertuesit "Fastech" sh.p.k., në të cilën evidentohet se në pikën 6.3 janë përshkruar identike të gjitha kriteret e kërkuara në pikën 7.3 të Aneksit për Termat e Referencës në DST.
- Formulari i njoftimit të fituesit me nr. 2574, datë 27.05.2024 nënshkruar nga shtetasja Mirlinda Karçanaj në rolin e Drejtorit të Përgjithshëm.

Arsyetim: Nga dokumentacioni i evidentuar rezulton se BOE "Datalog sh.p.k" & "Infosoft Systems" ka patur ofertë më të ulët se operatori fitues "Fastech" sh.p.k e megjithatë është skualifikuar. Kriteri i vendosur nga AK për enkriptimin e databazës dhe komunikimeve nuk është i detyrueshëm por mund të kryhet vetëm nëse aplikohet sipas kushteve që sistemi ka. Sipas operatorit të skualifikuar ky kriter është i paaplikueshëm pasi kërkohet një sistem tjetër i cili të ketë aftësinë për të kryer enkriptimin. AK e ka konsideruar si të detyrueshëm këtë kriter dhe mbi bazën e këtij arsyetimi ka bërë skualifikimin e tij. Minimalisht AK duhej të kërkonte sqarime lidhur me ofertën e paraqitur nga operatori i skualifikuar për të vlerësuar nëse ky kriter është nevojshëm për këtë procedurë. Ky veprim i kryer nga KVO është i qëllimshëm për të kualifikuar operatorin "Fastech" sh.p.k. i cili ka patur vlerë më të lartë të ofertës ekonomike.

Gjithashtu në këtë procedurë vihet re se tek kriteret e veçanta të kualifikimit është përcaktuar se punonjësit e operatorit ekonomik duhet të jenë të certifikuar me (CSP) pasi do të aksesojnë në zona të klasit të parë ose të dytë. Databaza dhe sistemet e përdorura nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kapedanit Shëndetësor nuk përmbajnë të dhëna të klasifikuara sipas ligjit të klasifikimit të informacionit. Gjithashtu vendndodhja e pajisjeve fizike të këtyre sistemeve nuk ndodhen në zona të klasifikuara. Si rrjedhojë ngrihet dyshimi se ky kriter vendoset formalisht në procedurat e tenderimit nga AKSII me qëllimin për të patur mundësinë për të skualifikuar operatorët të cilët nuk janë në marrëveshje me shtetasit Ermal Beqiri, Ergys Agasi dhe Mirlinda Karçanaj.

Procedura e prokurimit me objekt “Implementimi i infrastrukturës së desktopëve virtual për Autoritetin e Aviacionit Civil”, në të cilën evidentohet dokumentet e mëposhtme:

- Shkresa me nr. 6991, datë 05.12.2023 “Për hartimin e kriterëve të veçanta” nënshkruar nga shtetasit Arjana Demiri, Sidorel Hoxhaj dhe Florida Belulli, në të cilën specifikohet se punonjësit e operatorit ekonomik që do të kenë akses në zonat e sigurisë së klasit të parë dhe/ose të dytë duhet të jenë të pajisur me çertifikatë sigurie (CSP) të lëshuar nga AKSIK
- Procesverbal për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave datë 12.02.2024, në të cilën thuhet se në këtë procedurë prokurimi janë paraqitur dy operatorë: “Communication Progress” sh.p.k. me vlerë të ofertës 107 884 000 ALL dhe “Infosoft Systems” sh.p.k. me vlerë të ofertës 109 800 000 ALL pa TVSH. KVO ka vlerësuar se oferta fituese është ajo më e vogla pra operatori “Communication Progress” sh.p.k.
- Formulari i njoftimit të fituesit me nr. 1428, datë 26.03.2024 nënshkruar nga shtetasja Mirlinda Karçanaj.

Në këtë procedurë vihet re që fitues është subjekti “Communication Progress” sh.p.k. i cili ka lidhje me shtetasin Ermal Beqiri, pasi aksioneri dhe administratori i saj shtetasi Gentian Likaj është bashkëjetues me motrën e shtetasit Ermal Beqiri. Edhe në këtë procedurë vihet re futja e kriterit të pajisjes së punonjësve me CSP e cila është e pavend, pasi të dhënat e prodhuara dhe komunikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil nuk janë të klasifikuara, si dhe vendndodhja e infrastrukturës nuk është e klasifikuar.

Procedura e prokurimit “Implementimi i sistemit të qendëruar për dokumentet me nënshkrim elektronik 2.0, madulit të administratës publike”, në të cilën evidentohen dokumentet e mëposhtme:

- Procesverbal për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave i datës 18.03.2024, përbërë nga shtetasit Suela Ago, Klajdi Kokalla dhe Helena Çupi, në të cilën thuhet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë: - “3i Solution” sh.p.k. me ofertë 462 307 993 ALL; - “MC Networking” sh.p.k. me vlerë 501 026 292.40 ALL; - “Soft & Solution” me vlerë 513 579 899 ALL dhe “Fastech” sh.p.k. me vlerë 543 211 897 ALL. Nga shqyrtimi i këtyre ofertave ka rezultuar se “3i Solution” sh.p.k. nuk ka dorëzuar sigurimin e ofertës, sipas shtojcës 3. Gjithashtu ka paraqitur vërtetim realizimi të Kontratës nr. 41/1 datë 15.04.2021 në vlerën 65 877 427 e cila nuk përbën 40% të vlerës së kontratës që prokurohet; - “MCN” sh.p.k. ka ofertuar me subjekt mbështetës “UNI Systems”, nuk plotëson kushtin për shërbime të tjera të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit financiar me vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës; kontrata që ka kryer me Sekretariatit e Shtetit në Greqi në vitin 2020 vërtetohet me fatura jo të fiskalizuar; vërtetimi i

projektit me "Alpha Bank" nuk shoqërohet me fatura tatimore shitjeje; vërtetimi i realizimit të kontratës me Ministrinë e Politikës Digjitale nuk është i vëltur me vultë apostile; fatura me nr. 160/2024 nuk ka të parashikuar shërbimin e kryer. Pra, ky operator nuk plotëson kapacitetin teknik; Dëshmi të shërbimeve të mëparshme; - "Soft Solution" sh.p.k. i plotëson të gjitha kriteret dhe është vlerësuar ofertë e vlefshme; - "Fastech" sh.p.k. nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës duke mos përmbushur kriteret e vendosura në DST. Në këto kushte është klasifikuar vetëm një ofertë e vlefshme, ajo e "Soft & Solution".

Nga kjo procedurë rezulton se dy subjekte kanë ofertuar pa sigurim oferte me qëllim për të rritur fiktivisht numrin e operatorëve konkurrues në procedurë. Subjekti "MCN" është skualifikuar pa kërkuar informacion shtesë lidhur me dokumentet e paraqitura nga ky operator për punë të ngjashme si vërtetim me vultë apostile, fatura tatimore etj. Skualifikimi është bërë me qëllim për t'i hapur rrugë subjektit "Soft & Solution" i cili ka qenë dhe me ofertë të lartë ekonomike se "MCN".

- Procedurat e prokurimit që lidhen me tërheqjen nga ankimet pranë KPP, nga subjekti "ABS", në pronësi të shtetasit Gerond Meçe.

Procedura e prokurimit me objekt: "Mirëmbajtje e sistemit FER për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit", në të cilën konstatohen këto veprime:

- Memo nr. 4023, datë 20.08.2024 "Mbi përfundimin e kontratës nr. 23, datë 24.08.2022 me objekt -Përmirësimi i sistemit FER për DPPSH", drejtuar Mirlinda Karçanaj-Drejtor i Përgjithshëm, nëpërmjet Hava Delibashi-Zëvendës-drejtor i Përgjithshëm, për dijeni Aldo Kita- Drejtor i Menaxhimit dhe Koordinimit të Investimeve e-Gov dhe TIK, Viola Agasi-Drejtor Juridik, Integritetit dhe Prokurimeve e-Gov dhe TIK, Edlira Sallaku-Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, etj.
- Relacion me nr. 2840, datë 26.06.2025 për argumentimin e fondit limit dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit, në të cilën evidentohet se grupi i punës ka ndjekur proceset e punës për studimin e tregut duke iu drejtuar me ftesën për ofertë pesë operatorëve ekonomikë, të cilët operojnë në këtë fushë si "Kreatx" sh.p.k. me vlerë 19 440 000 ALL, "R&T" sh.p.k. me vlerë 17 040 000 ALL, "Fastech" sh.p.k. 18 000 000 ALL, "Soft & Solution" sh.p.k. 16 800 000 ALL, "Image & Communications Development" sh.p.k. 16 200 000 ALL, ku vlera mesatare vlerësohet 17 496 000 ALL. Gjithashtu, në këtë dokument janë pasqyruar kriteret e veçanta të kualifikimit të cilat në mënyrë të përmbledhur janë: - Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 15 punonjës të siguruar për periudhën e 3 mujorit të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave; - Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë në të cilën të listojë emrat dhe gjeneralitetet e punonjësve që do të kenë akses në Datacenter të Autoritetit Përfutues dhe duhet të identifikohet Oficeri i Sigurimit Industrial. Këta të gjithë duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie CSP të lëshuar nga AKSIK, etj.
- Procesverbal nr. 3331, datë 24.07.2025 drejtuar shtetasës Mirlinda Karçanaj -Drejtor i Përgjithshëm, për dijeni Hava Delibashi -Zëvendës-drejtor i Përgjithshëm, pranoi Helena Çupi - Përgjegjëse Sektori i Prokurimeve, konceptoi Desian Ibro -Specialist Sektori i Prokurimeve.

Procesverballi mbalhet për të dokumentuar ekstraktin e ankesës me nr. A/2025/5602 publikuar me formularin nr. 1978/2025, datë 24.07.2025 si dhe kërkohet ngritja e komisionit të shqyrtimit të ankesës.

- “Kthim përgjigje” nr. 3331/2, datë 08.08.2025, mbi ankesën e paraqitur me nr. 1624/2025 nga “ABS” sh.p.k., drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik dhe operatorit ankues, në të cilën vihet re se operatori ekonomik është ankuar me objekt modifikimin e dokumenteve të tenderit, konkretisht:
 - ✓ Për heqjen e kriterit të veçantë për staf të pajisur me CSP (Certifikatë për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar) dhe OSI (Oficer i Sigurisë Industriale), si kriter i panevojshëm i cili çënon konkurrencën e lirë dhe barazinë e OE
 - ✓ Modifikimi i kriterit për “Listëpagesat E-Sig për 3 muajt e fundit nga njoftimi i kontratës së shpallur” për të bërë të mundur përputhjen me legjislacionin në fuqi dhe garantimin e një procesi prokurimi të drejtë, barabartë dhe gjithëpërfshirës.
 - ✓ Të korrigjojë konfuzionin e shkaktuar në lidhje me bazën e të dhënave (Oracle apo PostgreSQL).

Nga shqyrtimi i këtyre ankesave Autoriteti Kontraktor ka konstatuar se ato nuk qëndrojnë dhe në këto kushte vendosi të mos pranojë ankesën e ngritur nga operatori ekonomik.

- Shtojcë nr. 1 “Për ndryshimin e dokumenteve të tenderit në zbatim të vendimit të KPP me nr. 1188/2025” nr. 3331/4, datë 02.10.2025 në të cilën është vendosur ndryshimi i dy prej kriterëve të veçanta të kualifikimit pikërisht lidhur me “Listëpagesat e-Sig për 3 muajt e fundit” e cila hiqet dhe ndryshimi i databazës qendrore nga PostgreSQL në Oracle19 C. Sipas këtij dokumenti ky tender ishte parashikuar që të kryhej më datë 13.08.2025.
- Shkresa nr. 3331/5, datë 02.10.2025 drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me zbatimin e vendimit nr. 1188/2025, në të cilën i bëhet me dije se ka reflektuar ndryshimet në dokumentet e tenderit për kriteret e mësipërme por për kriterin e CSP ka konsideruar se është në përputhje me ligjin për arsye se operatori ekonomik për nevoja të kontratës do të hyjë dhe në ambiente të AKSHI dhe se këto ambiente janë të certifikuara sipas ligjit për informacionit e klasifikuar.
- Shkresë nr. 3331/6, datë 10.10.2025 në të cilën njoftohet operatori ankues “ABS” sh.p.k. se ankesa e tyre me nr. A/2025/5899 nuk është në përputhje me ligjin dhe nuk plotëson kushtet për shqyrtimin e saj, pasi ndryshimet e kryera në dokumentet e tenderit nuk janë miratuar me Vendim nga KPP, kështu që nuk mundet të ketë ankim lidhur me këto ndryshime.

Procedura e prokurimit me objekt: “Softe kompjuterike me karakter të përgjithshëm për Agjencinë e Zhvillimit të Territorit”, në të cilën konstatohen këto veprime:

- Formulari i njoftimit të kontratës me nr. 3157, datë 15.07.2025 në të cilën njoftohet shpallja e kësaj procedure, me fond limit 3 995 107 ALL pa TVSH, ku afati kohor i dorëzimit të ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje është më datë 28.07.2025, ora 13:00.
- Shkresë drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI me nr. 2579, datë 12.06.2025 për hartimin e specifikimeve teknike.

- Procesverbal i dorëzimit/hapjes së ofertave mbajtur më datë 01.08.2025 nga KVO, në të cilën kanë marrë pjesë 6 operatorë ekonomik përfshirë dhe subjektin "ABS" sh.p.k.
- Procesverbal për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave mbajtur më datë 21.08.2025 në të cilën janë klasifikuar si oferta të vlefshme dorëzuar nga operatorët ekonomik "Instant.al" sh.p.k. me vlerë oferte 2 625 000 ALL, "C.C.S." sh.p.k me vlerë oferte 3 700 282 ALL dhe "PC Store" sh.p.k me vlerë oferte 3 859 436 ALL. Ndërkohë janë klasifikuar si oferta të pavlefshme nga operatorët ekonomikë "NOAL" sh.p.k, "ABS" sh.p.k. dhe "Xperts Systems" sh.p.k. Bazuar në metodën e vlerësimit oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim rezulton oferta e operatorit ekonomik "Instant.al" sh.p.k., në vendin e dytë "CCS" sh.p.k. dhe në vendin e tretë "PC Store" sh.p.k.
- Formulari i njoftimit të fituesit me nr. 4024, datë 10.09.2025, në të cilin thuhet se nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik "ABS" sh.p.k., rezulton se është anomalisht e ulët dhe se nuk është në përputhje me kriteret e vendosura në DST, duke e konsideruar atë të pavlefshme.

Procedura e prokurimit "Përmirësimi i sistemit të thesarit", në të cilën evidentohen veprimet e mëposhtme":

- Urdhër me nr. 326, datë 16.10.2024, "Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e termave të referencës, përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e kriterëve të veçanta" nënshkruar nga shtetasja Mirlinda Karçanaj.
- Relacion me nr. 6403, datë 06.12.2024 "Për argumentimin e fondit limit dhe hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit", bashkë me procesverbalin për argumentimin e kriterëve të veçanta për kualifikim nënshkruar nga grupi i punës Suela Ago, Ensuida Boda dhe Elona Papa.
- Formulari i njoftimit të kontratës me nr. 6824, datë 26.12.2024, ku afati i dorëzimit të ofertave është data 27.01.2025.
- Shqyrtim i kërkesës për sqarim me nr. 531, datë 05.02.2025 nënshkruar nga shtetaset Suela Ago, Ensuida Boda dhe Elona Papa, në të cilën pasqyrohet se operatori "ABS – Advanced Business Solution" sh.p.k., ka paraqitur kërkesë për sqarim në Sistemin e Prokurimit Publik më datë 28.01.2025, ora 23:37, në të cilën në mënyrë të përmbledhur kërkesat janë si më poshtë:
 - ✓ AK të unifikojë kërkesën për kohëzgjatjen e garancisë së pajisjeve elektronike nëse duhet të jetë 1 vit apo 3 vite, pasi në dokumentet e tenderit ka përcaktime të ndryshme lidhur me këtë kohëzgjatje. Kjo kërkesë është pranuar dhe në DST janë bërë ndryshimet përkatëse.
 - ✓ Të sqarohet nga AK nëse po kërkon servera me single power supply apo dual hot-swappable redundant (1+1) power supplies. Kjo kërkesë nuk është pranuar pasi në termat e referencës janë përcaktuar kërkesat minimale që kërkohen të përmbushet, duke konsideruar që çdo element të jetë dubluar.
 - ✓ Duke qenë se është kërkuar frekuencë më e madhe, AK të sqarojë nëse mund të ofertojnë servera me frekuencë më të madhe se 5GHZ të pasuruar me core me frekuencë të optimizuar në 5GHZ. Kjo kërkesë nuk është pranuar pasi është kërkuar minimumi të jetë 5GHZ dhe jo më të madhe se 5GHZ.

- ✓ Të reflektohen ndryshimet në termat e përdorur në parametrat e pajisjes Switch nga System Memory në RAM dhe nga Procesori në FLASH. Këto kërkesa janë pranuar dhe janë reflektuar në DST.
- Shqyrtim i kërkesës për sqarim me nr. 346, datë 24.01.2025 nënshkruar nga shtetaset Suela Ago, Ensuida Boda dhe Elona Papa, në të cilën pasqyrohet se operatori “ABS – Advanced Business Solution” sh.p.k., ka paraqitur kërkesë për sqarim në Sistemin e Prokurimit Publik më datë 24.01.2025, në të cilën në mënyrë të përmbledhur kërkesat janë si më poshtë:
 - ✓ Duke qenë se AK ka kërkuar që disku SAS për storage të jetë me shpejtësi rrotullimi 10 000 rpm dhe kjo është e pamundur teknikisht, kërkohet sqarimi i këtij përcaktimi. Kjo kërkesë është konsideruar e drejtë nga grupi i punës dhe si rrjedhojë janë bërë ndryshimet përkatëse në DST duke e ndryshuar në kërkesë minimale teknike shpejtësinë e rrotullimit në 7 200 rpm.
 - ✓ AK të sqarojë pse është limituar në mënyrë eksplicite që disqet e sistemit të jenë M.2 SATA SSD të serverit back-up. Kjo kërkesë nuk është pranuar pasi ky përcaktim paraqet kërkesën minimale që duhet të plotësohet nga ofertuesit dhe duke qenë se në këto disqe do të instalohen sistemi operativ dhe aplikacioni backup, nuk është e nevojshme performancë e lartë.
 - ✓ Në dokumentet e tenderit thuhet se largësia midis dy siteve, atij të Thesarit dhe AFMIS është më e madhe se 2km ndërkohë që për lidhjen e tyre janë përcaktuar kritere të pajisjeve të transmetimit që janë më të mëdha se kjo largësi. Grupi i punës e ka pranuar këtë kërkesë duke bërë ndryshimet në dokumentet e tenderit duke ndryshuar kriterin nga “maksimumi 10 km” në “minimumi 10 km” si dhe një përcaktim tjetër lidhur me “komunikimin nga pajisja WDM deri te infrastruktura fizike e thesarit” e cila më parë në dokumentet e tenderit ishte përcaktuar me togfjalëshin “midis dy siteve”.
 - ✓ Nëse mund të ofertohej servera që plotësojnë kriteret, të pasuruara me funksionalitete me instruksione të zgjeruara etj. Grupi i punës sqaron se në dokumentet e tenderit janë paraqitur kërkesat minimale të cilat janë të nevojshme për t’u realizuar. Nëse OE do të ofrojë specifikime teknike më të larta se kërkesat minimale ato do të pranohen si zgjidhje për pjesën e specifikimeve të harduerit.
- Shkresa me nr. 1052, datë 06.03.2025 “Vendim në lidhje me ankesën e administruar pranë Autoritetit Kontraktor me nr. 114/2025 nga OE “ABS” sh.p.k, për modifikim të dokumenteve të tenderit”, në të cilën në mënyrë të përmbledhur pasqyrohen ankimet e mëposhtme:
 - ✓ Kërkohet ndryshim në termat e referencës lidhur me afatin kohor të implementimit të projektit duke pasuruar grafikun e lëvrimit me detajet e ndryshuara. AK thotë se e ka sqaruar bazuar në kërkesat për sqarim ku tregohet se janë lejuar hapësira kohore për OE në dorëzimin e pajisjeve dhe kohën e instalimit dhe verifikimit të funksionalitetit të tyre dhe jo ndryshime në afate kohore. Nuk shihet e nevojshme ndryshimi i afateve pasi nuk ka asnjë ndryshim në afatet e vendosura. Për këtë arsye kjo ankesë nuk pranohet.
 - ✓ AK të përcaktojë ku do të ruhet backup i të dhënave si dhe të përcaktojë kujt i referohet me “appliance backup” në mënyrë që të modifikohen specifikimet lidhur me të. AK thotë se OE duhet të shfrytëzojë një pjesë në hapësirën e pajisjes “SAN Storage” si hapësirë backup, e ilustruar qartë në termat e referencës. Ky pretendim nuk qëndron dhe nuk pranohet.
 - ✓ AK të kthejë specifikimet siç ishin; - infrastruktura virtuale të jetë e përputhshme me sistemin operativ të serverave të aplikacionit SIFQ. Këto servera janë të bazuara në Linux OS.; - Të lejojë edhe prodhuesit e tjerë ndërkombëtarë të ofrojnë pajisjet e tyre dhe konkretisht të shtohet

...në "ose ekuivalent"; - Duke qenë se nuk ka asnjë server me frekuencë 5GHZ kërkohet të ndryshohet frekuenca e serverit nga min 5GHZ në max 5GHZ. Lidhur me kërkesën e parë AK nuk kërkon në mënyrë eksplicite ndonjë sistem operativ të caktuar por të ofrojnë nga sistemet operative të certifikuara, e cila do të pranohet. Për ankesën e dytë AK kërkon këtë specifikim harduerik sepse sistemi ekzistues Oracle EBS është shumë i personalizuar dhe ndryshimi i tij mund të ndikojë në disponueshmërinë e sistemit dhe vonojë zbatimin e projektit. Lidhur me kërkesën e tretë AK thotë se kërkimi i harduerit ku frekuenca "clock speed" e procesorit do të jetë 5GHZ ose më e lartë dhe për arkitekturën RISC, nuk e kufizon konkurrencën ndërmjet ofertuesve sepse shumë ofertues mund të ofrojnë të njëjtin harduer por të kenë propozime të ndryshme në ofertën teknike të tyre, duke siguruar kërkesat e kërkuara. Pra kjo ankesë nuk pranohet.

- ✓ AK të ndryshojë dokumentet e specifikimeve teknike dhe të përcaktojë qartë se cilat janë licencat ekzistuese që do të përdoren nga OE për ndërtimin e ambientit të TEST. AK thotë se i takon AK të organizojë se cili grup licencash kërkohet për zbatimin e projektit. Nuk ka nevojë të arsyetojë se si do të përdoren licencat për mjedise të caktuara. Si përfundim AK nuk është i detyruar të specifikojë kërkesat e licencimit të softuerit për mjedisin TEST.
- ✓ AK duhet të ndryshojë dokumentet e specifikimeve teknike dhe të përcaktojë qartë kërkesat për licencimin e produktit "Oracle Data Integrator" pasi ka impakt në çmim. AK thotë se për detyra specifike të integritetit ofertuesi duhet të ofrojë të gjitha produktet softuerike të cilat duhet të mbështesin sistemin e ri Oracle EBS me sistemet e tjera të IT të cilat janë në objektin e këtij projekti. OE duhet të përfshijë në ofertën e tij me përshkrim se si duhen bërë, dhe me kosto të qartë që tregojnë atë artikull të ofruar. Kjo ankesë nuk pranohet.
- ✓ AK të përcaktojë specifikimet teknike të platformës së virtualizimit. AK thotë se kërkon një platformë virtualizimi në përputhje me produktin Oracle EBS version 12.2.13 dhe nuk është i detyruar të zbatojë ndonjë platformë specifike virtualizimi duke ofruar specifikime për këtë, por duhet të jetë në përputhje me produktin Oracle EBS dhe pa kosto shtesë për AK. Edhe kjo kërkesë nuk pranohet.

- Urdhër me nr. 148, datë 28.04.2025 "Për heqjen nga pezullimi të procedurës së prokurimit".
- Shtojcë me nr. 1053/7, datë 28.04.2025 "Për ndryshimin e dokumenteve të tenderit" në të cilën ndryshohet afati kohor i kryerjes së tenderit nga data 27.01.2025 në datë 08.05.2025.
- Procesverbal i dorëzimit dhe hapjes së ofertave datë 08.05.2025, ku në këtë procedurë prokurimi janë paraqitur ofertat ekonomike: "Naol" sh.p.k me NIPT L92201032D; - "MetaSoft360" sh.p.k me NIPT M21913023I; - BOE "ABS" sh.p.k. dhe "Datalog" sh.p.k. me vlerë 614 040 000 ALL me TVSH; - BOE "Communication Progress" sh.p.k. me "Horizon" sh.p.k. me vlerë 815 999 999 ALL me TVSH.
- Procesverbal (Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave "Përmirësimi i sistemit të thesarit") pa datë dhe pa numër protokolli, në të cilën thuhet se në procedurë janë paraqitur 4 operatorë si vijon:

"NAOL" sh.p.k., nuk ka paraqitur ofertë ekonomike, e cila është konsideruar e pavlefshme.
 "MetaSoft360" sh.p.k., nuk ka paraqitur ofertë ekonomike, e cila është konsideruar e pavlefshme.
 BOE "ABS" sh.p.k. dhe "Datalog" kanë paraqitur ofertë si më sipër. Nga shqyrtimi rezulton se ky BOE nuk plotëson kriteret e veçanta/kapacitetin teknik për kualifikim dhe nuk plotëson specifikimet teknike për kualifikim, argumentuar si më poshtë:

- ✓ Teknologjia e kërkuar është Oracle. Ofertuesi do të përdorë servera të prodhuar nga "Lenovo". Kjo çënon funksionimin e shtresës së aplikacionit. Serveri i propozuar "Lenovo" nuk është i certifikuar apo mbështetur nga Lenovo për Oracle. Edhe në dokumentacionin zyrtar të Lenovo nuk rezulton që Oracle Linux të suportohet. Nuk suportohet as procesori i gjeneratës së 5-të lidhur me Oracle Linux. Frekuenca e performancës së procesorit "AMD" ofertuar (deri në 5.15 GHZ) bie në kundërshtim me zgjidhjen e kërkuar pasi procesori nuk mund të realizojë më shumë punë 4.1 – 5.15, por në të gjitha rastet mbi 5 GHZ. Të gjitha referencat zyrtare të AMD, paraqesin vetëm termin "up to 5.0 GHZ" si frekuencë maksimale.
- ✓ Nuk ka marrëveshje/kontratë/autorizim me vendorin "Oracle" për plotësimin e kriterit në të cilën OE duhet të jetë i autorizuar nga vendori për "field delivery support". Ndërkohë BOE ka paraqitur dokument zyrtar autorizimin që ka me Lenovo.
- ✓ Në procesverbal thuhet që oferta e BOE nuk rezulton anomalisht e ulët. Më pas KVO kërkon argument nga BOE për ofertën anomalisht të ulët. Më pas KVO argumenton se BOE nuk ka paraqitur argumentim të plotë për angazhimin që ka në projekte të tjera lidhur me punonjësit që do të angazhohen në këtë projekt, kohën e punës së tyre, kosto në varësi të kohës që punonjësit do të merren në këtë projekt, krahasimisht me pagat e tyre. Nuk ka paraqitur një arsye pse ka ofertë anomalisht të ulët si zgjidhja e përzgjedhur, kusht favorizues i jashtëzakonshëm. Pretendimi i BOE se ka stok të mëparshëm për pajisjet harduare nuk mbështetet me analizë financiare kur janë blerë këto pajisje, sa ka ndryshuar çmimi i tyre, kostot e amortizimit etj. Për këtë arsye oferta e kësaj BOE është përcaktuar e pavlefshme.
- ✓ BOE "Communication Progress" sh.p.k. dhe "HORIZON" sh.p.k. kanë paraqitur ofertë si më sipër. Nga shqyrtimi rezulton se oferta përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar.
- Urdhër me nr. 242, datë 20.06.2025 "Për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e komisionit për shqyrtimin e ankesave" për shqyrtimin dhe trajtimin e Formularit të Ankesës së administruar pranë KPP me nr. 1591/2025, datë 02.06.2025 nga operatori ekonomik "ABS" sh.p.k.
- Kthim përgjigje me nr. 2741/3, datë 30.06.2025 "Kthim përgjigje mbi ankesën e ardhur në sistemin elektronik pranë KPP me nr. 1591/2025 nga OE "ABS" sh.p.k. & "DATALOG" sh.p.k., drejtuar KPP dhe në dijeni BOE në fjalë. Në mënyrë të përmbledhur përgjigjet e KSHA janë si më poshtë:
 - ✓ KVO ka përmbushur detyrën duke kryer veprime proaktive nga anëtarët me dënduri komunikimi e analizë të dokumentacionit të dorëzuar, etj. Për procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar KVO kërkon sqarime për ofertat anomalisht të ulëta. KSHA gjykon se KVO ka kërkuar sqarime për një ofertë anomalisht të ulët "të vlefshme" por "jo të kualifikuar", ndryshe nga sa operatori ekonomik ankimes paraqet në ofertën e tij, ku pretendon se kërkesa për sqarim mbi një ofertë anomalisht të ulët e bën automatikisht ofertën e kualifikuar.
 - ✓ AK të pranojë që serveri i propozuar nga OE është i certifikuar për softuerë ORACLE. Autorizimi i disponuar nga Lenovo është në kundërshtim me DST ku elementi më thelbësor i procedurës lidhet me vendorin ORACLE. Autorizimi duhet të jepet nga ORACLE dhe jo nga Lenovo. E njëjta logjikë dhe për përmbushjen e specifikimeve të pajisjes Lenovo ku në DST AK qartazi është e interesuar dhe e bazuar në teknologji Oracle. Edhe zgjidhjet e tjera të ofertuara lidhur me këto specifikime si përpunimi i më shumë instruksioneve për cikël ku

procesori Zen 4 e ka më të lartë se SPARK V9, bic në kundërshtim me kërkesat sipas Termave të Referencës pasi procesori nuk mund të realizojë më shumë punë 4.1 – 5.15, por në të gjitha rastet mbi 5GHz.

- ✓ Lidhur me deklaratimet e punonjësve dhe kohës së punës KVO i ka kërkuar shpjegime BOE ankimes mbi faktin se oferta rezultoi anomalisht e ulët. BOE duhej të parashtronte një zbërthim të detajuar të çmimit dhe ofertës sipas zërave të saj e ndarë në nënzërat përkatës. Zbërthim i kontratës i bazuar në analizë financiare që i referohet çmimit të blerjes, kostove të transportit zhdoganimit normën e fitimit. Gjithashtu, edhe për kostot e shërbimit e cila do të fokusohet në kostot e stafit, kostot e dpd administrative dhe të lidhura me të, e në fund normën e fitimit të BOE. BOE nuk ka paraqitur:
- ✓ Analizë të mirëfilltë të angazhimit të stafit pikërisht në këtë projekt pa lënë jashtë analizës angazhimi që BOE ka në projekte të tjera të mundshme.
- ✓ Vlera nominale financiare/kosto dhe kohore që këta punonjës do të jenë të angazhuar me projektet
- ✓ Listën e inventarit të pajisjeve që do të ofertohej, e konfirmuar me deklaratimin në pasqyrat financiare ose dokumentacion provues të ekzistencës të këtyre pajisjeve në furnizues të tjerë ku të evidentohen çmimet reference përkatëse në korrelacion të logjikshëm me ofertën e dorëzuar.
- ✓ Ankimesi ka kërkuar verifikimin dhe analizën e zgjidhjeve teknike të propozuara nga operatori fitues për zëvendësimin e modulit Buxheti i Sektorit Publik, i cili mungon te Oracle E-Business Suite me implementimin e modulit Oracle Public Sector Financials Internationals, me të njëjtat specifika funksionale dhe teknike si Public Sector Budgeting; - sigurimi dhe instalimi i licencave Oracle për Oracle Weblogic Server; - përfshirja e elementit Oracle Access Manager; - stafi i certifikuar nga Oracle për E-Business Suite Support Specialist dhe General Product Support Specialist, Modulin e Librit të Madh etj; përfshirjen e elementit Runtime Layer dhe Management Layer; - përfshirjen e elementit “custom” reports (të personalizuar sipas kërkesave të MF) ; - përkthimin në gjuhën shqipe të versioneve të përditësuara të Oracle; - instalimi dhe konfigurimi i Oracle Data Integrator.... – përfshirjen e sigurimit dhe instalimit të licencave të ambientit test të kërkuara; - përfshirjen e shtimit të një appliance për ruajtjen e backupeve. KSHA thotë se për të kryer këto veprime vlerësimi është ezauruar pasi KVO ka vlerësuar dokumentacionin e dorëzuar dhe zgjidhjet përkatëse. Kërkesa për të bërë rivlerësim të ofertës së konkurrentit mbi argumente e deduksione përkatëse nuk gjen mbështetje ligjore.
- ✓ Urdhër me nr. 315, datë 18.08.2025 “Për heqjen nga pezullimi i procedurës së prokurimit”.
- ✓ Raport përmbledhës nr. 3649, datë 18.08.2025 miratuar nga shtetasja Mirlinda Karçanaj në rolin e Drejtorit të Përgjithshëm në të cilën thuhet se:
- ✓ KVO duke marrë parasysh ngarkesën në punë, angazhimin në detyra të tjera funksionale si dhe për shkak të mungesës në punë për arsye shëndetësore, ka patur vonesë në shqyrtimin e dokumentacionit. Më datë 09.06.2025 konstatoi se OE plotëson kriteret e DST, formularit të deklaratimit dhe parashikimeve ligjore. Pas njoftimit të fituesit paraprak, brenda afateve të parashikuara në zbatim të LPP u paraqit ankesë nga OE “ABS” sh.p.k. me nr. A/2025/5441 me nr. 1591/2025 data 20.06.2025 ankesë pas vlerësimit të ofertave. AK shqyrtoi ankesën e paraqitur nga OE ankimes me shkresë nr. 2741/2, datë 30.06.2025, ku u bë me dije APP lidhur me këtë ankesë. Me Vendimin nr. 1054/2025 KPP gjykon se OE ankimes ka të drejtë që në çdo kohë të tërhiqet përpara përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankesës nga ana e KPP.

Returuar kërkesës së tij operatori kërkon si vijon "Me anë të kësaj shkrese BOE "ABS" sh.p.k. dhe "Datalog" sh.p.k. njofton zyrtarisht tërheqjen e ankimit të paraqitur për procedurën e prokurimit sipas të dhënave të mësipërme. Pas një kohe të konsiderueshme që ka kaluar nga momenti i paraqitjes së ankimit dhe duke marrë në konsideratë se shoqëritë tashmë janë të angazhuara me projekte të tjera prioritare, kemi vendosur të mos vijojmë më me këtë proces. Qëllimi është të shmangim çdo rrezik për zbatimin e mundshëm të kësaj procedure dhe për të mos ndikuar negativisht në zhvillimin e saj të mëtejshëm". Në këto kushte përsa operatori ekonomik ankimues ka paraqitur kërkesë për tërheqje nga ankesa KPP do të ndërpresë shqyrtimin e ankesës A/2025/5441 datë 19.06.2025. Përsa më sipër, KPP vendos të përfundojë procedimin administrativ në lidhje me ankesën e BOE.

- ✓ Në përfundim KVO vendosi të shpallë ofertën fituese: BOE "Communication Progress" sh.p.k. dhe "HORIZON" sh.p.k. Nënshkruar nga Amarilda Shkurta, Dorian Maci dhe Gilberta Selmanaj.
- Formulari i njoftimit të fituesit me nr. 3650, datë 18.08.2025.
- Formulari i njoftimit të Kontratës së Nënshkruar me nr. 4078, datë 15.09.2025.

Procedura e ndjekur nga KPP:

Në zbatim të vendimit të Prokurorit, u këqyrën dhe morën dokumentet e dosjes së veprimeve të ndjekura nga KPP për procedurën në fjalë. Në këtë dosje evidentohen këto dokumente:

- Ankesë protokolluar me numër 1591/1, datë 20.06.2025 me ankimues "Advanced Business Solutions" sh.p.k dhe "Datalog" sh.p.k, me objekt "Modifikim i dokumentave të tenderit; - Kundërshtim i vendimit të KVO lidhur me skualifikimin e ofertës; - Kundërshtim i KVO lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit; - Pavlefshmëri kontrate.
- Formular për Publikim me nr. 1591/1, datë 23.06.2025 "Lidhur më arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues dhe pretendimet mbi kualifikimin e ofertuesve të tjerë".
- Shkresë nr. 58, datë 25.06.2025 protokolluar në KPP me numër 1591/2, datë 30.06.2025 "Dërgim ankimi elektronik A/2025/5441 REF-34655-12-26-2024, nga "ABS" sh.p.k drejtuar KPP dhe AKSHI.
- Shkresë me nr. 2741/3, datë 30.06.2025 e AKSHI, protokolluar në KPP me numër 1591/3, datë 07.07.2025 "Kthim përgjigje mbi ankesën e ardhur në Sistemin Elektronik të Ankesave pranë KPP me nr. 1591/2025, nga OE "ABS" sh.p.k & "Datalog" sh.p.k.
- Njoftim për tërheqje nga ankimi me nr. 73, datë 12.08.2025 protokolluar në KPP me numër 1591/5, datë 12.08.2025 nënshkruar nga administratori i OE "ABS" sh.p.k. shtetasi Shkëlqim Kërluku, në të cilën ndër të tjera thuhet "Me anë të kësaj shkrese, BOE "Advanced Business Solutions – ABS" dhe "Data Log" njofton zyrtarisht tërheqjen e ankimit të paraqitur për procedurën e prokurimit sipas të dhënave të mësipërme.
- Njoftim urgjent datë 13.08.2025 nënshkruar nga administratori i "ABS" sh.p.k shtetasja Eriksela Shuli, protokolluar në KPP me numër protokolli 1591/6, datë 13.08.2025 drejtuar KPP, në të cilën thuhet se "Ditën e sotshme më datë 13.08.2025 jemi vënë në dijeni përpara faktit se më datë

12.08.2025 persona të paaautorizuar kanë arritur të ndërhyjnë në llogarinë tonë në e-albania duke ngarkuar dokument në seksionin e ankesave drejtuar institucionit tuaj sipas të cilave deklarohet "dorëheqje e ankimit të paraqitur" për procedurën Me këtë njoftim, ju lutem injoroni çdo dokument drejtuar Institucionit tuaj, të datës 12.08.2025. Ne nuk kemi patur asnjëherë asnjë rast, dhe për asnjë arsye ndonjë qëllim të tillë dorëheqje.

- Projektvendim me nr. 1054/2025, datë 13.08.2025 protokolluar në KPP me nr. 1591/8+1 datë 13.08.2025, nënshkruar nga shtetasi Fiorent Zguro në rolin e Nënkyetarit, Kreshnik Tërnova dhe Anila Malaj në rolin e anëtarit, për shqyrtimin e kërkesës për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me nr. A/2025/5441 datë 19.06.2025 i bashkimit të operatorëve "ABS" sh.p.k dhe "Datalog" sh.p.k, në të cilën KPP vendos "Të përfundojë procedimin administrativ në lidhje me ankesën e BOE.....". Ky projektvendim është konceptuar nga inspektori E. Nasufi.
- Vendim me nr. 1054/2025, datë 13.08.2025 protokolluar në KPP me nr. 1591/9, datë 13.08.2025 përsa shpjeguar më sipër.
- Shkresë nr. 1591/10, datë 13.08.2025 drejtuar AKSHI, BOE "ABS" sh.p.k. dhe "Datalog" sh.p.k., BOE "Communication Progress" dhe "Horizon" sh.p.k., për dijeni APP, në të cilën dërgohet vendimi sa më sipër.
- Kërkesë datë 15.08.2025, dërguar nga "ABS" dhe "Datalog" për KPP, për rishikim nga KPP të Vendimit të përcjellë me shkresën 1591/1, datë 13.08.2025 lidhur me Vendimin nr. 1054/2025 për përfundimit e procedurës administrative, protokolluar në KPP me numër 1591/12, datë 19.08.2025.
- Projektvendim i KPP me nr. 1095/2025 protokolluar më numër 1591/13+1, datë 20.08.2025 nënshkruar nga Fiorent Zguro në rolin e Nënkyetarit, Kreshnik Tërnova, Gjergji Mersini dhe Anila Malaj në rolin e anëtarit, për rishikimin e Vendimit nr. 1054/2025, në të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës me arsyetimin se "me argumentet e paraqitura nga ana e operatorit ekonomik "ABS" sh.p.k. nuk ofrohet apo vërtetohet mbi ndonjë fakt apo rrethanë të re. Sipas Kodit të Procedurave Administrative barra e provës bie mbi palën që inicion procedurën. OE nuk e ka mbështetur me prova konkrete teknike si raport ekspertize IT, kallëzim penal, vendim i AKSHI si autoritet teknik përgjegjës për e-Albania. Çdo pretendim i OE për ndërhyrje të paaautorizuar në llogarinë e tij nuk mund të verifikohet nga KPP, nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga KPP. Ky projektvendim është konceptuar nga inspektori E. Nasufi.
- Vendim i KPP me nr. 1095/2025 protokolluar me numër 1591/14 datë 20.08.2025 nënshkruar vetëm nga shtetasi Fiorent Zguro në detyrën e Nënkyetarit të KPP ndërkohë që anëtarët e tjerë nuk kanë nënshkruar, me të njëjtën përmbajtje si projektvendimi i mësipërm.
- Shkresë me nr. 1591/15, datë 20.08.2025 i KPP drejtuar BOE "ABS" sh.p.k. dhe "Datalog" sh.p.k., AKSHI, BOE "Communication Progress" sh.p.k. dhe "HORIZON" sh.p.k., Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në të cilën dërgohet Vendimi i mësipërm.
- Shkresë e dërguar nga subjekti "Datalog" sh.p.k. datë 20.08.2025 protokolluar në KPP me numër 1591/16, datë 21.08.2025, në të cilën kërkohet rishikimi i Vendimit me nr. 1591/9, datë 13.08.2025 për përfundimin e procedurave administrative për arsye se ky subjekt nuk ka shprehur kurrë në asnjë vendim individual apo të përbashkët vullnetin që si operator ekonomik apo BOE të tërhiqen nga ankimi i kryer në KPP. Kjo për arsye se në marrëveshjen e bashkëpunimit të datës

16.06.2025 midis BOE, në pikën 3 të saj thuhet se "Asnjëra prej shoqërive nuk ka të drejtë të tërhiqet nga detyrat dhe përgjegjësitë e marra përsipër në këtë marrëveshje bashkëpunimi për ndarjen e shpenzimeve procedurale dhe të detyrave të përfaqësimit pa miratimin paraprak të shoqërisë tjetër. Gjithashtu KPP ka shkëlur Vendimin nr. 766 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e KPP" ku në pikën 2 të nenit 9 përcaktohet se koha dhe rendi i ditës së mbledhjes së radhës së Komisionit është detyrë funksionale e Kryetarit të KPP dhe në pikën 2 të nenit 10 përcaktohet se anëtarë i KPP duhet të njihet të paktën 2 ditë para relatimit të çështjes si dhe të njihet me rendin e ditës së mbledhjes, Neni 22 thotë se rendi i ditës hartohet të paktën 3 ditë përpara mbledhjes.

- Nga kjo veprimtari rezulton bindshëm se dhe KPP ka nxituar të pranojë ankimimet e OE "ABS" të cilat i janë marrë forcërisht në rrethanat e përshkruara në këtë kërkesë çka do të thotë që kjo ka qenë e koordinuar me veprimet e grupit të strukturuar kriminal.
- KPP ka marrë në konsideratë vetëm "tërheqjen nga ankimimi" të vetëm njërit prej OE pa marrë në vlerësim faktin që në këtë procedurë ka qenë dhe një kompani tjetër si BOE, gjë e cila është dokumentuar plotësisht në marrëveshjen e bashkëpunimit mes dy operatorëve për pjesëmarrjen në këtë procedurë. Në këtë marrëveshje është parashikuar shprehimisht se asnjë nga OE nuk mund të tërhiqet nga gara individualisht pa marrë pëlqimin e tjetrit.

Procedura me objekt "Ndërtimi i sistemit informatik të menaxhinut të proceseve të brendshme për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Institucioneve të Varësisë (IEVP) dhe Infrastrukturës hostuese", me numër REF-49169-05-27-2025 në të cilën evidentohen dokumentet e mëposhtme:

Urdhër me nr.269, datë 20.09.2024 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimeve e termave të referencës për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit" i cili do të kryesohet nga shtetasit Sonja Sinorukaj, Evio Skënderaj dhe Alket Malo nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Nga përcaktimi i fondit limit duket se grupi i punës i ka dërguar kërkesë për ofertë disa operatorëve ekonomik si "Facilization", "Soft & Solution", "Image & Communication Development", "Kreatx", "Fastech". Në dukje ofertat e ardhura janë midis vlerave 353 097 000 – 354 900 000 ALL. Vlera shumë të përafërta dhe të pajustificuara me zëra të detajuar. Ngrihet dyshimi se këto vlera janë të paracaktuara. Urdhër prokurimi me nr. 35, datë 26.05.2025.

Urdhër nr. 246, datë 23.06.2025 për "Krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave" në të cilën janë caktuar Elona Alimehmeti, Leonard Meci dhe Migena Lala.

Procesverbal për hapjen e ofertave datë 27.06.2025 në të cilën konstatohet se janë paraqitur për të dhënë ofertat e tyre operatorët ekonomik si "ABS" sh.p.k. me vlerë 221 249 535 ALL, "Communication Progress" me vlerë 275 020 000 ALL, "KREATX" me vlerë 284 150 000 ALL pa TVSH si dhe "Instantal" sh.p.k. e "NAOL" sh.p.k. pa ofertë ekonomike.

Procesverbal për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave datë 22.07.2025 në të cilën dokumentohet se fituesi i ofertave të shqyrtuara është ajo e operatorit "ABS" sh.p.k. si oferta me e ulët ekonomike. Ndërkohë në vendin e dytë është renditur subjekti "Communaction Progress" sh.p.k. Ndërsa operatorët e tjerë nuk kanë patur oferta të vlefshme.

Procesverbal për shqyrtimin dhe ri-vlerësimin e ofertave datë 01.10.2025, me të njëjtët anëtarë, në të cilën dokumentohet se operatori "ABS" sh.p.k. nuk disponon certifikimet për:

Operacionet e sigurisë në nivel profesional të cilat duhet të përfshijnë analizë të thelluar të log-ëve

nga burime të ndryshme siç kërkohet në SOC; - Menaxhim incidentesh, analiza të kërcënimeve ose përgjigje ndaj incidenteve; - Nuk mbulon teknologji SIEM, EDR, SOAR, etj; - Nuk zhvillon aftësi në kërkimin e kërcënimeve (threat hunting) , analizë Malware apo intel të sigurisë. Operatori ka sjellë certifikime që mbulojnë konfigurimin e avancuar të firewall Check Point; - Vendosi dhe menaxhim të VPN; - Zgjidhje të problemeve në gateway-të e sigurisë; - Menaxhimi i politikave të sigurisë dhe clustering; - Përdorimi i SmartConsole, GAIA OS dhe mjetet Check Point për administrim.

Punonjësit e operatorit ekonomik duhet të jenë të certifikuar për servera Microsoft ose ekuivalent. Certifikatat e dorëzuara nga OE janë për zgjidhjet fizike të serverave në infrastrukturën HPE, ato nuk trajtojnë në mënyrë të thelluar platforma virtuale të serverave si Microsoft HyperV apo servera virtuale në Cloud. KVO vëren se OE ka paraqitur në ofertën e tij certifikatën "Microsoft Certified Solutions Associate: Windows Server 2016" për punonjësin Ilva Tarelli, e cila është një certifikatë që e plotëson kriterin e AK por rezulton se në shtojcën 10 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" të plotësuar nga OE, ku certifikimi nuk është plotësuar në pikën 2.3.8. g. Gjithashtu certifikimi i deklaruar dhe paraqitur nga OR për zhvillim dhe administrim të databazave MCSA SQL 2016 Database Development për punonjësit Aneta Deliu dhe Vanjeta Pine janë zyrtarisht të skaduara (expired) dhe të tërhequra nga Microsoft prej 31 Janar 2021.

Për këto arsye oferta e OE "ABS" sh.p.k është konsideruar e pavlefshme dhe për këtë arsye është renditur i pari operatori ekonomik "Communication Progress" sh.p.k.

Procesverbal nr. 4818, datë 23.10.2025 për shqyrtimin e ankimimit dhe ngritjen e grupit të punës.

Urdhër nr. 430, datë 23.10.2025 i Drejtorit të Përgjithshëm për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e KSHA, të përbërë nga Marko Çela, Marian Mara dhe Iljan Shamija.

Vendim nr. 4818/1, datë 05.11.2025 në lidhje me ankesën e OE "ABS" sh.p.k, në të cilën dokumentohet se AK nuk ka pranuar ankesën lidhur me faktin e punonjësve të certifikuar në operacionet e sigurisë në nivel profesional. OE në ankesën e tij ka paraqitur faktin se kërkesat e AK për analiza të thelluara log-esh, menaxhim incidentesh, SIEM, EDR, etj., nuk gjejnë referencë në termat e referencës së kësaj procedure prokurimi dhe janë përdorur për herë të parë në vlerësimin e KVO. KSHA ka pranuar certifikimin e njërit prej punonjësve Gentian Idrizaj me emërtimin "Fortinet Certified Professional Security Operations" dhe nuk ka pranuar certifikimin e punonjësës Vanjela Pine "ISO/IEC 27001:2022 Siguria e Informacionit, siguria kibernetike & mbrojtja e privatësisë – Sis, menaxhimit të sigurisë së informacionit". AK nuk ka pranuar certifikimin e dy punonjësve të OE si zhvillues databaze Microsoft ose ekuivalent duke pretenduar se certifikatat e dorëzuara nga OE janë zyrtarisht të skaduara (expired) dhe të tërhequra. OE pretendon se KVO nuk e ka përkthyer mirë informacionin e deklaruar nga Microsoft për këto certifikime dhe sqaron se në bazë të këtyre certifikatave punonjësit kanë fituar njohuri dhe aftësi teknike për të përdorur, administruar dhe zhvilluar zgjedhje bazuar në produktet dhe teknologjitë Microsoft. Njohuritë nuk kanë afat vlefshmërie dhe nuk skadojnë. Ky pretendim është pranuar nga KSHA. E njëjta gjë ka ndodhur dhe për certifikimet për administrim databaze në Microsoft.

Procedura e prokurimit "Mirëmbajtja e sistemit elektronik LIMS për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave", me fond limit e 22, 065, 600 (njëzetë e dy milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) Lekë pa TVSH, në të cilën evidentohen veprimet e mëposhtme:

Urdhër me nr. 189, datë 20.05.2025, "Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt: "Mirëmbajtja e

Formulari elektronik LIMS për drejtorinë e përgjithshme të doganave" nënshkruar nga shtetasja Mirlinda Kallamaj.

Relacionin me nr. 3107 prot., datë 11.07.2025 "Për argumentimin e fondit limit dhe hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, bashkë me procesverbalin për argumentimin e kriterëve të veçanta për kualifikim" nënshkruar nga grupi i punës Meri Manaj, Denis Molla dhe Ingrida Lusha.

Formulari i njoftimit të kontratës me nr. 3142 prot., datë 14.07.2025, ku afati i dorëzimit të ofertave është data 14.08.2025.

Më datë 24.07.2025 është bërë ankesë pranë AK dhe KPP, nga operatori ekonomik "ABS" sh.p.k., i cili ka ankimuar disa nga kriteret e veçanta të kualifikimit të miratuara nga AK, që kanë të bëjnë me kërkesat për pajisjen me certifikatë sigurie të punonjësve, identifikimin e tyre si dhe prezencën e tyre në listëpagesat e OE, për të paktën 3 muajt e fundit për një periudhë të pandërprerë pune, duke kërkuar riformulimin dhe modifikimin e kriterëve.

Urdhër nr.2992, datë 24.07.2025, "Për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e komisionit për shqyrtimin e ankesave", i përbërë nga Bashkim Kullolli, Leonard Meci dhe Ueda Matmuja.

KSHA, me vendimin nr.3332/1 prot., datë 08.08.2025, ka vendosur të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "ABS" dhe ngarkon njësinë e prokurimit të vijojë me procedurën e prokurimit.

Vendim i KPP nr.1057/2025, datë 13.08.2025, për përfundimin e procedimit administrativ, për shkak të shkresës së OE "ABS", për heqje dorë nga ankimi nr.76 prot., datë 12.08.2025, "Njoftim për tërheqje nga ankimi".

Ndërkohë, në bazë të kërkesës "Për rishikim vendimi", të OE "Advanced Business Solutions-ABS", drejtuar KPP-së, me vendimin nr. 1085/2025, datë 20.08.2025, u vendos mospranimi i kërkesës së OE "Advanced Business Solutions-ABS".

Me urdhrin nr. 339, datë 27.08.2025, "Për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave", përcaktohet se ky komision do të përbëhet nga Suela Ago kryetare, Ueda Matmuja dhe Dorian Maci anëtare.

Bazuar në procesverbalin e hapjes së ofertave, ka rezultuar se janë paraqitur gjithsej 3 oferta, 2 prej tyre nuk kanë paraqitur ofertë ekonomike dhe për rrjedhojë, në raportin përmbledhës të KVO, nr. 4573 prot., datë 13.10.2025, është argumentuar se oferta e vetme e vlefshme është ajo e paraqitur nga OE "Fastech" sh.p.k., ofertë e cila i ka përmbushur të gjitha kriteret dhe është kualifikuar si oferta e vetme e vlefshme.

Me formularin për njoftimin e fituesit, nr.4574 prot., datë 13.10.2025 është shpallur OE "Fastech" sh.p.k. si ofertë e suksesshme.

Arsyetim ligjor: Në relacionin me nr. 3107 prot., datë 11.07.2025 "Për argumentimin e fondit limit dhe hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, bashkë me procesverbalin për argumentimin e kriterëve të veçanta për kualifikim" nënshkruar nga grupi i punës Meri Manaj, Denis Molla dhe Ingrida Lusha, konstatohet se kriteri i parashikuar në shtojcën 2.3.6, parashikon se: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë, në të cilën të listojë emrat dhe gjeneralitetet e punonjësve të autorizuar që do të kenë akses fizik në ambientet e qendrës së të dhënave (datacenter) të AK dhe se gjithashtu duhet të identifikohet oficeri i sigurimit industrial, duke përfshirë gjeneralitetet e tij dhe rolin specifik në mbikëqyrjen e zbatimit të masave të sigurisë gjatë aksesimit të këtyre ambienteve. (të gjithë punonjësit e paraqitur sipas kriterit 2.3.6, duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie (CSP), të lëshuar nga AKSIK dhe se ajo duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.)

Për sa më sipër, në procesverbalin e grupit të punës "Për argumentimin e kriterëve të veçanta për

klasifikim", në argumentimin e kriterit të parashikuar në shtojcën 2.3.6, "Aftësitë teknike dhe profesionale" arsyetohet se: "Duke qenë se punimet për këtë kontratë do të kryhen në zona sigurie të klasit të parë dhe/ose të dytë, nevojitet që në zbatim të akteve rregullatore në fuqi, punonjësit e OE fitues të jenë të pajisur me certifikatën përkatëse që i mundëson ata të kenë atributet ligjore të nevojshme për të pasur akses në këto ambiente. Sistemi pozicionohet dhe hostohet në data center-in qeveritar në AKSHI, dhoma e serverave të së cilës është klasifikuar si zonë e sigurisë së klasit të parë. Bazuar në VKM-në nr. 189, datë 04.03.2015 "Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar sekret shtetëror", të NATO-s, BE-së shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare", pika 8 germa "a", specifikohet se aksesit në këtë zonë lejohet vetëm për personat e certifikuar përshtatshëmrisht dhe të autorizuar specifikisht për të hyrë".

Oficeri i sigurisë industriale është punonjësi përgjegjës i ngarkuar nga titullari i operatorit ekonomik për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kërkesave për sigurinë e personelit dhe të disiplinave të tjera të informacionit të klasifikuar. Për sigurinë fizike dhe për hyrjen brenda zonave të sigurisë është OSI individ i përgjegjës për personelin e pajisur me CSP të operatorit ekonomik, etj. Në këtë kuadër kërkohet edhe certifikata e sigurisë për oficerin e sigurisë industriale. (Shënim: Të gjithë punonjësit e paraqitur sipas kriterit 2.3.6 duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie (CSP) të lëshuar nga AKSIK dhe ajo duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.)

Organizimi i punës për realizimin e implementimit të projektit që prokurohet është në diskrecionin e vetë operatorit fitues, i cili përcakton se cili nga punonjësit e tij teknik sipas planit të punës do të ketë akses në qendrën e të dhënave (datacenter) të AK.

Arsyetohet se; Referenca ligjore në VKM-në nr. 189, datë 04.03.2015 "Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar sekret shtetëror", të NATO-s, BE-së shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare" është e gabuar pasi kjo VKM është shtetëzuar sipas VKM-së nr. 823, datë 26.12.2024 për miratimin e rregullores "Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar 'sekret shtetëror' të NATO-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare" I".

Ligji nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar":

KREU III SIGURIA E PERSONELIT Neni 27, parashikon se:

Siguria e personelit 1. Siguria e personelit është tërësia e masave dhe procedurave, mbi bazën e të cilave vlerësohet nëse një individ, duke iu referuar besnikërisë, besueshmërisë dhe sigurisë së tij, mund të autorizohet për të pasur qasje tek informacioni i klasifikuar, pa e rrezikuar sigurinë e këtij informacioni. 2. Lëshimi, refuzimi, pezullimi i përkohshëm bëhet nga AKSIK. 3. Kur ekspozohet informacioni i klasifikuar apo për shkak të një kushti, të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër, arsyet e refuzimit, pezullimit të përkohshëm apo heqjes së CSP-së nuk i bëhen me dije individit, institucionit kërkues apo operatorit ekonomik. 4. Procesi i verifikimit të sigurisë vijon edhe pas pajisjes së aplikantit me CSP. Kjo përfshin vlerësim të vazhdueshëm sigurie për çdo ndryshim në sjelljen e individit, që e bën atë të cenueshëm nga pikëpamja e besnikërisë, besueshmërisë dhe e sigurisë së tij. 5. Rregullat e detajuara për sigurinë e personelit përcaktohen në rregulloren që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28 Kriteret për njohjen e informacionit të klasifikuar

a) janë të pajisur me CSP, të ruajnë, të administrojnë e të transferojnë informacion të klasifikuar vetëm për informacionin që sigurojnë të drejtën e njohjes për shkak të detyrës që kryejnë nga titullari i ministrit/së/institucionit ose oficeri i sigurimit industrial i kontraktorit; b) janë të brifuar më parë për njohjen e procedurave të sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe të përgjegjësive individuale për shkeljet e sigurisë; dhe c) janë të pajisur me CSP, me përjashtim të rasteve për njohjen me informacionin e klasifikuar. 2. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Kryeministri dhe Kryetari i Kuvendit janë të autorizuar që të kenë qasje tek informacioni i klasifikuar për shkak të kryerjes së detyrave të tyre zyrtare e pajisen me CSP pa iu nënshtruar procedurave të verifikimit të sigurisë.

Më tej, ligji përcakton qartë rastin kur do të nevojitet CSI, dhe konkretisht, në nenin 51 të tij parashikon se: Neni 51 "Inicimi i procedurave të sigurisë"

1. Institucionet e administratës publike, të cilat gjatë veprimtarisë së tyre prodhojnë, administrojnë dhe qarkullojnë informacion të klasifikuar, kanë të drejtë të iniciojnë procedurat për kryerjen e një prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmban informacion të klasifikuar, sipas parashikimeve të legjislacionit të posaçëm të prokurimit në këtë fushë. 2. Çdo institucion i administratës publike, në cilësinë e autoritetit kontraktor, ka përgjegjësi që gjatë hartimit të dokumentacionit të tenderit apo zbatimit të kontratës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, të aplikojë sistemin e masave të sigurisë që garanton mbrojtjen e këtij informacioni, sipas kërkesave të përcaktuara në të gjitha disiplinat e sigurisë së informacionit të klasifikuar. 3. Operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, i cili përmban informacion të klasifikuar, u nënshtrohen rregullave specifike të sigurisë. 4. Angazhimi i operatorëve ekonomikë në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar në nivelin operatori ekonomik është i pajisur me nivelin e kërkuar të Certifikatës së Sigurisë Industriale (CSI).

Nga analizimi i dispozitave të mësipërme, evidentohet qartë fakti se OE të cilët marrin pjesë në prokurime në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, duhet të jenë të pajisur me certifikatën e sigurisë industriale (CSI). Në rastin konkret, procedura e prokurimit objekt hetimi, nuk rezultojnë të jetë procedurë sekrete, por procedurë e hapur, sipas aktit nr. 3142 prot., datë 14.07.2025 "Formulari i njoftimit të kontratës", i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, në pikën 2 të së cilës parashikohet shprehimisht lloji i procedurës së prokurimit: "Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar".

Më tej analizohet se kjo lloj procedure, është parashikuar në ligjin nr. 162/2020, i ndryshuar "Për prokurimin publik", neni 41 "Procedurat standarde të prokurimit" dhe gjithashtu në nenin 46 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Gjithashtu, analizohet se vetë ligji për prokurimin publik, në nenin 10 parashikon se: "Kontrata sekrete dhe kontrata që kërkojnë masa të veçanta sigurie", ka parashikuar se: "Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit, në rast se prokurimi ose zbatimi i tyre është klasifikuar sekret shtetëror apo kërkon masa të veçanta sigurie sipas legjislacionit në fuqi, ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësore të shtetit, me kusht që të jetë përcaktuar që interesat thelbësore në fjalë nuk mund të garantohen me vendosjen e kriterëve që synojnë mbrojtjen e natyrës së klasifikuar të informacionit, që autoriteti ose enti kontraktor i vë në dispozicion në procedurën e prokurimit."

Nenin 12 "Prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë"

1. Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkursat e projektimit që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.
2. Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkursat e projektimit, që edhe pse nuk përjashtohen nga zbatimi i pikës 1. në rast se interesat thelbësorë të shtetit nuk mund të garantohen me mënyra më pak ndërhyrëse si vendosur në kriteret, që synojnë mbrojtjen e natyrës së klasifikuar të informacionit, që autoriteti ose enti kontraktor i vë në dispozicion në procedurën e prokurimit.
3. Në rastin e kontratave të përziera, që kanë si objekt të tyre prokurimin që mbulohet nga ky ligj dhe prokurimin që mbulohet nga legjislacioni në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, zbatohet legjislacioni në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Nisur nga sa më sipër, rezulton se gjithashtu legjislatori ka vendosur një tjetër rregullim ligjor për kontratat publike, zbatimi ose implementimi i të cilave është klasifikuar "sekret shtetëror" dhe konkretisht, ligji nr.36/2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë" dhe VKM nr. 659 viti 2024 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë".

Në nenin 4 të këtij ligji parashikohet se:

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. "Autoritet kontraktor" është një institucion shtetëror, që kryen procedura prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. 2. "Certifikata e Sigurimit Industrial (CSI)" është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton, nga pikëpamja e sigurisë, se një operator ekonomik ka kapacitetet dhe aftësitë organizative, teknike e fizike dhe i plotëson standardet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar në një projekt/program apo kontratë/nëkontratë të klasifikuar. 3. "Certifikata e Sigurimit të Personelit (CSP)" është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton, nga pikëpamja e sigurisë, se një individ i plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

Gjithashtu, në nenin 1 të VKM-së nr. 659 viti 2024 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë", parashikohet se:

"Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i sistemit të masave të sigurisë, i procedurave dhe i rregullave bazë, në funksion të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar nga aksesit apo përhapja e paautorizuar e tij gjatë prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar dhe zbatimit të kontratës."

Për sa më sipër, arsyetohet se jo pa qëllim, legjislatori i ka parashikuar këto dy përkufizime (CSI dhe CSP) në pjesën hyrëse të ligjit nr. 36/2020, pasi ato janë standarde të cilat duhet të jenë të plotësuara në rastet e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë (ashtu siç përcaktohet dhe nga VKM nr. 659/2024), për këtë shkak dhe vetë ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", në nenin 10 të tij ka

përfshikuar se ky ligj nuk gjen zbatim në rastin e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, porse do të zbatohet me ligj të veçantë.

Në rastin konkret, parashikimi dhe argumentimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit, është *haptazi në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij*, zbatimi i të cilave, ka sjellë dhe skualifikimin në mënyrë të padrejtë të OE pjesëmarrës "ABS", pasi qartazi, *kërkesat për pajisje me CSI dhe CSP, janë kërkesa të cilat mund dhe duhet të bëhen vetëm në rastet e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.*

Më tej, pas ankimit të OE "ABS", KSHA, me vendimin nr.3332/1 prot., datë 08.08.2025, ka vendosur të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "ABS", duke arsyetuar si më poshtë: *"Përfshirja e kërkesave për Oficerin e Sigurisë Industriale (OSI) dhe certifikatat e sigurisë personale (CSP) është vendosur në këtë procedurë mbi bazën e nenit 77, pika 4 e ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, sipas të cilit autoritetet kontraktore mund të përcaktojnë kriterë të veçanta për të siguruar që operatorët ekonomikë zotërojnë burimet njerëzore dhe teknike të përshtatshme, për të realizuar kontratën sipas standardeve të kërkuara të cilësisë dhe sigurisë. Sistemi LIMS i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave është një ndër sistemet më kritike të infrastrukturës qeveritare për shkak të funksionit të tij për regjistrimin dhe menaxhimin e mostrave të ardhura për analizim në Laboratorin Doganor, duke shijelluar më tej se ky vendim është në përputhje me VKM-në nr. 823, datë 26.12.2024, ku përcaktohet se aksesimi në zona sigurie të klasit të parë ose të dytë lejohet vetëm për persona të certifikuar përshtatshëmrisht dhe të autorizuar, pra të pajisur me CP. Edhe pse procedura është e hapur, ajo zhvillohet në mjedise që përmbajnë zona sigurie të akredituara, të cilat, sipas akteve në fuqi, nuk mund të aksesohen pa certifikimin dhe mbikëqyrjen e personelit përkatës. Kjo ndodh për arsye që kanë të bëjnë me natyrën e informacionit të kontratës dhe me ambientin në të cilin zbatohet ajo...OSI nuk është një rol simbolik, por një funksion i domosdoshëm dhe i sanksionuar në VKM-në nr. 659/2024, për zbatimin e kërkesave të sigurisë industriale dhe se OSI është i nevojshëm, në çdo rast kur kontrata zbatohet në zona sigurie që përfshijnë infrastrukturë të mbrojtur, siç është rasti konkret..."*

Referuar arsyetimit të KSHA-së, analizohet se termi *"sistemet më kritike të infrastrukturës qeveritare"* i përdorur për sistemin LIMS, nuk gjen rregullim në asnjë akt ligjor dhe/apo nënligjor, dhe klasifikimi i tij si *kritik dhe/apo sensitiv*, vetëm për shkak të faktit se ai është i vendosur në data center-in e AKSHI-t, i cili është i klasifikuar, nuk gjen gjithashtu asnjë mbështetje ligjore.

Për më tepër, referenca e përdorur për VKM-në nr. 823, datë 26.12.2024 për miratimin e rregullores *"Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar 'sekret shtetëror' të NATO-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare"*, i referohet qartësisht sigurimit fizik të informacioneve të klasifikuara sekret të Nato-së, BE-së, të shteteve dhe organizatave ndërkombëtare, *çka nuk ka të bëjë me sistemin LIMS të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, apo regjistrimit dhe menaxhimit të mostrave të ardhura për analizim në laboratorët doganore.*

Zonat e sigurisë dhe klasifikimi i informacionit, janë të rregulluara me ligj dhe akte nënligjore, të cilat qartazi parashikojnë se *përcaktimi i sistemit të masave të sigurisë, i procedurave dhe i rregullave bazë, në funksion të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar nga aksesimi apo përhapja e paautorizuar e tij do të*

jetë vetëm gjatë prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar, dhe zbatimit të kontratës.

Këto rregullime janë të posaçme pikërisht për shkak të rëndësisë dhe sensitivitetit të të dhënave që ato mbartin, duke parashikuar gjithashtu në mënyrë të detajuar edhe mënyrën e klasifikimit, dhe ruajtjes fizike të tyre.

Nisur nga arsyetimi i përdorur nga KSHA-ja, se data-center i AKSHI është i klasifikuar, dhe për këtë arsye nevojitet pajisja e OE me certifikatat e mësipërme, analizohet fakti se edhe përpara kësaj rrethane, nisur nga parashikimet ligjore të VKM-së nr. 792, datë 28.12.2023 për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për sigurinë e informacionit të klasifikuar, që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe informacionit (ski)" I", në nenin 30 të tij "Mjediset dhe infrastruktura e rrjetit", parashikon se:

1. Për mbrojtjen e sistemeve aplikohen masa të sigurisë fizike në mjediset dhe infrastrukturën e rrjetit. 2. Sistemet ku trajtohet informacion i klasifikuar "Konfidencial" e lart instalohen dhe operojnë në zona sigurie të klasit I ose II. 3. Sistemet ku trajtohet informacion i klasifikuar "I kufizuar" kur nevoja operationale kërkon operimin e tyre jashtë zonave të sigurisë, instalohen minimalisht në zonë administrative. 4. Në rastet e shkëmbimit të informacionit të klasifikuar në formë elektronike jashtë zonave të sigurisë aplikohet mbrojtja kriptografike e informacionit.

Neni 31 Sigurimi fizik i serverëve dhe pajisjeve të komunikimit

1. Serverët dhe pajisjet e komunikimit vendosen në ambiente të veçanta të ndara nga zyrat e përdoruesve. 2. Sallat e serverëve dhe pajisjeve të komunikimit vendosen në zona sigurie të klasit I. 3. Sallat e serverëve dhe pajisjeve të komunikimit, si dhe rack-et sigurohen nga aksesit i paautorizuar ose dëmtimet fizike. 4. Çelësat ose mekanizmat ekuivalentë të aksesit të dhomave të serverëve dhe pajisjeve të komunikimit, si dhe rack-ëve kontrollohen përshtatshmërisht. 5. Në ambientet ku administrohen materiale ose sisteme të një rëndësie të veçantë (p.sh. materiale kriptografike) vendosen masa shtesë sigurie, si: përforsimi i integritetit të sigurisë nëpërmjet dy personave, ku të gjitha veprimet dëshmohen nga minimalisht një person tjetër i kualifikuar. Në këto zona sigurohen të gjitha pikat e hyrjeve dhe daljeve.

Neni 32 Sigurimi fizik i pajisjeve dhe mediave kompjuterike

1. Pajisjet dhe mediat elektronike që ruajnë informacion të klasifikuar regjistrohen në regjistra të veçantë me numër unik identifikimi dhe ruhen në përputhje me kërkesat e sigurisë, si gjatë orarit zyrtar të punës, ashtu edhe jashtë tij. 2. Pajisjet dhe mediat elektronike që ruajnë informacion të klasifikuar administrohen brenda zonave të sigurisë dhe pajisen me çelës për mbrojtjen ndaj ndërhyrjeve të paautorizuara. 3. Në rastet kur nuk është e mundur të aplikohen masat e përshtatshme të sigurimit fizik të pajisjeve dhe mediave kompjuterike, të bëhet fshirja e memories RAM, si dhe të përdoret një nga metodat e mëposhtme: a) përdorimi i hard diskut të jashtëm, i cili të ruhet në kasafortë jashtë orarit zyrtar të punës; b) konfigurimi i sistemit për të penguar ruajtjen e të dhënave lokalisht; c) përdorimi i programeve kriptografike për kriptimin e pajisjeve dhe mediave kompjuterike.

Nga analizimi i dispozitave të mësipërme, arsyeshëm analizohet se nëse në data-center-in e AKSHI do të

kishte sisteme apo pajisje kompjuterike të klasifikuara, ato ruhen në mënyra të posaçme sipas përcaktimeve të kësaj VKM-je dhe aksesit nga persona të paautorizuar, do të ishte i pamundur, për shkak se ato duhet të qëndrojnë në një ambient të veçantë.

Gjithashtu, edhe VKM-ja nr. 823, datë 26.12.2024 për miratimin e rregullores “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar ‘sekret shtetëror’ të NATO-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, në nenin 10, parashikon se:

Siguria teknike, elektronike dhe siguri me rojë, institucionet e administratës publike ose operatorët ekonomikë, në kuadrin e një prokurimi të klasifikuar, marrin masa, sipas akteve nënligjore në fuqi, për zbatimin e mënyrave të sigurisë fizike të informacionit të klasifikuar.

Sic u arsyetua dhe më sipër, termi i përdorur në VKM “*prokurim i klasifikuar*”, ka të bëjë pikërisht me prokurime në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, të cilat nuk gjejnë zbatim në rastin konkret, pasi procedura objekt hetimi, është një procedurë e parashikuar nga ligji nr. 162/2020 i ndryshuar “Për prokurimin publik”, dhe jo nga dispozitat e ligjit nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”.

Procedura e prokurimit “*Mirëmbajtja e sistemit elektronik LIMS për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë*”, me fond limit 29.993.490 (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë) Lekë pa TVSH, në të cilën evidentohen veprimet e mëposhtme:

Urdhër me nr. 159, datë 05.05.2025, “Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt: “*Mirëmbajtja e sistemit elektronik LIMS për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë*” nënshkruar nga shtetasja Mirlinda Karçanaj.

Relacion me nr. 2791 prot., datë 24.06.2025 “Për argumentimin e fondit limit dhe hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit” nënshkruar nga grupi i punës Ersila Qeramixhiu, Enklid Pelari dhe Brixhilda Sinanaj.

Formulari i njoftimit të kontratës me nr. 3143 prot., datë 14.07.2025, ku afati i dorëzimit të ofertave është data 14.08.2025.

Më datë 24.07.2025 është bërë ankesë pranë AK dhe KPP, nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS”, i cili ka ankimuar disa nga kriteret e veçanta të kualifikimit të miratuara nga AK, që kanë të bëjnë me kërkesat për pajisje me pajisjen me certifikatë sigurie të punonjësve, identifikimin e tyre si dhe prezencën e tyre në listëpagesat e OE etj., duke kërkuar riformulimin dhe modifikimin e kriterëve.

Urdhër nr.293, datë 24.07.2025, “Për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e komisionit për shqyrtimin e ankesave”, i përbërë nga Bashkim Kullolli, Leonard Meci dhe Ueda Matmuja.

Nga këqyrja e dokumenteve, nuk disponohet vendimi përkatës i KSHA.

Vendim i KPP nr.1056/2025, datë 13.08.2025, për përfundimin e procedimit administrativ, për shkak të shkresës së OE “Advanced Business Solutions-ABS”, për heqje dorë nga ankimi nr.77 prot., datë 12.08.2025, “Njoftim për tërheqje nga ankimi”.

Ndërkohë, në bazë të kërkesës “Për rishikim vendimi”, të OE “Advanced Business Solutions-ABS”, drejtuar KPP-së, me vendimin nr. 1093/2025, datë 20.08.2025, u vendos mospranimi i kërkesës së OE

"Advanced Business Solutions-ABS".

Me urdhrin nr. 3340, datë 27.08.2025, "*Për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*", përcaktohet se ky komision do të përbëhet nga z. Behar Laco, Scrkho Asllanaj dhe Lazarin Kraja anëtar.

Bazuar në raportin përmbledhës të KVO, nr. 4469 prot., datë 07.10.2025, ka rezultuar se janë paraqitur gjithsej 3 oferta, 2 prej tyre nuk kanë paraqitur ofertë ekonomike ("NAOL" sh.p.k dhe "IKubinfo" sh.p.k) dhe për trjedhojë, është argumentuar se oferta e vetme e vlefshme është ajo e paraqitur nga OE "Communication Progress" sh.p.k, ofertë e cila i ka përmbushur të gjitha kriteret dhe është kualifikuar si oferta e vetme e vlefshme.

Me formularin për njofsimin e fituesit, nr.4470 prot., datë 07.10.2025 është shpallur OE "*Communication Progress*" sh.p.k si ofertë e suksesshme.

Arsyetim ligjor: Në relacionin me nr. 2791 prot., datë 24.06.2025 "*Për argumentimin e fondit limit dhe hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit*" nënshkruar nga grupi i punës Ersila Qeramixhiu, Enklid Pelari dhe Brixhilda Sinanaj, gjithashtu dhe në procesverbalin për argumentimin e kriterëve të veçanta për kualifikim, konstatohet se kriteri i parashikuar në shtojcën 2.3.6, parashikon se: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë, në të cilën të listojë emrat dhe gjeneralitetet e punonjësve të autorizuar që do të kenë akses fizik në ambientet e qendrës së të dhënave (datacenter) të AK dhe se gjithashtu duhet të identifikohet oficeri i sigurimit industrial, duke përfshirë gjeneralitetet e tij dhe rolin specifik në mbikëqyrjen e zbatimit të masave të sigurisë gjatë aksesimit të këtyre ambienteve (të gjithë punonjësit e paraqitur sipas kriterit 2.3.6, duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie (CSP), të lëshuar nga AKSIK dhe se ajo duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.)

Për sa më sipër, në procesverbalin e grupit të punës "*Për argumentimin e kriterëve të veçanta për kualifikim*", në argumentimin e kriterit të parashikuar në shtojcën 2.3.6, "*Aftësitë teknike dhe profesionale*" arsyetohet se: "Duke qenë se punimet për këtë kontratë do të kryhen në zona sigurie të klasit të parë dhe/ose të dytë, nevojitet që në zbatim të akteve rregullatore në fuqi punonjësit e OE fitues të jenë të pajisur me certifikatën përkatëse që i mundëson ata të kenë atributet ligjore të nevojshme për të pasur akses në këto ambiente. Sistemi pozicionohet dhe hostohet në data center-in qeveritar në AKSHI, dhoma e serverave të së cilës është klasifikuar si zonë e sigurisë së klasit të parë. Bazuar në VKM-në nr. 189, datë 04.03.2015 "*Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar sekret shtetëror*", të NATO-s, BE-së shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare", pika 8 germa "a", specifikohet se aksesit në këtë zonë lejohet vetëm për personat e certifikuar përshtatshëmrisht dhe të autorizuar specifikisht për të hyrë".

Oficeri i sigurisë industriale është punonjësi përgjegjës i ngarkuar nga titullari i operatorit ekonomik për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kërkesave për sigurinë e personelit dhe të disiplinave të tjera të informacionit të klasifikuar. Për sigurinë fizike dhe për hyrjen brenda zonave të sigurisë është OSI individ i përgjegjës për personelin e pajisur me CSP të operatorit ekonomik, etj. Në këtë kuadër kërkohet edhe certifikata e sigurisë për oficerin e sigurisë industriale. (Shënim: Të gjithë punonjësit e paraqitur sipas kriterit 2.3.6 duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie (CSP) të lëshuar nga AKSIK dhe ajo duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.)

Organizimi i punës për realizimin e implementimit të projektit që prokurohet është në diskrecionin e vetë

1. përcaktuar nga ligji për taktikën se cili nga punonjësit e tij teknik sipas planit të punës do të ketë akses në bazën e të dhënave (datacenter) të AK.

Sqarim: Ky kriter i vendosur nga AK, është i paqartë dhe nuk i referohet ndonjë baze ligjore konkrete. Për më tepër, referenca ligjore në VKM-në nr. 189, datë 04.03.2015 "Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar sekret shtetëror", të NATO-s, BE-së shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare" është e gabuar pasi kjo VKM është shfuqizuar sipas VKM-së nr. 823, datë 26.12.2024 për miratimin e rregullores "Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar 'sekret shtetëror' të NATO-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare" I".

Në referim të parashikimeve ligjore që janë cituar më poshtë, rezulton se termi CSP (i referohet certifikatës së sigurisë së personelit) dhe termi CSI (i referohet oficerit të sigurimit industrial), janë terma që i shërbejnë qëshijeve të ndryshme dhe kanë rregullime të posaçme ligjore:

Ligji nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar":

1. Siguria e personelit është lërësia e masave dhe procedurave, mbi bazën e të cilave vlerësohet nëse një individ, duke iu referuar besnikërisë, besueshmërisë dhe sigurisë së tij, mund të autorizohet për të pasur qasje tek informacioni i klasifikuar, pa e rrezikuar sigurinë e këtij informacioni. 2. Lëshimi, refuzimi, pezullimi i përkohshëm bëhet nga AKSIK-ja. 3. Kur ekspozohet informacioni i klasifikuar apo për shkak të një kushti, të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër, arsyet e refuzimit, pezullimit të përkohshëm apo heqjes së CSP-së nuk i bëhen me dije individit, institucionit kërkues apo operatorit ekonomik. 4. Procesi i verifikimit të sigurisë vijon edhe pas pajisjes së aplikantit me CSP. Kjo përfshin vlerësim të vazhdueshëm sigurie për çdo ndryshim në sjelljen e individit, që e bën atë të cenueshëm nga pikëpamja e besnikërisë, besueshmërisë dhe e sigurisë së tij. 5. Rregullat e detajuara për sigurinë e personelit përcaktohen në rregullaren që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Më tej, ligji përcakton qartë rastin kur do të nevojitet CSI, dhe konkretisht, në nenin 51 të tij parashikon se: Neni 51 "Inicimi i procedurave të sigurisë"

1. Institucionet e administratës publike, të cilat gjatë veprimtarisë së tyre prodhojnë, administrojnë dhe qarkullojnë informacion të klasifikuar, kanë të drejtë të iniciojnë procedurat për kryerjen e një prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmban informacion të klasifikuar, sipas parashikimeve të legjislacionit të posaçëm të prokurimit në këtë fushë. 2. Çdo institucion i administratës publike, në cilësinë e autoritetit kontraktor, ka përgjegjësi që gjatë hartimit të dokumentacionit të tenderit apo zbatimit të kontratës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, të aplikojë sistemin e masave të sigurisë që garanton mbrojtjen e këtij informacioni, sipas kërkesave të përcaktuara në të gjitha disiplinat e sigurisë së informacionit të klasifikuar. 3. Operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, i cili përmban informacion të klasifikuar, u nënshtrohen rregullave specifike të sigurisë. 4. Angazhimi i operatorëve ekonomikë në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar në nivelin operatori ekonomik është i pajisur me nivelin e kërkuar të Certifikatës së Sigurisë Industriale (CSI).

Nga analizimi i dispozitave të mësipërme, evidentohet qartë fakti se OE të cilët marrin pjesë në

prokurime në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, duhet të jenë të pajisur me certifikatën e sigurisë industriale (CSI). Në rastin konkret, procedura e prokurimit objekt hetimi, nuk rezultoi të jetë procedurë sekrete, por procedurë e hapur, sipas aktit nr. 4470 prot, datë 07.10.2025 "Formulari i njoftimit të fituesit", i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, në të cilën parashikohet shprehimisht lloji i procedurës së prokurimit: "Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar".

Më tej analizohet se kjo lloj procedure, është parashikuar në ligjin nr. 162/2020, i ndryshuar "Për prokurimin publik", nenin 41 "Procedurat standarde të prokurimit" dhe gjithashtu në nenin 46 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Gjithashtu, analizohet se vetë ligji për prokurimin publik, në nenin 10: "Kontrata sekrete dhe kontrata që kërkojnë masa të veçanta sigurie", ka parashikuar se: "Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkursat e projektimit, në rast se prokurimi ose zbatimi i tyre është klasifikuar sekret shtetëror apo kërkon masa të veçanta sigurie sipas legjislacionit në fuqi, ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësore të shtetit, me kusht që të jetë përcaktuar që interesat thelbësore në fjalë nuk mund të garantohen me vendosjen e kriterëve që synojnë mbrojtjen e natyrës së klasifikuar të informacionit, që autoriteti ose enti kontraktor i vë në dispozicion në procedurën e prokurimit."

Nisur nga sa më sipër, rezultoi se gjithashtu legjislatori, ka vendosur një tjetër rregullim ligjor për kontratat publike, zbatimi ose implementimi i të cilave është klasifikuar sekret shtetëror dhe konkretisht, ligji nr.36/2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë" dhe VKM nr. 659 viti 2024 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë".

Në nenin 4 të këtij ligji parashikohet se:

Në këtë ligj termet e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. "Autoritet kontraktor" është një institucion shtetëror, që kryen procedura prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. 2. "Certifikata e Sigurimit Industrial (CSI)" është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton, nga pikëpamja e sigurisë, se një operator ekonomik ka kapacitetet dhe aftësitë organizative, teknike e fizike dhe i plotëson standardet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar në një projekt/program apo kontratë/nënkontratë të klasifikuar. 3. "Certifikata e Sigurimit të Personelit (CSP)" është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton, nga pikëpamja e sigurisë, se një individ i plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

Gjithashtu, në nenin 1 të VKM-së nr. 659 viti 2024 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë", parashikohet se:

"Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i sistemit të masave të sigurisë, i procedurave dhe i rregullave bazë, në funksion të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar nga aksesit apo përhapja e paautorizuar e tij gjatë praktikimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë

informacion të klasifikuar dhe zbatimit të kontratës."

Për sa më sipër, arsyetohet se jo pa qëllim, legjislatori i ka parashikuar këto dy përkufizime (CSI dhe CSP) në pjesën hyrëse të ligjit nr. 36/2020, pasi ato janë standarde të cilat duhet të jenë të plotësuara në rastet e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë (ashtu siç përcaktohet dhe nga VKM nr. 659/2024), për këtë shkak dhe vetë ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", në nenin 10 të tij ka parashikuar se ky ligj nuk gjen zbatim në rastin e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë porse ato rregullohen me ligj të veçantë.

Në rastin konkret, parashikimi dhe argumentimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit, është haplazi në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, pasi qartazi, kërkesat për pajisje me CPI dhe CPS, janë kërkesa të cilat mund dhe duhet të bëhen vetëm në rastet e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Për më tepër, referenca e përdorur për VKM-në nr. 823, datë 26.12.2024 për miratimin e rregullores "Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar 'sekret shtetëror' të NATO-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare", i referohet qartësisht sigurimit fizik të informacioneve të klasifikuara sekret të Nato-së, BE-së, të shteteve dhe organizatave ndërkombëtare, çka nuk ka të bëjë me sistemin LIMS të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Zonat e sigurisë dhe klasifikimi i informacionit, janë të rregulluara me ligj dhe akte nënligjore, të cilat qartazi parashikojnë se përcaktimi i sistemit të masave të sigurisë, i procedurave dhe i rregullave bazë, në funksion të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar nga aksesimi apo përhapja e paautorizuar e tij do të jetë vetëm gjatë prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar, dhe zbatimit të kontratës.

Këto rregullime janë të posaçme pikërisht për shkak të rëndësisë dhe sensitivitetit të të dhënave që ato mbartin, duke parashikuar gjithashtu në mënyrë të detajuar edhe mënyrën e klasifikimit, dhe ruajtjes fizike të tyre.

Nisur nga parashikimet ligjore të VKM-së nr. 792, datë 28.12.2023 për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për sigurinë e informacionit të klasifikuar, që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe informacionit (ski)"1", në nenin 30 të tij "Mjediset dhe infrastruktura e rrjetit", parashikon se:

1. Për mbrojtjen e sistemeve aplikohen masa të sigurisë fizike në mjediset dhe infrastrukturën e rrjetit. 2. Sistemet ku trajtohet informacion i klasifikuar "Konfidencial" e lart instalohen dhe operojnë në zona sigurie të klasit I ose II. 3. Sistemet ku trajtohet informacion i klasifikuar "I kufizuar" kur nevoja operationale kërkon operimin e tyre jashtë zonave të sigurisë, instalohen minimalisht në zonë administrative. 4. Në rastet e shkëmbimit të informacionit të klasifikuar në formë elektronike jashtë zonave të sigurisë aplikohet mbrojtja kriptografike e informacionit.

Neni 31 Sigurimi fizik i serverëve dhe pajisjeve të komunikimit

1. Serverët dhe pajisjet e komunikimit vendosen në ambiente të veçanta të ndara nga zyrat e

përdoruesve. 2. Sallat e serverëve dhe pajisjeve të komunikimit vendosen në zona sigurie të klasit 1. 3. Sallat e serverëve dhe pajisjeve të komunikimit, si dhe rack-et sigurohen nga aksesit i paautorizuar ose dëmtimet fizike. 4. Çelësat ose mekanizmat ekuivalentë të aksesit të dhomave të serverëve dhe pajisjeve të komunikimit, si dhe rack-ëve kontrollohen përshtatshmërisht. 5. Në ambientet ku administrohen materiale ose sisteme të një rëndësie të veçantë (p.sh. materiale kriptografike) vendosen masa shtesë sigurie, si: përforsimi i integritetit të sigurisë nëpërmjet dy personave, ku të gjitha veprimet dëshmohen nga minimalisht një person tjetër i kualifikuar. Në këto zona sigurohen të gjitha pikat e hyrjeve dhe daljeve.

Neni 32 Sigurimi fizik i pajisjeve dhe mediave kompjuterike

1. Pajisjet dhe mediot elektronike që ruajnë informacion të klasifikuar regjistrohen në regjistra të veçantë me numër unik identifikimi dhe ruhen në përputhje me kërkesat e sigurisë, si gjatë orarit zyrtar të punës, ashtu edhe jashtë tij. 2. Pajisjet dhe mediat elektronike që ruajnë informacion të klasifikuar administrohen brenda zonave të sigurisë dhe pajisen me çelës për mbrojtjen ndaj ndërhyrjeve të paautorizuara. 3. Në rastet kur nuk është e mundur të aplikohen masat e përshtatshme të sigurimit fizik të pajisjeve dhe mediave kompjuterike, të bëhet fshirja e memories RAM, si dhe të përdoret një nga metodat e mëposhtme: a) përdorimi i hard diskut të jashtëm, i cili të ruhet në kasafortë jashtë orarit zyrtar të punës; b) konfigurimi i sistemit për të penguar ruajtjen e të dhënave lokalisht; c) përdorimi i programeve kriptografike për kriptimin e pajisjeve dhe mediave kompjuterike.

Nga analizimi i dispozitave të mësipërme, arsyeshëm analizohet se nëse në data-center-in e AKSHI do të kishte sisteme apo pajisje kompjuterike të klasifikuara, ato ruhen në mënyra të posaçme sipas përcaktimeve të kësaj VKM-je dhe aksesit nga persona të paautorizuar, do të ishte i pamundur, për shkak se ato duhet të qëndrojnë në një ambient të veçantë.

Gjithashtu, edhe VKM-ja nr. 823, datë 26.12.2024 për miratimin e rregullores “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar ‘sekret shtetëror’ të NATO-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, në nenin 10, parashikon se:

Siguria teknike, elektronike dhe sigurimi me rojë Institucionet e administratës publike ose operatorët ekonomikë, në kuadrin e një prokurimi të klasifikuar, marrin masa, sipas akteve nënligjore në fuqi, për zbatimin e mënyrave të sigurisë fizike të informacionit të klasifikuar.

Siç u arsyetua dhe më sipër, termi i përdorur në VKM “prokurim i klasifikuar”, ka të bëjë pikërisht me prokurime në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, të cilat nuk gjejnë zbatim në rastin konkret, pasi procedura objekt hetimi, është një procedurë e parashikuar nga ligji nr. 162/2020 i ndryshuar “Për prokurimin publik”, dhe jo nga dispozitat e ligjit nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”.

Procedura e prokurimit “Biletimi qëndror online për muzetë dhe sitet e trashëgimisë kulturore. Përmirësimi i sistemit të biletimit elektronik dhe platforma e shitjes së biletave”, me fond limit 213.795.898 (dyqind e trembëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSH, në të cilën evidentohen veprimet e mëposhtme:

1. Urdhër me nr. 123, datë 15.10.2025, "Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt: "Biletimi qëndror online për muzetë dhe sitet e trashëgimisë kulturore. Përmirësimi i sistemit të biletimit elektronik dhe platforma e shitjes së biletave" nënshkruar nga shtetasja Mirlinda Karçanaj.

Relacion me nr. 6004 prot., datë 20.11.2024 "Për argumentimin e fondit limit dhe hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt: "Biletimi qëndror online për muzetë dhe sitet e trashëgimisë kulturore. Përmirësimi i sistemit të biletimit elektronik dhe platforma e shitjes së biletave" nënshkruar nga grupi i punës Aurel Vrenos, Doralda Muka dhe Ardit Kaba.

Urdhër prokurimi nr. 69, datë 26.11.2024, njësia e prokurimit e përbërë nga Emirton Suli, Martin Dobi dhe Saimir Mehmetas.

Formulari i njoftimit të kontratës me nr. 6263 prot., datë 02.12.2025, ku afati i dorëzimit të ofertave është data 06.01.2025.

Urdhër nr. 455 prot., datë 31.12.2024, "Për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave", të përbërë nga Jona Hoxha, Arbër Malaj dhe Servete Ceka.

Më datë 06.01.2025 është mbajtur procesverbali i dorëzimit/hapjes së ofertave, nga i cili rezulton se në këtë procedurë prokurimi kanë dorëzuar ofertat 3 operatorë ekonomikë, konkretisht BOE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k. me "Synapse ATS" sh.p.k.; BOE "Image&Communication development" sh.p.k me "HardTech" sh.p.k.; si dhe OE "Naol" sh.p.k., i cili nuk ka dorëzuar asnjë ofertë ekonomike (konstatohet se në disa procedura prokurimi, operatori ekonomik "Naol" sh.p.k. nuk dorëzon ofertë ekonomike. Gjithashtu nga verifikimet e kryera, rezulton se ky operator ekonomik nuk ushtron aktivitetin në fushën e teknologjisë së informacionit, shkak i cili arsyeshëm krijon bindjen mbi paracaktimin e ofertuesve ekonomike dhe/ose operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.)

Me procesverbalin për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, datë 04.03.2025, rezulton të jetë renditur i pari bashkimi i operatorëve "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k. me "Synapse ATS" sh.p.k., me vlerë 160,347,000.00 (njëqind e gjashtëdhjetë milion e treqind e dyzet e shtatë mijë lekë), si oferta më e leverdisshme e bazuar në çmim, ndërsa evidentohet me interes fakti se OE "Naol" sh.p.k., përsëri nuk ka dorëzuar ofertë ekonomike.

Me formularin e njoftimit të fituesit nr. 1957 prot., datë 05.05.2025 është shpallur BOE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k, si oferta e suksesshme.

Memo datë 20.05.2025, hartuar nga shtetasja Helena Çupi, në cilësinë e përgjegjëses të prokurimit, në të cilën është argumentuar ndër të tjera se: "Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka administruar shkresën me nr. 1243 prot, datë 14.04.2025 me lëndë "Dërgohet lista e Operatorëve Ekonomikë të pajisur me CSI të vlefshme", protokolluar me tonën me nr. 09 prot., datë 14.04.2025, me anë të së cilës Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar i ka vendosur në dispozicion AKSHI-t në rolin e Autoritetit Kontraktor, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 43 datë 20.07.2023 "Për qeverisjen Elektronike", i ndryshuar, listën me emrat e operatorëve ekonomik të pajisur me CSI të vlefshme. Vihet re se sipas listës së dërguar nga AKSIK operatori ekonomik "Synapse ATS" sh.p.k. me NIPT: L12321011H, nuk rezulton i listuar si operator ekonomik i pajisur me CSI të vlefshme..". Më tej, shtetasja Helena Çupi i referohet edhe dokumentacionit të paraqitur nga ky OE, ku konkretisht parashikohet se në vetëdeklarimin e paraqitur nga BOE është sjellë edhe shkresa me nr. 1859 prot., datë 15.06.2022 "Për pajisjen me Certifikatë të Sigurisë Industriale", të OE "Synapse ATS". Kjo CSI mban nr.132, datë 14.06.2022. Vlefshmëria e CIS është deri në datën 13.06.2026. Në vijim të përmbajtjes së kësaj shkrese, arsyetohet se ndodhur në kushtet ku asnjë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës nuk i

plotëson kushtet/kriteret për lidhjen e kontratës, AK duhet të anulojë procedurën e prokurimit, duke propozuar konkretisht dhe anulimin e saj.

Po në të njëjtën datë, është publikuar dhe “Formulari i njoftimit të anulimit të procedurës së prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit”, me nr. 2179 prot., datë 20.05.2025.

Procesverbal nr.2437 prot., datë 03.06.2025 Formular ankese i OE “Advanced Business Solutions-ABS” datë 30.05.2025, i cili në mënyrë të përmbledhur liston shkaqet e ankimit, ndër të tjerë faktin se AK ka ngatërruar termin “CSI” me “CSP”. Pajisja me certifikatë të sigurisë së personelit “CSP”, ka qenë një kriter i pëmbushur nga OE, referuar edhe formularit të vetëdeklarimit dhe konkretisht shkresës nr. 1859 prot. datë 15.06.2022, lëshuar nga Drejtorin e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë Kryeministrit, e cila konfirmon se BOE “Synapse ATS” sh.p.k., ka 7 (shtatë) punonjës të pajisur me CSP (certifikatë të sigurisë së personelit), duke pëmbushur kriterin sipas pikës 2.3.7 të DT dhe ndërkohë, shkak i skualifikimit i bazuar mbi mungesën e CSI-së, nuk është përmendur asnjëherë si kriter në DT dhe është një kërkesë krejt e ndryshme nga ajo për CSP, duke evidentuar kështu faktin se aplikimi i kërkesës për CSI në këtë fazë, përbën një ndryshim të paautorizuar dhe thelbësor të kriterëve të kualifikimit, që çënon barazinë e pjesëmarrësve në garë dhe transparencën e procedurës.

Shkresa nr. 2437/1 prot., datë 16.06.2025 me lëndë “Vendim në lidhje me ankesën e administruar pranë AK me nr.A/2025/5360...”. Në vendim KSHA nuk pranon ankesat e OE “Advanced Business Solutions-ABS” dhe “Synapse ATS” sh.p.k., duke argumentuar ndër të tjera se pajisja me CSI është pashmangshmërisht e lidhur me pajisjen me CSP, duke cituar dhe bazën ligjore përkatëse (përbërë nga Suela Ago kryetare; Klajdi Kokalla dhe Ermir Hajdini anëtarë).

KKP, me vendimin nr. 926, datë 21.07.2025, ka vendosur të pranojë ankesën e OE “Advanced Business Solutions-ABS” sh.p.k, duke detyruar AK të anulojë vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, dhe ta rikthejë atë në fazën para marrjes së vendimit të anulimit.

Me dy vendime të tjera të KPP-së, është vendosur gjithashtu, për shkak të moszbatimit të vendimit të KPP-së nr. 926, datë 21.07.2025, moslejimi i AK, të vijojë me hapat e mëtejshëm të kësaj procedure prokurimi.

Arsyetim ligjor: Në relacionin me nr. 6004 prot., datë 20.11.2024 “Për argumentimin e fondit limit dhe hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt: “Biletimi qendror online për muzelë dhe sitet e trashëgimisë kulturore. Përmirësimi i sistemit të biletimit elektronik dhe platforma e shitjes së biletave”” nënshkruar nga grupi i punës Aurel Vrenos, Doralda Muka dhe Ardit Kaba, gjithashtu dhe në procesverbalin për argumentimin e kriterëve të veçanta për kualifikim, konstatohet se kriteri i parashikuar në shtojcën 2.3.7, parashikon se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë, ku të citojë listën e punonjësve me gjeneralitetet përkatëse, të cilët do të aksesojnë fizikisht ambientet e qendrës së të dhënave (datacenter) të Autoritetit Përfitues. (të gjithë punonjësit e paraqitur sipas kriterit 2.3.7, duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie (CSP), të lëshuar nga AKSIK dhe ajo duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.)

Shënim: Për sa më sipër, evidentohet me interes fakti se tashmë, në këtë procedurë prokurimi, në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk është parashikuar më “OSI”, ose oficeri i sigurisë industriale të operatorit ekonomik, si në rastin e dy procedurave të mëparshme (mirëmbajtja e sistemit Lims për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Lims për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë).

Ligji nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar";

KRFLU III Siguria e personelit Neni 27, parashikon se:

Siguria e personelit 1. Siguria e personelit është tërësia e masave dhe procedurave, mbi bazën e të cilave vlerësohet nëse një individ, duke iu referuar besnikërisë, besueshmërisë dhe sigurisë së tij, mund të autorizohet për të pasur qasje tek informacioni i klasifikuar, pa e rrezikuar sigurinë e këtij informacioni. 2. Lëshimi, refuzimi, pezullimi i përkohshëm bëhet nga AKSIK-ja. 3. Kur ekspozohet informacioni i klasifikuar apo për shkak të një kushti, të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër, arsyet e refuzimit, pezullimit të përkohshëm apo heqjes së CSP-së nuk i bëhen me dije individit, institucionit kërkues apo operatorit ekonomik. 4. Procesi i verifikimit të sigurisë vijon edhe pas pajisjes së aplikantit me CSP. Kjo përfshin vlerësim të vazhdueshëm sigurie për çdo ndryshim në sjelljen e individit, që e bën atë të cenueshëm nga pikëpamja e besnikërisë, besueshmërisë dhe e sigurisë së tij. 5. Rregullat e detajuara për sigurinë e personelit përcaktohen në rregulloren që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28 Kriteret për njohjen e informacionit të klasifikuar

1. Kanë të drejtë të njihen, të ruajnë, të administrojnë e të transferojnë informacion të klasifikuar vetëm personat, që: a) sigurojnë të drejtën e njohjes për shkak të detyrës që kryejnë nga titullari i ministrisë/institucionit ose oficeri i sigurimit industrial i kontraktorit; b) janë të brifuar më parë për njohjen e procedurave të sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe të përgjegjësi individuale për shkeljet e sigurisë; dhe c) janë të pajisur me CSP, me përjashtim të rasteve për njohjen me informacionin e klasifikuar 2. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Kryeministri dhe Kryetari i Kuvendit janë të autorizuar që të kenë qasje tek informacioni i klasifikuar për shkak të kryerjes së detyrave të tyre zyrtare e pajisen me CSP pa iu nënshtruar procedurave të verifikimit të sigurisë.

Më tej, ligji përcakton qartë rastin kur do të nevojitet CSI, dhe konkretisht, në nenin 51 të tij parashikon se: Neni 51 "Inicimi i procedurave të sigurisë"

1. Institucionet e administratës publike, të cilat gjatë veprimtarisë së tyre prodhojnë, administrojnë dhe qarkullojnë informacion të klasifikuar, kanë të drejtë të iniciojnë procedurat për kryerjen e një prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmban informacion të klasifikuar, sipas parashikimeve të legjislacionit të posaçëm të prokurimit në këtë fushë. 2. Çdo institucion i administratës publike, në cilësinë e autoritetit kontraktor, ka përgjegjësi që gjatë hartimit të dokumentacionit të tenderit apo zbatimit të kontratës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, të aplikojë sistemin e masave të sigurisë që garanton mbrojtjen e këtij informacioni, sipas kërkesave të përcaktuara në të gjitha disiplinat e sigurisë së informacionit të klasifikuar. 3. Operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, i cili përmban informacion të klasifikuar, u nënshtrohen rregullave specifike të sigurisë. 4. Angazhimi i operatorëve ekonomikë në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar në nivelin operatori ekonomik është i pajisur me nivelin e kërkuar të Certifikatës së Sigurisë Industriale (CSI).

Nga analizimi i dispozitave të mësipërme, evidentohet qartë fakti se OE të cilët marrin pjesë në prokurime në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, duhet të jenë të pajisur me certifikatën e sigurisë industriale (CSI). Në rastin konkret, procedura e prokurimit objekt hetimi, nuk rezulton të jetë procedurë sekrete, por procedurë e hapur, sipas aktit Formulari i njoftimit të kontratës me nr. 6263 prot.,

datë 02.12.2025, ku shprehimisht përcaktohet lloji i procedurës së prokurimit: *"Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar"*.

Më tej analizohet se kjo lloj procedure, është parashikuar në ligjin nr. 162/2020, i ndryshuar *"Për prokurimin publik"*, neni 41 *"Procedurat standarde të prokurimit"* dhe gjithashtu në nenin 46 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*.

Gjithashtu, analizohet se vetë ligji për prokurimin publik, në nenin 10 parashikon se: *"Kontrata sekrete dhe kontrata që kërkojnë masa të veçanta sigurie"*, ka parashikuar se: *"Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkursat e projektimit, në rast se prokurimi ose zbatimi i tyre është klasifikuar sekret shtetëror apo kërkon masa të veçanta sigurie sipas legjislacionit në fuqi, ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësore të shtetit, me kusht që të jetë përcaktuar që interesat thelbësore në fjalë nuk mund të garantohen me vendosjen e kriterëve që synojnë mbrojtjen e natyrës së klasifikuar të informacionit, që autoriteti ose enti kontraktor i vë në dispozicion në procedurën e prokurimit."*

Neni 12 *"Prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë"*

1. Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkursat e projektimit që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.
2. Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkursat e projektimit, që edhe pse nuk përjashtohen nga zbatimi i pikës 1, në rast se interesat thelbësorë të shtetit nuk mund të garantohen me mënyra më pak ndërhyrëse si vendosja e kriterëve, që synojnë mbrojtjen e natyrës së klasifikuar të informacionit, që autoriteti ose enti kontraktor i vë në dispozicion në procedurën e prokurimit.
3. Në rastin e kontratave të përziera, që kanë si objekt të tyre prokurimin që mbulohet nga ky ligj dhe prokurimin që mbulohet nga legjislacioni në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, zbatohet legjislacioni në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Nisur nga sa më sipër, rezulton se gjithashtu legjislatori ka vendosur një tjetër rregullim ligjor për kontratat publike, zbatimi ose implementimi i të cilave është klasifikuar "sekret shtetëror" dhe konkretisht, ligji nr.36/2020 *"Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë"* dhe VKM nr. 659 viti 2024 *"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë"*.

Në nenin 4 të këtij ligji parashikohet se:

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. "Autoritet kontraktor" është një institucion shtetëror, që kryen procedura prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. 2. "Certifikata e Sigurimit Industrial (CSI)" është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton, nga pikëpamja e sigurisë, se një operator ekonomik ka kapacitetet dhe aftësitë organizative, teknike e fizike dhe i plotëson standardet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar në një projekt/program apo kontratë/nënkontratë të klasifikuar. 3. "Certifikata e Sigurimit të Personelit (CSP)" është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton, nga pikëpamja e sigurisë, se një individ i plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen,

ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

Gjithashtu, në nenin 1 të VKM-së nr. 659 viti 2024 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë"", parashikohet se:

"Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i sistemit të masave të sigurisë, i procedurave dhe i rregullave bazë, në funksion të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar nga aksesit apo përhapja e panautorizuar e tij gjatë prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar dhe zbatimit të kontratës."

Për sa më sipër, arsyetohet se jo pa qëllim, legjislatori i ka parashikuar këto dy përkufizime (CSI dhe CSP) në pjesën hyrëse të ligjit nr. 36/2020, pasi ato janë standarde të cilat duhet të jenë të plotësuara në rastet e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë (ashtu siç përcaktohet dhe nga VKM nr. 659/2024), për këtë shkak dhe vetë ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", në nenin 10 të tij ka parashikuar se ky ligj nuk gjen zbatim në rastin e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë porse ato rregullohen me ligj të veçantë.

Siç u arsyetua dhe më sipër, termi i përdorur në VKM "prokurim i klasifikuar", ka të bëjë pikërisht me prokurime në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, të cilat nuk gjejnë zbatim në rastin konkret, pasi procedura objekt hetimi, është një procedurë e parashikuar nga ligji nr. 162/2020 i ndryshuar "Për prokurimin publik", dhe jo nga dispozitat e ligjit nr. 36/2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë".

Në vijim, në memon e shtetasës Helena Çupi, miratuar nga titullarët Hava Delibashi dhe Mirlinda Karçanaj, datë 20.05.2025, në cilësinë e përgjegjëses të prokurimit, është argumentuar ndër të tjera se: "Agjencia Kombëtare Shqërisë së Informacionit ka administruar shkresën me nr. 1243 prot, datë 14.04.2025 me lëndë "Dërgohet lista e Operatorëve Ekonomikë të pajisur me CSI të vlefshme", protokolluar me tonën me nr. 09 prot, datë 14.04.2025, me anë të së cilës Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar i ka vendosur në dispozicion AKSHI-t në rolin e Autoritetit Kontraktor, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 43 datë 20.07.2023 "Për qeverisjen Elektronike", i ndryshuar, listën me emrat e operatorëve ekonomik të pajisur me CSI të vlefshme. Vihet re se sipas listës së dërguar nga AKSIK operatori ekonomik "Synapse ATS" sh.p.k, me NIPT: L12321011H, nuk rezulton i listuar si operator ekonomik i pajisur me CSI të vlefshme..". Më tej, shtetasja Helena Çupi i referohet edhe dokumentacionit të paraqitur nga ky OE, ku konkretisht parashikohet se në vetëdeklaratën e paraqitur nga BOE është sjellë edhe shkresa me nr. 1859 prot., datë 15.06.2022 "Për pajisjen me Certifikatë të Sigurisë Industriale", të OE "Synapse ATS", kjo CSI mban nr.132, datë 14.06.2022. Vlefshmëria e CIS është deri në datën 13.06.2026.

CSI e cituar në shkresën nr. 1243 prot., datë 14.04.2025 me lëndë "Dërgohet lista e Operatorëve Ekonomikë të pajisur me CSI të vlefshme", i referohet Certifikatës së Sigurisë Industriale dhe nuk ka asnjë lidhje me kriterin 2.3.7 të DT-së, në të cilin parashikohet se të gjithë punonjësit e paraqitur sipas kriterit 2.3.7, duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie (CSP), të lëshuar nga AKSIK dhe se ajo duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Më tej, nisur nga arsyetimi ligjor i këtij dokumenti, evidentohet me interes fakti se kthim përgjigja e AKSIK me nr. 1243 prot., datë 14.04.2025, me lëndë *"Dërgohet lista e operatorëve ekonomikë të pajisur me CSI të vlefshme"*, protokolluar pranë AKSHI, me nr. 09 prot, datë 14.04.2025 , së cilës i referohet memo, trajton heqjen dhe pezullimin e CSI (certifikatës së sigurisë industriale) dhe për rrjedhojë dhe heqjen e CSP (certifikatës së sigurisë së personelit), për disa nga punonjësit e operatorit ekonomik "Synapse ATS" sh.p.k.

Për sa më sipër, në memo interpretohet se: *"...Punonjësit e operatorëve ekonomikë e fitojnë CSP si rrjedhojë e pajisjes me CSI të Operatorit Ekonomik dhe nuk pajisen me akt administrativ apo ligjor të veçantë por enrat e tyre shënohen në aktin administrativ që përfiton operatori ekonomik kur pajiset me CSI..."*. Lidhur me këtë arsyetim si dhe referuar ligjit nr. 10/2023 *"Për informacionin e klasifikuar"*, analizohet se certifikata e sigurisë së personelit (CSP), dhe konkretisht CSI (certifikata e sigurisë industriale), është dokument i cili merret vetëm nga operatorët ekonomikë të cilët marrin pjesë në prokurime në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Konfuzioni ligjor i autoriteti kontraktor lidhur me pajisjen me CSP dhe CSI, duhet të ishte qartësuar dhe me dokumentacionin e administruar nga ana e tyre dhe këqyruar nga organi procedues, konkretisht korrespondencës shkresore me AKSIK të muajit Tetor 2025 (shkresë nr. 6203 prot., datë 27.10.2025), nëpërmjet të cilës AKSIK ka arsyetuar se: *"..Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), bazuar në kërkesat e ligjit nr.10/2023 "Për informacionin e klasifikuar" dhe në përcaktimet e pikës 2, të nenit 3 dhe pikës 4, të nenit 13, të VKM nr. 659, datë 23.10.2024 "Për sigurinë industriale, rregullat, procedura dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë", i konfirmon autoritetit kontraktor afatin e vlefshmërisë, nivelin dhe tipin e CSI-së, si dhe personelin e pajisur me CSP të përshtatshme, vetëm për operatorët ekonomikë që do të jenë pjesë e fazave të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar. Për rrjedhojë, në mungesë të një procedure konkrete prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmban informacion të klasifikuar, AKSIK nuk është në pozita ligjore dhe procedurale për të vënë në dispozicion një konfirmim të tillë, referuar shkresës tuaj".*

Për sa më sipër, arsyetohet se interpretimet dhe vendimmarrjet e autoritetit kontraktor, vijnë haptazi në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi, lidhur me pajisjen e operatorëve ekonomikë detyrimisht me CSP dhe për rrjedhojë me CSI, me argumentimin se do të aksesohet data-center-i i autoriteti përfitues.

Për rrjedhojë, miratimi i këtij kriteri dhe anulimi i procedurës së prokurimit, vijnë në kundërshtim me ligjin nr.162/2020 *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar, si dhe VKM-në nr.285/2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, të ndryshuar, duke krijuar arsyeshëm bindjen, se ato veprime të cilat janë kryer me qëllimin e vetëm për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për operatorë të tjerë ekonomikë.

Në vijim, me shkresën nr. 2437/1 prot., datë 16.06.2025 me lëndë *"Vendim në lidhje me ankesën e administruar pranë AK me nr.A/2025/5360..."*, KSHA nuk pranon ankesat e OE "Advaced Business

Solutions-ABS" dhe "Synapse ATS" sh.p.k., duke argumentuar ndër të tjera se pajisja me CSI është pushimangshëmrisht e lidhur me pajisjen me CSP, duke cituar dhe bazën ligjore përkatëse.

KPP, me vendimin nr. 926, datë 21.07.2025, ka vendosur të pranojë ankesën e OE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k., duke detyruar AK të anulojë vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, dhe ta rikthejë atë në fazën para marrjes së vendimit të anulimit.

Evidentohet me interes fakti se në hetimin administrativ të kryer nga KPP-ja është mbajtur edhe një korrespondencë shkresore me AKSIK, nga përmbajtja e së cilave, rezulton qartë fakti se pavarësisht se CSI dhe CSP janë të lidhura me njëra-tjetrën, *ato janë të domosdoshme vetëm në prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë*, çka arsyeshëm nënkupton faktin se edhe vetë ky kriter i vendosur nga grupi i punës me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor Mirlinda Karçanaj, por edhe arsyetimi ligjor i përdorur nga KSHA, janë haptazi në kundërshtim me ligjin. Në vijim të këtij arsyetimi, edhe në vetë referencat ligjore të përdorura nga KSHA, është cituar VKM nr. 659, viti 2024 *"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë"*. Vetë titulli i kësaj VKM-je, referon rregullat që kanë të bëjnë me procedurat e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Gjithashtu, në vendimin e KPP-së, është arsyetuar gjithashtu se nga ana e BOE ankimes ishte dorëzuar lista me punonjës me CSP të vlefshme në fazën e konkurrimit në këtë procedurë prokurimi, fakt ky që nuk ishte evidentuar nga ana e AK, duke pranuar kështu ankimin e bërë nga operatorët ekonomikë, dhe duke detyruar AK, të anulojë vendimin e anulimit, duke e rikthyer procedurën në fazën përpara anulimit.

Procedura e prokurimit *"Mirëmbajtja e sistemit elektronik të menaxhimit të vizitave dhe hyrje-daljeve në IEVP"*, me fond limit 46,800,000.00 (dyzet e gjashtë milion e tetëqind mijë) Lekë pa TVSH, në të cilën evidentohen veprimet e mëposhtme:

Urdhër me nr. 16, datë 20.01.2025, "Për ngritjen e grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt: *"Mirëmbajtja e sistemit elektronik të menaxhimit të vizitave dhe hyrje-daljeve në IEVP"*, nënshkruar në mungesë dhe me urdhër nga shtetasja Hava Delibashi. Grupi i punës i përbërë nga Ersila Qeramixhiu kryetare, Marianthi Derraj dhe Leonard Meci, anëtare.

AK i ka drejtuar kërkesë për ofertë operatorëve ekonomikë "Soft & Solution" sh.p.k., "R&T" sh.p.k., "Kreatx" sh.p.k., "Image and Communication Development" sh.p.k., "Fastech" sh.p.k.

Relacion me nr. 952 prot., datë 28.02.2025 *"Për argumentimin e fondit limit dhe hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit"* nënshkruar nga grupi i punës Ersila Qeramixhiu, Marianthi Derraj dhe Leonard Meci.

Formulari i njoftimit të kontratës me nr. 1151 prot., datë 12.03.2025, ku afati i dorëzimit të ofertave është data 14.04.2025.

Urdhër nr. 88, datë 12.03.2025 "Për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave" nr. 1166 prot., datë 12.03.2025, anëtarët Klod Metushllari kryetar dhe Marvin Gora dhe Pavlina Hysko anëtarë.

Procesverbal i dorëzimit/hapjes së ofertave, dt. 14.04.2025, nga i cili rezulton se janë paraqitur ofertat e

mëposhtme: OE "Naol" sh.p.k. i cili nuk ka paraqitur ofertë; OE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k., me ofertë 36,979,920 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH; OE "Communication Progress" sh.p.k., me ofertë 42,588,000 (dyzet e dy milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH; OE "R&T" sh.p.k., me ofertë 43,360,000 (dyzet e tre milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa TVSH; dhe OE "Albascan" sh.p.k., me ofertë 44,700,000 (dyzet e katër milion e shtatëqind mijë) lekë pa TVSH.

Procesverbal "Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave", datë 03.06.2025, nga i cili rezulton se OE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k., me ofertë 36,979,920 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH, ka plotësuar të gjitha kriteret dhe është renditur i pari si oferta ekonomike më e vlefshme.

Procesverbal "Për rivlerësimin e ofertave", datë 10.10.2025, nga i cili rezulton se OE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k., me ofertë 36,979,920 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH, tashmë nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, konkretisht KVO, vlerëson se: *"Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke u nisur edhe nga specializimet që kanë, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020.....si dhe kriterëve të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit, vendosën që të bëjnë shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi...në dokumentet standarde të tenderit kërkohet në pikën 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë partneritet me prodhuesin e pajisjeve të kontrollit të aksesit Matrix. Për të provuar këtë kërkesë duhet të paraqitet certifikata apo deklarimi zyrtar në faqen Web të prodhuesit. Pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori në lidhje me partneritetin me prodhuesin Matrix u konstatua se ky operator nuk rezulton në listën e partnerëve në faqen zyrtare të prodhuesit Matrix. Dokumenti i përcjellë nga "ABS" deklaroi se është shitës i autorizuar, dhe pas komunikimit elektronik me prodhuesin, Matrix shprehet se operatori ekonomik "ABS" nuk është partner zyrtar dhe të vetmit partner zyrtar për Shqipërinë janë të reflektuar në faqen Web...."* duke vendosur nëpërmjet këtij arsytimi, skualifikimin e këtij operatori ekonomik dhe duke kualifikuar kështu OE "Communication Progress" sh.p.k, si oferta ekonomike e vlefshme e bazuar në kriterin e çmimit më të ulët.

Urdhër nr.436, datë 28.10.2025 *"Për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e komisionit për shqyrtimin e ankesave"*, nr. 4909 prot, datë 28.10.2025, për shkak të ankesës së OE të skualifikuar "Advanced Business Solutions-ABS", me nr. aplikimi të ankesës online A/2025/6009, administruar nga KPP me nr. 3025/2025, datë 27.10.2025, si dhe ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), të përbërë nga Klodian Mazari kryetar, dhe anëtarë Enxhi Duro dhe Alida Zela.

KSHA, me vendimin nr. 4908/1 prot., datë 03.11.2025, ka vendosur mospranimin e ankesës së OE "Advanced Business Solutions-ABS", duke argumentuar në mënyrë të përmbledhur, në lidhje me ankesën e OE si më poshtë: *"...nga analizimi i të gjithë dokumentacionit, KSHA vlerëson se dokumenti i paraqitur në procedurë nga ana e "ABS", është një autorizim prodhuesi në të cilën autorizohet shoqëria të marrë pjesë në tender. Këto dy tipe dokumentesh janë totalisht të ndryshme...kërkesa "për status partneriteti" nënkupton që operatori ekonomik duhet të vërtetojë një marrëdhënie bashkëpunimi me prodhuesin, të jetë i regjistruar si partner i prodhuesit, i listuar në faqen zyrtare të tij. Ndërkohë, dokumenti i "autorizimit nga prodhuesi" është ai që specifikon që operatori ka të drejtë të furnizojë mallin e kërkuar, në territorin e përmendur, për modelin konkret, me vulë, firmë dhe datë, për një procedurë të caktuar. Dokumenti i partneritetit ka vlerë për të gjithë periudhën që ekziston ky status ndërsa autorizimi i prodhuesit është i vlefshëm vetëm për një procedurë me një objekt të caktuar..."* Ndër

të tjera, KSIIA shprehet se: "Me qëllim verifikimin e vlefshmërisë së këtij dokumenti, AK ka kryer komunikim zyrtar me prodhuesin "Matrix", i cili në përgjigjen e vet konfirmon se operatori ekonomik ankimues, statusin e partnerit zyrtar e ka marrë vetëm nga data 16 Tetor 2025, e në vijim, pra pas përfundimit të procedurës së tenderimit, çka vërteton që në momentin e zhvillimit të procedurës nuk ka qenë ky status dhe operatori ekonomik nuk e ka plotësuar këtë kriter...." Më tej, në lidhje me pretendimin e ankuesit për mosvënien në dispozicion të komunikimeve të zhvilluara ndërmjet KVO-së dhe prodhuesit, KSHA vlerëson se: "...këto komunikime përbëjnë pjesë të procesit të vlerësimit të ofertave dhe përmbajnë korrespondencë zyrtare me palë të treta, duke argumentuar kështu se AK ka të drejtë të mos vërë në dispozicion informacionin që mund të dëmtojë pozicionin tregtar të prodhuesit ose të operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurë. Për rrjedhojë, mosdhënia e këtyre komunikimeve nuk përbën shkelje të të drejtave të ankuesit, pasi përmbajtja thelbësore e verifikimit është reflektuar në mënyrë të plotë në arsyetimin e vendimit të KVO-së..."

Nga dokumentacioni i këqyrur rezulton se ende nuk është lidhur kontrata.

Arsyetim ligjor: Edhe në këtë procedurë prokurimi, si në rastet e tjera të konstatuara, kërkohet pajisja me CSP (certifikatë për sigurinë e personelit), e parashikuar në shtojcën 2.3.8, për shkak të aksesimit të Data-center të AKSHI. Ndryshe nga procedurat e tjera të prokurimit të zhvilluara nga AK, as në këtë procedurë nuk është kërkuar OSI (oficeri i sigurisë industriale), çka arsyeshëm nënkupton dhe konfuzionin ligjor të grupeve të punës mbi vendosjen e këtij kriteri, mungesën e bazës ligjore të tij, duke krijuar kështu dyshimin e arsyeshëm se është përdorur me qëllim favorizimin e operatorëve të tjerë ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura prokurimi.

Më tej, *evidentohet me interes fakti se* nëpërmjet procesverbalit të dorëzimit/hapjes së ofertave, dt. 14.04.2025, rezulton se janë paraqitur ofertat e mëposhtme: OE "Naol" sh.p.k. i cili nuk ka paraqitur ofertë; OE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k, me ofertë 36,979,920 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH; OE "Communication Progress" sh.p.k, me ofertë 42,588,000 (dyzet e dy milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH; OE "R&T" sh.p.k, me ofertë 43,360,000 (dyzet e tre milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa TVSH; dhe OE "Albascan" sh.p.k, me ofertë 44,700,000 (dyzet e katër milion e shtatëqind mijë) lekë pa TVSH.

Nga procesverbali "Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave", datë 03.06.2025, rezulton se OE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k, me ofertë 36,979,920 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH, ka plotësuar të gjitha kriteret dhe është renditur i pari si oferta ekonomike më e vlefshme.

Ndërkohë, pavarësisht faktit se KVO është shprehur mbi vlerësimin e ofertave, të cilin e ka botuar dhe në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), nëpërmjet procesverbalit "Për rivlerësimin e ofertave", datë 10.10.2025, se OE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k., me ofertë 36,979,920 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH, tashmë nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, konkretisht KVO, vlerëson se: "Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke u nisur edhe nga specializimet që kanë, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020.....si dhe kriterëve të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit, vendosën që të bëjnë

shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi në dokumentet standarde të tenderit kërkohet në pikën 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë partneritet me prodhuesin e pajisjeve të kontrollit të aksesit Matrix. Për të provuar këtë kërkesë duhet të paraqitet certifikata apo deklarimi zyrtar në faqen Web të prodhuesit. Pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori në lidhje me partneritetin me prodhuesin Matrix u konstatua se ky operator nuk rezulton në listën e partnerëve në faqen zyrtare të prodhuesit Matrix. Dokumenti i përcjellë nga "ABS" deklaron se është shitës i autorizuar, dhe pas komunikimit elektronik me prodhuesin, Matrix shprehet se operatori ekonomik "ABS" nuk është partner zyrtar dhe të vetmit partner zyrtar për Shqipërinë janë të reflektuar në faqen Web...." duke vendosur nëpërmjet këtij arsyetimi, skualifikimin e këtij operatori ekonomik dhe duke kualifikuar kështu OE "Communicatio Progress" sh.p.k., si oferta ekonomike e vlefshme e bazuar në kriterin e çmimit më të ulët.

Për sa më sipër, evidentohet me interes fakti se ripërpilimi i këtij procesverballi apo edhe rivlerësimi i ofertave, nuk ka asnjë bazë ligjore as në ligjin nr.162/2020 "Për prokurimin publik", apo dhe VKM-në nr.285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke krijuar kështu dyshime të arsyeshme mbi arsyet dhe shkaqet që shtynë këtë komision të rivlerësonte dokumentacionin për të cilin ishte shprehur tashmë me vendimin e datës 03.06.2025. Për më tepër, nga analizimi i dokumenteve të dorëzuara nga operatori ekonomik "Advanced Business Solutions-ABS", evidentohet me interes fakti se dokumenti i kërkuar sipas DT, konkretisht, i parashikuar në pikën 2.3.5 (Operatori ekonomik duhet të ketë partneritet me prodhuesin e pajisjeve të kontrollit të aksesit Matrix. Për të provuar këtë kërkesë duhet të paraqitet certifikata apo deklarimi zyrtar në faqen Web të prodhuesit), operatori ekonomik ka depozituar dokumentin e noterizuar dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, të lëshuar nga shoqëria "Matrix", i cili shprehimisht thotë: "Kjo letër vërteton se partneri ynë. "Advanced Business Solutions – ABS" është i autorizuar të ofrojë, shesë, instalojë dhe shërbejë Matrix Cosmec Pvt, Ltd, Produkti dhe Zgjidhjet...". Qartësisht ky dokument përmbush edhe kriterin e parashikuar në pikën 2.3.5, i cili kërkon që operatori të ketë partneritet me prodhuesin e pajisjeve të kontrollit të aksesit Matrix, nisur edhe nga fakti që në kriteret e miratuara, nuk ka sqarime shtesë, për formën apo përmbajtjen e dokumentit për vërtetimin e partneritetit me prodhuesin.

Siç edhe rezulton nga aktet e këqyrura, një sqarim i tillë as nuk rezulton të jetë kërkuar nga KVO, sipas parashikimeve ligjore të nenit 75, pika 4 e VKM-së nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në të cilën parashikohet shprehimisht se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit, nga Njësia e Prokurimit.

Më tej, për shkak të ankimimit të këtij vendimi nga ana e operatorit ekonomik, nëpërmjet Urdhrit nr.436, datë 28.10.2025 "Për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e komisionit për shqyrtimin e ankesave", nr. 4909 prot., datë 28.10.2025, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit dhe ngritja e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), të përbërë nga Klodian Mazari kryetar, dhe anëtarë Enxhi Duro dhe Alida Zela.

KSHA, me vendimin nr. 4908/1 prot., datë 03.11.2025, ka vendosur mospranimin e ankesës së OE "Advanced Business Solutions-ABS", duke argumentuar në mënyrë të përmbledhur, në lidhje me ankesën e OE si më poshtë: "...nga analizimi i të gjithë dokumentacionit, KSHA vlerëson se dokumenti i

paraqitur në procedurë nga ana e "ABS", është një autorizim prodhuesi në të cilën autorizohet shoqëria të marrë pjesë në tender. Këto dy tipe dokumentesh janë totalisht të ndryshme... kërkesa "për status partneriteti" nënkupton që operatori ekonomik duhet të vërtetojë një marrëdhënie bashkëpunimi me prodhuesin, të jetë i regjistruar si partner i prodhuesit, i listuar në faqen zyrtare të tij. Ndërkohë, dokumenti i "autorizimit nga prodhuesi" është ai që specifikon që operatori ka të drejtë të furnizojë mallin e kërkuar, në territorin e përmendur, për modelin konkret, me vulë, firmë dhe datë, për një procedurë të caktuar. Dokumenti i partneritetit ka vlerë për të gjithë periudhën që ekziston ky status ndërsa autorizimi i prodhuesit është i vlefshëm vetëm për një procedurë me një objekt të caktuar..." Ndër të tjera, KSHA shprehet se: "Me qëllim verifikimin e vlefshmërisë së këtij dokumenti, AK ka kryer komunikim zyrtar me prodhuesin "Matrix", i cili në përgjigjen e vet konfirmon se operatori ekonomik ankimes, statusin e partnerit zyrtar e ka marrë vetëm nga data 16 Tetor 2025, e në vijim, pra pas përfundimit të procedurës së tenderimit, çka vërteton që në momentin e zhvillimit të procedurës nuk ka qenë ky status dhe operatori ekonomik nuk e ka plotësuar këtë kriter..." Më tej, në lidhje me pretendimin e ankuesit për mosvënien në dispozicion të komunikimeve të zhvilluara ndërmjet KVO-së dhe prodhuesit, KSHA vlerëson se: "...këto komunikime përbëjnë pjesë të procesit të vlerësimit të ofertave dhe përmbajnë korrespondencë zyrtare me palë të treta, duke argumentuar kështu se AK ka të drejtë të mos vërë në dispozicion informacionin që mund të dëmtojë pozicionin tregtar të prodhuesit ose të operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurë. Për rrjedhojë, mosdhënia e këtyre komunikimeve nuk përbën shkelje të të drejtave të ankuesit, pasi përmbajtja thelbësore e verifikimit është reflektuar në mënyrë të plotë në arsyetimin e vendimit të KVO-së..."

Për sa më sipër, analizohet se arsyetimi ligjor i KSHA-së, është haptazi i pabazuar, pasi nuk ka asnjë bazë ligjore, apo referim në ndonjë normë ligjore konkrete, mbi përkufizimet kërkesa "për status partneriteti" apo dokumenti i "autorizimit nga prodhuesi", aq më tepër që ky kriter i parashikuar në DT, nuk ka patur asnjë sqarim shtesë mbi formën dhe përmbajtjen e tij.

Për më tepër, edhe dokumenti i dorëzuar nga operatori tjetër "Communication Progress" sh.p.k., nuk rezulton të shprehë qartë "partneritetin" me subjektin "Matrix", pasi nga përmbajtja e tij, rezulton si një certifikim, çka arsyeshëm krijon bindjen se vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe KSHA-së, kanë favorizuar dukshëm operatorin ekonomik "Communication Progress", duke skualifikuar në mënyrë të padrejtë OE "Advanced Business Solutions-ABS".

Nga këqyrja e dokumenteve të dosjes për procedurën e mësipërme të prokurimit pranë KPP-së, ka rezultuar se:

Lims për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë

Formular i ankesës pranë Autoritetit/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik datë 24.07.2025, nga ankimesi "ABS" sh.p.k. nënshkruar nga shtetasja Eriksela Shuli, protokolluar në KPP me nr. 1988, datë 24.07.2025.

Njoftim për tërheqjen nga ankimi nr. 77, datë 12.08.2025 nga "ABS" sh.p.k. nënshkruar nga shtetasi Shkëlqim Kërluku në rolin e administratorit, protokolluar në KPP me nr. 1988/1, datë 12.08.2025.

Njoftim urgjent datë 13.08.2025 drejtuar KPP nga "ABS" sh.p.k. nënshkruar nga shtetasja Eriksela Shuli në detyrën e administratores në të cilën thuhet se "Me këtë njoftim, ju lutem injoroni çdo dokument

drejtuar institucionet tona të datës 12.08.2025. Ne nuk kemi patur asnjëherë dhe për asnjë rast dhe për asnjë arsye ndonjë qëllim të tillë tërheqjeje”. Ky dokument është protokolluar në KPP me nr. 1988/2, datë 13.08.2025.

Projektvendim i KPP me nr. 1056, datë 13.08.2025 protokolluar me numër 1988/4+1, datë __.08.2025, i përbërë nga Fiorent Zguro, Kreshnik Tërnova, Anila Malaj dhe Gjergji Mersini në të cilën KPP vendos të përfundojë procedimin administrativ për këtë procedurë prokurimi, nënshkruar nga të gjithë anëtarët. Projektvendimi është punuar nga E. Streza.

Vendim i KPP me nr. 1056, datë 13.08.2025, protokolluar me numër 1988/5 datë 13.08.2025, i përbërë nga Fiorent Zguro, Kreshnik Tërnova dhe Anila Malaj në të cilën KPP vendos të përfundojë procedimin administrativ për këtë procedurë prokurimi, nënshkruar vetëm nga shtetasi Fiorent Zguro në cilësinë e Nënkretarit.

Shkresë nr. 1988/6, datë 13.08.2025 i KPP dërguar AKSHI dhe “ABS” sh.p.k. në të cilën dërgohet vendimi i mësipërm. Kjo shkresë është punuar nga E. Nasufi.

Projektvendim i KPP me nr. 1093/2025 datë 20.08.2025 protokolluar nr. 1988/7+1, datë __.08.2025, i përbërë nga Fiorent Zguri, Kreshnik Tërnova, Anila Malaj dhe Gjergji Mersini. Në pjesën arsyetuese të vendimit thuhet se: “Pretendimi i operatorit ekonomik në shkresën e datës 13.08.2025, në të cilën deklaron se tërheqja nga ankesa nuk është bërë me vullnetin e tyre, nuk përmban prova konkrete si akt ekspertize nga ekspertë të licencuar, komunikimi me AKSHI. Pretendimet nuk mund të merren në shqyrtim nga KPP por nga organet hetimore me karakter penal. OE nuk parashtrohet fakte apo dyshime të bazuara por ngre pretendime apriori, duke ngritur dyshime dhe hamendësime lidhur me ndërhyrjen në sistemin e-albania, në llogarinë e operatorit nga persona të paautorizuar. Gjithashtu KPP konstaton se kërkesa për tërheqje përmban të gjitha elementët e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative, formën e mundshme e cila në rastin konkret është e shkruar, kërkesa ka përcaktuar qëllimin i cili në rastin konkret është tërheqja nga ankesa 1988/2025, si dhe kërkuar në cilin është OE kërkuar. Për këto arsye KPP ka vendosur të mos pranojë kërkesën e “ABS” sh.p.k., për rishikim të vendimit të ndërprerjes së procedurës administrative. Projektvendimi është punuar nga E. Streza.

Vendim me nr. 1093/2025, datë 20.08.2025 protokolluar me numër 1988/8, datë 20.08.2025 në të cilën janë parashtruar të gjitha konstatimet dhe vendimet e shënuara në projektvendim. Ky vendim është nënshkruar vetëm nga shtetasi Fiorent Zguri në cilësinë e Nënkretarit të KPP.

Shkresë nr. 1988/9, datë 20.08.2025 i KPP drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, “ABS” sh.p.k., në të cilën dërgohet vendimi i mësipërm.

Procedura e prokurimit “Mirëmbajtja e sallës së monitorimit për Drejtorinë Përgjithshme të Burgjeve”, me fond limit 79,996,200 (shtatëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind) Lekë pa TVSH, në të cilën evidentohen veprimet e mëposhtme:

Urdhër me nr. 387, datë 20.11.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e termave të referencës, përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit” për procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtja e sallës së monitorimit për Drejtorinë Përgjithshme të Burgjeve” nënshkruar nga shtetasja Mirilinda Karçanaj.

Relacion me nr. 1000 prot., datë 04.03.2025 “Për argumentimin e fondit limit dhe hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtja e sallës së monitorimit për Drejtorinë Përgjithshme të Burgjeve”, nënshkruar nga grupi i punës Yrgys Çela kryetar, Elio Macaj dhe

1. Vio Skënderi anëtarë.

Procesverbal për argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Urdhër prokurimi nr. 14, datë 11.03.2025, nr. 1133 prot., datë 11.03.2025, Njësia e Prokurimit e përbërë nga Helena Çupi kryetare, Desian Ibro dhe Blerta Vuthaj.

Formulari i njoftimit të kontratës me nr. 1152 prot, datë 12.03.2025, ku afati i dorëzimit të ofertave është data 14.04.2025.

Urdhër nr. 89, datë 12.03.2025, "Për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave", të përbërë nga Klajd Memaj kryetar dhe Henri Arbana dhe Melsi Beli anëtarë.

Urdhër nr.133, datë 11.04.2025, për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave Melsi Beli me Gilberta Selamaj.

Më datë 14.04.2025 është mbajtur procesverbali i dorëzimit/hapjes së ofertave, nga i cili rezulton se në këtë procedurë prokurimi kanë dorëzuar ofertat 5 operatorë ekonomikë, konkretisht OE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k.; OE "AES Communication" sh.p.k.; OE "RATech" sh.p.k.; OE "ALBASCAN" sh.p.k., si dhe OE "Naol" sh.p.k., i cili nuk ka dorëzuar asnjë ofertë ekonomike *(konstatohet se në disa procedura prokurimi, operatori ekonomik "Naol" sh.p.k. nuk dorëzon ofertë ekonomike. Gjithashtu nga verifikimet e kryera, rezulton se ky operator ekonomik nuk ushtron aktivitetin në fushën e teknologjisë së informacionit, shkak i cili arsyeshëm krijon bindjen mbi paracaktimin e ofertuesve ekonomike dhe/ose operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.)*

Me procesverbalin për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, datë 07.05.2025, rezulton të jetë i renditur i pari operatori "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k me vlerë 59,997,150.00 (pesëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, si oferta më e leverdisshme e bazuar në çmim, ndërsa evidentohet me interes fakti se OE "Naol" sh.p.k., përsëri nuk ka dorëzuar ofertë ekonomike.

Më datë 19.05.2025 është mbajtur përsëri një procesverbal rivlerësimi nga KVO, konkretisht, në procesverbal argumentohet ndër të tjera se: "...Në përfundim të procedurës së prokurimit, thekson se ka zbatuar plotësisht përcaktimet ligjore të parashikuara në ligjin nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik"...dhe VKM 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar..etj. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të mësipërm, KVO deklaron të mbyllur fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave dhe në mbështetje të nenit 90, nenit 92, të ligjit nr. 162, viti 2020, vendosi të njoftojë menjëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës për këtë procedurë prokurimi në lidhje me vlerësimin e deklaruar më sipër, nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik në faqen zyrtare të APP-së, më datë 07.05.2025. Njësia e Prokurimit ka njoftuar nëpërmjet postës elektronike operatorin e renditur i pari, për paraqitjen e dokumentacionit të deklaruar në formularin e deklarimit. Njësia e Prokurimit kreu veprimet përkatëse në sistemin elektronik të APP-së pas vlerësimit të kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sa më sipër. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi mori në dorëzim dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k. konstatoi se: Operatori ekonomik fitues, ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kriterëve pika 2.3.3. për punonjësit me gjeneralitetet sipas dokumentacionit, por se tashmë KVO ka konstatuar se punonjësit të cilët janë të certifikuar nga AKSIK, me certifikatë të sigurisë së personelit të cilët disponojnë atributet e nevojshme ligjore për aksesimin e ambienteve të klasifikuara të AK, nuk kanë certifikimet e nevojshme teknike të kërkuar nga DST për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe/ose dhënien e suportit në rast problematike në lidhje me sistemin e kamerave, alarmit, akses kontrollit apo pajisjeve të menaxhimit të imazheve filmike.

Nisur nga sa më sipër KVO gjykon se kriteret e veçanta të specifikuara nga AK janë në funksion të ofrimit për AK të sigurisë së operatorit ekonomik me të cilin do të lidhet kontrata përkatëse dhe do të ofrojnë shërbimet e kërkuara sipas specifikimeve teknike, disponon të gjithë burimet dhe kapacitetet e nevojshme, ndër të tjera teknike, për të siguruar një zbatim të plotë dhe të saktë në sasi dhe cilësi të kontratës. *Pra, kriteret janë komplementarë të njëri-tjetrit në shërbim të një funksioni të vetëm* "Dhënie e sigurisë që OE disponon kapacitetet e nevojshme për zbatimin e kontratës. Në vijim të sa më sipër trajtuar, KVO gjykon se punonjësit e certifikuar me certifikatë të sigurisë së personelit nuk disponojnë kapacitetet e nevojshme teknike për të zbatuar kërkesat e AK që lidhen me sistemet e menaxhimit të video VMS, sistemet e akses kontrollit, sistemet e alarmit, sistemet e monitorimit me kamera, sistemet e telefonisë VOIP dhe njëkohësisht, punonjësit të cilët sipas dokumentacionit të paraqitur rezultojnë se i disponojnë këto kapacitete, nuk janë të pajisur me certifikatë CSP dhe për rrjedhojë e kanë të pamundur të aplikojnë njohuritë e tyre teknike në vend për të ofruar shërbimin sipas kërkesave të AK..", duke sjellë si rrjedhojë skualifikimin e këtij operatori dhe kualifikimin në vend të parë të OE "RATECH" sh.p.k, me vlerë të ofertës 71,996,600.00 (shtatëdhjetë e një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH. (afërsisht 12,000,000.00 (dymbëdhjetë milionë) lekë më shumë se oferta e OE "Advanced Business Solutions-ABS").

Më datë 22.07.2025 është bërë ankesë pranë AK dhe Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e OE "Advanced Business Solutions-ABS", i cili në mënyrë të përmblodhur ka parashtruar faktin se: me shkresën nr. 38 prot., datë 13.05.2025, pas njoftimit në SPE për shpalljen e fitues dhe njoftimit nga njësia e prokurimit për dorëzimin fizik të dokumentacionit sipas shtojcës nr.10 të formularit të vetëdeklarimit, KVO, ka rivlerësuar ndryshe, në kapërcim të kompetencave ligjore, dokumentacionin e dorëzuar i cili i ishte nënshtruar verifikimit pasi kishte qenë i ngarkuar në SPE dhe me vlerësimin e dytë, KVO bën një tjetër vlerësim të kriterëve të veçanta të kualifikimit, duke sjellë si pasojë skualifikimin e këtij operatori. Ndër të tjera, OE ka arsyetuar se rivlerësimi i KVO-së, duke i trajtuar kërkesat e pikave 2.3.5 dhe 2.3.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit si komplementare ndaj njëra-tjetrës, bën një vlerësim subjektiv dhe të pabazuar pasi në vetë DT është përcaktuar fakti se "Organizimi i punës për realizimin e implementimit të projektit që prokurohet është në diskrecionin e vetë operatorit ofertues, i cili përcakton se cili nga punonjësit e tij teknik sipas planit të punës do të ketë akses në ambientet e klasifikuara të Autoritetit Përfitues. Përcaktimi nga Autoriteti Përfitues të personelit teknik të operatorit që do të ketë akses fizik në zonat e sigurisë do të ishte ndërhyrje në organizimin e punës së operatorit".

Urdhër nr.282, datë 23.07.2025 me nr.3301 prot, datë 23.07.2025 "Për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave", i cili do të përbëhet nga Klodian Mazari Kryetar dhe Iljan Shamija dhe Jonida Mona anëtare.

Shkresa me nr. 3300/1 prot., datë 05.08.2025 me lëndë "Vendim në lidhje me ankesën e administruar pranë Autoritetit Kontraktor me nr.1965/2025, nga operatori ekonomik "Advanced Business Solutions-ABS", sh.p.k për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të procedurës së prokurimit me objekt "Mirëmbajtja e sallës së monitorimit për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve" me nr. REF-40695-03-12-2025.

Në arsyetimin e tij, në mënyrë të përmblodhur, KSHA ka argumentuar se:

"...KSHA gjykon se KVO ka vepruar tërësisht në përputhje me interesin publik, interesin e autoritetit kontraktor dhe bazën ligjore në fuqi. Teknikisht dhe ligjërisht KVO ka konstatuar dhe argumentuar se AK në kërkesat e përcaktuara në DST është kërkuar që operatorët ekonomikë të interesuar duhet të kenë një

ndër të caktuar punonjësish të certifikuar sipas objekteve përkatëse në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe vëllimin e shërbimeve që kërkohen. Pra, është e qartë që një ose më shumë punonjës të operatorit ekonomik që zotërojnë certifikimet teknike, në rast se nuk posedojnë CSP, do të çojnë AK, operatorin ekonomik dhe autoritetin përfitues përpara dy zgjedhjeve, ose të mos zbatohet kontrata gjë e cila ka një impakt fatal për fondet buxhetore, interesin publik, mosrealizimin e shërbimit, rrezikimin e jetës së punonjësve të institucioneve të ekzekutimit të dënimit, rritjen e shpenzimeve procedurale, etj, ose të mos zbatohet legjislacioni në fuqi për informacionin e klasifikuar...”

Vendim nr.1055/2025 i KPP, lidhur me njoftimin për tërheqje nga ankimi nr. nr.1965/2025, datë 23.07.2025 i OE “Advanced Business Solutions-ABS” sh.p.k. (rezulton se më datë 12.08.2025 Komisioni i Prokurimit Publik ka administruar shkresën nr.78 prot, datë 12.08.2025 me objekt “Njoftim për tërheqje nga ankimi”, protokolluar pranë KPP me nr. 1965/3 prot, datë 12.08.2025, me anë të së cilës OE “Advanced Business Solutions-ABS” sh.p.k, ka paraqitur një kërkesë për tërheqjen nga ankimi për procedurën e mësipërme të prokurimit. Për sa më sipër, KPP ka vendosur pranimin e kërkesës dhe përfundimin e procedimit administrativ.)

Urdhër nr.316, datë 18.08.2025 “Për heqjen nga pezullimi procedurës së prokurimit”, nr.3651 prot., datë 18.08.2025, mbështetur në vendimin nr.1055/2025 të KPP nr.1965/7 prot., datë 13.08.2025.

Formular i njoftimit të fituesit, në përfundim të afateve të ankimit, nr.3653 prot., datë 18.08.2025, për shpalljen e ofertës fituese OE “Ratech” sh.p.k.

Arsyetim ligjor: Bazuar në relacionin me nr. 1000 prot., datë 04.03.2025 “Për argumentimin e fondit limit dhe hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtja e sallës së monitorimit për Drejtorinë Përgjithshme të Burgjeve”, nënshkruar nga grupi i punës Yrgys Çela kryetar, Elio Macaj dhe Evio Skënderi anëtarë, rezulton se në kreun 2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, pika 2.3.5 e aftësive teknike dhe profesionale, parashikohet se operatori ekonomik duhet të ketë në listëpagesa një numër të caktuar punonjësish të cilët disponojnë certifikimet përkatëse sipas kësaj pike, duke qartësuar se një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim. Ndërsa në pikën 2.3.6 përcaktohet se operatori ekonomik duhet të citojë listën e punonjësve të cilët do të aksesojnë fizikisht ambientet e klasifikuara ku do të implementohet/zbatohet ky projekt dhe se të gjithë punonjësit e paraqitur sipas këtij kriteri duhet të jenë të pajisur me certifikatën e sigurisë personale (CSP), të lëshuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar. Gjithashtu, më poshtë është sqaruar se organizimi i punës për implementimin e projektit është në diskrecionin e operatorit ekonomik ofertues, i cili përcakton se cili nga punonjësit e tij do të ketë akses në ambientet e klasifikuara të autoritetit përfitues dhe se përcaktimi nga ana e autoritetit përfitues se cili nga punonjësit do të ketë akses në ambientet e klasifikuara, do të ishte ndërhyrje në organizimin e punës së operatorit.

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave datë 07.05.2025, rezulton të jetë i renditur i pari operatori “Advanced Business Salutions-ABS” sh.p.k., me vlerë 59,997,150.00 (pesëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, si oferta më e leverdisshme e bazuar në çmim.

Më datë 19.05.2025 është mbajtur një procesverbal rievlerësimi nga KVO, konkretisht, në procesverbal argumentohet ndër të tjera se: “...Në përfundim të procedurës së prokurimit, theksan se ka zbatuar plotësisht përcaktimet ligjore të parashikuara në ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”...dhe VKM 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të

ndryshuar, etj. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të mësipërm, KVO deklaroi të mbyllur fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave dhe në mbështetje të nenit 90, nenit 92, të ligjit nr. 162, viti 2020, vendosi të njoftojë menjëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës për këtë procedurë prokurimi në lidhje me vlerësimin e deklaruar më sipër, nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik në faqen zyrtare të APP-së, me datë 07.05.2025. Njësia e Prokurimit ka njoftuar nëpërmjet postës elektronike operatorin e renditur i pari, për paraqitjen e dokumentacionit të deklaruar në formularin e deklarimit. Njësia e prokurimit kreu veprimet përkatëse në sistemin elektronik të APP-së pas vlerësimit të kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sa më sipër. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi mori në dorëzim dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k, konstatoi se: Operatori ekonomik fitues, ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kriterëve pika 2.3.3. për punonjësit me gjeneralitetet sipas dokumentacionit, por se tashmë KVO ka konstatuar se punonjësit të cilët janë të certifikuar nga AKSIK, me certifikatë të sigurisë së personelit të cilët disponojnë atributet e nevojshme ligjore për aksesimin e ambienteve të klasifikuara të AK, nuk kanë certifikimet e nevojshme teknike të kërkuar nga DST për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe/ose dhënien e suportit në rast problematike në lidhje me sistemin e kamerave, alarmit, akses kontrollit apo pajisjeve të menaxhimit të imazheve filmike. Nisur nga sa më sipër KVO gjykon se kriteret e veçanta të specifikuara nga AK janë në funksion të ofrimit për AK të sigurisë se operatori ekonomik me të cilin do të lidhet kontrata përkatëse dhe do të ofrojë shërbimet e kërkuara sipas specifikimeve teknike, disponon të gjithë burimet dhe kapacitetet e nevojshme, ndër të tjera teknike, për të siguruar një zbatim të plotë dhe të saktë në sasi dhe cilësi të kontratës. Pra, kriteret janë komplementarë të njëri tjetrit në shërbim të një funksioni të vetëm: Dhënien e sigurisë që OE disponon kapacitetet e nevojshme për zbatimin e kontratës. Në vijim të sa më sipër trajtuar, KVO gjykon se punonjësit e certifikuar me certifikatë të sigurisë së personelit nuk disponojnë kapacitetet e nevojshme teknike për të zbatuar kërkesat e AK që lidhen me sistemet e menaxhimit të video VMS, sistemet e akses kontrollit, sistemet e alarmit, sistemet e monitorimit me kamera, sistemet e telefonisë VOIP dhe njëkohësisht, punonjësit të cilët sipas dokumentacionit të paraqitur rezulton se i disponojnë këto kapacitete, nuk janë të pajisur me certifikatë CSP dhe për rrjedhojë e kanë të pamundur të aplikojnë njohuritë e tyre teknike në vend për të ofruar shërbimin sipas kërkesave të AK..", duke sjellë si rrjedhojë skualifikimin e këtij operatori dhe kualifikimin në vend të parë të OE "RATECH" sh.p.k, me vlerë të ofertës 71,996,600.00 (shtatëdhjetë e një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH. (afërsisht 12,000,000.00 (dymbëdhjetë milionë) lekë më shumë se oferta e OE "Advanced Business Solutions-ABS").

Për sa më sipër, arsyetohet se rivlerësimi i bërë nga KVO, nuk ka asnjë mbështetje ligjore si në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ashtu dhe në VKM nr.285/2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Evidentohet qartë fakti se KVO, në aktin e dytë, pavarësisht referimin në aktet ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura, nuk referon në asnjë dispozitë ligjore konkrete, rivlerësimin dhe/apo nevojën për rivlerësim të dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë ofertues, duke vepruar kështu në tejkalim të kompetencave ligjore dhe në kundërshtim flagrant me ligjin nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr.285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Për më tepër, edhe në ankimin e operatorit ankimues "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k., është dokumentuar fakti se ky operator ekonomik ishte shpallur fitues dhe ishte njoftuar në SPE

...KSH ka dorëzuar dokumentacionin fizik sipas shtojcës 10 të formularit të vetë-deklarimit. Gjithashtu, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, evidentohet me interes fakti se dokumentacioni provues i vlerësuar tashmë nga KVO, nëpërmjet vendimit datë 07.05.2025, i ishte nënshtruar një vlerësimi nga ky organ, duke u konsideruar i plotë dhe në përputhje me dokumentet standarde të tenderit. Referuar parashikimeve ligjore, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit nga ana e operatorit ekonomik të renditur i pari (në rastin konkret OE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k), konkretisht në referim të nenit 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 5, e VKM-së nr.285 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", parashikohet se: *Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbal.*

Në rastin konkret, jo vetëm që KVO nuk ka kërkuar sqarime nga OE ofertues, por pavarësisht se dokumentacioni ishte ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik, dhe se KVO e kishte vlerësuar si të plotë dhe në përputhje me DT, me rivlerësimin e datës 19.05.2025 KVO mban një qëndrim tjetër, duke interpretuar kriteret e veçanta të kualifikimit dhe konkretisht duke i konsideruar ato si komplementare ndaj njëra-tjetrës, fakt ky që solli si pasojë dhe skualifikimin e operatorit ekonomik "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k.

Gjithashtu, në pretendimet e OE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k., drejtuar AK dhe KPP, evidentohet qartë fakti se KVO e kishte mbajtur tashmë një qëndrim ligjor lidhur me vlerësimin e dokumentacionit të ngarkuar në SPE dhe ofertës së OE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k. dhe nuk kishte asnjë mundësi tjetër ligjore për t'i rivlerësuar ato, në mbështetje të përcaktimeve ligjore të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ashtu dhe VKM-së nr.285/2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Më tej, pas administrimit të ankesës së operatorit ekonomik "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k., nga ana e titullares së autoritetit kontraktor Mirlinda Karçanaj, është disponuar me urdhrin nr.282, datë 23.07.2025 me nr.3301 prot., datë 23.07.2025 "Për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave", i përbërë nga Klodian Mazari Kryetar, Iljan Shamija dhe Jonida Mona anëtare.

Në aktin me nr. 3300/1 prot., datë 05.08.2025 me lëndë "Vendim në lidhje me ankesën e administruar pranë Autoritetit Kontraktor me nr.1965/2025, nga operatori ekonomik "Advanced Business Solutions-ABS", sh.p.k për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të procedurës së prokurimit me objekt "Mirëmbajtja e sallës së monitorimit për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve" me nr. REF-40695-03-12-2025, në mënyrë të përmbledhur KSHA ka argumentuar se:

"...KSHA gjykon se KVO ka vepruar tërësisht në përputhje me interesin publik, interesin e autoritetit kontraktor dhe bazën ligjore në fuqi. Teknikisht dhe ligjërisht KVO ka konstatuar dhe argumentuar se AK në kërkesat e përcaktuara në DST është kërkuar që operatorët ekonomikë të interesuar duhet të kenë një numër të caktuar punonjësish të certifikuar sipas objekteve përkatëse në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe sasinë e shërbimeve që kërkohen. Pra, është e qartë që një ose më shumë punonjës të operatorit ekonomik që zotërojnë certifikimet teknike, në rast se nuk posedojnë CSP, do të çojnë AK, operatorin ekonomik dhe autoritetin përfshues përpara dy zgjedhjeve, ose të mos zbatohet kontrata gjë e cila ka një

impakt fatal për fondet buxhetore, interesin publik, mosrealizimin e shërbimit, rrezikimin e jetës së punonjësve të institucioneve të ekzekutimit të dënimit, rritjen e shpenzimeve procedurale, etj, ose të mos zbatohet legjislacioni në fuqi për informacionin e klasifikuar...”

Referuar arsytimit ligjor të KSHA-së, me interes evidentohet fakti se KSHA nuk i ka dhënë përgjigje të gjitha ankesave të operatorit ekonomik ankimues, lidhur me rivlerësimin e bërë nga KVO, porse i referohet vetëm vlerësimit të dytë të këtij Komisioni, atij të datës 19.05.2025, pa argumentuar dhe kundërshtuar ligjërisht pretendimet e operatorit ekonomik ankimues. Referimi i KSHA-së në arsyetimin e rivlerësimit të dytë të bërë nga KVO, arsyeshëm nënkupton dhe njëanshmërinë e këtij komisioni apo dhe KVO-së ndaj këtij operatori ekonomik në veçanti.

Gjithashtu, evidentohet me interes fakti se arsyetimi i KSHA-së, mbi mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, nuk referohet në asnjë dispozitë ligjore konkrete, është haptazi i paarsyetuar dhe nuk i referohet të gjitha prapësimeve/kundërshtimeve të bëra nga ana e operatorit ekonomik ankimues.

Procedura e prokurimit “Përmirësimi dhe integrimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit për ndihmën ekonomike, personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimit social”, me fond limit 226,460,451.00 (dyqind e njëzet e gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e një) Lekë pa TVSH, në të cilën evidentohen veprimet e mëposhtme:

Urdhër me nr. 306, datë 14.10.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e termave të referencës, përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit” për procedurën e prokurimit me objekt: “Përmirësimi dhe integrimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit për ndihmën ekonomike, personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimit social” nënshkruar nga shtetasja Mirlinda Karçanaj, me nr.5004 prot, datë 14.10.2024.

Në vijim, grupi i punës i përbërë nga kryetar Arjana Demiri dhe anëtarë Fatos Lala dhe Sidorel Hoxhaj, u kanë dërguar ftesë për ofertë disa operatorëve ekonomikë si më poshtë:

OE “Fastech” sh.p.k.; “First” sh.p.k.; “Soft & Solution” sh.p.k.; “Axians Albania” sh.p.k.; “Communication Progress” sh.p.k.

Relacion me nr. 5452 prot., datë 30.10.2025 “Për argumentimin e fondit limit dhe hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt: “Përmirësimi dhe integrimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit për ndihmën ekonomike, personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimit social”, nënshkruar nga grupi i punës kryetar Arjana Demiri dhe anëtarë Fatos Lala dhe Sidorel Hoxhaj.

Procesverbal për argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilin, në pikën 2.3.7 parashikohet se operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku të citojë listën e punonjësve me gjeneralitetet përkatëse, të cilët do të aksesojnë fizikisht ambientet e qendrës së të dhënave (Datacenter) të AK, duke argumentuar se punimet për këtë kontratë do të kryhen në zona sigurie të klasit të parë dhe/ose të dytë, nevojitet që në zbatim të akteve rregullatorë në fuqi punonjësit e operatorit ekonomik fitues do të jenë të pajisur me certifikatën përkatëse që i mundëson ata të kenë atributet ligjore të nevojshme për të pasur akses në këto ambiente, dhe se bazuar në VKM-në nr. 189, datë 04.03.2015 “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar sekret shtetëror të NATOS-s BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, pika 8, germa “a”, specifikohet se aksesit në këtë zonë lejohet

etëm për personat e certifikuar përshtatshëmrisht dhe të autorizuar specifikisht për të hyrë, dhe se të cilave punonjësit e paraqitur sipas kriterit 2.3.7 duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie (CSP) të kështu nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, e cila duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Urdhër prokurimi nr. 66, datë 20.11.2024, nr. 6006 prot., datë 20.11.2025, njësia e prokurimit e përbërë nga Emirton Suli, Martin Dobi dhe Saimir Mehmetas.

Formulari i njoftimit të kontratës me nr. 6081 prot., datë 21.11.2024, ku afati i dorëzimit të ofertave është data 26.12.2024.

Urdhër nr. 444, datë 24.12.2024, "*Për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave*", të përbërë nga Ana Hoxha kryetare dhe Malvina Pisi dhe Ardi Sulo anëtarë.

Më datë 26.12.2024 është mbajtur procesverbali i dorëzimit/hapjes së ofertave, nga i cili rezulton se në këtë procedurë prokurimi kanë dorëzuar ofertat 5 operatorë ekonomikë, konkretisht BOE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k. dhe "Synapse ATS" sh.p.k., me ofertë ekonomike 179.080.000 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH; BOE "Image & Communication Development" sh.p.k. me "Hardtech" sh.p.k., me vlerë të ofertës 219.665.646 (dyqind e nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH; si dhe OE "Naol" sh.p.k., i cili nuk ka dorëzuar asnjë ofertë ekonomike (*konstatohet se në disa procedura prokurimi, operatori ekonomik "Naol" sh.p.k. nuk dorëzon ofertë ekonomike. Gjithashtu nga verifikimet e kryera, rezulton se ky operator ekonomik nuk ushtron aktivitetin në fushën e teknologjisë së informacionit, shkak i cili arsyeshëm krijon bindjen mbi paracaktimin e ofertuesve ekonomike dhe/ose operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.*)

Me procesverbalin për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, datë 04.03.2025, rezulton të jetë i renditur i pari operatori BOE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k. dhe "Synapse ATS" sh.p.k., me ofertë ekonomike 179.080.000 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, si oferta më e leverdisshme e bazuar në çmim, ndërsa evidentohet me interes fakti se OE "Naol" sh.p.k. përsëri nuk ka dorëzuar ofertë ekonomike.

Raport përmbledhës me nr. 1980 prot., datë 06.05.2025 i KVO.

Formulari i njoftimit të fituesit (në përfundim të afateve të ankimit) nr. 1981 prot., datë 06.05.2025.

Memo me nr. 2207 prot., datë 20.05.2025 e shtetases Helena Çupi, në cilësinë e përgjegjëses së prokurimit, drejtuar titullares Mirlinda Karçanaj dhe Hava Delibashi, me lëndë: "Mbi procedurën e prokurimit me objekt "*Përmirësimi dhe integrimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit për ndihmën ekonomike, personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimit social*". Në këtë memo, arsyetohet se Agjencia Kombëtare Shoqërisë së Informacionit ka administruar shkresën me nr. 1243 prot., datë 14.04.2025, me lëndë "Dërgohet lista e operatorëve ekonomikë të pajisur me CSI të vlefshme", protokolluar me nr. 09 prot., datë 14.04.2025, me anë të së cilës Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar i ka vendosur në dispozicion AKSHI-t, në rolin e autoritetit kontraktor listën me emrat e operatorëve ekonomikë, të pajisur me CSI të vlefshme. Vihet re se sipas listës së dërguar nga AKSIK, operatori ekonomik "Synapse ATS" sh.p.k., nuk rezulton i listuar si operator ekonomik i pajisur me CSI të vlefshme. Për sa trajtuar më sipër rezulton se BOE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k. me "Synapse ATS" sh.p.k., nuk disponojnë certifikatën e sigurisë industriale. Punonjësit e operatorëve ekonomikë e fitojnë CSP si rrjedhojë e pajisjes me CSI të Operatorit Ekonomik dhe nuk pajisen me akt administrativ apo ligjor të veçantë, por emrat e tyre shënohen në aktin administrativ që përfiton operatori ekonomik kur pajiset me CSI. Nëse një akt administrativ nuk rinovohet ose bëhet nul në kuptim të ligjeve

dhe akti i përbashkët nuk humbet fuqinë e tij ligjore si në formë, përmbajtje apo në përmbajtjen e tij material. Kështu rrjedhë gjendemi përpara situatës së parashikuar në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin elektronik" i ndryshuar, neni 80 "Parimet e përzgjedhjes", pika 4.

Për rrjedhë, nisur dhe nga fakti që BOE i renditur i dyti, kishte vlerë oferte më të madhe se vlera e sigurimit të ofertës.

Urdhër nr.213 prot., datë 03.06.2025, nr. 2438 prot., datë 03.06.2025, "Për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngratien e komisionit për shqyrtimin e ankesave", me anë të së cilit janë caktuar shtetasit Suela Ago kryetare, Klajdi Kokalla dhe Ermir Hajdini si anëtarë të këtij komisioni.

Vendim nr. 2436 i prot., datë 16.06.2025 "Vendim në lidhje me ankesën nr. A/2025/5361 të BOE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k me "Synapse ATS" sh.p.k. Në arsyetimin e vendimit, KSHA bazohet në VKM- nr. 659/2024 "Për miratimin e rregullores për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë", neni 24 "Lëshimi i CSI-së dhe CSP-së, duke argumentuar ndër të tjera se "...vlen për t'u theksuar se marrja e CSP-së nga ana e punonjësve të operatorit ekonomik është e lidhur pazgjidhshmërisht me marrjen e CSI-së nga ana e operatorit ekonomik, nëse operatori ekonomik humbet CSI-në dhe AKSIK nuk konfirmon më si operator të certifikuar, atëherë për rrjedhë automatikisht dhe CSP të lëshuar për personelin e operatorit ekonomik bëhen nul...", duke vendosur për rrjedhë të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik.

Vendim i KPP-së nr. 930/2025, datë 21.07.2025, me anë të të cilit është pranuar kërkesa e BOE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k. me "Synapse ATS" sh.p.k., pasi është konstatuar/dokumentuar se punonjësit e shoqërisë "Synapse ATS" sh.p.k., kanë patur CSP të vlefshme deri në datën 19.06.2025, pra se në fazën kur autoriteti kontraktor ka marrë vendim për anulimin e procedurës së prokurimit, ata e kishin përmbushur këtë kriter.

(Ndërkohë, nga dokumentacioni i këqyruar pranë KPP-së, jemi vënë në dijeni të faktit se shoqëria "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k, nëpërmjet administratorit të saj Shkëlqim Kërluku, me shkresën nr. 74 prot., datë 12.08.2025, protokolluar pranë KPP-së, me nr.1399/20 prot., datë 12.08.2025, ka njoftuar zyrtarisht tërheqjen nga ankimi i paraqitur për procedurën e prokurimit. Ndërkohë, të nesërmen, më datë 13.08.2025, shoqëria "ABS", i ko drejtuar një tjetër shkresë KPP-së, me lëndë "Njoftim urgjent", protokolluar pranë KPPS-së me nr. 1399/21 prot., datë 13.08.2025, nëpërmjet së cilës ko vënë në dijeni KPP-në se persona të paautorizuar kanë arritur të ndërhyjnë në llogarinë e shoqërisë në e-albania, në datë 12.08.2025, duke ngarkuar dokumentin me objekt "Dorëheqje e ankimit të paraqitur", duke pretenduar kështu injorimin nga ana e KPP-së të këtij njoftimi, pasi nuk kanë patur asnjëherë për asnjë rast dhe për asnjë arsye ndonjë qëllim për të hequr dorë.)

Arsyetim ligjor: Nëpërmjet relacionit me nr. 5452 prot, datë 30.10.2025 "Për argumentimin e fondit limit dhe hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt: "Përmirësimi dhe integrimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit për ndihmën ekonomike, personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimit social", nënshkruar nga grupi i punës kryetar Arjana Demiri dhe anëtarë Fatos Lala dhe Sidorel Hoxhaj, si dhe procesverbalit për argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilin, në pikën 2.3.7 parashikohet se operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku të citojë listën e punonjësve me gjeneralitetet përkatëse, të cilët do të aksesojnë fizikisht ambientet e qendrës së të dhënave (Datacenter) të AK, duke argumentuar se punimet për këtë kontratë do të kryhen në zona sigurie të klasit të parë dhe/ose të dytë, nevojitet që në zbatim të akteve rregullatorë në fuqi punonjësit e

Operatori ekonomik fitues do të jenë të pajisur me certifikatën përkatëse që i mundëson ata të kenë akses në bazën e të dhënave të nevojshme për të pasur akses në këto ambiente...dhe se bazuar në VKM-në nr. 189, datë 04.03.2015 "Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar sekret shtetëror të NATOS-s BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare", pika 8, germa "a", specifikohet se aksesit në këtë zonë lejohet vetëm për personat e certifikuar përshtatshmërisht dhe të autorizuar specifikisht për të hyrë, dhe se të gjithë punonjësit e paraqitur sipas kriterit 2.3.7 duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie (CSP) të lëshuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, e cila duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Arsyetim ligjor: Në relacionin me nr. 6004 prot., datë 20.11.2024 "Për argumentimin e fondit limit dhe hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt: "Biletimi qendror online për muzetë dhe sitet e trashëgimisë kulturore. Përmirësimi i sistemit të biletimit elektronik dhe platforma e shitjes së biletave"" nënshkruar nga grupi i punës Aurel Vrenos, Doralda Muka dhe Ardit Kaba, gjithashtu dhe në procesverbalin për argumentimin e kriterëve të veçanta për kualifikim, konstatohet se kriteri i parashikuar në shtojcën 2.3.7, parashikon se: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë, ku të citojë listën e punonjësve me gjeneralitetet përkatëse, të cilët do të aksesojnë fizikisht ambientet e qendrës së të dhënave (datacenter) të Autoritetit Përfitues. (të gjithë punonjësit e paraqitur sipas kriterit 2.3.7, duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie (CSP), të lëshuar nga AKSIK dhe ajo duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.)

Shënim: Për sa më sipër, evidentohet me interes fakti se tashmë, në këtë procedurë prokurimi, në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk është parashikuar më "OSI", ose oficeri i sigurisë industriale të operatorit ekonomik, si në rastin e dy procedurave të mëparshme (mirëmbajtja e sistemit Lims për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Lims për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë).

Ligji nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar":

KREU III Siguria e personelit Neni 27, parashikon se:

Siguria e personelit 1. Siguria e personelit është tërësia e masave dhe procedurave, mbi bazën e të cilave vlerësohet nëse një individ, duke iu referuar besnikërisë, besueshmërisë dhe sigurisë së tij, mund të autorizohet për të pasur qasje tek informacioni i klasifikuar, pa e rrezikuar sigurinë e këtij informacioni. 2. Lëshimi, refuzimi, pezullimi i përkohshëm bëhet nga AKSIK-ja. 3. Kur ekspozohet informacioni i klasifikuar apo për shkak të një kushti, të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër, arsyet e refuzimit, pezullimit të përkohshëm apo heqjes së CSP-së nuk i bëhen me dije individit, institucionit kërkues apo operatorit ekonomik. 4. Procesi i verifikimit të sigurisë vijon edhe pas pajisjes së aplikantit me CSP. Kjo përfshin vlerësim të vazhdueshëm sigurie për çdo ndryshim në sjelljen e individit, që e bën atë të cenueshëm nga pikëpamja e besnikërisë, besueshmërisë dhe e sigurisë së tij. 5. Rregullat e detajuara për sigurinë e personelit përcaktohen në rregulloren që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28 Kriteret për njohjen e informacionit të klasifikuar

1. Kanë të drejtë të njihen, të ruajnë, të administrojnë e të transferojnë informacion të klasifikuar vetëm personat, që: a) sigurojnë të drejtën e njohjes për shkak të detyrës që kryejnë nga titullari i ministrisë/institucionit ose oficeri i sigurimit industrial i kontraktorit; b) janë të brifuar më parë për njohjen e procedurave të sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe të përgjegjësive individuale për shkeljet e

sigurisë, dhe c) janë të pajisur me CSP, me përjashtim të rasteve për njohjen me informacionin e klasifikuar. 2. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Kryeministri dhe Kryetari i Kuvendit janë të autorizuar që të kenë qasje tek informacioni i klasifikuar për shkak të kryerjes së detyrave të tyre zyrtare e pajisen me CSP pa iu nënshtruar procedurave të verifikimit të sigurisë.

Më tej, ligji përcakton qartë rastin kur do të nevojitet CSI, dhe konkretisht, në nenin 51 të tij parashikon se: Neni 51 "Inicimi i procedurave të sigurisë"

1. Institucionet e administratës publike, të cilat gjatë veprimtarisë së tyre prodhojnë, administrojnë dhe qarkullojnë informacion të klasifikuar, kanë të drejtë të iniciojnë procedurat për kryerjen e një prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmban informacion të klasifikuar, sipas parashikimeve të legjislacionit të posaçëm të prokurimit në këtë fushë. 2. Çdo institucion i administratës publike, në cilësinë e autoritetit kontraktor, ka përgjegjësi që gjatë hartimit të dokumentacionit të tenderit apo zbatimit të kontratës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, të aplikojë sistemin e masave të sigurisë që garanton mbrojtjen e këtij informacioni, sipas kërkesave të përcaktuara në të gjitha disiplinat e sigurisë së informacionit të klasifikuar. 3. Operatorët ekonomikë të Interesuar për të marrë pjesë në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, i cili përmban informacion të klasifikuar, u nënshetrohen rregullave specifike të sigurisë. 4. Angazhimi i operatorëve ekonomikë në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar në nivelin operatori ekonomik është i pajisur me nivelin e kërkuar të Certifikatës së Sigurisë Industriale (CSI).

Nga analizimi i dispozitave të mësipërme, evidentohet qartë fakti se OE të cilët marrin pjesë në prokurime në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, duhet të jenë të pajisur me certifikatën e sigurisë industriale (CSI). Në rastin konkret, procedura e prokurimit objekt hetimi, nuk rezulton të jetë procedurë sekrete, por procedurë e hapur, sipas aktit Formulari i njoftimit të kontratës me nr. 6081 prot, datë 21.11.2024, ku shprehimisht përcaktohet lloji i procedurës së prokurimit: "Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar".

Më tej analizohet se kjo lloj procedure, është parashikuar në ligjin nr. 162/2020, i ndryshuar "Për prokurimin publik", neni 41 "Procedurat standarde të prokurimit" dhe gjithashtu në nenin 46 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Gjithashtu, analizohet se vetë ligji për prokurimin publik, në nenin 10: "Kontrata sekrete dhe kontrata që kërkojnë masa të veçanta sigurie", ka parashikuar se: "Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit, në rast se prokurimi ose zbatimi i tyre është klasifikuar sekret shtetëror apo kërkon masa të veçanta sigurie sipas legjislacionit në fuqi, ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësore të shtetit, me kusht që të jetë përcaktuar që interesat thelbësore në fjalë nuk mund të garantohen me vendosjen e kriterëve që synojnë mbrojtjen e natyrës së klasifikuar të informacionit, që autoriteti ose enti kontraktor i vë në dispozicion në procedurën e prokurimit."

Neni 12 "Prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë"

1. Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

2. Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit, që edhe pse nuk përjashtohen nga zbatimi i pikës 1, në rast se interesat thelbësorë të shtetit nuk mund të garantohen me mënyra më pak ndërlhyrëse si vendosja e kriterëve, që synojnë mbrojtjen e natyrës së klasifikuar të informacionit, që autoriteti ose enti kontraktor i vë në dispozicion në procedurën e prokurimit.

3. Në rastin e kontratave të përziera, që kanë si objekt të tyre prokurimin që mbulohet nga ky ligj dhe prokurimin që mbulohet nga legjislacioni në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, zbatohet legjislacioni në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Nisur nga sa më sipër, rezulton se gjithashtu legjislatori, ka vendosur një tjetër rregullim ligjor për kontratat publike, zbatimin ose implementimin i të cilave është klasifikuar sekret shtetëror dhe konkretisht, ligji nr.36/2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë" dhe VKM nr. 659 viti 2024 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë".

Në nenin 4 të këtij ligji parashikohet se:

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. "Autoritet kontraktor" është një institucion shtetëror, që kryen procedura prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. 2. "Certifikata e Sigurimit Industrial (CSI)" është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton, nga pikëpamja e sigurisë, se një operator ekonomik ka kapacitetet dhe uftësitë organizative, teknike e fizike dhe i plotëson standardet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar në një projekt/program apo kontratë/nënkcontratë të klasifikuar. 3. "Certifikata e Sigurimit të Personelit (CSP)" është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton, nga pikëpamja e sigurisë, se një individ i plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

Gjithashtu, në nenin 1 të VKM-së nr. 659 viti 2024 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë", parashikohet se:

"Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i sistemit të masave të sigurisë, i procedurave dhe i rregullave bazë, në funksion të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar nga aksesit apo përhapja e paautorizuar e tij gjatë prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar dhe zbatimit të kontratës."

Për sa më sipër, arsyetohet se jo pa qëllim, legjislatori i ka parashikuar këto dy përkufizime (CSI dhe CSP) në pjesën hyrëse të ligjit nr. 36/2020, pasi ato janë standarde të cilat duhet të jenë të plotësuara në rastet e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë (ashtu siç përcaktohet dhe nga VKM nr. 659/2024), për këtë shkak dhe vetë ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", në nenin 10 të tij ka parashikuar se ky ligj nuk gjen zbatim në rastin e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë porse ato rregullohen me ligj të veçantë.

Siç u arsyetua dhe më sipër, termi i përdorur në VKM "prokurim i klasifikuar", ka të bëjë pikërisht me

prokurime në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, të cilat nuk gjejnë zbatim në rastin konkret, pasi procedura objekti hetimi, është një procedurë e parashikuar nga ligji nr. 162/2020 i ndryshuar "Për prokurimin publik", dhe jo nga dispozitat e ligjit nr. 36/2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë".

Në vijim, në memon, datë 20.05.2025, miratuar nga titullarët Hava Delibashi dhe Mirlinda Karçanaj, është argumentuar ndër të tjera se: "Agjencia Kombëtare Shqiptare e Informacionit ka administruar shkresën me nr. 1243 prot., datë 14.04.2025 me lëndë "Dërgohet lista e Operatorëve Ekonomikë të pajisur me CSI të vlefshme", protokolluar me tanën me nr. 09 prot., datë 14.04.2025, me anë të së cilës Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar i ka vendosur në dispozicion AKSHI-t në rolin e Autoritetit Kontraktar, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 43, datë 20.07.2023 "Për qeverisjen Elektronike", i ndryshuar, listën me emrat e operatorëve ekonomikë të pajisur me CSI të vlefshme. Vihet re se sipas listës së dërguar nga AKSIK operatori ekonomik "Synapse ATS" sh.p.k, me NIPT: L12321011H, nuk rezultan i listuar si operator ekonomik i pajisur me CSI të vlefshme..". Më tej, shtetasja Helena Çupi i referohet edhe dokumentacionit të paraqitur nga ky OE, ku konkretisht parashikohet se në vetëdeklaratën e paraqitur nga BOE është sjellë edhe shkresa me nr. 1859 prot., datë 15.06.2022 "Për pajisjen me Certifikatë të Sigurisë Industriale", të OE "Synapse ATS", kjo CSI mban nr.132, datë 14.06.2022. Vlefshmëria e CSI është deri në datën 13.06.2026.

CSI e cituar në shkresën nr. 1243 prot., datë 14.04.2025 me lëndë "Dërgohet lista e Operatorëve Ekonomikë të pajisur me CSI të vlefshme", i referohet Certifikatës së Sigurisë Industriale dhe nuk ka asnjë lidhje me kriterin 2.3.7 të DT-së, në të cilin parashikohet se të gjithë punonjësit e paraqitur sipas kriterit 2.3.7, duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie (CSP), të lëshuar nga AKSIK dhe se ajo duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Më tej, nisur nga arsyetimi ligjor i këtij dokumenti, evidentohet me interes fakti se kthim përgjigja e AKSIK me nr. 1243 prot., datë 14.04.2025, me lëndë "Dërgohet lista e operatorëve ekonomikë të pajisur me CSI të vlefshme", protokolluar pranë AKSHI, me nr. 09 prot., datë 14.04.2025, së cilës i referohet memo, trajton heqjen dhe pezullimin e CSI (certifikatës së sigurisë industriale) dhe për rrjedhojë dhe heqjen e CSP (certifikatës së sigurisë së personelit), për disa nga punonjësit e operatorit ekonomik "Synapse ATS" sh.p.k.

Për sa më sipër, në memo interpretohet se: "...Punonjësit e operatorëve ekonomikë e fitojnë CSP si rrjedhojë e pajisjes me CSI të Operatorit Ekonomik dhe nuk pajisen me akt administrativ apo ligjor të veçantë por emrat e tyre shënohen në aktin administrativ që përfiton operatori ekonomik kur pajiset me CSI...". Lidhur me këtë arsyetim si dhe referuar ligjit nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar", analizohet se certifikata e sigurisë së personelit (CSP), dhe konkretisht CSI (certifikata e sigurisë industriale), është dokument i cili merret vetëm nga operatorët ekonomikë të cilët marrin pjesë në prokurime në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Konfuzioni ligjor i autoriteti kontraktor lidhur me pajisjen me CSP dhe CSI, duhet të ishte qartësuar dhe me dokumentacionin e administruar nga ana e tyre dhe këqyru nga organi procedues, konkretisht korrespondencës shkresore me AKSIK të muajit Tetor 2025 (shkresë nr. 6203 prot., datë 27.10.2025),

nëpërmjet të cilës AKSIK ka arsyetuar se: *"..Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), bazuar në kërkesat e ligjit nr.10/2023 "Për informacionin e klasifikuar" dhe në përcaktimet e pikës 2, të nenit 3 dhe pikës 4, të nenit 13, të VKM nr. 659, datë 23.10.2024 "Për sigurinë industriale, rregullat, procedura dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë", i konfirmon autoritetit kontraktor afatin e vlefshmërisë, nivelin dhe tipin e CSI-së, si dhe personelin e pajisur me CSP të përshtatshme, vetëm për operatorët ekonomikë që do të jenë pjesë e fazave të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar. Për rrjedhojë, në mungesë të një procedure konkrete prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmban informacion të klasifikuar, AKSIK nuk është në pozita ligjore dhe procedurale për të vënë në dispozicion një konfirmim të tillë, referuar shkresës tuaj."*

Për sa më sipër, arsyetohet se interpretimet dhe vendimmarrjet e autoritetit kontraktor, vijnë haptazi në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi, lidhur me pajisjen e operatorëve ekonomikë detyrimisht me CSP dhe për rrjedhojë me CSI, me argumentimin se do të aksesohet datacenter-i i autoriteti përfitues.

Për rrjedhojë, miratimi i këtij kriteri, dhe anulimi i procedurës së prokurimit, vijnë në kundërshtim me ligjin nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe VKM-në nr.285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, duke krijuar arsyeshëm bindjen, se ato veprime janë kryer me qëllimin e vetëm për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për operatorë të tjerë ekonomikë.

Me procesverbalin për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, datë 04.03.2025, si dhe nëpërmjet Raportit përmbledhës me nr. 1980 prot., datë 06.05.2025 të anëtarëve të KVO-së, rezulton të jetë renditur i pari operatori BOE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k dhe "Synapse ATS" sh.p.k., me ofertë ekonomike 179.080.000 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, si oferta më e leverdisshme e bazuar në çmim, ndërsa evidentohet me interes fakti se OE "Naol" sh.p.k., përsëri nuk ka dorëzuar ofertë ekonomike.

Për sa më sipër, evidentohet me interes fakti se operatori ekonomik "Naol" sh.p.k., rezulton pjesëmarrës/ofertues në disa procedura prokurimi, të cilat arsyeshëm krijojnë dyshimin se janë fiktive, pasi operatori ekonomik në asnjë prej rasteve nuk ka paraqitur asnjë dokument në SPE, duke krijuar kështu dyshime mbi pjesëmarrje fiktive në garë. Gjithashtu, evidentohet se nga verifikimet e kryera, rezulton se ky operator ekonomik, nuk ka në objektin e veprimtarisë së tij, asnjë aktivitet në fushën e teknologjisë së informacionit.

Më tej, nëpërmjet formularit të njoftimit të fituesit (në përfundim të afateve të ankimit) nr. 1981 prot, datë 06.05.2025, është njoftuar BOE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k. dhe "Synapse ATS" sh.p.k., mbi identifikimin e tij si oferta më e suksesshme dhe është ftuar të paraqitet pranë autoritetit kontraktor, me qëllim sigurimin e kontratës, brenda një afati 5 ditor nga njoftimi i këtij publikimi.

Në vijim, nëpërmjet memos me nr. 2207 prot, datë 20.05.2025 të shtetases Helena Çupi, në cilësinë e përgjegjëses së prokurimit, drejtuar titullares Mirlinda Karçanaj dhe zv.drejtoreshës Hava Delibashi,

me lëndë: "Mbi procedurën e prokurimit me objekt *"Përmirësimi dhe integrimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit për ndihmën ekonomike, personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimet sociale"*, evidentohet se Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka administruar shkresën me nr. 1243 prot., datë 14.04.2025, me lëndë *"Dërgohet lista e operatorëve ekonomikë të pajisur me CSI të vlefshme"*, protokolluar me tonën me nr. 09 prot., datë 14.04.2025, me anë të së cilës Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar i ka vendosur në dispozicion AKSHI-t, në rolin e autoritetit kontraktor listën me emrat e operatorëve ekonomikë, të pajisur me CSI të vlefshme. Vihet re se sipas listës së dërguar nga AKSIK, operatori ekonomik "Synapse ATS" sh.p.k., nuk rezulton i listuar si operator ekonomik i pajisur me CSI të vlefshme. Për sa trajtuar më sipër, rezulton se BOE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k. me "Synapse ATS" sh.p.k., nuk disponojnë certifikatën e sigurisë industriale, duke sugjeruar kështu dhe anulimin e procedurës së prokurimit.

Sipas arsytimit të miratuar nga titullarët e autoritetit kontraktor Hava Delibashi dhe Mirlinda Karçanaj evidentohet se: *"Punonjësit e operatorëve ekonomikë e fitojnë CSP si rrjedhojë e pajisjes me CSI të Operatorit Ekonomik dhe nuk pajisen me akt administrativ apo ligjor të veçantë por emrat e tyre shënohen në aktin administrativ që përfshin operatori ekonomik kur pajiset me CSI. Nëse një akt administrativ nuk rinovohet ose bëhet nul në kuptim të ligjeve dhe akteve nënligjore ai e humbet fuqinë e tij ligjore si në formë, përmbajtje apo në përmbajtjen e tij materiale, për rrjedhojë gjendemi përpara situatës së parashikuar në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 80 "Parimet e përzgjedhjes", pika 4..."*

Konfuzioni ligjor i autoritetit kontraktor lidhur me pajisjen me CSP dhe CSI, duhet të ishte qartësuar dhe me dokumentacionin e administruar nga ana e tyre dhe këqyrur nga organi procedues, konkretisht korrespondencës shkresore me AKSIK të muajit Tetor 2025 (shkresë nr. 6203 prot., datë 27.10.2025), nëpërmjet të cilës AKSIK ka arsyetuar se: *"..Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), bazuar në kërkesat e ligjit nr.10/2023 "Për informacionin e klasifikuar" dhe në përcaktimet e pikës 2, të nenit 3 dhe pikës 4, të nenit 13, të VKM nr. 659, datë 23.10.2024 "Për sigurinë industriale, rregullat, procedura dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë", i konfirmon autoritetit kontraktor afatin e vlefshmërisë, nivelin dhe tipin e CSI-së, si dhe personelin e pajisur me CSP të përshtatshme, vetëm për operatorët ekonomikë që do të jenë pjesë e fazave të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar. Për rrjedhojë, në mungesë të një procedure konkrete prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmban informacion të klasifikuar, AKSIK nuk është në pozita ligjore dhe procedurale për të vënë në dispozicion një konfirmim të tillë, referuar shkresës tuaj."*

Procedura e prokurimit *"Pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për përdorim zyrtar"*, loti 6, me numër reference të lotit nr. REF-50809-06-112025, me objekt: *"KOMPJUTERA"*, me fond limit të lotit 1,348,052,656 (një miliard e treqind e dyzetë e tetë milion e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, në të cilën evidentohen veprimet e mëposhtme:

Urdhër me nr. 412, datë 13.12.2024, *"Për përcaktimin e standardeve të pajisjeve TIK, të cilat do të ndiqen nga administrata shtetërore për vitin 2025"*, me grup pune të përbërë nga zv.Drejtor i Përgjithshëm Hava Delibashi dhe anëtarë Aldi Kita, Marko Çela, Enis Ylli, Jona Hoxha, Viola Agasi dhe

Songa Sinorukaj, nënshkruar nga shtetasja Mirlinda Karçanaj, me nr.6574 prot, datë 13.12.2024.

Memo me nr. 592 prot., datë 07.02.2025 e grupit të punës, *"Mbi përcaktimin e standardeve në TIK, të cilat do të ndiqen nga Administrata Shtetërore për vitin 2025"*. Në këtë dokument, përcaktohet se grupi i punës, pasi analizoi standardin e vitit 2023 dhe 2024, ndryshimet teknologjike për pajisjet e përcaktuara në të dhe nevojat e përcjella gjatë këtij viti, hartoi draftin fillestar të standardeve të pajisjeve TIK të cilat do të ndiqen nga administrata shtetërore për vitin 2025, të cilat gjenden bashkëlidhur kësaj Memo.

Memo me nr. 869 prot., datë 26.02.2025, *"Mbi përcaktimin e standardeve në TIK, të cilat do të ndiqen nga Administrata Shtetërore për vitin 2025"*. Në këtë dokument përcaktohet se fillimisht, grupi i punës hartoi draftin fillestar të standardeve të pajisjeve TIK, të miratuara me memon nr. 592 prot., datë 07.02.2025. Në vijim, grupi i punës iu drejtua operatorëve ekonomikë që operojnë në treg, me ftesë për paraqitje të sugjerimeve/ komenteve/ vërejtjeve në lidhje me specifikimet e hartuara si më sipërcituar. Gjithashtu, këto specifikime u publikuan në faqen zyrtare të AKSHI, duke paraqitur edhe publikisht ftesën për paraqitje të sugjerimeve, nga palët e interesuara. Grupi i punës, realizoi gjithashtu më datë 17.02.2025, edhe një takim të hapur me të gjitha palët e interesuara për të dëgjuar dhe paraqitur diskutimet e tyre në lidhje me specifikimet e hartuara. Në përfundim, bashkëlidhur memo-s, paraqitet versioni i propozuar si version përfundimtar i grupit të punës të ngritur me urdhrin nr. 412, datë 13.12.2024, si dhe ndryshimet e aplikuara në këtë version, krahasimisht me draftin fillestar të standardeve të pajisjeve TIK, të cilat do të ndiqen nga administrata shtetërore për vitin 2025, të cilat janë miratuar me nr. 592 prot., datë 07.02.2025.

Urdhër nr. 90, datë 13.03.2025 *"Për përlogaritjen e çmimeve limit për njësi për pajisjet e përcaktuara në standardet TIK për vitin 2025 dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit"*, nr. 1175 prot., datë 13.03.2025.

Grupi i punës, i ka dërguar ftesë për ofertë shoqërive "Fastech" sh.p.k.; "BNT Electronics" sh.p.k.; "Introvis" sh.p.k.; "Horizon" sh.p.k.; "Sinteza Co" sh.p.k.; "Infosoft Systems" sh.p.k., etj.

Relacion për përlogaritjen e çmimeve limit për njësi për pajisjet e përcaktuara për Standardet TIK për vitin 2025 dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, nr. 2059 prot., datë 09.05.2025.

Procesverbal për argumentimin e kriterëve të veçanta për procedurën e prokurimit *"Pajisje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për përdorim zyre 2025"*.

Urdhër nr. 187, datë 19.05.2025 *"Për përlogaritjen e fondit limit dhe sasisë së parashikuar për blerjen e përqendruar të pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për përdorim zyre sipas standardeve të miratuara për vitin 2025"*.

Relacion *"Për përlogaritjen e fondit limit dhe sasive të parashikuara për blerjen e përqendruar të pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për përdorim zyre sipas standardeve për vitin 2025"*, nr. 2319 prot, datë 26.05.2025.

Urdhër prokurimi nr. 39, datë 10.06.2025, nr. 2533 prot., datë 10.06.2025, njësia e prokurimit e përbërë nga Helena Çupi, Desian Ibro dhe Blerta Vuthaj.

Formulari i njoftimit të kontratës me nr. 2562 prot., datë 11.06.2025, me afat kohor për dorëzimin e ofertave, datë 14.07.2025.

Urdhër nr. 251, datë 24.06.2025 *"Për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave"*, nr.2797 prot, datë 24.06.2025, në të cilin janë caktuar si anëtarë Elio Fyshku dhe Elio Macaj si dhe Eni Lale kryetar.

Vendim nr.2796/1 prot., datë 01.07.2025, në lidhje me ankesën e administruar pranë AK, me nr.1624/2025, nga OE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k., për modifikimin e dokumenteve të

tenderit, nëpërmjet të cilit nuk është pranuar ankesa e këtij operatori ekonomik.

Vendim nr.1016/2025 i KPP, me objekt Modifikim i dokumenteve të tenderit..., me ankimues OE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k., nëpërmjet të cilit KPP ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës së OE. Duke detyruar autoritetin kontraktor të modifikojë pjesërisht dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e arsyetuara në vendim, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në SEP.

Shtojcë 1, nr. 2796/7 prot., datë 11.08.2025 "Për ndryshimin e dokumenteve të tenderit", në zbatim të vendimit nr. 1016/2025 të KPP.

Shkresë nr. 2796/8, datë 11.08.2025, me lëndë "Mbi zbatimin e vendimit nr. 1016/2025 të Komisionit të Prokurimit Publik", drejtuar KPP.

Vendim nr. 1047/2025 i KPP, me objekt zbatimin e vendimit nr. 1016/2025..., nëpërmjet të cilit është vendosur të lejohet AK të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit...

Urdhër nr. 312, datë 18.08.2025, "Për heqjen nga pezullimi i procedurës së prokurimit", në zbatim të vendimit nr. 1047/2025 të KPP.

Urdhër nr. 317, datë 18.08.2025, "Për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave", të përbërë nga Daniel Abasllari kryetar dhe Henri Arbana dhe Alfred Ruçi anëtarë.

Me procesverbalin për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, datë 22.09.2025, rezulton se nga procesverbali i hapjes së ofertave, datë 28.08.2025, ora 13:00, në këtë procedurë prokurimi u paraqitën 8(tetë) operatorë, dhe konkretisht: "Introvis Solutions" sh.p.k., me vlerë 1,148,017,200 (një miliard e njëqind e dyzet e tetë milion e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë pa TVSH; "Fastech" sh.p.k., me vlerë 1,170,495,200 (një miliard e njëqind e shtatëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind) lekë pa TVSH; "Atom" sh.p.k., me vlerë 1,203,809,150 (një miliard e dyqind e tre milion e tetëqind e nëntë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH; "Sinteza Co", me vlerë 906,068 (nëntëqind e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH; "BNT Electronics", me vlerë 969,270 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH; "PC STORE", me vlerë 673,566,859 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH; "Advanced Business Solutions-ABS", me vlerë 1,011,039,493.26 (një miliard e njëmbëdhjetë milion e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tre, pikë njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH; "C.C.S", me vlerë 1,204,294,400 (një miliard e dyqind e katër milion e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e katërqind) lekë pa TVSH. Në përfundim të vlerësimit ka rezultuar se operatorët ekonomikë fitues janë shpallur "Introvis Solutions" sh.p.k.; "Fastech" sh.p.k. dhe "Atom" sh.p.k., me vlerat respektive.

Raport përmbledhës me nr. 5219 prot., datë 12.11.2025 i KVO.

Formulari i njoftimit të fituesit (në përfundim të afateve të ankimit) nr. 5220 prot., datë 12.11.2025.

Marrëveshje kuadër nr. 5242 prot., datë 13.11.2025, lidhur mes AK(AKSHI) dhe OE "Introvis Solutions" sh.p.k.; "Fastech" sh.p.k. dhe "Atom" sh.p.k.

Arsyetim ligjor: Nisur nga përbërja e grupit të punës, caktuar me urdhrin me nr. 412, datë 13.12.2024, "Për përcaktimin e standardeve të pajisjeve TIK, të cilat do të ndiqen nga administrata shtetërore për vitin 2025", të përbërë nga zv.Drejtor i Përgjithshëm Hava Delibashi dhe anëtarë Aldi Kita, Marko Çela, Enis Ylli, Jona Hoxha, Viola Agasi dhe Sonja Sinorukaj, nënshkruar nga shtetasja Mirilinda Karçanaj, me nr.6574 prot., datë 13.12.2024, në harmoni me provat e tjera të grumbulluara dhe të analizuara në fazën e hetimeve paraprake, arsyeshëm krijohet bindja mbi mundësinë e paracaktimit dhe/ose të krijimit

të privilegieve të padrejtja për operatorët ekonomikë, që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi, e konkretisht të operatorëve ekonomikë të lidhur me shtetasit Ermal Beqiri (ortak në shoqëritë "Soft & Solution" sh.p.k. dhe "Horizon" sh.p.k.) si dhe shtetasit Ergys Agasi (ortak i vetëm i shoqërisë "EA Solution" sh.p.k.), pasi nga veprimet hetimore të kryera deri në këtë fazë, janë krijuar dyshime të arsyeshme se këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe me shtetasen Mirlinda Karçanaj, kanë krijuar avantazhe të padrejta në procedura të shumta prokurimi, për shoqëritë në pronësi të tyre/dhe ose për shoqëri të tjera tregtare, të cilat janë të lidhur ngushtësisht me shtetasit e sipërpërmendur, për shkak të interesave të përbashkëta financiare.

Konkretisht, evidentohet me interes fakti se në bazë të urdhrit nr. 90, datë 13.03.2025 "Për përlogaritjen e çmimeve limit për njësi për pajisjet e përcaktuara në standardet TIK për vitin 2025 dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit", nr. 1175 prot., datë 13.03.2025, grupi i punës, i ka dërguar ftesë për ofertë shoqërive "Fastech" sh.p.k.; "BNT Electronics" sh.p.k.; "Introvus" sh.p.k.; "Horizon" sh.p.k.; "Sinteza Co" sh.p.k.; "Infosoft Systems" sh.p.k.

Evidentohet se nga provat e grumbulluara deri në këtë fazë, është krijuar dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se ortaku i shoqërisë "Fastech" sh.p.k, shtetasi Andis Papa, ka raporte të afërta me shtetasin Ermal Beqiri (në rastin konkret ortak në shoqërinë Horizon sh.p.k.), si dhe në disa procedura prokurimi të fituara nga ky operator ekonomik, ai ka nënkontraktuar shërbime në vlera të konsiderueshme financiare, nga shoqëria "EA Solutions" sh.p.k. në pronësi të shtetasit Ergys Agasi, por pa u takuar apo biseduar asnjëherë me këtë shtetas, por vetëm duke u nisur nga rekomandimi i shtetasit Ermal Beqiri, se këto shërbime, duhet dhe mund të merreshin nga shoqëria "EA Solution" (referuar shpjegimeve të dhëna si person që ka dijeni për veprën penale të shtetasit Andis Papa).

Gjithashtu, nga të dhënat dhe informacionet e grumbulluara, ka rezultuar se shtetasja Viola Agasi (e motra e shtetasit Ergys Agasi), është emëruar pranë AKSHI, pikërisht nëpërmjet ndikimit të paligjshëm të shtetasit Ergys Agasi, fakt ky, i cili në përputhje me provat e tjera të administruara, arsyeshëm shpjegon lidhjen shoqërore dhe interesat e përbashkët të shtetasve Mirlinda Karçanaj dhe Ergys Agasi.

Më tej, në bazë të urdhrit nr. 251, datë 24.06.2025 "Për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave", nr.2797 prot., datë 24.06.2025, me anëtarë të këtij komisioni Eni Lale kryetar dhe anëtarë Elio Fyshku dhe Elio Macaj, është ngritur KSHA, i cili, me vendimin nr.2796/1 prot., datë 01.07.2025, në lidhje me ankesën e administruar pranë AK, me nr.1624/2025, nga OE "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k., për modifikimin e dokumenteve të tenderit, ka vendosur mospranimin e ankesës së këtij operatori ekonomik.

Në mënyrë të përmbledhur, nga ana e përfaqësuesit të kompanisë "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k., janë ngritur disa pretendime lidhur fillimisht me një prej kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe konkretisht në shtojcën 8 "formular i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit" "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.2.1 "afërsitë teknike dhe profesionale", të dokumenteve të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues të kenë realizuar furnizime të ngjashme të mëparshme, si më poshtë vijon:

"2.2.1. Dëshmi të furnizimeve të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit

financiare, me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”.

Lidhur me këtë kriter por edhe bazuar në ankesën e OE “Advanced Business Solutions-ABS” sh.p.k., se: “...Në ankimin tonë, kemi deklaruar se AK, në respekt të detyrimeve ligjore nuk rezulton të ketë kryer ndonjë analizë apo vlerësim të konkurrencës së tregut për të parë se sa OE kanë mjaftueshëm kontrata të ngjashme me vlera të tilla në tre vitet e fundit. Në këtë këndvështrim, AK nuk ka bërë asnjë përpjekje për të nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; apo për të nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; apo për të siguruar një trajtim të barabartë dhe ja diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; apo për të siguruar integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik (sipas dispozitave të Nenit 2 dhe Nenit 3 të Ligjit për Prokurimin Publik... Ne kemi deklaruar, se AK nuk ka bërë absolutisht asnjë lloj studimi të tillë, por i ka përshtatur kriteret e veçanta për kualifikim bazuar në një qasje klienteliste)...”, arsyeshëm krijohet bindja se ky kriter është përshtatur me qëllim dhënien e mundësisë vetëm një numri të kufizuar operatorësh ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Pavarësisht faktit se lidhur me këtë çështje është shprehur dhe KPP, në vendimin nr. 1016/2025, datë 06.08.2025, nga ana e organit procedues, në harmoni dhe në përputhje të plotë me provat e tjera të grumbulluara, evidentohet me interes fakti se ekzistojnë të dhëna të arsyeshme të bazuara në prova, se kriteret e vendosura në këtë procedurë prokurimi, janë përshtatur në mënyrë të paligjshme, me qëllim kufizimin/shtrembërimin e konkurrencës dhe krijimin e privilegjeve të padrejta për operatorë të tjerë ekonomikë, konkretisht për operatorë ekonomikë, të lidhur me shtetasit Mirlinda Karçanaj, Ergys Agasi, Ermal Beqiri, Gëzim Hoxha dhe Andis Papa.

Më tej, evidentohet me interes fakti se lidhur me argumentimin dhe studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit, ekzistojnë të dhëna faktike të kontratës së mëparshme ekzistuese (nr. 2204, dt. 05.05.2023 dhe me afat deri në 31.12.2024, lidhur me OE “Advanced Business Solutions-ABS” sh.p.k.), e cila është kontrata më relevante dhe më e afërt në kohë, nëpërmjet së cilës, mund të nxirreshin të dhëna reale dhe faktike, mbi gjendjen dhe nevojën apo përcaktimin e sasisë së mallit që do prokurohej sipas objektit konkret të procedurës së prokurimit (kompjutera).

Në neni 76 të VKM-së nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet se: Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit

1. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë vijon:
 - a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
 - b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
 - c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
 - ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Nëa dhe nga kuadri ligjor i cituar më sipër, evidentohet me interes fakti se studimi i tregut i kryer nga grupi i punës, duke dërguar ftesë për ofertë disa operatorëve ekonomikë si dhe nxjerrjen e mesatares së përgjithshme të çmimeve nisur nga shumatorja e përgjithshme e çmimeve të ofertuara, ka sjellë për pasojë, *frtyrjen në mënyrë fiktive të fondit limit për procedurën e prokurimit objekt hetimi, pasi ajo nuk përfaqëson një vlerë reale për kushtet e tregut dhe konkretisht:*

Nisur nga ofertat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, në fazën e ftesës për ofertë, ka rezultuar se operatori ekonomik “Fastech” sh.p.k., në ofertën e tij për studim tregu, ka ofertuar listën (të përmbledhur vetëm për lotin 6) me çmimet e mëposhtme:

Kompjutera Desktop 1 – 134,750 lekë
Kompjutera Desktop 2 – 148,050 lekë
Kompjutera Workstation (sipas prodhuesit) – 326,850 lekë
Kompjutera Workstation Advanced (sipas prodhuesit) – 352,200 lekë
Laptop basic – 121,000 lekë
Laptop advanced – 225,000 lekë
Laptop praktik – 120,150 lekë etj..

Referuar këtyre çmimeve shoqërisë “Fastech”, por dhe atyre të lidhura ngushtë me të (Horizon sh.p.k.), ashtu si dhe i shoqërive të tjera, në përfundim, grupi i punës ka hartuar fondin limit duke përcaktuar për zërat “Kompjutera”, loti 6, sipas objektit të kësaj procedure prokurimi, vlerat si më poshtë:

Kompjutera Desktop 1 – 122,745 lekë
Kompjutera Desktop 2 – 143,974 lekë
Kompjutera Workstation (sipas prodhuesit) – 324,309 lekë
Kompjutera Workstation Advanced (sipas prodhuesit) – 345,300 lekë
Laptop basic – 111,220 lekë
Laptop advanced – 231,966 lekë
Laptop praktik – 114,130 lekë etj..

Nga ana tjetër, në ofertën zyrtare të operatorit ekonomik “Fastech” sh.p.k., sipas publikimit në SPE, pas publikimit të njoftimit të kontratës, për lotin 6 Kompjutera, janë ofertuar zyrtarisht (në mënyrë të përmbledhur) çmimet si më poshtë:

Kompjutera Desktop 1 – 103,600 lekë
Kompjutera Desktop 2 – 126,800 lekë
Kompjutera Workstation (sipas prodhuesit) – 266,400 lekë

Komputera Workstation Advanced (sipas prodhuesit) – 291,300 lekë
Laptop basic – 97,800 lekë
Laptop advanced – 216,000 lekë
Laptop praktik – 91.800 lekë etj..

Pra, metodologjia e përzgjedhur nga grupi i punës, ka sjellë për pasojë rritjen artificiale të vlerës së produkteve që kërkohet të prokurohen, pasi fondi limit është përcaktuar mbi vlera jo reale, të dhëna nga operatorët ekonomikë, me qëllim maksimizimin e përfitimit, çka të njëjtën kohë mund të sjellë dhe dëmtimin e buxhetit të shtetit dhe kryerjen e shpenzimeve pa efikasitet.

Nga analizimi i listave të çmimeve, konkretisht analizohet shembulli i produktit “Komputera Workstation Advanced (sipas prodhuesit)”, i cili kur ofrohet nga operatori ekonomik “Fastech” sh.p.k, me qëllim studimin e tregut, ofrohet në vlerën 345,300 lekë, ndërsa në ofertën zyrtare ekonomike të ngarkuar në SPE, i njëjti produkt, pas miratimit të fondit limit, ofrohet në vlerën 266,400 lekë, pra me një diferencë prej 79,800 lekë.

Diferenca tejet e lartë midis vlerës së ofruar për studimin e tregut dhe asaj të ofertuar zyrtarisht, në bazë të fondit limit të përcaktuar për këtë procedurë prokurimi, tregon qartë fiktivitetin e ofertave të dhëna gjatë fazës së studimit të tregut, çka nuk pasqyron realitetin e çmimeve, kjo bazuar dhe në vetë ofertat zyrtare të operatorëve ekonomikë, fakt i cili përforcon arsyeshëm bindjen mbi fiktivitetin e procedurave të prokurimit, dhe favorizimin dhe/apo krijimin e privilegjeve të padrejta për operatorë të caktuar ekonomikë.

Për sa më sipër, arsyeshëm krijohet bindja se studimi i tregut nëpërmjet kërkesave për ofertë drejtuar operatorëve të mësipërm ekonomikë, nuk ka pasqyruar në mënyrë objektive dhe reale çmimet e tregut, duke mosparaqitur vlerën reale të këtyre produkteve, çka ka sjellë për pasojë, një vlerë disa herë më të lartë të parashikuar për blerjen e këtyre produkteve, duke ulur efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik si dhe duke mos siguruar mirë përdorim të fondeve publike dhe rritjen fiktive të shpenzimet procedurale, në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Nga analizimi i procedurave të mësipërme të prokurimit, krijohen dyshime të arsyeshme mbi vendosjen e kriterëve të caktuara kualifikuese (pajisja me CSP dhe për rrjedhojë CSI), me qëllim favorizimin e operatorëve të caktuar ekonomikë, dhe konkretisht i operatorëve ekonomikë “Soft & Solution” sh.p.k.; “Fastech” sh.p.k. si dhe “First” sh.p.k., apo dhe i operatorëve ekonomikë të tjerë të lidhur me këta të fundit.

Më tej, është bërë dhe marrja në pyetje e disa prej anëtarëve të grupeve të punës, pjesëmarrës në procedurat e mësipërme të prokurimit, nga pyetja e të cilëve, kanë rezultuar me interes për hetimin të dhënat si më poshtë:

Lidhur me procedurën e prokurimit “Mirëmbajtja e sistemit elektronik LIMS për drejtorinë e

perqutivhme te doganave" Relacion me nr. 3107 prot., datë 11.07.2025 "Për argumentimin e fondit limit dhe hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, bashkë me procesverbalin për argumentimin e kriterëve të veçanta për kualifikim" janë pyetur anëtarët e grupit të punës Meri Manaj, Denis Molla dhe Ingrida Lusha.

Nga pyetja e shtetasës Meri Manaj, datë 27.12.2025 rezultoi se: *"..Aktualisht jam drejtoreshë e drejtorisë TIK të doganave, pranë AKSHI, detyrë të cilën e ushtroj qysh prej vitit 2023. Më herët kam qenë e punësuar pranë shoqërisë "Soft & Solution", por ishte punë shumë e lodhshme dhe kur u pashë që kishte pozicione pune pranë AKSHI, aplikova dhe fitova, konkretisht dërgova email, dhe pastaj më thërrinë në intervistë, të cilën e kam kryer me shtetasen Marseda Harizi, e cila ka qenë përgjegjëse e zyrës së burimeve njerëzore. Nuk më kujtohet me thënë të drejtën përmbajtja e intervistës..."*

Lidhur me hartimin dhe argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, shtetasja Meri Manaj deklaroi se: *"...Mund t'ju them që unë nuk jam juriste dhe me thënë të drejtën në këto kritere i kemi konsultuar paraprakisht me zyrën juridike dhe kemi kërkuar asistencën e tyre për bazën ligjore. Nuk mund të them se kush është personi me të cilin jemi konsultuar por di që një vajzë me emrin Helena, ka qenë përgjegjëse në zyrën e prokurimit dhe ndoshta nuk jemi konsultuar me atë personalisht por di që kemi bërë disa takime për këtë çështje. Nuk di ta them sepse është vënë kjo bazë ligjore, por logjikisht mund t'ju them se vënia e CSP-së si kriter, për mendimin tim është i domosdoshëm për shkak se i gjithë rrjeti i AKSHI-t është i klasifikuar sekret nga titullari i institucionit. Unë e kam parë në logjikën e IT-së këtë çështje, pasi nuk jam juriste dhe nuk mund t'ju jap shpjegime të detajuara për kriteret e vendosura, nga ana ligjore..."*

Nga deklaratimet e shtetasit Denis Molla, rezultoi me interes se: *"..Nuk di t'ju them konkretisht se çfarë hapash janë ndjekur pasi nuk jam jurist me profesion. Gjatë gjithë periudhës së kryerjes së veprimeve, në cilësinë e anëtarit të këtij grupi pune, jam konsultuar me eprorin time, shtetasen Meri Manaj, të cilës i kam thënë dhe që unë nuk merrja vesh nga letrat, por gjithashtu jam munduar të konsultohem me kolegë të tjerë brenda AKSHI-t, lidhur me përpilimin e dokumentacionit, të cilët më kanë thënë që kishte një urdhër të titullarit për klasifikimin e data-center dhe prandaj duhej vendosur si kriter..."*

Në vijim, ky shtetas deklaroi gjithashtu faktin se: *"..Unë kam dëgjuar që për të hyrë në data center të AKSHI, duhet të kesh një certifikatë sigurie, siç e kam dhe unë vetë. Në logjikën time dhe në dijeninë time ka dhe një urdhër për aksesin në data – center, pra që nevojitet pajisja me certifikatë sigurie. Në logjikën time si IT dhe jo si jurist, mendoj që është e drejtë. Gjithashtu unë mund t'ju them se unë nuk jam në gjendje ta përpiloj këtë dokument, pra procesverbalin e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi nuk kam njohuri në fushën e ligjit, por se nuk e mbaj mend dhe nuk mund t'ju them emrin e personit që e ka përpiluar atë..."*

Ndërkohë, nga pyetja e shtetasës Ingrida Lusha rezultoi se: *"..Ne jemi nisur për hartimin e kriterëve, duke u nisur nga një urdhër i brendshëm i AKSHI, i cili në dijeninë time thotë që datacenter përmban informacion sensitiv dhe për rrjedhojë të gjithë ata që do të aksesojnë data center-in, duhet të jenë të pajisur me certifikatën përkatëse, për shkak të informacionit sensitiv që përmban ky data-center, por nuk kam informacion nëse ky data-center përmban informacion të klasifikuar ose jo. Gjithashtu, sqaroj faktin*

se dokumenti relacion nr. 3107 prot., datë 11.07.2025 apo dhe procesverbali për hartimin e kriterëve, nuk janë hartuar personalisht nga ana ime. Ato janë produkt i konsultimeve dhe është një punë e bërë nga grupi i punës ku unë kam qenë pjesë, por se nuk kam informacion se cili person e ka hartuar këtë dokument në veçanti. Unë personalisht, kam rënë dakort, duke u nisur nga diskutimet që kishim bërë si grup dhe nga sqarimet që dhashë, mbi hartimin e këtyre kriterëve...”

Lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtja e sistemit elektronik LIMS për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë”, Relacion me nr. 2791 prot., datë 24.06.2025 “Për argumentimin e fondit limit dhe hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit” janë pyetur anëtarët e grupit të punës Ersila Qeramixhiu, Enklid Pelari dhe Brixhilda Sinanaj.

Nga pyetja e shtetasit Enklid Pelari datë 02.12.2025 rezultoi se: “...Fillimisht, dua të shpjegoj faktin se unë kisha vetëm pesë ose gjashtë muaj që kisha filluar punë kur u caktova në këtë grup pune. Jam ekonomist me profesion dhe kisha punuar si IT për rreth 2 vite në sektorin privat. Nuk kam njohuri në fushën e ligjit dhe mund të ishte hera e parë ose e dytë që përballesha me një situatë të tillë. Fillimisht, kur doli urdhëri që u caktova në këtë grup pune, na kanë marrë në telefon dhe na kanë njoftuar nga zyra e prokurimeve që duhet të paraqiteshim dhe të mbledheshim sipas urdhërimit të titullarit. Edhe stesat për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë, nuk i kam dërguar unë pasi nuk kisha asnjë informacion dhe as i njoh asnjërin prej tyre. Ato janë bërë në dijeninë time nga grupi i punës dhe unë sigurisht që e kam nënshkruar porcesverbalin nga presioni i punës dhe zbatimit të urdhërit të titullares. Më tej, ju informoj gjithashtu mbi faktin se argumentimi i kriterëve, ka qenë një dokument i përgatitur paraprakisht dhe ka ardhur i gatshëm nga zyra e prokurimeve. Unë nuk mund të them se kush e ka hartuar atë dokument por ju them me siguri që ka ardhur i ipërgatitur dhe na është kërkuar ta nënshkruajmë. Sigurisht që e kam lexuar përpara se ta firmosja, por nuk jam kompetent për të vlerësuar bazueshmërinë ligjore të tij, pasi siç thashë më sipër, nuk jam jurist. Gjithashtu, i shtyrë nga presioni për të zbatuar urdhërin e titullarit, pasi sigurisht më rrezikohej vendi i punës nëse do ta refuzoja zbatimin e këtij urdhëri, e kam nënshkruar atë sëbashku me grupin e punës...”

Më tej, lidhur me faktin nëse është konsultuar me grupin e punës për hartimin e kriterëve, dhe faktin se kush ja kishte vënë në dispozicion këtë material, shtetasi Enklid Pelari deklaroi se: “...Për rastin konkret, nuk jemi konsultuar asnjëherë paraprakisht mbi këto dokumente që ju cituat. Na kanë thirrur në AKSHI, vetëm për të nënshkruar dokumentat dhe as nuk jemi ulur një herë të diskutonim. Në AKSHI jemi thirrur nga zyra e prokurimeve, për të nënshkruar dokumentacionin dhe unë personalisht jam paraqitur dhe e kam nënshkruar atë. Sinqerisht nuk e mbaj mend e kush na ka thërritur për të nënshkruar par rregull është që nga zyra e prokurimeve, pasi ata janë dhe përgjegjës të procedurës së prokurimit. Madje dhe momentin e nënshkrimit, nuk kemi qenë të gjithë anëtarët e grupit të punës prezent, për shkak të angazhimeve dhe vendndodhjeve të ndryshme, por kemi shkruar secili kur jemi njoftuar dhe kemi nënshkruar veç e veç...”

Nga pyetja e shtetases Ersila Qiramixhiu, datë 01.12.2025, rezultoi se: “...Fillimisht, dua të shpjegoj faktin se unë nuk jam juriste por jam me profesion inxhinierë IT. Nuk e dija që isha emëruar kryetare e këtij komisioni, të paktën nuk e mbaja mend një fakt të tillë. Nuk e kam hartuar unë atë dokument por di t’ju them që zakonisht, nëpërmjet zyrës së prokurimeve apo dhe zyrës së projekteve, konsultohemi

dhe marrim dokumentacion apo bazë ligjore të përgatitur, lidhur me hartimin e këtyre kritereve. Në rastin konkret, ka kaluar një kohë e gjatë, dhe nuk mund të them ekzaktësisht se kush na e ka dhënë këtë material, pasi nuk më kujtohet, por mund t'ju them se gjithnjë konsultoheshim para se të nënshkruanim, konsulta që herë i zhvillonim me përfaqësues të zyrës së projekteve dhe herë me përfaqësues të zyrës së prokurimit...”.

Më tej, kjo shtetase deklaroi gjithashtu faktin se: “...Në rastin konkret, ma ka dhënë dokumentin dikush nga zyra e projekteve, por nuk mund t'ju them ekzaktësisht kush ma ka dhënë dokumentin nuk e mbaj mend mirë...”... “Në procedurën e punës tonë, zakonisht kur ngarkohemi me detyrën për të hartuar kritere për procedura prokurimi, janë grupe pune nga zyra e projekteve ose prokurimeve që mund ta përgatisin paraprakisht materialin dhe na e japin për ta nënshkruar. Sigurisht që ne e lexojmë paraprakisht por nuk kemi mundësi ta verifikojmë me detaje pasi shumë çështje kërkojnë njohuri të thelluara juridike që ne nuk i disponojmë. Pra ne pyesim dhe diskutojmë por e kemi të pamundur të bëjmë një vlerësim teknik dhe ligjor të këtyre dokumenteve.”

Nga pyetja e shtetases Brixhilda Sinanaj, datë 29.11.2025, rezultoi se: “.. Jo, fizikisht në kompjuter nuk kam punuar unë me hartimin e tij dhe nuk di ta them se kush e ka hartuar atë dokument...”... “Jo, nuk jam konsultuar me bazën ligjore në fuqi dhe as nuk e mbaj mend se kush ma dha për ta nënshkruar këtë dokument...”

Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Biletimi qëndror online për muzetë dhe sitet e trashëgimisë kulturore. Përmirësimi i sistemit të biletimit elektronik dhe platforma e shitjes së biletave”, Relacion me nr. 6004 prot, datë 20.11.2024 “Për argumentimin e fondit limit dhe hartimit të kritereve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt: “Biletimi qëndror online për muzetë dhe sitet e trashëgimisë kulturore. Përmirësimi i sistemit të biletimit elektronik dhe platforma e shitjes së biletave”” u bë marrja në pyetje e grupit të punës Aurel Vrenos, Doralda Muka dhe Ardit Kaba, si dhe gjithashtu marrja në pyetje e anëtares së njësisë së prokurimit Helena Çupi për shkak të hartimit të memos datë 20.05.2024.

Nga pyetja e shtetasit Helena Çupi, datë 02.12.2025, konkretisht lidhur me hartimin e Memos, rezultuan me interes të dhënat si më poshtë: “... Lidhur me hartimin e kësaj memoje kam për të thënë se, rreth 3 herë në vit, është procedurë standarde pune, që institucioni ynë i kërkon AKSIK-së, se cilat subjekte apo operatorë ekonomikë, janë të pajisur me CSI. Pasi mu vendos për dijeni në dispozicion shkresa e klasifikuar me nr. 09 prot., datë 14.04.2025, ku evidentohet se asnjëri nga anëtarët e BOE nuk ishin të pajisur me CSI, në rolin e oficerit të sigurisë për AKSH. Ndërkohë, në rolin e personit përgjegjës për prokurimin, u zhvillua një mbledhje me titullarët dhe u diskutua mbi faktin se ishim në një rast që operatori ekonomik, konkretisht BOE “Advanced Business Solutions-ABS” dhe “Synapse ATS” ishin shpallur ndërkohë fitues dhe duhej lidhur kontrata, sipas detyrimeve ligjore. Në këto kushte, ndodhur përpara këtij fakti, që sipas ligjit, edhe sipas interpretimit të zëvendës drejtoreshës Hava Delibashi, në momentin që operatori ekonomik humbet CSI, ai humbet dhe CSP-në dhe për rrjedhojë, u përpilua dhe kjo memo nga ana ime, e cila u miratua nga të dyja titullaret. Në memo, u sugjerua që procedura duhet të anulohet...”.

Lidhur me faktin nëse kishte ndodhur që grupet e punës të ishin konsultuar paraprakisht mbi hartimin e

termave të referencës, shtetasia Helena Çupi deklaroi se: *"Ka patur raste që kanë kërkuar dokumenta të prokurimeve të mëparshme, dhe kur mi kanë kërkuar ja kemi dhënë, por në asnjë rrethanë nuk janë konsultuar me mua personalisht për hartimin e kriterëve. Patjetër nëse kanë nevojë për ndonjë gjë, kemi ofruar asistencën tonë..."*

Nga marrja në pyetje e shtetasit Aurel Vrenos, lidhur me hartimin e këtyre kriterëve, ai deklaroi se: *"...Jemi ulur me grupin e punës dhe kemi diskutuar mbi kriteret dhe përcaktimin e fondit limit. Sigurisht për TOR-at, pra termat e referencës, jemi IT dhe i njohim dhe ana teknike se si duhet të hartohen. Lidhur me kriteret e veçanta të kualifikimit, sidomos për pjesën e pajisjes me CSP të operatorëve ekonomikë, kemi kërkuar mbështetje dhe kemi diskutuar dhe me shtetasin Aldo Kita, i cili është drejtor i drejtorisë së projekteve. Aldo na ka orientuar që operatorët pjeëmarrës duhet të jenë pajisur me certifikatë sigurie, pasi do aksesohet data-center i AKSIIT, i cili është i klasifikuar si zonë sigurie. Ky kriter më është dukur i drejtë nga ana logjike, por nuk mund t'ju jap një arsye të thelluar ligjare për këtë pasi nuk jam jurist. Edhe bazën ligjore për këtë kriter, e kemi konsultuar me Aldon, por draftimi i dokumentit është bërë nga të gjithë anëtarët, dhe konkretisht e kemi punuar bashkarisht dokumentin..."*

Nga deklaratimet e shtetasës Hava Delibashi, datë 02.12.2025, e cila u pyet mbi hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit rezultoi se: *"...Kur kam ardhur në punë ne kemi ndjekur një rregull pasi për shkak se i kemi të shpërndarë nëpër institucione të ndryshme njerëzit, në mbledhjet tona është vendosur që për shkak se drejtorët e drejtorive e dinë mirë ngarkesën e gjithë secilit, kemi vendosur që të kemi një ndarje të punajësve që do të merren me procedurat e prokurimit. Varet dhe nga sistemi, pasi do të pyeten drejtorët përkatës, në varësi të llojit të procedurës..."*

Lidhur me kriterin e pajisjes së operatorëve ekonomikë me CSP, shtetasja Hava Delibashi deklaroi se: *"...Unë marr dijeni për kriteret e vendosura, kur vijnë ankesat nga operatorët ekonomikë. Ka një vendim të titullarit, për klasifikimin e data – center, si zonë e klasifikuar. Për këtë ka një autorizim të kryeministrit, për klasifikimin pasi është tagër i delegueshëm nga Kryeministri..."*

Nga deklaratimet e shtetasës Mirlinda Karçanaj, datë 03.12.2025, e cila u pyet lidhur me ndjekjen dhe organizimin e procedurave të prokurimit rezultoi se: *"...Sipas ligjit për prokurimin publik, nuk lihet shumë hapësirë për veprime të tjera, pasi ligji e përcakton qartë se si funksionon kjo procedurë. Në rastin kur sipas ligjit për qeverisjen elektronike, vijnë kërkesa nga institucione të ndryshme, ato diskutohen paraprakisht me AKSHI dhe në rast se vlerësohet nevoja, ne ndjekim të gjithë procedurën e prokurimit, si hartimin e termave të referencës e të gjithë pjesën tjetër të procedurës, sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Në rast se buxheti miratohet, ne i drejtohem institucioneve përgjegjëse për krijimin e grupeve të punës pasi na duhen përfaqësues të këtyre institucioneve, pasi është e nevojshme për shkak të problematikave ose nevojave që kanë këto institucione, gjithmonë në varësi të tipologjisë së nevojave apo procedurës konkrete që do të prokurohet. Termet e referencës dakordësohen nga grupet e punës, përveç se mbledhjeve të drejtorisë së projekteve që bën mbledhje në mënyrë të vazhdueshme. Ndërhyrja ime në termat e referencës gjithnjë ka karakter teknik, lidhur me platformën e ndërveprimit. Projektet ndiqen edhe nga ne dhe nga ana e institucioneve kërkuese, me qëllim garantimin e integritetit dhe mirëfunksionimit të të gjithë sistemeve që do të prokurohen. Në përvojën time 12 vjeçare, nuk kam ndërhyrë ndonjëherë në hartimin apo modifikimin e kriterëve..."*

"Janë të pashmangshme errësira në mapet e punës të cilat hartojnë kriteret e veçanta të kualifikimit ajo deklaruesit". Në varësi të tipologjisë së sistemit, konsultohem me drejtorët e departamenteve apo shefat e sektorëve pasi ata kanë dhe informacion lidhur me ngarkesën e punës së stafit të tyre, por dhe ekspertizën e gjithsecilit. Zakonisht janë tre veta në grup, gjithnjë me një përfaqësues të institucionit i cili do të marrë dhe shërbimin. Në rastin e blerjeve të pajisjeve TIK, janë të gjithë drejtorët e drejtorive të institucionit tonë, të cilët janë pjesë e hartimit të termave të referencës, përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit si dhe përcaktimin e fondit limit..."

Lidhur me interpretimin e bërë në dy memo-t të datës 20.05.2025, si pasojë e të cilave u anuluan dy procedura prokurimi, pas njoftimit të shpalljes së fituesit, konkretisht BOE "Advanced Business Solutions-ABS" dhe "Synapse ATS, shtetasja Mirlinda Karçanaj shpjegoi se: "Kjo lidhet me CSP pasi oficeri i sigurisë së AKSH ka marrë dijeni që operatori në fjalë i është hequr CSI dhe si rrjedhojë ka sugjeruar anulimin. Me thënë të drejtën në 12 vite punë, nuk jam marrë ndonjëherë me operatorët ekonomikë. Sipas argumentimit të kësaj memo, CSP fitohet ngushtësisht e lidhur me vendin e punës që kishte AKSHI. Në rastin konkret, shoqëria ABS, kishte CSP të pajisura vetëm për vendin e punës në Kuvend dhe vetëm për këtë ambient dhe për rrjedhojë nuk do të mund të kualifikohej dhe as të lejohej të hynte në data-center. Nuk di t'ju them lidhur me vendimmarrjen e KVO-së pasi ata kanë bërë punën e tyre sipas përcaktimeve ligjore. Memo në fjalë, është konsultuar me zëvendës drejtoreshën dhe me mua, sepse siguria e data-center është primare dhe unë i kom qëndruar këtij arsytimi pasi nëse do lidhnim kontratën me operatorin në fjalë, ai do të ishte i paaftë të përgjigjej kërkesave të kontratës së lidhur. Madje mund t'ju them se është bërë një problem i madh nga ky operator ekonomik pasi ka pezulluar punën e të gjithë institucioneve shqiptare, nëpërmjet ankesave që ka bërë për shumë procedura prokurimi dhe jo vetëm në AKSHI, fakt për të cilin kam rënë në dijeni, edhe nëpërmjet informacionit që është publik në faqen e KPP-së."

Përsa i përket faktit nëse ajo ka njohje personale me ndonjë nga operatorët ekonomikë të cilët janë pjesëmarrës në procedura prokurimi të zhvilluara nga institucioni që ajo drejton, shtetasja Mirlinda Karçanaj deklaroi se: "Raport miqësor nuk kam me asnjë por për t'i njohur i njoh të gjithë pasi janë pak dhe janë ekspertë të fushës. As nuk pi kafe dhe as nuk rri apo të shoqërohem me ndonjë operator ekonomik jashtë zyre. Ka patur një rast ku kam takuar një operator ekonomik të cilin e kam takuar rastësisht në zyrën e një të njohurit tim, të cillin e kisha takuar për një kafe në zyrën e tij, për shkak të një konsulence private, konkretisht në zyrën e shtetasit Ergys Agasi, me të cilin kam njohje të vjetra, të cilin e kam takuar disa herë në zyrën e tij, për çështje private. Ergysi do të bënte një partneritet që donte të bënte me një kompani izraelite, dhe më pyeti për një zgjedhje teknike. Në këtë ambient ka qenë dhe shtetasi Ermal Beqiri, i cili rezultoi në mënyrë rastësore prezent në këtë takim. Me shtetasin Ermal Beqiri mund të jem takuar vetëm një herë jashtë zyre në një ambient privat por jemi takuar në ambientet e AKSHI si me çdo drejtues të kompanive private, për të mirëmenaxhuar implementimin e projekteve shtetërore. Me shtetasin Ergys Agasi, mund të jem takuar disa herë në zyrën e tij, për shkak të raportit miqësor që ne kemi. Pa kështu, deklaroj faktin se lidhur me njohjen time me shtetasin Ermal Beqiri, kam qenë gjithashtu në një udhëtim të përbashkët me shumë përfaqësues të tjerë të shoqërive të teknologjisë dhe informacionit, të cilat kanë krijuar një organizatë jofitimprurëse së bashku dhe gjatë kohës së fushatës, u kërkua nga kryeministri, që të shkohej në Greqi dhe t'u kërkohesh emigrantëve që të ktheheshin në atdhe, me qëllim për t'u punësuar në institucione të ndryshme dhe institucionin tonë. Në këtë evenimnet në Greqi kanë qenë të gjithë operatorët ekonomikë, pjesë të shqatës "Akti", në të cilën

bën pjesë të shprehësve të shtetasit Ermal Beqiri. Ky evenimet dhe prezenca e kompanive në panairin e punësimit nga kompanitë e vendës kryeministria në bllokun e ekonomisë...

Ndërsa u pyet konkretisht për bisedën e zhvilluar midis saj dhe shtetasit Ergys Agasi, shtetasja Mirlinda Karçanaj deklaroi se: *"Ka qenë një projekt që nuk kishte të bënte me shtetin, një projekt izraelit, nuk më kujtohet saktë se për çfarë bëhej fjalë, por për shkak të njohurive të mia në këtë fushë, më kërkoi mendim teknik lidhur me çështjen..."*.

Përsa i përket lidhjes shoqërore mes shtetasve Ermal Beqiri dhe Ergys Agasi ajo deklaroi se nuk ishte në dijeni të raportit që ata kanë midis tyre.

Gjithashtu, shtetasja Mirlinda Karçanaj u pyet edhe për faktin nëse në bisedën e zhvilluar midis saj dhe shtetasit Ergys Agasi, a kuptoi që dhe shtetasi Ermal Beqiri do të ishte pjesë e këtij projekti, pyetje së cilës ajo ju përgjigj duke deklaruar se: *"Jo, ai qëlloi thjesht aty dhe nuk mu duk sikur ai ishte pjesë e këtij projekti..."*.

Ndërkohë, lidhur me faktin që shtetasit Ergys Agasi dhe Ermal Beqiri kanë dhe bashkëpunim financiar, konkretisht se dhe shtetasi Ergys Agasi është ortak i një shoqërisë "EA Solution", e cila ka objekt aktiviteti zhvillim, implementim dhe mirëmbajtje të sistemeve, programeve në fushën e teknologjisë së informacionit, shtetasja Mirlinda Karçanaj u përgjigj se *nuk ka qenë në dijeni të këtij fakti, dhe se nuk ka qenë pjesë e diskutimeve asnjë herë*.

Në mënyrë të përmbledhur, nisur nga të dhënat e grumbulluara nga shpjegimet e personave të mësipërm, arsyeshëm evidentohet fakti se në pjesën dërrmuese të tyre, personat e pyetur nuk janë në gjendje të japin shpjegime të thelluara mbi arsyetimin ligjor të kriterëve të veçanta të kualifikimit në raport me bazën ligjore në fuqi, kjo dhe për faktin e mungesës së njohurive në fushën e ligjit. Lidhur me vendosjen e kriterit për pajisjen me CSP të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, konkludohet se ky element, në harmoni dhe me provat e tjera të grumbulluara gjatë hetimeve paraprake, është një kriter i vendosur dhe miratuar qëllimisht nga titullarja e autoritetit kontraktor, me qëllimin e vetëm krijimin e avantazheve të padrejta për operatorë të tjerë ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura prokurimi. Trajtimi i kontratave të paklasifikuara ose të procedurave të hapura të prokurimit, si kontrata të klasifikuara, nëpërmjet vendosjes së këtij kriteri, ka sjellë për pasojë skualifikimin e operatorëve ekonomikë, të papajisur me CSI dhe CSP, ndërkohë që referuar bazës ligjore në fuqi (*Ligji nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij*), qartazi sanksionohet se këto certifikata janë të domosdoshme vetëm në prokurimet apo kontratat në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, zhvillimi ose implementimi i të cilave, gjithashtu rregullohet me ligj të veçantë (neni 10 dhe 12 i ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar).

- Procedurat e prokurimit, për të cilat dyshohet se janë bërë pagesa fiktive, në drejtim të subjektit "EA Solution" sh.p.k, në pronësi të shtetasit Ergys Agasi:

Procedura e prokurimit me objekt: *"Përmirësimi i Qendrës Kombëtare të Biznesit"*, në të cilën konstatohet se fitues i kësaj procedure është bashkimi i operatorëve ekonomik "HORIZON" sh.p.k.


dhe "Soft Solution" sh.p.k. me ofertën ekonomike më të ulët në vlerën 194 545 212 ALL. Sipas dokumentit "Aneksi 1 – Tema Reference për Projektet TIK" në pikën 2.2 "Qëllimi" thuhet se qëllimi i kësaj kontrate është përmirësimi i moduleve dhe regjistrave elektronikë duke ofruar shërbime të unifikuara për bizneset në Republikën e Shqipërisë që lëshohen nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe rritjen e nivelit të automatizimit të proceseve të punës së institucionit.

Procedura e prokurimit me objekt *"Implementimi i e-albania 2.0, site sekondar dhe open data"*, me vlerë 1,462,500,000 (një miliard e katërqind e gjashtëdhjetë e dy milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH. Nga dokumentet e tenderit rezulton se fitues i kësaj procedure prokurimit është subjekti "Fastech" sh.p.k.

Nga analiza e këtyre dy procedurave të prokurimit, në harmoni dhe me shpjegimet e punonjësve të shoqërisë "EA Solution", krijohet bindja se këto procedura prokurimi, fitohen nga subjektet e kontrolluara nga shtetasi Ermal Beqiri, në bashkëpunim me shtetasin Andis Papa, fitimet e të cilave, i kalohen në mënyrë fiktive subjektit "EA Solution", në pronësi të shtetasit Ergys Agasi.

Në vijim të kryerjes së veprimeve hetimore, bazuar në vendimin e prokurorit, për këqyrjen dhe marrjen e procesverbaleve të procedimeve të tjera, është marrë një kopje e njehsuar me origjinalin, e aktit të ekspertimit, lidhur me sekuestrimin e aparatit celular të shtetasit Emirton Suli, i punësuar pranë AKSH, në kuadër të procedimit penal nr. 146/2022.

Nga këqyrja e pjesshme e komunikimeve të këtij shtetasi, kanë rezultuar biseda me interes për hetimin, midis këtij shtetasi dhe shtetases Hava Delibashi, e cila në periudhën e komunikimeve të këqyrura, ka patur detyrën e drejtoreshës juridike pranë këtij institucioni.



Nga komunikimet e mësipërme, rezulton se shtetasja Hava Delibashi, udhëzon shtetasin Emirton Suli, lidhur me detyrat e tij në cilësinë e përgjegjës të prokurimeve, urdhëra këto të diktuar nga titullarja e

AK-së, shtetasja Mirlinda Karçanaj.

Konkretisht, krijohet bindja se këto urdhërime kanë të bëjnë me listën e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, në bisedën e datës 28.02.2024, ora 07:37:04 e në vijim. Nga përmbajtja e këtyre komunikimeve evidentohen të dhëna mbi fiktivitetin e garës në procedurën e prokurimit me objekt *"Mirëmbajtja e sistemit ATP WEB Gis për Agjencinë e Trajtimin të Pronave"*, për të cilën shtetasi Emirton Suli shprehet se OE i dyti në garë është shoqëria *"Fastech"* sh.p.k., por se nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion (nga verifikimet e kryera se procedura e mësipërme e prokurimit është fituar nga shoqëria *"Communication Progress"* sh.p.k., gjithashtu e lidhur me shtetasin Ermal Beqiri, pasi ortaku i saj me 50% dhe njëkohësisht administratori është shtetasi Gentian Likaj, bashkëjetuesi i motrës së shtetasit Ermal Beqiri).

Gjithashtu, në komunikimin e datës 12.03.2024, evidentohet me interes komunikimi mes shtetasve Hava Delibashi dhe Emirton Suli, konkretisht lidhur me disa operatorë ekonomik të cilëve u dërgohet ftesë për ofertë, duke kërkuar zëvendësimin e subjektit *"Intech +"* sh.p.k, me subjektin *"Soft & Solution"* sh.p.k, *çka arsyeshëm nënkupton faktin se* titullarët e autoritetit kontraktor, kontrollojnë të gjithë procedurën e prokurimit, duke favorizuar operatorë të caktuar ekonomik, konkretisht shoqëritë e kontrolluara nga shtetasi Ermal Beqiri, apo të lidhura me të, nga momenti i hartimit të kriterëve të kualifikimit, studimi i tregut e deri tek momenti i shpalljes së tyre fitues.

Kjo e dhënë, mbështetet dhe qëndron në harmoni dhe me provat e tjera të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, dhe konkretisht, në disa procedura prokurimi, evidentohet qartë se në fazën e dërgimit të ftesave për ofertë (psh. procedura për blerjen e pajisjeve tik, loti 6), shtetasja Hava Delibashi ka qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe përcaktimin e fondit limit, e cila nëpërmjet dërgimit të ftesave për ofertë në drejtim të operatorëve të caktuar ekonomik (*Fastech* sh.p.k.; *Horizon* sh.p.k. e cila gjithashtu është në pronësi të shtetasit Ermal Beqiri), ka *"fryrë"* fiktivisht fondin limit, duke shkaktuar potencialisht një dëm të konsiderueshëm financiar në buxhetin e shtetit, konkretisht duke kërkuar të prokurohen pajisje me një çmim disa herë më të lartë se vlera reale e tregut, kjo referuar dhe vetë ofertave zyrtare të dorëzuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Kjo e dhënë, në përputhje me provat e tjera të grumbulluara, krijon bindjen se shtetasja Hava Delibashi, në bashkëpunim me shtetasit Mirlinda Karçanaj, Ergys Agasi, Ermal Beqiri dhe në vijim gjatë implementimit shtetasit Andis Papa dhe Gëzim Hoxha, kanë nën kontroll të plotë ecurinë e të gjitha procedurave të prokurimit, duke filluar që nga momenti i hartimit të temave të referencës, kriteret e veçanta të kualifikimit, studimi i tregut e deri tek shpallja e fituesit.

Kjo e dhënë përputhet plotësisht dhe me faktin se në momentin që ankimimet e shtetasit Gerond Meçe, në cilësinë e ortakut të shoqërinë *"Advanced Business Solutions-ABS"*, krijuan një mekanizëm bllokues për përfundimin e procedurave të prokurimit pranë AKSHI, ai u mor peng forcërisht, duke e detyruar të heqë dorë nga të gjitha procedurat e ankimuara.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës organi procedues argumenton se:

Roli i shtetasve të dyshuar në grupin e strukturuar kriminal.

Shtetasit Ergys Agasi dhe Ermal Beqiri, janë në rolin e organizatorëve të grupit të strukturuar kriminal. Ata kanë krijuar këtë skemë të mirëorganizuar, me qëllim kontrollin e procedurave të prokurimit të cilat tenderohen nga Autoritetit Kombëtar i Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), me qëllim krijimin e përfitimeve të padrejta materiale.

Shtetasja Mirlinda Karçanaj, në rolin e titullarit të Autoritetit Kontraktor (AKSHI), shtetasja Hava Delibashi, në cilësinë e zëvendës drejtoreshës së përgjithshme të AKSHI (me herët në cilësinë e drejtoreshës juridike), siguron vendosjen e kriterëve të paligjshme në procedurat e prokurimit, me qëllim favorizimin dhe krijimin e privilegjeve të padrejta, për operatorët e ekonomikë "Soft & Solution" sh.p.k., "First" sh.p.k dhe "Fastech" sh.p.k., apo dhe shoqërive të tjera tregtare, të lidhura në mënyrë të tërthortë me shtetasin Ermal Beqiri, si shoqëritë "Horizon" sh.p.k. dhe "Communication Progress" sh.p.k.

Shtetasit Andis Papa dhe Gëzini Hoxha, kanë rol aktiv në pjesëmarrjen dhe përfitimin e paligjshëm të procedurave të prokurimit, të cilat diktohen nga shtetasit e sipërpërmendur, e dhëna e cila rezulton qartë nga analiza financiare e kryer dhe konkretisht, duke rezultuar se këta shtetas, kanë kredituar shumë të konsiderueshme monetare tek shoqëria "EA Solution", në pronësi të shtetasit Ergys Agasi, veprim të cilit e kanë kryer nën udhëzimin e shtetasit Ermal Beqiri.

Njësimi i kësaj veprimtarie të paligjshme i dy subjekteve Ergys Agasi dhe Ermal Beqiri, dokumentohet dhe nga deklaratimet e punonjësve të shoqërisë "EA Solution", ashtu si dhe nga deklaratimet e administratorëve të kësaj shoqërie, shtetasës Ina Ciko, nga të cilat ka rezultuar se punonjësit e kësaj shoqërie rekrutohen dhe menaxhohen nga shoqëria "Soft & Solution", në pronësi të shtetasit Ermal Beqiri, se ata nuk kishin punuar në asnjë ambient tjetër përveç se ambjenteve të shoqërisë "Soft & Solution", çka krijon bindjen mbi fiktivitetin e shërbimeve të "supozuara" të kryera nga shoqëria "EA Solution", në pronësi të shtetasit Ergys Agasi.


Shtetasit Ermal Beqiri, Ergys Agasi dhe Erjon Ismaili, në bashkëpunim dhe me persona të tjerë ende të paidentifikuar, kanë planifikuar dhe organizuar rrëmbimin e shtetasit Gerond Meçe, me qëllim detyrimin e këtij të fundit për tërheqjen nga ankimimet e bëra pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Nga analizimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit, bën të besohet fakti se heqja dorë e këtij shtetasi nga ankimimet e bëra pranë KPP-së, do t'i krijonte lehtësira të konsiderueshme shtetasve të sipërpërmendur, me qëllim vijimin e aktivitetit kriminal në fushën e prokurimeve publike, aktivitet i cili ishte pezulluar në disa raste, për shkak të ankimeve të bëra pranë KPP nga shoqëria "Advanced Business Solutions-ABS".

Gjithashtu, nga deklaratimet e shtetasit Gerond Meçe, jemi njoftuar mbi faktin se shtetasi Erjon Ismaili (me detyrë zëvendës drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë), i ka kërkuar "të rrijë larg AKSHI", fakt ky i cili përputhet gjithashtu dhe me rezultatin e pamjeve të këqyrura në zyrën e shtetasit Ergys Agasi, pra se këta të fundit kanë lidhje shoqërore dhe interesa të përbashkët. Nga kqyrja e

pamjeve filmike të sekuestruara në zyrën e shtetasit Ergys Agasi, evidentohen shumë takime mes tij dhe shtetasit Erjon Ismaili.

Për të ilustruar "modus operandi" të kësaj veprimtarie të shtetasit Ergys Agasi sjellim në vëmendje se; Nga hetimet e kryera rezulton gjithashtu se shtetasi Ergys Agasi, në një komunikim të datës 06.03.2019 me shtetasin Alqi Bllako, lidhur me një "situatë" në të cilën dyshohet se shtetasi Damian Gjicknuri "ishte bërë pengesë", lidhur me përfitimet e paligjshme të tyre si më poshtë:



Nga përmbajtja e kësaj bisede, evidentohet se personi me emrin "Ibri", është shtetasi *Elgerti Bixha*, për të cilin shtetasi Ergys Agasi do ta emërojë si administrator në një shoqëri private e cila ka fituar një koncesion me ministrinë e drejtuar në atë kohë nga ish ministri *Damian Gjicknuri*, i cili pretendohet se është bërë pengesë për realizimin e këtyre përfitimeve të paligjshme nga ana e shtetasve Ergys Agasi, Elgerti Bixha dhe Alqi Bllako. Në këtë komunikim, konkretisht në mesazhin e datës 06.03.2019, ora 21:54:43, shtetasi Ergys Agasi shprehet se: "*Do ja qi robt do fusim cunatboastaj..*" (do fusim çunat pastaj), çka nënkupton faktin se ai përdor lidhjet e tij me persona me rrezikshmëri të lartë shoqërore, për të "hequr" këto pengesa.

Kjo rrethanë, lidhet dhe me pengmarrjen e shtetasit Gerond Meçe, pasi ai gjithashtu si në rastin e shtetasit Damian Gjicknuri, kishte krijuar "pengesa", nëpërmjet ankimimeve të shumta pranë KPP-së, për procedurat e prokurimit të zhvilluara pranë AKSH, duke nënkuptuar faktin se "modus operandi" i këtij grupi kriminal është i njëjtë.

Në vijim të këtij arsytimi, dyshimi i arsyeshëm në ngarkim të shtetasit Ergys Agasi, si organizator dhe pjesëmarrës i pengmarrjes së shtetasit Gerond Meçe, përforcohet dhe nga fakti se automjeti i përdorur për

kryerjen e pengmarrjes, rezulton të jetë në pronësi të subjektit "Merkaj 3" sh.p.k., me nipt L31722005D, në pronësi të shtetasit Endri Merkaj.

Nga burimet e hapura është verifikuar fakti se shtetasi Endri Merkaj, së bashku me vëllain e tij Klajdi Merkaj, janë lidhje me interes të shtetasve Arjan Ormenaj dhe Arben Lamçe, pjesë e grupit kriminal "Çopja". Gjithashtu, gjatë kontrollit të banesës së shtetasit Ergys Agasi, janë gjetur dokumente me interes për hetimin, konkretisht "Kontratë shitje pasuri e paluajtshme me rezervë kalim pronësie me nr. 1370/798 rep/kol datë 07.03.2024, mbajtur dhe legalizuar pranë zyrës noteriale Fatmir Koseni, midis shtetasve Drita Hoxha, në cilësinë e palës shitëse, shtetasve Mira Hoxha, Irfan Hoxha dhe Nikolin Jaka në cilësinë e palës dhënëse të pëlqimit dhe shoqërisë "Elba Beton" me numër NIPT K12608201B përfaqësuar nga shtetasi Arjan Ormenaj...".

Këto të dhëna, në përputhje dhe me deklaratimet e shtetasit Gerond Meçe, i cili shpjegon se ka konstatuar se dy nga personat që e kishin rrëmbyer kishin dialekt nga zona e Elbasanit, madje njëri prej tyre i kishte thënë se po ta shihte në Elbasan, do ta përshëndeste.

Sa i takon kuadrin ligjor, kuptimi i grupit të strukturuar kriminal jepet nga neni 28/4 i Kodit Penal, i cili është i ndarë në dy paragrafë. Paragrafi i parë, i pikës 4 i nenit 28 të këtij Kodi, përcakton tre elementë apo karakteristikat e para të grupit të strukturuar kriminal të cilat janë:

- A- Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi;
- B- Grupi i strukturuar kriminal formohet nga bashkëpunimi i të paktën tre ose më shumë personave;
- C- Objekti i veprimtarisë së grupit të strukturuar kriminal nuk është i përcaktuar, ai mund të kryejë ç'do lloj vepre penale të parashikuar në Kodin Penal, por që e kryen me qëllimin e posaçëm për të realizuar përfitime materiale ose jo materiale.

Elementët apo karakteristikat e tjera të grupit të strukturuar kriminal, jepen nga paragrafi i dytë, i pikës 4 të nenit 28 të këtij Kodi. Mirëpo, ky paragraf në dallim nga paragrafi i parë i pikës 4 të nenit 28, jep disa karakteristika që janë përjashtuese për grupin e strukturuar kriminal, pra parashikon shprehimisht elementë që nuk duhet t'i ketë grupi i strukturuar kriminal. Nga interpretimi nga e kundërta, a contrario, evidentojmë edhe këto elementë të tjerë të grupit të strukturuar kriminal e më konkretisht:

A- Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një ose disa veprave penale, me qëllim realizimin e përfitimeve materiale ose jo materiale, nuk formohet rastësisht. Për të qenë para kësaj forme të bashkëpunimit të veçantë, kërkohet që ky bashkëpunim të mos jetë rastësor, por të ketë ekzistuar, paraprakisht para se të fillojë kryerja e veprës penale dhe ky bashkëpunim të ekzistojë edhe në momentin e fillimit të kryerjes së veprës dhe, gjatë kohës së kryerjes së veprës penale. Në vijim të kësaj do të duhet që bashkëpunimi të jetë i planifikuar dhe i paramenduar, që para se të fillojë kryerja e veprës penale, nga të paktën një prej bashkëpunëtorëve.

B- Grupi i strukturuar ka një strukturë dhe organizim, minimal, për kryerjen e një ose më shumë veprave penale. Duke iu referuar dispozitës ligjore konstatojmë se ligjvënësi shprehet "nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar", ç'ka nënkupton se grupi nuk kërkon një organizim dhe strukturim të zhvilluar, por një farë strukture dhe organizimi minimal duhet ta ketë, për shkak se grupi i strukturuar nuk është një formacion i

ngritur aty për aty dhe kuptohet që ai duhet të jetë i qëndrueshëm. Kjo do të thotë që, grupi i strukturuar me qëllim kryerjen e një ose më shumë veprave penale, ka gjithmonë një minimum organizimi dhe strukturimi, edhe pse ky organizim dhe strukturim, nuk është i zhvilluar.

C- Grupi i strukturuar si formë e veçantë bashkëpunimi, kërkon që të ekzistojë një ndarje minimale detyrash, ndërmjet anëtarë të grupit, ku një ose disa anëtarë të jenë organizatorë dhe të tjerët të jenë në rolin e ndihmësit, shtytësit apo ekzekutorit. Nëse nuk kemi një ndarje minimale detyrash dhe rolesh, ndërmjet bashkëpunëtorëve për kryerjen e veprës penale, nuk mund të jemi para grupit të strukturuar kriminal, por do të jemi para formave të tjera të bashkëpunimit.

D- Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e aktivitetit të tij kriminal, kërkon një qëndrueshmëri minimale midis anëtarëve të tij- Grupi i strukturuar kriminal ka një anëtarësi të përcaktuar për kryerjen e veprave penale, por që kjo anëtarësi nuk shquhet apo nuk dallohet për qëndrueshmërinë e saj, domethënë kjo anëtarësi ekziston, në çdo rast, por nuk është e qëndrueshme për një kohë të gjatë, por ekziston për një periudhë minimale, të shkurtër.

Ndërkohë, që vetë Gjykata e Lartë, në përmbledhje të sa më sipër, ka konkluduar se: "...*"Grupi i strukturuar kriminal", si formë e veçantë bashkëpunimi, është parashikuar në pikën 4 të nenit 28 të Kodit Penal, në fuqi, në të cilën thuhet: "Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një ose më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jo materiale. Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një vepre penale nuk formohet rastësisht e nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar."*

Duke iu referuar përmbajtjes së kësaj dispozite, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se, për të qenë para *"Grupit të strukturuar kriminal"*, si formë e veçantë bashkëpunimi, duhet të ekzistojnë, këto kushte:

- a) Duhet që të ekzistojë bashkëpunimi për kryerjen e një ose disa veprave penale, ndërmjet, të paktën tre ose më shumë personave;
- b) Duhet që kryerja e veprave penale të bëhet me qëllimin e posaçëm të realizimit të përfitimeve materiale ose jo materiale;
- c) Duhet që grupi i strukturuar të mos jetë krijuar rastësisht dhe
- d) Nuk është e nevojshme që grupi i strukturuar të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar....".

Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jo materiale. Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një vepre penale nuk formohet rastësisht e nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar. Krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës së posaçme të këtij Kodi ose të dispozitave të tjera penale të veçanta. Anëtarët e organizatës kriminale, të organizatës terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal janë përgjegjës për të gjitha veprat penale të kryera prej tyre, në përmbushjen e qëllimeve të veprimtarisë së tyre kriminale.

-Argumentet në lidhje me kërkesën për caktim mase dhe llojin e saj.

Nga tregesia e veprimeve hetimore të kryera deri më tani, krijohet dyshimi i arsyeshëm se shtetasit **Ermal Beqiri, Ergys Agasi, Mirlinda Karçanaj, Ilava Delibashi, Gëzim Hoxha dhe Andis Papa**, në bashkëpunim me njëri-tjetrin në kundër të një grupi të strukturuar kriminal që drejtohet nga shtetasi **Ergys Agasi**, janë përfshirë një skemë të mirëorganizuar, me qëllim kontrollimin e procedurave të prokurimit të cilat tenderohen nga Autoritetit Kombëtar i Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), me qëllim krijimin e përfimeve të padrejta materiale.

Konkretisht, shtetasja **Mirlinda Karçanaj**, në rolin e titullarit të Autoritetit Kontraktor (AKSHI), shtetasja **Ilava Delibashi**, në cilësinë e zëvendës drejtoreshës së përgjithshme të AKSHI (më herët në cilësinë e drejtoreshës juridike), kanë siguruar vendosjen e kriterëve të paligjshme në procedurat e prokurimit, me qëllim favorizimin dhe krijimin e privilegjeve të padrejta, për operatorët e ekonomikë "**Soft & Solution**" sh.p.k., "**First**" sh.p.k. dhe "**Fastech**" sh.p.k., apo dhe shoqërive të tjera tregtare, të lidhura në mënyrë të tërthortë me shtetasin **Ermal Beqiri**, si shoqëritë "**Horizon**" sh.p.k. dhe "**Communication Progress**" sh.p.k.

Shtetasit **Andis Papa** dhe **Gëzim Hoxha**, kanë rol aktiv në pjesëmarrjen dhe përfitimin e paligjshëm të procedurave të prokurimit, të cilat diktohen nga shtetasit e sipërpërmendur, e dhëna e cila rezulton qartë nga analiza financiare e kryer dhe konkretisht, duke rezultuar se këta shtetas, kanë kredituar shuma të konsiderueshme monetare tek shoqëria "**EA Solution**", në pronësi të shtetasit **Ergys Agasi**, veprim të cilin e kanë kryer nën udhëzimin e shtetasit **Ermal Beqiri**. Po ashtu edhe shoqëria tregtare e shtetasit **Rogers Rryta**, ka kryer veprime financiare të dyshimta e dyshohet se është pjese e kësaj skeme.

Gjithashtu, shtetasit **Ermal Beqiri, Ergys Agasi**, në bashkëpunim edhe me persona të tjerë ende të paidentifikuar, në kuadër të një grupi të strukturuar kriminal që drejtohet nga shtetasi **Ergys Agasi**, kanë planifikuar dhe organizuar rrëmbimin e shtetasit **Gerond Meçe**, me qëllim detyrimin e këtij të fundit për tërheqjen nga ankimimet e bëra pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Nga analizimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit, arsyeshëm bën të besohet fakti se heqja dorë e këtij shtetasi nga ankimimet e bëra pranë KPP-së, do t'i krijonte lehtësira të konsiderueshme shtetasve të sipërpërmendur, me qëllim vijimin e aktivitetit kriminal në fushën e prokurimeve publike, aktivitet i cili ishte pezulluar në disa raste, për shkak të ankimimeve të bëra pranë KPP nga shoqëria "**Advanced Business Solutions-ABS**".

Gjithashtu, nga deklaratimet e shtetasit **Gerond Meçe**, jemi njoftuar mbi faktin se shtetasi **Erjon Ismaili** (me detyrë zëvendës drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë), i ka kërkuar "**të rrijë larg AKSHI**", fakt ky i cili përputhet gjithashtu dhe me rezultatin e pamjeve të këqyrura në zyrën e shtetasit **Ergys Agasi**, pra se këta të fundit kanë lidhje shoqërore dhe interesa të përbashkët.

Për sa më sipër, ekziston dyshimi i bazuar në prova se personat ndaj të cilëve zhvillohen hetime shtetasit **Ermal Beqiri, Ergys Agasi** dhe persona ende të paidentifikuar kanë konsumuar elementët e veprave penale "**Heqja e paligjshme e lirisë**", "**Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës**", në formën e veçantë të bashkëpunimit "**Grupi i strukturuar kriminal**", "**Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal**", të parashikuara nga nenet 170/b, paragrafi i dytë, 28 pika 4,

333/a paragrafi i dytë dhe 334 të Kodit Penal, ndersa shtetasi Ismaili, dyshohet për veprën e parashikuar nga neni 170/b në kuader të grupit të strukturuar kriminal.

Ekziston dyshimi i bazuar në prova se personat ndaj të cilëve zhvillohen hetime shtetasit **Ermal Beqiri, Ergys Agasi, Mirlinda Karçanaj, Hava Delibashi, Andis Papa dhe Gëzim Hoxha** kanë konsumuar elementët e veprave penale, "*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*", në formën e veçantë të bashkëpunimit "*Grupi i strukturuar kriminal*", "*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", të parashikuara nga nenet 258, paragrafi i dytë, 28 pika 4, 333/a paragrafi i dytë dhe 334 të Kodit Penal.

Ekziston dyshimi i bazuar në prova se personat ndaj të cilëve zhvillohen hetime shtetasit **Ermal Beqiri, Ergys Agasi, Andis Papa, Gëzim Hoxha dhe Rogers Rryta** kanë konsumuar elementët e veprave penale, "*Pastrimi i produkteve të veprës penale*", në formën e veçantë të bashkëpunimit "*Grupi i strukturuar kriminal*", "*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", të parashikuara nga nenet 258, paragrafi i dytë, 28 pika 4, 333/a paragrafi i dytë dhe 334 të Kodit Penal.

Në rastin konkret deri në këto momente nuk ka asnjë shkak padënueshmërie apo shuarje të veprave penale për të cilat po hetohen personat nën hetim.

Sa më sipër plotësohen kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal të parashikuara nga neni 228 i Kodi Procedurës Penale për personat ndaj të cilëve zhvillohen hetimet: Ermal Beqiri, Ergys Agasi, Mirlinda Karçanaj, Erjon Ismaili, Hava Delibashi, Andis Papa, Gëzim Hoxha dhe Rogers Rryta dhe konkretisht:

Për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të personave ndaj të cilëve zhvillohen hetimet, ka rrezik se ata sërish mund të kryejnë krime më të rënda ose të të njëjtit lloj me të cilin po procedohen, pasi nga aktet e deritanishme hetimore rezulton se ata vazhdojnë veprimtarinë e tyre kriminale.

Plotësohen kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të parashikuara nga nenet 229 dhe 230/1 të K.Pr.Penale, për caktimin ndaj personave nën hetim të masave të sigurimit personal shtrënguese "*Arrest në burg*" të parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale:

Rrezikshmëria e veprave penale të për të cilat po hetohen këta persona nën hetim, pasi veprat penale dënohen me burgim;

Nga aktet e deritanishme rezulton se rrezikshmëria e personave nën hetim është mjaft e madhe, si dhe ka rrezik se ata sërish mund të kryejnë krime më të rënda ose të të njëjtit lloj me të cilin po procedohen dhe mund të vazhdojnë veprimtarinë e tyre kriminale duke shkaktuar dëm të konsiderueshëm financiar buxhetit të shtetit.

Gjithashtu ekziston rreziku që këta persona t'u fshihen hetimeve, duke ju shmangur hetimit, apo pasojave të ekzekutimit të dënimeve të mundshme.

Si dhe plotësohen kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal të parashikuara nga neni 228 të Kodit të Procedurës Penale për personat ndaj të cilëve zhvillohen hetimet Ermal Beqiri, Ergys Agasi, Mirlinda Karçanaj, Erjon Ismaili, Hava Delibashi, Andis Papa, Gëzim Hoxha dhe Rogers Rryta.

Sa më sipër provohet nga provat e administruara gjatë hetimit të sipër përmendura, si dhe aktet e tjera procedurale dhe shkresore që ndodhen në fashikullin e hetimit të procedimit penal nr.20/1 të vitit 2025, kopje të njehsuara me origjinalin të të cilave i bashkëngjitet kësaj kërkesë.

Për arsyet e sipër përmendura, si dhe për të siguruar një vazhdim normal të hetimeve paraprake, në bazë të neni 244 të K.Pr.Penale, prokurori kërkon caktimin e masave personale shtrënguese/ndaluese përkatëse për personat nën hetim, konkretisht: ndaj personave nën hetim Ergys Agasi, Ermal Beqiri, caktimin si masë sigurimi personale shtrënguese atë të "arrestit në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale; ndaj personave nën hetim Mirlinda Karçanaj, Hava Delibashi, caktimin si masë sigurimit personale shtrënguese atë të "arrestit në shtëpi", parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale; ndaj personit nën hetim Erjon Ismaili, caktimin si masë sigurimi personale shtrënguese "Ndalim i daljes jashtë shtetit", parashikuar nga neni 233 të K.Pr.Penale dhe caktimin si masë sigurimi personale ndaluese "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik", parashikuar nga neni 242 të K.Pr.Penale; si dhe ndaj personave nën hetim Andis Papa, Gëzim Hoxha, Rogers Rryta, caktimin si masa sigurimi personale shtrënguese "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", parashikuar nga neni 233 të K.Pr.Penale, të dyshuar për kryerjen e veprave penale respektive.

Bashkë me kërkesën janë bashkëlidhur kopje të njehsuar me origjinalin të akteve të procedimit penal nr.20/1 të vitit 2025. mbi të cilat mbështetet kërkesa e Prokurorisë së Posacme.

- Vendim për bashkimin e procedimit penal nr.20/2023 me procedimin penal nr.10/2024;
- Vendim për bashkimin e procedimit penal nr. 36/4 viti 2025 me procedimin penal nr.20/1 viti 2025 (vendim për ndarjen e procedimit penal nr. 36/4 viti 2019; urdhër regjistrimi bashkëlidhur);
- Vendim për ndarjen dhe veçimin e akteve të procedimit penal nr. 20/1 viti 2025;
- Vendim për këqyrje marrje dokumentash pranë (AKSHD). (procesverbalet për këqyrjen dhe marrjen e CD bashkëlidhur);
- Vendim për lejimin e kontrollit të vendeve dhe kontrollit personal GJKKO, nr. 403, datë 18.06.2025; Procesverbalet e kontrollit dhe procesverbalet e sekuestrimit dhe vendimet e ekspertimit bashkëlidhur;
- Akt ekspertimi teknik nr. 207, datë 17.07.2025;
- Procesverbal për këqyrjen e pjesshme të aktit të ekspertimit;
- Shkresë drejtuar bankave për shoqëritë në pronësi të shtetasit Ergys Agasi (kthim përgjigje bashkëlidhur);
- Shkresa nr. 29508 datë 01.10.2025 drejtuar Vodafone sha (kthim përgjigje bashkëlidhur);
- Vendim qqyrje datë 17.10.2025 dërguar me shkresën nr. 37056 drejtuar Vodafone sha;
- Shkresë drejtuar kompanisë One (kthim përgjigje bashkëlidhur);
- Shkresë APP (kthim përgjigje bashkëlidhur);
- Procesverbal për marrjen e akteve të procedimit penal nr.36 viti 2025;
- Procesverbal për këqyrjen e të dhënave kompjuterike në faqen zyrtare të KPP;

- Procesverbal inventarimit të aktave të procedimit penal nr. 10/2024;
- Informacion material kallëzues, me nr.29885 prot, datë 03.09.2025;
- Informacion material kallëzues, me nr.28792 prot, datë 21.08.2025
- Procesverbal për këqyrjen e të dhënave nga QKB;
- Procesverbal për këqyrjen e të dhënave nga TIMS, për shtetasen Blerta Beqiri;
- Procesverbal për këqyrjen e sistemit TIMS;
- Vendim për këqyrjen dhe marrjen e procesverbaleve të procedimeve të tjera nga procedimi penal nr.146/2022 (procesverbali këqyrjes së pjeshme të aktit të ekspertimit bashkëlidhur);
- Deklarime të marra në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit të shtetasve Gerond Meçe, Mirlinda Karcanaj, Hava Delibashi, Helena Cupi, Rogers Rryta, Ersila Qiramixhiu, Brixhilda Sinanaj, Enklid Pelari, Suela Ago, Klajdi Kokalla, Ardit Kaba, Aurel Vrenos, Leonard Meçi, Denis Molla, Ingrida Lusha, Meri Manaj, Bashkim Kullolli, Andis Papa, Gëzim Hoxha, Malvina Kryemadhi, Keli Muçaj, Endri Grëmi, Ina Ciko, Jonida Muçobega, Kozeta Leka etj.;
- Akte të tjera të procedimit penal nr. 20/1 të vitit 2025.

Pasur parasysh sa më sipër, përpara Gjykatës shtrohet për zgjidhje kjo çështje:

- a) *A duhet të caktohen masa kufizuese personale dhe/ose ndaluese ndaj personave nën hetim Ergys Agasi, Ermal Beqiri, Mirlinda Karcanaj, Hava Delibashi, Erjon Ismaili, Rogers Rryta, Andis Papa dhe Gëzim Hoxha? Nëse po, cila masë sigurimi përmbush kushtet për t'u zbatuar në rastin konkret për secilin nga personat nën hetim?*

III. Legjislacioni i zbatueshëm

Neni 28 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: "Personi të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi c, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orëve nga çasti i marrjes së dokumentave për shqyrtim".

Neni 5 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut parashikon se: "Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijajnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

.....c) kur është arrestuar dhe paraburgasur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;.....

3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatësi ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohe brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër.

... mund të liqet re i vet nga garanci për t'u paraqitur para gjykatës".

Neni 228 i K.Pr.Penale parashikon se: "1. Askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal nëse ai nuk ka ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova.

2. Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie të shuarjes së veprës penale, ose të dënimit.

3. Masat e sigurimit personal vendosen:

- a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e proves, bazuar në rrethanat fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;
- b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet;
- c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet".

Neni 229 i K.Pr.Penale parashikon se: "1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret.

2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal.

3. Kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete".

Neni 230 i K.Pr.Penale parashikon se: "1. Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit....".

Neni 25 i Kodit Penal parashikon se: "Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre".

Neni 28, pika 4 i Kodit Penal parashikon se: "Grupi i strukturuar kriminal është një formë e veçantë bashkëpunimi që, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale.

Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një vepre penale nuk formohet rastësisht e nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar...".

Neni 110 i Kodit Penal parashikon se: "Heqja e paligjshme e lirisë së personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Kur kjo vepër shoqërohet me vuajtje të rënda fizike, kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet".

Neni 170/b i Kodit Penal parashikon se: "Kryerja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare, e veprimeve të konkurrencës, me anë të kërcënimit ose dhunës dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

Kur veprimet e lartkrahues drejtohen ndaj veprimtarive të financuara plotësisht ose pjesërisht dhe në çfarëdo mënyre të shantazhit ose korrupsionit publike, dënimi me burgim shtohet me një të tretën".

Neni 258 të Kodit Penal parashikon se: "Kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, kur tenderi ose ankandi publik është deri në vlerën 800,000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim deri në një vit.

Po kjo vepër, kur kryhet në tender ose ankande publike me vlerë mbi 800,000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet".

Neni 333/a i Kodit Penal parashikon se: "Krijimi, organizimi ose drejtimi i një grupi të strukturuar kriminal për kryerjen e veprave penale dënohen me burgim nga tre deri në tetë vjet.

Pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet".

Neni 334 i Kodit Penal parashikon se: "1. Kryerja e veprave penale nga pjesëtarë të organizatës kriminale dhe të grupit të strukturuar kriminal dënohet sipas dispozitave penale përkatëse, duke i shtuar dënimit për veprën penale të kryer edhe pesë vjet burgim, si dhe gjohën në masën një të tretën, por pa kaluar kufirin maksimal të dënimit me burgim.

2. Kur dispozita përkatëse referuese përmban dënim me burgim apo me burgim të përjetshëm, dënohet me njëzet e pesë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm...".

IV. Vlerësimi i gjykatës

Në lidhje me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj personave nën hetim Ergys Agasi, Ermal Beqiri, Mirlinda Karçanaj, Hava Delibashi, Erjon Ismaili, Rogers Rryta, Andis Papa dhe Gëzim Hoxha

Një nga të drejtat themelore kushtetuese është liria e personit. Garantimi i kësaj të drejte është parakusht për ushtrimin e shumë të drejtave të tjera, siç janë psh: liria e tubimit dhe e shoqërizimit, jeta familjare, e drejta e lirisë së lëvizjes etj. Megjithë rëndësinë e padiskutueshme që ka, kjo e drejtë nuk është absolute, pasi si, në aktet ndërkombëtare edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, parashikohen në mënyrë taksative rastet se kur kjo liri kufizohet. Nga ana tjetër duke parashikuar rastet e kufizimeve në mënyrë shteruese kjo në vetvete përbën një garanci në nivel kushtetues në lidhje me këtë të drejtë. Pasur parasysh edhe paragrafin e parë të nenit 5 të KEDNJ-së, që përmban prezumimin që çdokush duhet të gëzojë lirinë e tij, duhet të kemi parasysh se kjo e drejtë është një e drejtë e kufizueshme në rrethana që e justifikojnë atë, prandaj si rrjedhojë, një personi mund t'i privohet kjo liri në rrethana përjashtuese të cilat domosdoshmërisht duhet të jenë shteruese.

Masat e sigurimit⁷ janë veprime procedurale që heqin ose kufizojnë lirinë dhe të drejtat e personit ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal. Ato kanë si qëllim të parandalojnë veprimtarinë e mëtejshme kriminale të tij që ka kryer një veprë penale, të pengojnë shmangien e tij nga procedimi, përpykjet që ai mund të bëjë për të vënë në rrezik marrjen e provës ose vërtetësinë e saj, si dhe të garantojë shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale. Masa e sigurimit nuk është dënim penal që të përdoret si masë ndëshkimore për personin që dyshohet se ka kryer një veprë penale dhe nga ana tjetër, nuk jepet për të lehtësuar punën e organit të prokurorisë në hetimin e një çështjeje penale⁸. Masat e sigurimit aplikohen për shkaqe dhe kritere të përcaktuara në mënyrë të qartë në nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin Unifikues nr.4, datë 24.06.2009 janë shprehur ndër të tjera: *"Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar dy mënyra për caktimin e masave të sigurimit personal. Mënyra e parë që është rregulli për caktimin e masave të sigurimit është ajo që parashikohet nga neni 244 e vijues i këtij Kodi. Sipas këtij rregullimi është prokurori, i cili, mbasi ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme se në ngarkim të personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet për një veprë të caktuar penale ekziston dyshimi i bazuar në prova për kryerjen e veprës penale, duke patur parasysh kushtet dhe kriteret që parashikon Kodi i Procedurës Penale, në nenet 228 e vijues të tij, i bën kërkesë gjykatës që të caktojë një masë sigurimi personal, me qëllim që të garantojë nevojat e sigurimit. Në këtë rast, Gjykata verifikon nëse ekzistojnë realisht nevojat e sigurimit dhe nëse ekzistojnë kushtet për caktimin e masës së sigurimit personal duke verifikuar rrethanat faktike përcakton llojin e masës së sigurimit në përputhje me kriteret ligjore, me kushtin e vetëm që masa të mos jetë më e rëndë se ajo që kërkohet nga prokurori.*

Kjo procedurë që ndiqet për caktimin e masës së sigurimit nuk bazohet në parimin e kontradiktoritetit dhe nuk garantohen të drejta themelore që ka personi ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit për t'u dëgjuar, për tu mbrojtur vetë ose me avokat, për të ngritur pretendime dhe prova, pasi në vetvete kjo procedurë e caktimit të masës së sigurimit nuk është një gjykim i mirëfilltë me elementët që ka të përcaktuar sipas Kodit të Procedurës Penale, për shkak se, nevojat e sigurimit, këtë fazë të procedimit e konsiderojnë sekret dhe nuk e detyrojnë as prokurorin dhe as gjykatën të njoftojnë të pandehurin dhe mbrojtësin e tij lidhur me këtë veprim procedural. Ky rregullim ligjor është logjik, sepse në themel do të garantojë që një person që dyshohet të ketë kryer një veprë penale, të mos kryejë një veprë tjetër, të mos vërë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, apo t'i largohet dhe shmangët procedimit penal. Këto janë edhe shkaqet që prokurori, edhe pse nuk kemi një gjykim me palë, duhet t'ia parashtrojë dhe provojë gjykatës se ekzistojnë së bashku ose veçmas kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit personal".

Caktimi i masave të sigurimit duhet të bëhet në rastet e parashikuara nga K.Pr.Penale. Konkretisht në paragrafin e parë dhe të dytë të nenit 228 janë parashikuar kushtet e përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit, që duhet të mbajë parasysh gjykata në caktimin e masës së sigurimit të cilat janë:

⁷ Masat e sigurimit personal drejtohen ndaj personit të dyshuar për kryerjen e një veprë penale, duke privuar nga disa të drejta ose duke e ngarkuar me detyrime të veçanta. Ato ndahen në masa shtrënguese dhe masa ndaluese. Masat shtrënguese janë parashikuar në nenin 232 të K.Pr.Penale dhe janë: a) ndalimi i daljes jashtë shtetit; b) ndalimi dhe detyrimi për qëndrim në një vend të caktuar; c) garancia pasurore; ç) arresti në shtëpi; d) arresti në burg; dh) shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik. Masat ndaluese parashikohen në nenin 240 të K.Pr.Penale dhe janë: a) pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik dhe ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste.

⁸ Vendimi nr.489, datë 12.12.2000 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Dyshimi i arsyeshëm i mbështet në prova, ose elementi provues (fumus criminis delicti). Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova është kushti më i rëndësishëm, pasi askush nuk mund t'i nënshtrohet masave sigurimit personit nëqoftëse në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova. Gjithashtu, edhe DNJ-ja ka theksuar se dyshimi i arsyeshëm përbën standardin kryesor për heqjen e lirisë së personit¹⁰. Gjithashtu, edhe DNJ-ja në vendimin "*Stogmuller kundër Austrisë*" ka theksuar se kriteri i "dyshimit të arsyeshëm" duhet të ekzistojë në gjithë kohëzgjatjen e hetimeve, pasi nëse ky kriter pushon së ekzistuari, vazhdimësia e ndalimit bëhet e paligjshme. Është e vërtetë se dyshimi i arsyeshëm duhet detyrimisht të bazohet në prova, por se ai nuk kërkon detyrimisht që të tregojë sigurinë e plotë mbi autorin e veprës penale, por mundësinë se personi është autor i veprës penale.

Ekzistenca e veprës penale. Përveç dyshimit të arsyeshëm gjykata duhet të konstatojë nëse ekzistojnë dhe dy kushtet e tjera të përgjithshme. Kushti i dytë është ekzistenca e veprës penale ku kërkohet që fakti të jetë parashikuar nga ligji si vepër penale, apo vepra penale të mos jetë shuar për shkak parashkrimi të ndjekjes penale, ose për shkak të shfuqizimit të dispozitave penale, apo të mos jetë amnistuar.

Ekzistenca e kushteve të dënueshmërisë sipas së drejtës penale. Kushti i tretë i përgjithshëm është ekzistenca e shkaqeve të dënueshmërisë së personit ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit. Nuk mund të caktohet masë sigurimi ndaj një personi që nuk mund të merret si i pandehur, ose nuk mund të dënohet si p.sh. personi që nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, apo personi që është i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore, kur jemi para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprës penale, apo kur veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi ndaj personit. Në rastin konkret Gjykata thekson se:

Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar se personat nën hetim, shtetasit **Ergys Agasi dhe Ermal Beqiri**, në rolin e tyre si organizatorë, kanë krijuar një formacion të posaçëm kriminal, me qëllim kontrollin e procedurave të prokurimit të cilat prokurohen/tenderohen nga Autoritetit Kombëtar i Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, me qëllim krijimin e përfitimeve të padrejta materiale. Shtetasja **Mirlinda Karçanaj**, në rolin e titullarit- *Drejtoreshë e Përgjithshme* të Autoritetit Kontraktor (AKSHI), shtetasja **Hava Delibashi**, në cilësinë e Zëvendësdrejtoreshës së Përgjithshme të AKSHI (më herët në cilësinë e drejtoreshës juridike), kanë siguruar vendosjen e kriterëve të paligjshme në procedurat e prokurimit, me qëllim favorizimin dhe krijimin e privilegjeve të padrejta, për operatorët ekonomikë "*Soft & Solution*" sh.p.k., "*First*" sh.p.k. dhe "*Fastech*" sh.p.k., apo dhe shoqërive të tjera tregtare, të lidhura në mënyrë të tërthortë me shtetasin Ermal Beqiri, si shoqëritë "*Horizon*" sh.p.k. dhe "*Communication Progress*" sh.p.k.

Shtetasit **Andis Papa dhe Gëzim Hoxha**, kanë rol aktiv në pjesëmarrjen dhe përfitimin e paligjshëm të procedurave të prokurimit, të cilat diktohen nga shtetasit e sipërpërmendur, e dhëna e cila rezulton qartë

⁹ Vendimi i GjEDNJ-së, Murray k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. kërkesë 14310/88, datë vendimi 28 tetor 1994.

¹⁰ Në vendimin e dhënë për çështjen "*Fox, Campbell dhe Hariley kundër Mbretërisë së Bashkuar*", kjo Gjykatë e ka konsideruar shkelje të standardit faktin që "qeveria e Mbretërisë së Bashkuar kishte arrestuar dhe ndaluar aplikuesit si terroristë të dyshuar të IRA-s, por nuk arriti t'u jap gjykatave vendos faktet dhe të dhëna të përshkueshme për të mbështetur pretendimin për "dyshimin e arsyeshëm se ata kishin kryer një vepër të jashtëligjshme".

Nga analiza financiare e kryer dhe konkretisht, duke rezultuar se këta shtetas, kanë kredituar shumë të konsiderueshme monetare tek shoqëria "EA Solution", në pronësi të shtetasit Ergys Agasi, veprim të cilit e kanë kryer nën udhëzimin e shtetasit Ermal Beqiri. Njësimi i kësaj veprimtarie të paligjshme i dy subjekteve Ergys Agasi dhe Ermal Beqiri, dokumentohet dhe nga deklaratimet e punonjësve të shoqërisë "EA Solution", ashtu si dhe nga deklaratimet e administratores së kësaj shoqërie, shtetases Ina Ciko, nga të cilat ka rezultuar se punonjësit e kësaj shoqërie rekrutohen dhe menaxhohen nga shoqëria "Soft & Solution", në pronësi të shtetasit Ermal Beqiri, se ata nuk kishin punuar në asnjë ambient tjetër përveç se ambjentëve të shoqërisë "Soft & Solution", çka krijon bindjen mbi fiktivitetin e shërbimeve të "supozuara" të kryera nga shoqëria "EA Solution", në pronësi të shtetasit Ergys Agasi.

PO ashtu, shtetasit Ermal Beqiri, Ergys Agasi në bashkëpunim dhe me persona të tjerë ende të paidentifikuar, kanë planifikuar dhe organizuar rrëmbimin e shtetasit Gerond Meçe, ortak i operatorit ekonomik, shoqërisë "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k., me qëllim detyrimin e këtij të fundit për tërheqjen nga ankimimet e bëra pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ndersa shtetasi Ismaili dyshohet se ka kryer në kuader të këtij grupi të strukturuar kriminal vetëm veprën e paarshikuar nga neni 170/b të K.Penal.

Nga analizimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit, krijohet dyshimi se heqja dorë e këtij shtetasi nga ankimimet e bëra pranë KPP-së, do t'i krijonte lehtësira të konsiderueshme shtetasve të sipërpërmendur, me qëllim vijimin e aktivitetit kriminal në fushën e prokurimeve publike, aktivitet i cili ishte pezulluar në disa raste, për shkak të ankimimeve të bëra pranë KPP nga shoqëria "Advanced Business Solutions-ABS".

Gjithashtu, nga deklaratimet e shtetasit Gerond Meçe, bëhet e ditur se shtetasi Erjon Ismaili (me detyrë zëvendës drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë), i ka kërkuar "të rrijë larg AKSHF", fakt ky i cili përputhet gjithashtu dhe me rezultatin e pamjeve të këqyrura në zyrën e shtetasit Ergys Agasi, pra se këta të fundit kanë lidhje shoqërore dhe interesa të përbashkëta. Nga këqyrja e pamjeve filmike të sekuestruara në zyrën e shtetasit Ergys Agasi, evidentohen shumë takime mes tij dhe shtetasit Erjon Ismaili.

Për të ilustruar "modus operandi" të kësaj veprimtarie të shtetasit Ergys Agasi, në kuadër të hetimeve është konstatuar shtetasi Ergys Agasi, në një komunikim të datës 06.03.2019 me shtetasin Alqi Bllako, të cilët komunikojnë me një "situatë" në të cilën dyshohet se shtetasi Damian Gjijnuri "ishte bërë pengesë", lidhur me përfitime të paligjshme të tyre.

Nga përmbajtja e kësaj bisede, evidentohet se personi me emrin "Iabi", është shtetasi Elgerti Bixha, për të cilin shtetasi Ergys Agasi do ta emërojë si administrator në një shoqëri private e cila ka fituar një koncension me ministrinë e drejtuar në atë kohë nga ish-ministri Damian Gjijnuri, i cili pretendohet se është bërë pengesë për realizimin e këtyre përfitimeve të paligjshme nga ana e shtetasve Ergys Agasi, Elgerti Bixha dhe Alqi Bllako. Në këtë komunikim, konkretisht në mesazhin e datës 06.03.2019, ora 21:54:43, shtetasi Ergys Agasi shprehet se: "Do ja qì robt do fusim cunatboastaj.." (do fusim çunat pastaj), çka nënkupton faktin se ai përdor lidhjet e tij me persona me rrezikshmëri të lartë shoqërore, për të "hequr" këto pengesa.

Kjo rrethje, lidhet dhe me pengmarrjen e shtetasit Gerond Meçe, pasi ai gjithashtu si në rastin e shtetasit Damian Çajkuri, kishte krijuar "pengesa", nëpërmjet ankimimeve të shumta pranë KPP-së, për procedurat e prokurimit të zhvilluara pranë AKSHI, duke nënkuptuar faktin se "modus operandi" i këtij grupi kriminal është i njëjtë.

Në vijim të këtij arsytimi, dyshimi i arsyeshëm në ngarkim të shtetasit Ergys Agasi, si organizator dhe pjesëmarrës i pengmarrjes së shtetasit Gerond Meçe, përforcohet dhe nga fakti se automjeti i përdorur për kryerjen e pengmarrjes, rezulton të jetë në pronësi të subjektit "Merkaj 3" sh.p.k., me nipt L31722005D, në pronësi të shtetasit Endri Merkaj.

Nga burimet e hapura është verifikuar fakti se shtetasi Endri Merkaj, së bashku me vëllain e tij Klajdi Merkaj, janë lidhje me interes të shtetasve Arjan Ormenaj dhe Arben Lamçe, pjesë e grupit kriminal "Çopja". Gjithashtu, gjatë kontrollit të banesës së shtetasit Ergys Agasi, janë gjetur dokumente me interes për hetimin, konkretisht "Kontratë shitje pasuri e paluajtshme me rezervë kalim pronësie me nr. 1370/798 rep/kol datë 07.03.2024, mbajtur dhe legalizuar pranë zyrës noteriale Fatmir Koseni, midis shtetasve Drita Hoxha, në cilësinë e palës shitëse, shtetasve Mira Hoxha, Irfan Hoxha dhe Nikalin Jaka në cilësinë e palës dhënëse të pëlqimit dhe shoqërisë "Elba Beton" me numër NIPT K12608201B përfaqësuar nga shtetasi Arjan Ormenaj...".

Këto të dhëna, janë në përputhje dhe me deklaratimet e shtetasit Gerond Meçe, i cili shpjegon se ka konstatuar se dy nga personat që e kishin rrëmbyer kishin dialekt nga zona e Elbasanit, madje njëri prej tyre i kishte thënë se po ta shihte në Elbasan, do ta përshëndeste.

Duke vlerësuar në tërësi sa më sipër parashtuar, në pjesën e parashtimit të rrethanave të faktit në mënyrë të detajuar nga organi i akuzës, krijohet dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se, në fushën e prokurimeve publike me Autoritet Kontraktor AKSHI-n është ngritur një formacion i posaçëm kriminal, i formësuar si grup i strukturuar kriminal, me qëllim përfitimin e fondeve publike që prokurohen ng ky institucion në cilësinë e Autoritetit Kontraktor.

Gjykata, duke mbajtur në konsideratë parashikimin ligjor të bërë në nenin 28/4 të cituar më sipër, konstaton se në këtë rast personat e përfshirë, ata që janë identifikuar deri më tani, rezulton të kenë bashkëpunuar si një grup i posaçëm dhe jo në bashkëpunim të thjeshtë. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, ka arsyetuar se: "...."Grupi i strukturuar kriminal", si formë e veçantë bashkëpunimi, është parashikuar në pikën 4 të nenit 28 të Kodit Penal, në fuqi, në të cilën thuhet: "Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një ose më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jo materiale. Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një veprë penale nuk formohet rastësisht e nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar."

Duke iu referuar përmbajtjes së kësaj dispozite, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se, për të qenë para "Grupit të strukturuar kriminal", si formë e veçantë bashkëpunimi, duhet të ekzistojnë, këto kushte:

a) Duhet që bashkëpunimi për kryerjen e një ose disa veprave penale, ndërmjet, të paktën tre ose më shumë personave;

b) Duhet që kryerja e veprave penale të bëhet me qëllimin e posaçëm të realizimit të përfitimeve materiale ose jo materiale;

c) Duhet që grupi i strukturuar të mos jetë krijuar rastësisht dhe

d) Nuk është e nevojshme që grupi i strukturuar të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar....".

Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jo materiale. Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një veprë penale nuk formohet rastësisht e nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar. Krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës së posaçme të këtij Kodi ose të dispozitave të tjera penale të veçanta. Anëtarët e organizatës kriminale, të organizatës terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal janë përgjegjës për të gjitha veprat penale të kryera prej tyre, në përmbushjen e qëllimeve të veprimtarisë së tyre kriminale.

Sa sipër, duke vlerësuar në tërësi rolin e secilit person në arritjen e qëllimeve të grupit, të faktit se ky formacion është i shtrirë në kohë dhe nuk është rastësor dhe as episodik, qëllimet e tij janë të qartë, qëllim përfitimi material (*përvetësimi i fondeve publike të veshura nën petkun e procedurave të ligjshme të prokurimit publik*), Gjykata vlerëson se ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se jemi para veprës penale të "*Grupit të strukturuar kriminal*", parashikuar nga neni 333/a të K.Penal.

Përveç sa sipër, në kuadër të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova dhe dyshimeve për veprat penale të kryera nga personat nën hetim, gjykata arsyeton edhe si më poshtë vijon:

Shtetasja Mirlinda Karçanaj është Drejtoreshë e Përgjithshme e Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (shkurt AKSHI), autoriteti përgjegjës për qeverisjen elektronike. Po ashtu, AKSHI është institucion përgjegjës për infrastrukturën qendrore të shërbimeve elektronike dhe ofrimin e shërbimeve elektronike të përqëndruara. Veprimtaria dhe funksionimi i këtij autoriteti, personi juridik publik, buxhetor, rregullohet me ligjin nr. 43/2023 "*Për Qeverisjen Elektronike*". Ky institucion drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie. Drejtori i përgjithshëm mbështetet nga një zëvendës drejtor.

Në nenet 26, 27 dhe 28 të Ligjit 43/2023, parashikohen detyrat e AKSHI-t në përmbushje të misionit të tij: (i) detyrat e AKSHI-t si krijues, zhvillues dhe administrues i sistemeve dhe i infrastrukturës; (ii) detyrat e AKSHI-t si kontribuues në hartimin e politikave në fushën TIK; (iii) detyrat e AKSHI-t në zbatim të detyrimeve ndërkombëtare. Po ashtu, në nenin 29 të këtij ligji, parashikohen detyrat të tjera të AKSHI-t, ndër to, edhe ... "*..dh) organizon, kryen prokurimet e qëndëruara dhe lidh kontratat për sistemet, pajisjet software dhe hardware, mirëmbajtjen, si dhe shërbimet e internetit dhe intranetit me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla për të gjitha institucionet e administratës shtetërore në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi; e) organizon, kryen prokurimet e përqëndruara për pajisjet TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara "sekret shtetëror", për institucionet e*

administratës shtetërore në përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë; ë) organizon prokurimin e përqëndruar për pajisjet TIK, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla dhe për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, për të cilat jo më vonë se data 30 qershor i dërgojnë kërkesë me shkrim AKSHI-t për nevojat e tyre për projekte dhe pajisjet TIK për vitin pasardhës, ose sipas një afati të mëvonshëm të përcaktuar me udhëzim të drejtorit të përgjithshëm të AKSHI-t...".

Në shkronjën "h", të nenit 26 të Ligjit nr. 43/2023, thuhet se për pajisjet, sistemet në të cilat përpunohet informacion i klasifikuar "sekret shtetëror", i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, AKSHI ndjek dhe zbaton politikat dhe strategjitë e hartuara nga institucioni përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar për këtë qëllim, i cili mbikëqyr zbatimin e legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

Në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, ligji që përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet dhe entet kontraktore për kontratat publike dhe konkurset e projektimit, në nenin 10 të tij parashikohet se, ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit në rast se prokurimi ose zbatimi i tyre është klasifikuar sekret shtetëror apo kërkon masa të veçanta sigurie sipas legjislacionit në fuqi, ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësore të shtetit, me kusht që të jetë përcaktuar që interesat thelbësore në fjalë nuk mund të garantohen me vendosjen e kriterëve që synojnë mbrojtjen e natyrës së klasifikuar të informacionit, që autoriteti ose enti kontraktor i vë në dispozicion në procedurën e prokurimit. Po ashtu, në nenin 12 të këtij ligji, parashikohet se: "1. Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

2. Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit, që edhe pse nuk përjashtohen nga zbatimi i pikës 1, në rast se interesat thelbësore të shtetit nuk mund të garantohen me mënyra më pak ndërhyrëse si vendosja e kriterëve, që synojnë mbrojtjen e natyrës së klasifikuar të informacionit, që autoriteti ose enti kontraktor i vë në dispozicion në procedurën e prokurimit.

3. Në rastin e kontratave të pëziera, që kanë si objekt të tyre prokurimin që mbulohet nga ky ligj dhe prokurimin që mbulohet nga legjislacioni në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, zbatohet legjislacioni në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë".

Ligjvënësi shqiptar në kuadër të zhvillimit të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, ka miratuar ligjin nr. 36/2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë". Ky ligj ka si objekt të tijin kontratat që lidhen me fushat e mbrojtjes dhe të sigurisë, për: (a) furnizimin me pajisje ushtarake dhe pjesët dhe/ose njësitë përbërëse të tyre; (b) furnizimin me pajisje të klasifikuara dhe pjesët dhe/ose njësitë përbërëse të tyre; (c) punë, mallra dhe shërbime që lidhen drejtpërdrejt me pajisjet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", për çdo dhe të gjithë elementet e ciklit jetësor të tyre; (ç) punë, pajisje dhe shërbime ushtarake që, për arsye sigurie, përfshijnë, kërkojnë dhe/ose përmbajnë informacion të klasifikuar dhe trajtohen si punë, mallra dhe shërbime të klasifikuara. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për prokurimet në fushën e mbrojtjes e të sigurisë së institucioneve shtetërore dhe të mbrojtjes e sigurisë në Republikën e Shqipërisë.

Referuar këtij ligji:

- **“Certifikata e Sigurimit ndustrial (CSI)”**: është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton, nga pikëpamja e sigurisë, se një operator ekonomik ka kapacitetet dhe aftësitë organizative, teknike e fizike dhe i plotëson standardet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar në një projekt/program apo kontratë/nënkcontratë të klasifikuar.
- **“Certifikatë e Sigurimit të Personelit (CSP)”**: është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton, nga pikëpamja e sigurisë, se një individ i plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.
- **“Informacion i klasifikuar”**: është çdo dokument ose material, pavarësisht nga forma dhe natyra ose mënyra e transmetimit e tij, i përgatitur ose që përgatitet, të cilit i është vendosur niveli i caktuar i klasifikimit dhe afati i ruajtjes së klasifikimit në pajtim me legjislacionin në fuqi, në interes të mbrojtjes, dhe të sigurisë kombëtare, që kërkon mbrojtje nga çdo lloj shkatërrimi, humbje, vjedhje, rrjedhje, përhapje të paautorizuar ose aksesit nga çdo individ i paautorizuar ose çdo lloj tjetër kompromentimi sigurie, ku përfshihet: informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror”, i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar një marrëveshje sigurie.

Sipas nenit 7 të këtij ligji, “Kontratat e përziera”, parashikohet se: “1. Kontratat, që kanë, njëkohësisht, si objekt të tyre punë, mallra ose shërbime në zbatim të këtij ligji dhe, pjesërisht, në zbatim të ligjit të prokurimeve publike, prokurohen sipas dispozitave të këtij ligji, me kushtin që, për arsyë objektive, është i pamundur prokurimi në kontrata të ndara.

2. Kontratat, që kanë, njëkohësisht, si objekt të tyre punë, mallra ose shërbime që rregullohen pjesërisht nga ky ligj, ndërsa pjesa tjetër nuk është objekt as i këtij ligji dhe as i ligjit të prokurimit publik, nuk janë subjekt i këtij ligji, me kushtin që prokurimi i një kontrate të vetme të bazohet në arsye objektive.

3. Në çdo rast, vendimi për të prokuruar vetëm një kontratë nuk mund të merret me qëllim përjashtimin e kontratave nga zbatimi i këtij ligji ose i ligjit të prokurimit publik”.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave është miratuar VKM nr. 823, datë 26.12.2024 “Për miratimin e rregullores “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, të NATO-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”. Referuar pikës 2 të kësaj VKM-je, thuhet se, “Vendimi nr. 189, datë 4.3.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, shfuqizohet”. Kjo rregullore zbatohet nga institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomikë, të cilët duhet të marrin masa për sigurinë fizike të informacionit të klasifikuar. Sipas kuptimit që i jepen termave të përdorur në këtë ligj, me termin “perimetri i sigurisë”, kuptohet kufiri fizik i zonave të sigurisë, ku ruhet apo administrohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë.

Në kuadër të informacionit të klasifikuar, në fuqi është ligji nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, ligj që përcakton parimet bazë dhe rregullat për krijimin, administrimin, deklasifikimin,

zhvlerësimin dhe mbikëqyrjen e informacionit të klasifikuar gjatë gjithë ciklit jetësor të tij. Sipas kuptimit të termave të këtij ligji:

- “**Autoritet klasifikues**” janë titullarët e institucioneve, që në përmbushje të detyrave zyrtare, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo me autorizim të Kryeministrit, fitojnë të drejtën për klasifikimin e informacionit.
- “**Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**” (AKSIK) është autoriteti përgjegjës për hartimin dhe kontrollin e zbatimit të politikave dhe standardeve të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO-s, të BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
- “**Dokument i klasifikuar “sekret shtetëror”**” është çdo dokument i regjistruar, pavarësisht formës fizike ose karakteristike, përfshirë dokumentin e shkruar të printuar ose në formë elektronike, klasifikuar sipas këtij ligji.
- “**Certifikata e sigurisë së personelit (CSP)**” është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton nga pikëpamja e sigurisë se një individ plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.
- “**Certifikata e sigurisë industriale (CSI)**” është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton nga pikëpamja e sigurisë se një operator ekonomik ka kapacitetet dhe aftësisë organizative, teknike e fizike dhe i plotëson standardet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar në një projekt/program apo kontratë/nëkontratë, që përmban informacion të klasifikuar.
- “**Informacion i klasifikuar “Sekret shtetëror”**” është çdo dokument ose material, pavarësisht nga forma dhe natyra e tij, i përgatitur ose që përgatitet, të cilit i është vendosur një nivel i caktuar klasifikimi dhe afat ruajtjeje klasifikimi në përputhje me këtë ligj, në interes të sigurisë kombëtare dhe mbrohet nga shkatërrimi, humbja, vjedhja, rrjedhja, përhapja e paautorizuar ose qasja nga qdolloj tjetër kompromentimi sigurie.
- “**Klasifikimi**” është procesi përmes të cilit një informacion si i klasifikuar “sekret shtetëror”, duke i caktuar nivelin e klasifikimit dhe afatin e ruajtjes së këtij klasifikimi në përputhje me këtë ligj.
- “**Siguria kombëtare**” është mbrojtja e pavarësisë, integritetit territorial, rendit kushtetues, jetës dhe mirëqenies së qytetarëve, pasurisë kombëtare dhe marrëdhënieve me jashtë të Republikës së Shqipërisë.
- “**Sistemet e Komunikimit dhe Informacionit**” (SKI) janë sistemet që trajtojnë ose do të trajtojnë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”, të NATO-s, BE-së, shteteve dhe/ose organizatave të tjera ndërkombëtare me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje sigurie.

E drejta e njohjes me informacionin e klasifikuar kufizohet vetëm tek ata persona që kanë nevojë për njohje dhe përmbushin kriteret e sigurisë. Disiplina për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar janë: (a) *siguria e informacionit*; (b) *siguria e personelit*; (c) *siguria fizike*; (ç) *siguria e sistemeve të komunikimit dhe informacionit*; (d) *projekte të klasifikuara dhe siguria industriale.*

Informacioni i sigurisë fizike" ajo është tërësia e masave fizike, teknike, elektronike dhe procedurale për ruajtjen e zonave, ndërtësive, zyrave, dhomave dhe pajisjeve ku prodhohet, administrohet dhe shkatërrohet informacioni i klasifikuar.

Zonat e sigurisë janë hapësirat ku prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, transmetohet, ruhet, arkivohet dhe shkatërrohet informacioni i klasifikuar. Titullari i institucionit miraton me urdhër ndarjen e zonave të sigurisë, planin dhe skemën e sigurisë fizike të objektit ku mbahet dhe administrohet informacioni i klasifikuar. Zonat e sigurisë ndahen në tri kategori: (a) zona e sigurisë së klasit të parë; (b) zona e sigurisë së klasit të dytë; (c) zona administrative. Informacioni i klasifikuar "sekret shtetëror" i nivelit "tepër sekret" prodhohet dhe administrohet në zonat e sigurisë së klasit të parë. Informacioni i klasifikuar "sekret shtetëror" i nivelit "konfidencial" e lart prodhohet dhe administrohet në zonat e sigurisë së klasit të parë dhe të dytë. Informacioni i klasifikuar "sekret shtetëror" i nivelit "i kufizuar" prodhohet dhe administrohet në zonën administrative. Përveç këtyre zonave, ligji njih edhe zonën teknike të sigurt, e cila përbën zonën në të cilën organizohen takime të klasifikuara dhe kërkon mbrojtje kundër sulmeve teknike dhe përgjimeve. Zona teknike të sigurt u nënshtrohet kontrolleve të rregullta fizike, teknike dhe hyrja në to duhet të ketë kontroll të rreptë.

Po ashtu, kuptimi i sigurisë industriale jepet nga neni 50 i Ligjit, ku parashikohet se: "1. Siguria industriale është aplikimi i sistemit të masave të sigurisë, procedurave dhe rregullave bazë, përmes të cilave realizohet parandalimi i përhapjes së paautorizuar, humbjes apo shkeljes së sigurisë së informacionit të klasifikuar, i cili trajtuhet në kushtet e zbatimit të një projekti, programi, kontrate dhe nënkontrate në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmban informacion të klasifikuar..". Në nenin 51 të ligjit "Inicimi i procedurave të sigurisë" parashikohet se: "1. Institucionet e administratës publike, të cilat gjatë veprimtarisë së tyre prodhojnë, administrojnë dhe qarkullojnë informacion të klasifikuar, kanë të drejtë të iniciojnë procedurat për kryerjen e një prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmban informacion të klasifikuar, sipas parashkimeve të legjislacionit të posaçëm të prokurimit në këtë fushë.

2. Çdo institucion i administratës publike, në cilësinë e autoritetit kontraktor, ka përgjegjësi që gjatë hartimit të dokumentacionit të tenderit apo zbatimit të kontratës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, të aplikojë sistemin e masave të sigurisë që garanton mbrojtjen e këtij informacioni, sipas kërkesave të përcaktuara në të gjitha disiplinat e sigurisë së informacionit të klasifikuar.

3. Operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, i cili përmban informacion të klasifikuar, u nënshtrohen rregullave specifike të sigurisë.

4. Angazhimi i operatorëve ekonomikë në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar në nivelin "Konfidencial" e lart, bëhet vetëm pasi më parë operatori ekonomik është i pajisur me nivelin e kërkuar të Certifikatës së Sigurisë Industriale (CSI)".

Znj. Karçanaj rezulton të ketë njohje të drejtpërdrejta me shtetasin Ernal Beqiri, ky i fundit ortak i shoqërive tregtare, operatorëve ekonomikë që marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, AKSHI. PO ashtu, ky shtetas është lidhje e shtetasit Ergys Agasi, i cili ka në pronësi, pra është ortak i shoqërisë "EA Solutions" sh.p.k. Edhe ky shtetas është njohje e znj. Karçanaj. Të dhënat e përfuara nga pamjet filmike, të cilat ndodhen në pajisjen kompjuterike të sekuestruar "4-Smart battery camera", tregojnë se këta shtetas janë lidhje e njëri-tjetrit dhe flasin edhe për procedura apo

detyra që lidhen me projekte në dukje prokurimi, pasi përmendin se “projekti bën 2 milion, ne do ta bëjmë 4”, ose “nuk futet as në eksperiencë”, të cilat nënkuptojnë përcaktimin e kriterëve të procedurave të prokurimit, vlera e kontratave që do të publikohen (fondi limit) etj. Znj. Karçanaj ka deklaruar në deklaratimet e saj, se me shtetasin Ergys Agasi ka raport miqësor, ka njohje të vjetra dhe e ka takuar disa herë në zyrën e tij, për çështje private. Po ashtu, nga të dhënat e përfuara, organi procedues ka ardhur në dijeni të faktit se shtetësja Viola Agasi (që rezulton të jetë në përbërje të grupeve të punës në procedurat e AKSHI-t), e punësuar te AKSHI, është e motra e shtetasit Ergys Agasi. Lidhur me shtetasin Ermal Beqiri, znj. Karçanaj ka deklaruar se e ka takuar njëherë rastësisht në zyrën e z. Agasi, ku z. Agasi donte të bënte një partneritet me një kompani izraelite, dhe e ka pyetur atë për zgjidhje teknike. Prezent në ambient ka qenë edhe z. Beqiri, i cili sipas deklaruës ka qenë prezent në mënyrë rastësore. Po ashtu, me z. Beqiri deklaroi që ka patur një udhëtim të përbashkët, me shumë përfaqësues të tjerë të shoqërive të teknologjisë dhe informacionit, të cilët kanë krijuar një organizatë jofitimprurëse. Në fakt, takimi në zyrën e z. Agasi konfirmon faktin se të tre këta shtetas janë lidhje e njëri-tjetrit dhe po ashtu znj. Karçanaj është në dijeni të plotë të faktit se z. Agasi dhe z. Beqiri janë njohje dhe lidhje e njëri-tjetrit.

Po ashtu, rezulton nga provat e administruara deri më tani, se shtetasi Gerond Meçe, është ortak i vetëm i shoqërisë tregtare “Advanced Business Solutions” -ABS sh.p.k. Kjo shoqëri tregtare, në cilësinë e operatorit ekonomik ka marrë pjesë në shumë procedura prokurimi publik zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor-AKSHI, përgjatë viteve, përfshirë edhe vitin 2025. Gjatë këtij viti, ky operator ka paraqitur ankime pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për procedura prokurimi që lidhen me AKSHI-n, duke pretenduar për vendosjen e kriterëve të paligjshme të paparashikuara nga ligji, me qëllim pengimin e pjesëmarrjes në tendera, përfitimin e procedurave të prokurimit nga persona të caktuar etj.

Në datën 12.08.2025, sipas të dhënave të përfuara: deklaratimit të këtij shtetasi, që përputhet me pamjet filmike të marra nga kamera të ndryshme të pallatit ku ai jeton, të dhënat e përfuara nga telefoni i shtetasit z. Kërluku, administrator i kësaj shoqërie, të dhënat në sistemin e KPP-së lidhur me njoftimet për tërheqjet nga procedurat e prokurimit, vendimet e KPP-së, rezulton se persona të paidentifikuar fillimisht duke e shtyrë në lajthim (duke qenë se personat e automjetit Land Rover Defender me targa AC121JJ, kanë qenë të veshur me uniforma/jelekë që kanë pasur shënimet “POLICIA” dhe “BKH” dhe makina ka pasur fenelina policie), dhe më pas me anë të dhunës dhe kanosjes me armë, i kanë hequr në mënyrë të paligjshme lirinë shtetasit Gerond Meçe, veprim që ka zgjatur disa orë dhe është bërë kryesisht në zonën e Elbasanit. Këta shtetas i kanë kërkuar z. Meçe që të tërhiqej nga të gjitha ankimimet që ai, pra shoqëria e tij, vetëm apo si bashkim operatorësh, kishte bërë pranë KPP-së, për procedurat e prokurimit publik me Autoritetet Kontraktor AKSHI-n. Këta shtetas e kanë detyruar z. Meçe që t’i dorëzojë aparatën telefonik, të cilët e kanë përdorur për të komunikuar me administratorin e shoqërisë, shtetasin Shkëlqim Kërluku. Në këto komunikime këta shtetas janë paraqitur sikur të ishte duke komunikuar vetë shtetasi Gerond Meçe, që i kërkon administratorit të veprojë shpejt për të hequr dorë (tërhequr) nga ankimimet e kryera nga ky subjekt në AKSHI-n dhe KPP-në. Administratori ka kryer veprime në platformën “E-Albania”, duke u tërhequr nga të gjitha ankimimet, duke u tërhequr madje edhe në ato procedura prokurimi ku ka marrë pjesë si BOE, pra bashkim operatorësh. Vetëm pasi janë konfirmuar tërheqjet, është lënë i lirë z. Meçe.

Duke qene se informacioni ka rezultuar i saktë lidhur me procedurat ky shoqëria e z. Meçe kishte aplikuar si operator ekonomik apo bashkim operatorësh ekonomikë në procedurat e zhvilluar nga AKSHI, si autoritet kontraktor, lind dyshimi i logjikshëm, se ky informacion që kishin këta shtetas është dhënë nga dikush apo persona brenda AKSHI-t ose/dhe KPP-së.

PO ashtu, është e logjikshme të arrihet në përfundimin që tërheqja nga ankimimet e shoqërisë "ABS" sh.p.k., si operator ekonomik i vetëm ose BOE, lidhet me interesat e drejtpërdrejta apo tërthorta të konkurrenësve të tjerë në këto procedura prokurimi publik. Në një nga pamjet filmike të administruara, konstatohet biseda mes shtetasve Ergys Agasi dhe Ermal Beqiri, ku diskutohet për dy tendera për procedurë, si dhe përmendet kompania ABS. Nga kjo bisedë përftohet e dhëna se këta shtetas janë të shqetësuar për praninë e kompanisë ABS me ortak të vetëm z. Meçe dhe po ashtu përftohet e dhëna tjetër e rëndësishme, se z. Agasi (*pra shoqëritë e tij tregtare ku ai është ortak*) përveç se nuk merr pjesë në procedurat e prokurimit publik të AKSHI-t, ku flet për "*ofertë*" dhe se "*ishin dy tendera për procedurë, ishte një A Bi E*", tregon që ai ka interes të drejtpërdrejtë mbi këto procedura, për shkak se, sikurse do analizohet dhe më poshtë, është përfitues fundor dhe faktit i tyre.

PO ashtu, edhe vetë z. Meçe ka deklaruar se ai dyshon që rrëmbimin e tij ta ketë kryer shtetasi Ermal Beqiri, gjë që e thotë me siguri, për shkak se pas çdo procedure të tillë qëndron një nga shoqëritë e tij ose që janë të lidhura me të. Këtë bindje e forcon me faktin se diku nga periudha prill-qershor 2024, administratorja e firmës "Soft&Solution" e Ermal Beqirit i ka shkruar në ambientet e kompanisë dhe ka kërkuar të takohet me të. Pasi e njoftuan kush është, ka refuzuar ta takojë pasi ishte kompani e lakuar në treg për shumë procedura. Në dhjetor të 2023, shtetasi Gent Progni ka dalë në media duke e akuzuar se "ABS" bashkëpunon me "Soft&Solution", "Comunication progres", "Fastech" etj. Duke qënë se deri në atë moment s'ka patur asnjë lloj kontakti me këto kompani preferoi të mos e takonte administratoren. Në momentin që stafi i tij ka komunikuar që nuk do e takojë, ajo në dalje e sipër ka thënë që "kështu do të vazhdoni ju të bashkëpunoni me ne". Pas kësaj kanë filluar problematikat e kompanisë lidhur me bllokimin e procedurave me AKSHI. Këtu përmend një procedurë me Hardëare e AKSHI, që është futur bashkë me kompaninë InfoSoft, e cila u zhvillua dy herë dhe u anulua pa shkaqe të arsyeshme. Kur InfoSoft u fut herën e tretë vetëm, u shpall fitues. Pas këtij momenti fillon edhe historia e ankimeve që u bë edhe shkak i rrëmbimit.

Lidhur me arsyen e mos bërjes së denoncimit në polici lidhet me faktin që nëndrejtori i Policisë së Tiranës, Erjon Ismaili, kohë më parë nëpërmjet një personi që për momentin nuk i kujtohet, në janar-shkurt 2025 i kishte kërkuar që të qëndronte sa më larg nga AKSHI. Rastësisht, postieri i zonës në rrugën e RTSH rreth muajve prill-maj 2025, duhet të dërgonte një letër një kompanie sigurimesh te ABA Tower dhe ndërkohë që letrën ja refuzojnë atje, postieri e merr në telefon e i thotë që ka një letër për të. Zarfë ishte i hapur dhe kishte një letër brenda ku Prokuroria e Tiranës kërkonte informacion bankar dhe informacion nga sigurimet për të dhe familjen e tij. Kësaj shkresë i ka bërë një foto dhe ja ka kthyer postierit pasi letra i drejtohej një kompanie sigurimesh te ABA Tower. Më pas është interesuar dhe ka marrë vesh që kjo praktikë hetimore ishte iniciuar nga Erjon Ismaili, që ishte nëndrejtor i Policisë së Tiranës. Kjo shkresë rezulton të jetë administruar dhe është pjesë e dosjes hetimore.

Po ashtu, rezulton se z. Ismaili është lidhje e z. Agasi dhe z. Beqiri dhe në datën 30.10.2023, janë takuar me zyrën e z. Agasi, e dhënë që mbështet deklarinin e z. Meçe, i cili ka deklaruar se z. Ismaili (me detyrë revendësdrori i Drektorisë Vendore të Policisë Tiranë), i ka kërkuar “të rrijë larg nga AKSHI”.

Kjo mënyrë sjellje e z. Agasi, pra *modus operandi e njëjtë*, evidentohet edhe në një rast tjetër, nga ku rezulton se shtetasi Ergys Agasi, ka një komunikim të datës 06.03.2019, me shtetasin Alqi Bllako, lidhur me një “situate”, në të cilën dyshohet se shtetasi Damian Gjikhuri “*ishte bërë pengesë*”, lidhur me përlitimet e paligjshme të tyre. Në shqetësimet e tyre, diskutojnë që nëse nuk zgjidhet çështja sikurse e duan ata, Ergys Agasi, shprehet se “*Do ja q..robt do fusim cunatboastaj*” (*do fusim cunat pasta*), gjë që tregon faktin se ai përdor lidhjet e tij me persona me rrezikshmëri të lartë shoqërore, për të “hequr” këto pengesa.

Në lidhje me mjetin Land Rover Defender, me të cilin është rrëmbyer z. Meçe, rezulton të jetë në pronësi të shoqërisë “Merkaj 3” sh.p.k., në pronësi të shtetasi Endri Merkaj. Nga burimet e hapura, bëhet me dije se, ky shtetas, së bashku me të vëllain e tij, Klajdi Merkaj, janë lidhje me interes e shtetasve Arjan Ormenaj dhe Arben Lamçe, pjesë e grupit kriminal “Çopja”. Po ashtu, edhe gjatë kontrollit të banesës së shtetasit Ergys Agasi, ndër të tjera është gjetur një kontratë shitje për pasuri të pauajtshme me rezervë kalim pronësie, ku z. Ormenaj rezulton përfaqësues i njëres prej palëve kontraktore. PO ashtu, z. Meçe ka deklaruar se dy nga personat që e kishin rrëmbyer kishin dialekt nga zona e Elbasanit, madje njëri prej tyre i kishte thënë se po ta shihte në Elbasan, do ta përshëndeste.

Të gjitha sa sipër, krijojnë dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova se, personat nën hetim Ergys Agasi, Ermal Beqiri dhe persona të tjerë, ende të paidentifikuar, kanë kryer veprat penale të “*Heqjes së paligjshme të lirisë*”, “*Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës*”, në kuadër të një formacioni të posaçëm, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga nenet 110, 170/b, paragrafi i dytë, neni 28/4, 333/a dhe 334 të K.Penal, ndërsa deri më tani krijohet dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se personi nën hetim Erjon Ismaili, të ketë kryer veprat penale të “*Konkurrencës së paligjshme nëpërmjet dhunës*”, në kuadër të një formacioni të posaçëm, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga nenet 170/b, paragrafi i dytë, neni 28/4, 333/a dhe 334 të K.Penal,

Këta shtetas dyshohet të kenë organizuar ngjarjen e datës 12.08.2025 ndaj z. Meçe, ku për disa orë atij i është hequr liria, duke e detyruar që të tërhiqet nga të gjitha procedurat e prokurimit që ka pranë AKSHI-t dhe KPP-së. Ai është liruar vetëm pasi personat që i kanë hequr lirinë kanë konfirmuar se ai është tërhequr nga këto procedura prokurimi¹¹. Po ashtu, këta shtetas me veprimet e tyre të kundërligjshme,

¹¹ Në lidhje me figurën e veprës penale të “*Heqjes së paligjshme të lirisë*”, parashikuar nga neni 110 të K.Penal, gjykata eidenton se: Lidhur me veprën penale të “*Heqjes së paligjshme të lirisë*”, parashikuar nga neni 110 të K.Penal, ajo ka për objekt të saj, garantimin e paprekshmërisë së lirisë individuale të personit, liria e lëvizjes dhe e disponimit të vetvetes. Në lidhje me anën objektive, kjo veprë kryhet duke i privuar lirinë personale dikujt. Në togfjalëshin “heqje lirie”, do të përfshihet çdo liri që gëzon qytetari i zakonshëm. Nisur nga objekti që merret në mbrojtje dhe nga sanksionet që parashikohen, duhet të konsiderohet si një kufizim i thjeshtë lirie. Kjo manifestohet në forma nga më të ndryshmet dhe mund të kryhet me mënyra apo mjete të shumëllojshme, në varësi kjo të tiparit të lirisë që i hiqet një personi apo grupi personash të caktuara. Nëpërmjet përdorimit të forcës fizike, një personi i ndalohet apo kufizohet që të zgjedhë vendin e qëndrimit dhe të lëvizjes sipas dëshirës

Është bërë se kanë kryer edhe veprime kriminale që konfigurohen në veprën penale të "Konkurrencës së ligjshme nëpërmjet dënimit" parashikuar nga neni 170/b¹² të K.Penal, pasi ata kanë kryer veprime duke shkelur parimin e lirë dhe në konkurrencë të mbajtjes së armëve, ku e kanë detytuar z. Meçe që të tërhiqet nga prokurimi i prokurorit ku shoqërin e tij vetëm, ose si BOE merrte pjesë në procedurat e prokurimit.

Lidhur me kualifikimin e këtyre veprimeve të kundërligjshme në këtë rast, gjykata parashtron se organi procedues do të duhet të ketë në konsideratë figurën e veprës penale të "Rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit", parashikuar nga neni 109 të K.Penal. Në figurën e kësaj vepre penale parashikohet se: "Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit me qëllim për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër, për të përgatitur krijimin e kushteve lehtësuese për kryerjen e një krimi, për të ndihmuar fshehjen ose largimin e autorëve ose bashkëpunëtorëve në kryerjen e një krimi, për t'iu shmangur dënimit, për të detyruar realizimin e kërkesave a kushteve të caktuara, për qëllime politike ose çdo qëllim tjetër, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet". Po ashtu, referuar Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 1, datë 25.03.2005, është arsyetuar se: "...Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit, neni 109 i Kodit Penal synon të mbrojë në rradhë të parë lirinë e personit. Interpretimi dhe zbatimi korrekt i kësaj dispozite kërkon të mbahen parasysh ndërmjet të tjerave, dy elemente thelbësore:

a) përfitimi i padrejtë e realizimi i interesave të tjera të paligjshme në kuptim të rasteve të parashikuara nga dispozita dhe

b) lirimi i viktimës përkundrejt marrjes së këtij përfitimi.

së tij; bëhet izolimi fizik në një ambient apo vend të caktuar, ku ai nuk dëshiron të gjendet dhe njëkohësisht nga ky vend dalja nuk i lejohet. Subjekti pasiv (viktima) izolohet fizikisht, nuk i lejohet që ta jetojë jetën personale sipas zgjedhjes së tij, nuk lejohet të komunikojë me të tjerët, me botën e jashtme, nuk mund të ndjekë apo të frekuentojë lirshëm një mjedis të caktuar, i kufizohet jeta sociale. Kohëzgjatja e kufizimit të lirisë nuk ka rëndësi për ekzistencën e këtij krimi. Vepra penale kryhet në këto rrethana cilësuese: (a) kur vepra shoqërohet me vuajtje të rënda fizike; (b) kryhet në bashkëpunim; (c) kundër disa personave; (ç) më shumë se një herë. Subjekti i kësaj vepre penale sipas paragrafit të parë është çdo gjashtëmbëdhjetëvjeçar dhe i përgjegjshëm, ndërsa sipas paragrafit të dytë, subjekti i veprës penale është çdo person, i cili ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç. Nga ana subjektive vepra kryhet vetëm me dashje direkte.

¹² Lidhur me këtë figurë të veprës penale, gjykata eidenton se: Kjo vepër penale ka për objekt të sajin mbrojtjen e marrëdhënieve juridike të vendosura për të siguruar funksionimin e rregullt të veprimtarisë prodhuese, tregtare ose të shërbimit në shoqëritë tregtare, të pa ndikuar nga veprimet e konkurrencës së pandershme e të paligjshme, veçanërisht nga ato të kryera nëpërmjet kërcënimeve dhe dhunës nga anëtarët e një shoqërie tjetër ose me nxitjen e tyre. Nga ana objektive vepra penale kryhet me veprime aktive të ndryshme të autorit të shoqëruara me anë të kërcënimeve ose dhunës. Këto sjellje të paligjshme konsistojnë në përdorimin e forcës detyruese ndaj palës tjetër që të mos bëjë konkurrencë, të lërë tregun e lirë që autori të tregtojë lirshëm mallrat apo shërbimet e tij. Kërcënimet bëhen nëpërmjet përdorimit të fjalëve apo gjesteve të cilat mund të jenë nga më të ndryshmet, mjafton që të krijojnë tek i dëmtuari ndjenjën e frikës se atij do t'i shkaktohet një e keqe nëse nuk zbaton kërkesat e autorit.

Dhuna përfaqëson një formë më të avancuar të veprimeve të paligjshme të autorit. Dhuna në këtë rast është fizike, e tillë që të detyrojë të dëmtuarin të pranojë ato çfarë i kërkon autori. E godet me pëllëmbë apo me grushte, e rreh apo e plagos lehtë. Duke vepruar në shkelje të praktikave konkurruese të tregut, Autori me veprimet e tij, e dobëson apo ka mundësi të dobësojë ndjeshëm lirinë e zgjedhjes së palës tjetër për tregtimin, prodhimin apo shërbimin dhe në këtë mënyrë, e detyron palën tjetër të marrë një vendim, të cilin në të kundërt nuk do ta kishte marrë atij.

Paragrafi i dytë parashikon si rrethanë cilësuese, kur konkurrenca e paligjshme drejtohet ndaj veprimtarive të financuara plotësisht ose pjesërisht dhe në çfarëdo mënyre nga shteti ose entet publike.

Subjekti i veprës penale është i përgjithshëm, çdo person i moshës mbi katërmëdhjetë vjeç. Nga ana subjektive vepra penale kryhet gjithmonë me dashje direkte.

Edhe pse është e vëndosur në seksionin VII "veprat penale kunder lirisë së personit", neni 109 ka për objekt jo thjesht mbrojtjen e lirisë personale por edhe paprekshmërinë dhe mbrojtjen e pasurisë. Objekt dhe motivet e autoreve të veprës penale e kthejnë viktimën në një instrument, "send" të cënuar si pasuri përdoruese dhe në interesat e tij pasurore e jopasurore. Ekziston një lidhje e ngushtë midis qëllimit të veprës, përfitimit dhe lirimit të personit për këtë shkak. Ai shikëmbetet, pra lihet i lirë, vetëm përkundrajt realizimit të përfitimit të pasurisë, përfitimeve dhe qëllimeve të tjera të parashikuara në dispozitë.

Në aspektin subjektiv, ekzistenca ose jo e një marrëveshje apo marrëdhënie të mëparshme mes viktimës dhe autorit të veprës penale mund të përbëjnë edhe shkakun për kryerjen e veprës penale të rrëmbimit a mbajtjes peng të personit, por ky aspekt duhet të konsiderohet i përfshirë në qëllimin final të realizimit të një përfitimi të padrejtë e të paligjshëm, si një çmim, kompensim për lirim të viktimës, apo edhe për të lehtësuar gjendjen e të dëmtuarit që i është hequr liria në mënyrë të paligjshme.

Neni 109 është i qartë në këtë drejtim, sepse ligjvënësi ka përcaktuar vendimtar në kuptim të anës subjektive realizimin e qëllimit "... për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër" dhe jo shkakun e saj. Pra qëllimi i përfitimit dhe lirimi i viktimës përkundrajt realizimit të këtij qëllimi, përbëjnë në mënyrë të njëkohshme elementë thelbësorë të kësaj vepre penale.

Neni 109 i Kodit Penal (ashtu sikurse edhe neni 110 i tij), duhet të konsiderohet i kryer me heqjen e paligjshme të lirisë, rrëmbimin a mbajtjen peng të viktimës, pavarësisht nëse autori ka arritur ose jo të realizojë përfitimet dhe qëllimet e parashikuara në vepër dhe përkundrajt të cilave ai do të lirojë viktimën.

Nëse gjatë gjykimit vërtetohet natyra e padrejtë e përfitimit si motiv për rrëmbimin a mbajtjen peng, jemi përpara rastit kur një person privohet nga liria, pra, rrëmbehet a mbahet peng dhe i kërkohet një përfitim i padrejtë përkundrajt lirimit të tij. Në këtë rast është evidente lidhja e ngushtë ndërmjet veprimeve të kryera, qëllimit të përfitimit të padrejtë dhe kërkesës për të dhënë përfitim përkundrajt lirimit të viktimës. Prandaj në këto raste, Kolegjet çmojnë se figura e veprës penale që duhet të gjejë zbatim është ajo e rrëmbimit ose marrjes peng të personit, neni 109 i K.P.

Po ashtu, fakti që ka ekzistuar një kërkim a marrëdhënie e mëparshme qoftë edhe e paligjshme ndërmjet të autorit të veprës dhe viktimës, shërben vetëm për të individualizuar llojin dhe masën e dënimit, por jo aspektet e tjera të anës subjektive që kërkan neni 109 të Kodit Penal, realizimi i një përfitimi të padrejtë përkundrajt lirimit të viktimës.

Një nga elementët specifike që është dallues dhe përcaktues në kualifikimin e veprës sipas nenit 109, apo nenit 110 të Kodit Penal lidhet me anën subjektive të tyre, pikërisht me qëllimin, motivin e autorit të veprës penale dhe që ka të bëjë me realizimin e një përfitimi pasuror, përfitimeve a qëllimeve të tjera (të ngjashme). Kjo situatë del nga vetë kuptimi në tërësi i nenit 109 të Kodit Penal ku përfitimet dhe qëllimet duhet të jenë të padrejta, të përbëjnë një interes të paligjshëm, për vehte ose për të tjerët, përkundrajt lirimit të viktimës. Motivi dhe qëllimi i veprës sipas nenit 109 të K.P. lidhet me realizimin në mënyrë të padrejtë të një përfitimi pasuror, të një qëllimi tjetër të paligjshëm a në rrugë të paligjshme, përfshirë edhe qëllime të tjera të ngjashme me ato të përmendura shprehimisht në këtë dispozitë.

Ndërkohë, heqja e paligjshme e lirisë nuk i ka të përcaktuara motivet në kuptim të anës subjektive, gjë që do të thotë se ato janë të tilla që nuk përfshihen në nenin 109 të K.P. ose në vepra të tjera penale.

Duke analizuar përmbajtjen e nenit 109 të Kodit Penal rezultojnë dy çështje thelbësore për anën objektive të kësaj vepre. Kështu, sjellja dhe veprimet e autorit, sipas nenit 109 të Kodit Penal janë:

... "meqë ato mbajnë për vetë personit", që në vetvete nuk janë gjë tjetër veçse veprime që kanë kuptim vetëm në lidhje me shprehjet e tyre në paligjshme të lirisë së viktimës. Nga ana objektive, kjo veprë penale në kodin e shprehjet mbajtja peng dhe rrëmbimi të personit, pavarësisht se dy dispozitat përmbajnë fjalë e termat e përbashkëta në pikëpamjen gjuhësore: "rrëmbim ose mbajtja peng" dhe "heqje e paligjshme e lirisë". Edhe në rastin e nenit 110, nga pikëpamja e anës objektive, është e nënkuptuar se heqja e paligjshme e lirisë e përmban në vetvete ushtrimin e dhunës, kryerjen e veprimeve të tilla që çojnë në heqjen e lirisë dhe pamundësinë e personit për të "lëvizur" në liri. Këto veprime jo vetëm nuk përjashtojnë, por përfshijnë si rastet e mbajtjes peng e rrëmbimit të personit, ashtu edhe forma të tjera të privimit të lirisë pa ushtrim dhune fizike të përmendura më sipër në interpretimin e nenit 110 të Kodit Penal...". Ndaj në këtë rast, veprimet e kundërligjshme të këtyre shtetasve në raport me veprimet që kanë bërë ndaj z. Meçe konfigurohen në veprën penale të parashikuar nga neni 109 të K.Penal, pasi z. Meçe i është hequr liria me qëllim që ai të tërhiqet nga procedurat e ankimit dhe është liruar vetëm kur është konfirmuar fakti i tërheqjes së tij nga këto procedura, duke i lënë kështu rrugë të lirë konkurrentëve të tjerë, me interesa të organizatorëve që të vazhdojnë dhe fitojnë procedurat e prokurimit. Pra, plotësohen elementët e anës objektive të kësaj veprë penale, megjithatë gjatë hetimeve prokurori ka atributiv ekskluzive mbi akuzën penale dhe gjykata shprehet në këtë vendim për aq sa kërkohet duke qenë garante e të drejtave dhe interesave të individëve, megjithatë gjykata mund të japë orientimet dhe vlerësimet e saj, pa cenuar të drejtat e palëve në proces.

Po ashtu, gjatë kontrollit të ushtruar në shoqërinë tregtare "EA Solutions" sh.p.k., kontrolli i së cilës është lejuar me vendim gjyqësor, oficerët e BKH-së, kanë konstatuar se kjo shoqëri kishte për adresë të deklaruar, të njëjtë me atë të shoqërisë "INGW-T" sh.p.k. Pasi është saktësuar adresa që do kontrollohej, është shkuar në objekt dhe janë gjendur 10 punonjës, të cilët kanë deklaruar se janë punonjës të shoqërisë "Soft & Solutions". Nuk kishin dijeni rreth shoqërisë "EA Solutions". Nuk njihnin asnjë punonjës të shoqërisë "EA Solutions". Është kontaktuar me administratoren e shoqërisë, shtetasen Ina Ciko e cila ka shkuar në adresën ku ishin oficerët dhe ka deklaruar se ajo ishte adresa e saktë e shoqërisë "EA Solutions". Vetëm një punonjëse e cila ishte prezent, znj. Muçobega, ka rezultuar punonjëse e shoqërisë "EA Solutions".

Nga kontrolli i ushtruar rezultoi se në zyrë ndodhej i afishuar ekstrakti i shoqërisë "Soft & Solution". Në zyrë kishte disa kuti të cilat kishin të shënuar emrin e shoqërisë "Soft & Solution" dhe në dollapet e shoqërisë të gjitha dosjet dhe dokumentat ishin të kësaj shoqërie. Lidhur me këtë fakt, shtetasja Ina Ciko deklaroi se shoqëria "EA Solution" e ka marrë ambientin me qira nga shoqëria "Soft & Solution" dhe se ndoshta kjo shoqëri ende nuk i ka marrë dokumentet e saj. Kjo shtetase nuk kishte dijeni se ku ishin punonjësit e shoqërisë "EA Solution", me çfarë projektsh merreshin ata dhe nuk kishte dijeni se të kujt ishin kompjuterët në të cilët po punonin punonjësit. Shtetasja Jonida Muçobega deklaroi më pas se kishte dijeni që ishte punonjëse e shoqërisë "EA Solution". Kjo shtetase deklaroi se kishte kryer trajnimin pranë shoqërisë "Soft & Solution" dhe që kishte idenë se këto shoqëri janë bashkë. Asnjë nga personat të cilët ishin prezent nuk kishte dijeni lidhur me shoqërinë "INGW-T" sh.p.k. Shoqëria "INGW-T" sh.p.k., e cila ka adresën në të njëjtin vend, është në pronësi të shtetaseve Arjola Koromani dhe Erisa Malellari. Shtetasja Arjola Koromani ka qenë ortakë dhe administratore e shoqërisë "Soft & Solution". Më pas kjo shtetase ka qenë ortakë apo administratore në disa shoqëri të lidhura me shoqërinë "Soft & Solution".

Nga verifikimi i librave të shitjes rezulton se shoqëria "EA Solution" ka realizuar shitje në vlerën 779,582,683 lekë. Thuhet se të gjitha shitjet kjo shoqëri i ka realizuar me shoqërinë "Soft & Solution" (apo shoqëri të tjera të cilat kanë fituar tendera nga AKSH).

Nga verifikimi i librave të blerjes rezulton se shoqëria "EA Solution" ka realizuar blerje në vlerën 33,438.389 lekë, nga të cilat një faturë është e datës 13.04.2025, me shitës AZ Auto Zetrum (Gjermani), me përshkrimin Të përdorura, me sasi 1, me vlerë 28,035,524 lekë. Kjo faturë dyshohet se është për blerje automjeti, çka tregon se shoqëria "EA Solution" nuk ka fare fatura blerje.

Nga verifikimi në sistemin C@ts rezulton se shoqëria "EA Solution" ka një punësim prej 10-15 punonjësish, me paga të konsiderueshme, dhe disa prej tyre janë të punësuar që nga krijimi i shoqërisë.

Nisur nga të dhënat më sipër krijohet dyshimi i mbështetur në prova se shoqëria "EA Solution" është themeluar fiktivisht, me qëllim kalimin e pagesave të përfituara nga shoqëria "Soft & Solution" drejt shtetasit Ergys Agasi.

Në vijim, me qëllim verifikimin e të dhënave të konstatuara, të cilat rezultuan nga ushtrimi i këtij kontrolli, është proceduar me marrjen në pyetje të disa punonjësve të shoqërisë "EA Solution" sh.p.k. Këta shtetas në tërësi kanë deklaruar se njoftimet për punë i kanë parë në internet, trajnimet e tyre i ka bërë shtetasja Xhenila Tamizi. Nga aktet kjo shtetase rezulton të jetë e punësuar në shoqërinë "Soft & Solutions" sh.p.k., madje në emër të saj rezulton edhe sendi i blerë nga Ermal Beqiri, mjete lundrues Predator 50 Skyfall (jaht). Pasi janë trajnuar, punonjësit bëjnë me dije se kontratat janë lidhur me një shoqëri tjetër, të ndryshme nga "Soft & Solutions", konkretisht me shoqërinë "EA Solutions".

Nga tërësia e shpjegimeve të dhëna nga punonjësit e shoqërisë "EA Solution", arsyeshëm krijohet bindja se kjo shoqëri ekziston në mënyrë krejtësisht fiktive dhe se nuk ka realizuar asnjë punë apo shërbim konkret, por se në realitet, të gjitha punët dhe/apo shërbimet e kryera prej saj, janë kryer nga punonjës të shoqërisë "Soft&Solution". Në këtë kontekst, edhe faturimet e shoqërive të tjera dhe/apo blerja e shërbimeve nga palë të treta, nga shoqëria "EA Solutions" sh.p.k., dyshohet se janë fiktive.

Po ashtu nga analiza financiare e veprimeve/transaksioneve të subjektit "EA Solution" kanë rezultuar me interes për hetimit të dhënat si në vijim:

Nga betimet e mësipërme ka rezultuar se subjektet "Soft & Solution" sh.p.k, "First" sh.p.k. dhe "Fastech" sh.p.k. kanë kaluar fonde në llogarinë e subjektit "EA Solution" sh.p.k. në pronësi të shtetasit Ergys Agasi. Subjekti "Soft & Solution" sh.p.k. është në pronësi të shtetasit Ermal Beqiri. Subjekti "First" sh.p.k rezulton me NIPT K82020002A dhe është në pronësi të shtetasit Gëzim Hoxha. Subjekti "Fastech" sh.p.k rezulton me NIPT J81609010U dhe është në pronësi të shtetasit Andis Papa.

Hetimet tregojnë se në sistemin "@CATS" të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve rezulton se subjekti "EA Solution" ka faturuar shitje në drejtim të subjektit "Fastech" sh.p.k. për periudhën 11.12.2024 – 26.09.2025 shumë prej 2 235 761 543 ALL. Në drejtim të subjektit "First" sh.p.k

shumën prej 130 317 172 ALL. Në drejtim të subjektit "Soft & Solution" sh.p.k shumë prej 527 63 500 ALL.

Si konkluzion, rezulton se faturimet e kryera nga "EA Solution" sh.p.k. në drejtim të tre subjekteve të tjera të përshkruara më sipër janë fiktive dhe me qëllim përfitimin e parave që rrjedhin nga procedurat e prokurimeve të paracaktuara nga grupi kriminal. Ky faktitet konstatohet në faktin që subjekti "EA Solution" sh.p.k. nuk ka ambiente për realizimin e aktivitetit të biznesit por përdor ambientet e "Soft & Solution" sh.p.k., punonjësit e deklaruar në emër të këtij subjekti janë rekrutuar nga punonjës të burimeve njerëzore të subjektit "Soft & Solution" sh.p.k. dhe nuk kanë patur asnjëherë kontakt me administratorin e subjektit "EA Solution" sh.p.k, shtetasen Ina Ciko. Nga ana tjetër kjo e fundit nuk ka kryer asnjë veprimtari dhe nuk ka asnjë dijeni lidhur me kontraktimin e punëve që merret nga subjektet e tjera. Gjithashtu, në deklaratimet e shtetasit Andis Papa dhe Gëzim Hoxha thuhet se ata kanë kontraktuar shërbimet në "EA Solution" nëpërmjet shtetasit Ermal Beqiri i cili i ka drejtuar të ky subjekt. **Pra, të gjitha aktivitetet drejtohen nga shtetasit Ermal Beqiri dhe Ergys Agasi me qëllimin përfundimtar përfitimin e paligjshëm të fondeve të marra nga kontratat publike me institucionin e AKSHI.**

Nga hetimet rezulton gjithashtu se, subjekti "Soft & Solution" sh.p.k. dhe "Fastech" sh.p.k., për periudhën 2018 - 2021 kanë blerë produkte nga subjekti "Mega Distribution" sh.p.k. regjistruar me NIPT L02302016U. Ky subjekt aktualisht rezulton në pronësi dhe administrim të shtetasit Bedri Rryta. Në periudhën e mësipërme ky subjekt ka qenë në pronësinë e shtetasit Rogers Rryta, i cili është pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit. Nga deklaratimet e këtij shtetasi, por edhe sikurse rezulton nga të dhënat e ushtrimit të aktivitetit, kjo shoqëri tregtare tregton veshje dhe produkte ushqimore. Gjatë kohës që ai ka qenë administrator, ka patur marrëdhënie tregtare me kompanitë "Fastech" sh.p.k. dhe "Soft & Solutions" sh.p.k., për tregtimin e çokollatave dhe biskotave.

Referuar akteve, në llogaritë e kësaj shoqërie, rezultojnë kreditime gjatë viteve 2018, 2020 dhe 2021, në shumë në total mbi 10 milionë Euro, në llogari të ndryshme të këtij subjekti dhe këto fatura sipas tij bëhen për shitjet e çokollatave dhe biskotave. Nuk ka dijeni për aktivitetin tregtar të subjekteve "Fastech" sh.p.k., "Soft & Solutions" sh.p.k., si dhe nuk njih shtetasit Ermal Beqiri, Andis Papa, Ergys Agasi dhe Mirlinda Karçanaj.

Po ashtu janë pyetur administratorët e shoqërive tregtare "Fastech" sh.p.k. dhe "First" sh.p.k. Personi nën hetim Gëzim Hoxha, është administrator dhe ortak i shoqërisë "First" sh.p.k. Ka shpjeguar se shoqëria e tij, si operator i vetëm është shpallur fituese në një procedurë të prokuruar nga AKSHI, që kishte të bënte me sigurinë kibernetike me AKSIK (*menaxhimin e rrezikut si operator ekonomik i vetëm*). Një pjesë të shërbimit e ka nënkontraktuar shoqëria "Soft & Solutions" sh.p.k. Mirëpo, kur janë mbledhur dhe kanë diskutuar, për shkak të angazhimeve në punë të tjera, Ermali i ka thënë që modulet do t'i bënte një shoqëri me staf të kualifikuar, shoqëria "EA Solutions". Kjo kontratë ende nuk ka përfunduar dhe po ashtu nuk di të thojë me saktësi për llogaritjen e fitimit, por thotë se shpenzimet në tërësi kanë qenë rreth 50 % e vlerës së fondit limit.

•
Po ashtu, ka deklaruar se shoqëria e tij ka fituar në një procedurë tjetër prokurimi e cila është sekret, procedurë e prokuruar nga AKSIII dhe AKSIK, me një vlerë të lartë rreth 60 mln euro. Ky tender është sekret dhe ka nënkontraktuar disa shërbime nga shoqëria "EA Solutions" sh.p.k.

Të dy këto procedura prokurimi do të duhet të administrohen nga ana e organit procedues, për të analizuar në tërësi veprimet e kryera nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe organeve përgjegjëse, madje edhe fazën e zbatimit të këtyre projekteve, duke qenë se janë të dyja në fazë zbatimi dhe ende nuk kanë përfunduar e dorëzuar. Megjithatë, marrë në konsideratë deklaratimet e administratorit të shoqërisë, si në nenin 52 të ligjit nr. 36/2020 "*Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë*", ashtu edhe në nenin 126 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", të ndryshuar, parashikohet "*nënkontraktimi*" pra e drejta e operatorit fitues që një pjesë të kontratës ta përmbushë apo ekzekutojë një palë tjetër, e ndryshme nga operatori fitues ose BOE fituese. Megjithatë ligji në çdo rast kërkon që emri i nënkontraktorit ose nënkontraktorëve duhet t'i bëhet i ditur Autoritetit që gjatë zhvillimit të procedurave, pra kur ofertohet, pasi Autoriteti ose enti kontraktor miraton nënkontraktorët e mundshëm përpara lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, pa cenuar parimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni. Autoriteti kontraktor miraton vetëm nënkontraktorët e mundshëm të deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatori ekonomik dhe procesi i miratimit kryhet vetëm në Sistemin e Prokurimit Elektronik. PO ashtu, verifikimi i përmbushjes së kapaciteteve të nënkontraktorit të propozuar kryhet për aq sa është e aplikueshme nga ligji i prokurimit publik, në të njëjtën mënyrë si për operatorin ekonomik pjesëmarrës.

PO ashtu, është pyetur edhe shtetasi Andis Papa, i cili është administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë "Fastech" sh.p.k., i cili ka deklaruar se njeh shtetasin Ermal Beqiri dhe ka edhe njëfarë lidhje farefisnore me të. Ka marrë pjesë në procedura të ndryshme tenderimi, por që nga viti 2018 e në vijim ka bashkëpunuar edhe më shumë me AKSHI-n si institucion, përveç të tjerave. Por, pas vitit 2019, ky institucion ka qenë prota kryesore për ta, ku shihnin gjithmonë për punë. Ka aplikuar si operator i vetëm dhe si BOE, në raste të ndryshme. Ka bashkëpunuar edhe me shoqërinë "Soft & Solutions", sh.p.k.

Po ashtu deklaroi se ka njohje dhe bashkëpunim me shoqërinë "EA Solutions" sh.p.k., dhe ia ka prezantuar Ermal Beqiri. Kontakt drejtpërdrejt me këtë shoqëri nuk ka, madje di që dhe zyrat i ka tek shoqëria "Soft & Solutions" sh.p.k. Di që ka bërë pagesa për këtë shoqëri në vlerën 1.5 mln euro.

Z. Papa ka deklaruar se bashkëpunim ka edhe me shoqërinë "Mega Distribution" sh.p.k., bashkëpunim në fushën e teknologjisë dhe informacionit. Megjithatë kur shikon objektin e veprimtarisë së aktivitetit tregtar të kësaj shoqërie, shprehet se nuk di se çfarë ka blerë. Ka bërë edhe kontrata me këtë shoqëri.

Në zbatim të vendimit të këqyrjes dhe marrjes së dokumenteve, nëpërmjet procesverbalit të këqyrjes së datës 03.11.2025 janë administruar disa praktika të procedurave të prokurimit publik. Këto prokurime për qëllime të hetimit janë ndarë në tre kategori: (i) prokurime të realizuara në periudhën kur dokumentohen takimet midis shtetasve Ergys Agasi, Mirlinda Karçanaj dhe Ermal Beqiri; (ii) prokurime të lidhura me subjektin "ABS" sh.p.k ku përfshihen tërheqjet nga ankimimet por jo vetëm, si dhe, (iii) prokurime që lidhen me aktivitete fiktive të kryera nga "EA Solution" në favor të "Soft & Solution" sh.p.k., etj.

që kanë marrë parë në kuestuar që lidhen me prokurimet e zhvilluara nga AKSHI, gjatë periudhës së zhvillimit të aktivate mbi shtetasve Mirlinda Karçanaj, Ergys Agasi dhe Ermal Beqiri janë:

- Procedura e prokurimit me objekt *"Mirëmbajtja e sistemit të ATP-WEB-GIS për Agjencinë e Trajtimin të Pronave, Procedurë e Hapur"* me fond limit në total 39 528 000 ALL pa TVSH.
- Procedura e prokurimit me objekt *"Përmirësimi i sistemit të lejeve, zhvillimi i modulit të monitorimit të impaktit në mjedis dhe monitorimit në zbatim"* për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me vlerë limit të kontratës 314 961 948 ALL pa TVSH.
- Procedura e prokurimit me objekt *"Përmirësim dhe shtim i funksionaliteteve të sistemit të menaxhimit dhe raportimit të incidenteve kibernetike"*.
- Procedura e prokurimit *"Mirëmbajtja e sistemit të depove farmaceutike (eDepo) për FSDKSH"*.
- Procedura e prokurimit me objekt *"Implementimi i infrastrukturës së desktopëve virtual për Autoritetin e Aviacionit Civil"*.
- Procedura e prokurimit *"Implementimi i sistemit të qendëruar për dokumentet me nënshkrim elektronik 2.0, modulit të administratës publike"*.

(ii)Procedurat e prokurimit që lidhen me tërheqjen nga ankimet pranë KPP, nga subjekti "ABS", në pronësi të shtetasit Gerond Meçe, janë si më poshtë vijon:

- Procedura e prokurimit me objekt: *"Mirëmbajtje e sistemit FER për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit"*.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Softe kompjuterike me karakter të përgjithshëm për Agjencinë e Zhvillimit të Territorit"*.
- Procedura e prokurimit *"Përmirësimi i sistemit të thesarit"*.
- Procedura me objekt *"Ndërtimi i sistemit informatik të menaxhimit të proceseve të brendshme për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Institucioneve të Varësisë (IEVP) dhe Infrastrukturës hostuese"*.
- Procedura e prokurimit *"Mirëmbajtja e sistemit elektronik LIMS për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave"*, me fond limit e 22, 065, 600 (njëzetë e dy milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) Lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit *"Mirëmbajtja e sistemit elektronik LIMS për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë"*, me fond limit 29.993.490 (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë) Lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit *"Biletimi qëndror online për muzetë dhe sitet e trashëgimisë kulturore. Përmirësimi i sistemit të biletimit elektronik dhe platforma e shitjes së biletave"*, me fond limit 213.795.898 (dyqind e trembëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit *"Mirëmbajtja e sistemit elektronik të menaxhimit të vizitave dhe hyrje-daljeve në IEVP"*, me fond limit 46,800,000.00 (dyzet e gjashtë milion e tetëqind mijë) Lekë pa TVSH.

- Procedura e prokurimit *"Mirëmbajtja e sallës së monitorimit për Drejtorinë Përgjithshme të Burgjeve"*, me fond limit 79,996,200 (shtatëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind) Lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit *"Përmirësimi dhe integrimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit për ndihmën ekonomike, personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimit social"*, me fond limit 226,460,451.00 (dyqind e njëzet e gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e një) Lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit *"Pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për përdorim zyre"*, loti 6, me numër reference të lotit nr. REF-50809-06-112025, me objekt: *"KOMPJUTERA"*, me fond limit të lotit 1,348,052,656 (një miliard e treqind e dyzetë e tetë milion e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

(iii) Procedurat e prokurimit, për të cilat dyshohet se janë bërë pagesa fiktive, në drejtim të subjektit "EA Solution" sh.p.k., në pronësi të shtetasit Ergys Agasi:

- Procedura e prokurimit me objekt: *"Përmirësimi i Qendrës Kombëtare të Biznesit"*, në të cilën konstatohet se fitues i kësaj procedure është bashkimi i operatorëve ekonomik "HORIZON" sh.p.k. dhe "Soft Solution" sh.p.k. me ofertën ekonomike më të ulët në vlerën 194 545 212 ALL. Sipas dokumentit "Aneksi 1 – Terma Reference për Projektet TIK" në pikën 2.2 "Qëllimi" thuhet se qëllimi i kësaj kontrate është përmirësimi i moduleve dhe regjistrave elektronikë duke ofruar shërbime të unifikuara për bizneset në Republikën e Shqipërisë që lëshohen nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe rritjen e nivelit të automatizimit të proceseve të punës së institucionit.
- Procedura e prokurimit me objekt *"Implementimi i e-albania 2.0, site sekondar dhe open data"*, me vlerë 1,462,500,000 (një miliard e katërqind e gjashtëdhjetë e dy milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH. Nga dokumentet e tenderit rezulton se fitues i kësaj procedure prokurimit është subjekti "Fastech" sh.p.k.

Gjykata vlerëson se në pjesën e përshkrimit të rrethanave të faktit, burimit të provave dhe analizës së bërë, organi procedues në mënyrë të detajuar ka bërë pasqyrimin e rrethanave të faktit, analizën ligjore përkatëse dhe shkeljet e evidentuara dhe nuk ka vend për përsëritje nga ana e gjykatës në këtë pjesë të arsyetimit të vendimit, pasi arsyetimi i prokurorisë është ezaurues dhe i mbështetur në ligj përrsa rezulton deri më tani.

Në tërësi gjykata konstaton se lidhur me këto procedura prokurimi të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, AKSHI, ato janë kryer në referim të ligjit nr. 162/2020, *"Për prokurimin publik"* të ndryshuar dhe në respektim të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar. Asnjëra nga procedurat e sekuestruara dhe të analizuara nuk rezulton të jetë bërë në kuadër të ligjit nr. 36/2020, *"Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë"*. Megjithatë, nën miratimin e titullares së Autoritetit Kontraktor, znj. Karçanaj dhe të zëvendës drejtoreshës znj. Delibashi, grupet e punës që kanë vendosur kriteret e veçanta kualifikuese kanë kërkuar në procedura të ndryshme prokurimi (sipas rastit e procedurës përkatëse), pajisjen e operatorëve ekonomikë me CSI dhe CSP, ndërkohë që referuar bazës ligjore në fuqi (Ligjit nr. 10/2023 *"Për informacionin e klasifikuar"*, si dhe aktet

po ashtu, në rasti kur çartazi bartazi sanksionohet se këto certifikata janë të domosdoshme vetëm në procedurat apo kontratat në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, zhvillimi ose implementimi i të cilave, për shkak të rrethojave ligjore të veçantë (neni 10 dhe 12 i ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar). Në çdo rast Autoriteti Kontraktor është në shkelje të ligjit, pasi nëse në rast se do të duhehin certifikatat e sigurisë të kërkuara sikurse pretendon autoriteti, atëherë procedurat e prokurimit në këtë rast nuk mund të bëheshin bazuar në parashikimet ligjore të ligjit nr. 162/2020, por duhet të ishin bërë sipas legjislacionit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, gjë që parashikohet qartazi dhe në mënyrë të padiskutueshme, në nenin 12, pika 3 të ligjit nr. 162/2020.

Po ashtu, rezulton se në procedurat e prokurimit, ku rezulton të jetë kualifikuar i pari operatori ekonomik "Advanced Business Solutions-ABS" sh.p.k., me ortak të vetëm shtetasin Gerond Meçe, është gjetur një zgjidhje ekstraligjore, duke bërë rivlerësim të ofertave të paraqitura nga KVO, veprim që nuk ka asnjë mbështetje ligjore, si në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe as në VKM nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Në fakt, rivlerësimi i ofertave nga ana e KVO-së është një koncept që nuk njihet dhe as është njohur me parë në fushën e prokurimit publik. Kështu, KVO ndërsa fillimisht ka kualifikuar operatorin ekonomik "ABS" sh.p.k., duke e kualifikuar të parin, gjatë rivlerësimit ka bërë skualifikimin e tij, duke konstatuar managësi të dokumentacionit të certifikuar nga AKSIK, lidhur me certifikatat e sigurisë ose subjekti nuk ka certifikimet e nevojshme teknike të kërkuar nga DST. Këto veprime kanë çuar që të kualifikohen operatorë të tjerë ekonomik si fitues, me diferencë të konsiderueshme dhe me vlera më të larta të ofertuara, duke sjellë kështu dëm buxhetit të shtetit. Ndërsa në rastet kur "ABS" sh.p.k., ka qenë OE i vetëm në atë procedurë, është vendosur anulimi fare i procedurës së prokurimit publik të zhvilluar.

PO ashtu rezultojnë në raste të caktuara vendosja e kriterëve që nuk gjejnë mbështetje ligjore, ose janë të pajustificuara apo të përshtatura me qëllim dhënien e mundësisë vetëm të një numri të kufizuar operatorësh ekonomikë për të marrë pjesë në procedura, gjë që ka çuar në kufizimin e konkurrencës gjatë procedurave të prokurimit publik.

Duhet thënë se veprimtaria e Autoritetit Kontraktor, në këtë rast e AKSHI-t është mbështetur edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik. Ky Komision i ka gjetur në raste të caktuara të mbështetura kriteret e kërkuara në DST nga Autoriteti Kontraktor dhe po ashtu, në rastin e tërheqjes nga ankimimet të z. Meçe, në datën 12.08.2025, ky komision ka marrë vendim që ditën pasardhëse, datë 13.08.2025, duke argumentuar urgjencën, ndërkohë që pavarësisht se u ka shkruar një shkresë ditën tjetër se sistemi i tyre (shoqërisë ABS) ishte hakëruar (në fakt nuk ishte hakëruar por rezultoi se z. Meçe ishte detyruar të tërhiqej nga ankimimet), ky organ shtetëror mund të verifikonte të paktën këtë pretendim, duke qenë se ky nuk ishte një operator i panjohur në procedurat e prokurimit dhe vetë fakti që në të njëjtën ditë ishte tërhequr nga të gjitha procedurat e ankimimit, mund të kërkonte një verifikim paraprak, padyshim pa dëmtuar barazinë e palëve në proces. Po ashtu, rezulton se KPP, në rastet e tërheqjes së "ABS" sh.p.k., kur ka qenë si BOE, ka marrë në konsideratë vetëm vullnetin e "tërheqjes nga ankimimi" të vetëm njërit prej OE, pa marrë vlerësim faktin që në këtë procedurë, ka qenë edhe një kompani tjetër pjesëmarrëse si BOE, gjë e cila është dokumentuar plotësisht në marrëveshjen e bashkëpunimit mes dy operatorëve për pjesëmarrjen në këtë procedurë. Po ashtu kjo procedurë është zhvilluar në nxitim e sipër, pa respektuar edhe procedurën që duhet ndjekur në këtë rast. Të gjitha këto çojnë në dyshime të bazuara se persona me

*Interesa të caktuara kanë ardhur të ndikojnë edhe KPP-në në këtë rast, pasi veprimet e të gjithëve koordinohen me qëllim arritjen e rezultatit të kërkuar nga personat që dyshohet se janë organizatorët.

Rezulton po ashtu, se asnjë nga punonjësit e AKSHI-t, që kanë marrë pjesë në grupet e punës për vendosjen e kriterëve gjatë procedurave të prokurimit të zhvilluar, nuk mbron dot punën e tij në këto procedura. Në tërësi ata kanë deklaruar se argumentimi i kriterëve, ka qenë një dokument i përgatitur paraprakisht dhe ka ardhur i gatshëm nga zyra e prokurimeve apo zyra përgjegjëse. Edhe në ndonjë rast kur është deklaruar se dokumenti është hartuar nga grupi i punës, deklaruesit nuk dinë të japin shpjegime bindëse lidhur me mënyrën e të proceduarit, arsyetimin për kriteret e vendosura etj. Në asnjë nga këto grupe ku ata kanë marrë pjesë nuk rezulton të ketë pasur jurist. Ata shprehen se thjesht kanë rëndë dakort mesa ka qenë prezantuar dhe kanë nënshkruar, por shpjegime të detajuara nuk dinë të japin dhe arsyet lidhur me kriteret e vendosura.

Znj. Delibashi, gjatë pyetjes së saj, ka deklaruar se, dijeni për kriteret e vendosura ajo merr kur vijnë ankesat nga operatorët ekonomikë. Ka një vendim të titullarit, për klasifikimin e data – center të AKSHI-t, si zonë e klasifikuar. Për këtë ka një autorizim të kryeministrit, për klasifikimin pasi është tagër i delegueshëm nga Kryeministri. Lidhur me data-centerin e AKSHI-t, si zonë e klasifikuar, është përmendur në deklaratimet apo gjatë procedurave të prokurimit edhe nga funksionarët e tjerë të AKSHI-t, megjithatë deri më tani nuk rezulton nga aktet një gjë e tillë. Për më tepër, përcaktimi i një zone të një institucioni si e “klasifikuar”, mund të bëhet nga Titullari i një Institucioni, kur ka një autorizim të Kryeministrit, por ama në këtë rast zhvillohet një procedurë e tërë dhe në këtë rast, organi procedues do të duhet të verifikojë nëse vërtet ka një procedurë të tillë sipas parashikimeve ligjore apo jo. Megjithatë, sikurse u citua edhe më lart, nëse kjo zonë e AKSHI-t do të ishte e “klasifikuar”, atëherë procedurat që lidhen me të apo aksesimin e tij, do të duhet të zhvilloheshin sipas legjislacionit të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Përveç sa sipër, rezultojnë shkelje lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit. Në nenin 76 të VKM-së nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet mënyra sesi përlllogaritet fondi limit. Janë disa alternativa që jepen në këtë akt nënligjor, ndërsa është e vërtetë që Autoriteti Kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të dhëna në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në një nga procedurat e prokurimit publik të zhvilluar, atë të prokurimit me objekt “Pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komuniimit për përdorim zyre”, loti 6, me fond limit të lotit 1,348,052,656 lekë pa TVSH, rezulton se, në fazën e ftesë për ofertë, OE “Fastech” sh.p.k., në ofertën e tij për studim tregu, ka ofertuar çmime për pajisje të ndryshme (Kompjuterat). Referuar këtyre çmimeve të dhëna, dhe atyre të shoqërive të tjera, përfshirë edhe “Horizon” sh.p.k., grupi i punës ka hartuar fondin limit, dhe në zërat “Kompjuterat”, ka bërë përlllogaritjet përkatëse. Ndërkohë që ky OE kur ka paraqitur ofertën zyrtare të OE “Fastech” sh.p.k., në këtë procedurë prokurimi, ka ofertuar zyrtarisht çmime për të njëjtat pajisje disa herë më të vogël (diferencë e dukshme) me ato të studimit të tregut. Kjo gjë ka sjellë për pasojë rritjen artificiale të vlerës që prokurohet, pasi fondi limit është përcaktuar mbi vlera jo reale, me qëllim kjo maksimizimin e fitimit, dhe dëmtimin e buxhetit të shtetit. Në të njëjtën kohë, fondi limit,

ndjen edhe në vendosjen e kriterëve të tjera, që në rastin e punëve të ngjashme, referojnë te fondi limi,⁹ të që çon në kufizimin e konkurrencës së operatorëve ekonomikë.

Si shihet, evidentohet nga aktet edhe një rast kur znj. Delibashi, ka orientuar grupin e punës se kujt do t'i dërgohet kërkesa për ofertë tregu, duke e bërë orientimin tek subjekti "Soft & Solutions".

Të gjitha sa më sipër, duke vlerësuar në tërësi jo vetëm sa rezultojnë nga dokumentet e këtyre procedurave të prokurimit, por edhe veprimet e tjera, njohjet mes shtetasve në fjalë, duke pasur në konsideratë ngjarjen kriminale me viktimë z. Meçe, transferimet e dyshimta financiare nga shoqëritë që marrin pjesë në procedurat e prokurimit me Autoritet Kontraktor, AKSHI-n, krijohet dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se personat nën hetim Ergys Agasi, Ermal Beqiri, Mirlinda Karçanaj, Hava Delibashi, të kenë kryer veprën penale, "*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*", kryer në bashkëpunim të posaçëm, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 258, paragrafi dytë, 28/4 dhe 334, pika 1 të K.Penal.

Veprimet e këtyre shtetasve konfigurohen në figurën e kësaj vepre penale, pasi nga ana objektive: 1) kjo vepër penale kryhet nga i pandehuri/t vetëm me veprime aktive, të kundraligjshme. Këto veprime të të pandehurit kanë synim sjelljen e pasojave të caktuara kriminale: pengimin e lirisë dhe të barazisë së pjesëmarrësve në tender /ankand me qëllim krijimin e avantazheve apo përfitimeve të padrejta për një/disa pjesëmarrës në tender apo ankandin publik. Pra, është e domosdoshme që të ekzistojë lidhja shkakësore mes veprimeve të të pandehurit dhe pasojave kriminale, që parashikon kjo dispozitë. Nëse nuk ekziston kjo lidhje shkakësore nuk jemi përpara veprës penale të "*Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*". Mënyrat sesi konsumohet kjo vepër penale janë dy: 1) pengimi i palëve për të marrë pjesë në tender/ankand p.sh: pengim fizik për të hyrë në ambjentet ku zhvillohet tenderi; mosdhënie në kohë e dokumentacionit; mospranim në kohë i dokumentacionit, përjashtim abuziv nga pjesëmarrja në tender/ankand, shtyrja e datës së tenderit/ankandit derisa të largohet shoqëria e padeshiruar, vendosja e kushteve fiktive apo kushteve që dihet se, plotësohen vetëm nga pjesëmarrës të caktuar, etj...; 2) vlerësim i pabarabartë i një kushti/disa kushteve të plotësuar nga të gjitha palët. Pra, pavarësisht se pjesëmarrësit janë në kushte të barabarta konkurrimi, njëri apo disa nga këto kushte vlerësohen në mënyrë jo të barabartë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) dhe vetëm ky/këta kushte dhe asnjë tjetër të passjellin fitoren e njërit pjesëmarrës dhe skualifikimin e pjesëmarrësve të tjerë. Gjithashtu, Gjykata çmon se, neni 258 i Kodit Penal është një dispozitë blankete, që të referon në ligje të tjera, për të përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e personave të akuzuar që rrjedhin nga aktet ligjore, për të konkluduar më pas nëse të akuzuarit i kanë kryer veprime në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët.

Lidhur me kualifikimin ligjor të veprës për z. Agasi dhe z. Beqiri që nuk janë funksionarë publikë, apo persona që referuar ligjit të prokurimit publik janë të ngarkuar nga ligji i posaçëm për kryerjen e procedurave të prokurimit ose kanë cilësi të caktuara në kuadër të këtyre procedurave, gjykata vlerëson se në rastin objekt gjykimi, duke parë veprimet e këtyre shtetasve, pavarësisht se ata nuk janë subjekte të posaçme sipas ligjit, ata mbajnë përgjegjësi penale.

Në këtë pikë, gjykata mban në konsideratë vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 3, datë 02.11.2015, ku, ndër të tjera, është arsytuar se: "...61. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se një nga parimet themelore të së drejtës penale është edhe ai i autonomisë së përgjegjësisë, i quajtur mbyshe edhe parimi i përgjegjësisë personale të personit që kryen veprë penale. Parimi i autonomisë së përgjegjësisë shfaqet edhe në bashkëpunimin e dy ose më shumë personave në kryerjen e veprës penale në formën e dhënies të secilit prej tyre të një kontributi material ose moral për kryerjen e veprës penale. Dallimi mes aplikimit të parimit të autonomisë së përgjegjësisë në veprat penale me një autor të vetëm, nga ato të kryera në bashkëpunim, qëndron në faktin se, në rastin e parë, autori duhet të ketë kryer edhe materialisht veprën penale, ndërsa në rastin e bashkëpunimit, mjafton edhe që ai të ketë lehtësuar kryerjen e veprës penale nga persona të tjerë (Vendimi Unifikues nr.4, datë 15.04.2011), duke sjellë një kontribut relevant për kryerjen e veprës penale në mënyrë kolektive nga një pluralitet personash.

62. Sa i përket institutit të bashkëpunimit në veprën penale, sipas doktrinës shqiptare, bazën e përgjegjësisë penale në bashkëpunim, në kuptimin material dhe juridiko-formal, ashtu sikurse edhe për kryerjen e veprës penale nga një person i vetëm, në çdo rrethanë e përbën prania e veprës penale dhe e figurës së saj juridike me veprimin ose mosveprimin e pjesëmarrësit. E drejta penale nuk devijon nga ky parim themelor dhe i përgjithshëm i përgjegjësisë penale as në kushtet kur vepra kryhet në bashkëpunim.

63. Në lidhje me konfigurimin e veprës penale të bashkëpunimit (eventual) të personave në një veprë penale, janë të nevojshëm: 1) pluraliteti i subjekteve aktivë, 2) realizimi i një veprë penale të parashikuar si të atillë nga ligji material penal, 3) kontributi objektivisht relevant i bashkëpunëtorit (përkatesisht i ndarë sipas roleve vertikale: organizatorë, ekzekutorë, shtytës, ndihmës, apo të ndarë horizontalisht sipas punëve në veprën e përbashkët (Vendimi Unifikues nr.1, datë 12.03.2002), dhe 4) elementi subjektiv.

64. Nga pikëpamja e anës objektive kërkohet që vepra penale të jetë kryer nga jo më pak se dy persona, pra të provohet që në kryerjen e saj të kenë marrë pjesë më shumë se një person, pavarësisht rolit dhe veprimeve të kryera nga secili prej tyre, të cilat çmohen dhe përcaktohen nga gjykatat e faktit referuar rrethanave të faktit, në përputhje me parashikimet e nenit 26 të Kodit Penal.

65. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ana subjektive përbën një nga komponentët strukturore të institutit të bashkëpunimit, i cili kërkan si element të domosdoshëm ekzistencën e një marrëveshjeje në kryerjen e veprës penale (pactum sceleris). Në përcaktimin e kushteve të marrëveshjes për kryerjen e veprës penale në bashkëpunim, ana subjektive në kryerjen e veprës penale në bashkëpunim konsiston në dy elemente: - ndërgjegjja dhe vullneti i personit për të kryer veprën penale dhe - vullneti për të bashkëpunuar me persona të tjerë për kryerjen e saj. (Vendimi Unifikues nr.4, datë 15.04.2011). Që një veprë penale të konsiderohet e kryer në bashkëpunim, nuk kërkohet prania e një marrëveshjeje të shprehur, por mjafton edhe rënia dakord me anë të veprimeve konkludente në faza të ndryshme të konceptimit, përgatitjes, organizimit dhe ekzekutimit të veprës penale, me kushtin që secili prej bashkëpunëtorëve të jetë i ndërgjegjshëm për veprimet e të tjerëve, duke ndikuar/lehtësuar ato në kryerjen e një fakti penal të përbashkët.

.....

71. Ndërsa në lidhje me veprat e tjera penale, për të cilat nuk është parashikuar në mënyrë posaçërisht të shprehur nga norma penale inkriminuese, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, kur vepra penale kryhet në bashkëpunim në formën bashkëekzekutimit, si rregull, të gjithë bashkëpunëtorët do të përgjigjen për të "njëjtën veprë penale" të parashikuar nga e njëjta dispozitë e Pjesës së Posaçme të Kodit Penal. Në

rastin e personave të tjerë të përgjithshëm (extraneus) që nuk mbajnë cilësitë e veçanta apo nuk kanë pozitën subjektive të personit të cilësuar në veprën penale dhe që bashkëpunojnë me subjektin e cilësuar, të gjithë bashkëpunëtorët, qofshin ata të cilësuar apo të përgjithshëm, do të përgjigjen për të njëjtën veprë penale, vetëm kur personat e përgjithshëm bashkëpunëtorë që nuk janë të cilësuar (extraneus) janë të vetëdijshëm, duke pasur dijeninë në lidhje me cilësinë apo pozitën subjektive të personave të cilësuar dhe kjo cilësi e tyre ka lehtësuar bashkëpunimin për kryerjen e veprës penale të përbashkët. Pra, nëse personat e tjerë nga ata që janë të cilësuar, kanë anën subjektive lidhur me cilësinë e veçantë të personit të veprës penale, qoftë në formën e pakujdesisë, ku personi duhej dhe mund ta kishte parashikuar rrethanën e cilësisë së veçantë të personit të veçantë, qoftë në formën e dashjes, të dy këto kategori bashkëpunëtorësh do të përgjigjen për të njëjtën veprë penale. Në mënyrë që bashkëpunëtorët e tjerë të përgjigjen për veprën penale të kryer nga bashkëpunëtorë me cilësi të veçanta (intraneus), ata duhet të kenë dijeninë rreth bashkëpunimit (kontributit bashkëpunues) dhe pranisë së një subjekti të veçantë, domethënë të cilësuar që ka kontribuar në kryerjen e veprës penale që është rënë dakord edhe me të tjerët. Nëse mungon elementi subjektiv rreth dijenisë së rolit dhe subjektit të posaçëm, nga të gjithë bashkëpunëtorët e tjerë, atëherë për këtë cilësi, kur konsiderohet jashtë marrëveshjes së të gjithë bashkëpunëtorëve do të përgjigjet vetëm personi që ka apo në rast bashkëkzekutimi vetëm ata persona që e kanë bashkëkzekutuar, duke u konsideruar kjo cilësi si ekse i ekzekutorit, dhe mos iu atribuuar bashkëpunëtorëve të tjerë. Në arritjen e këtij përfundimi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbajnë parasysh parimin themelor të së drejtës penale të përgjegjësisë personale të personit që kryen veprën penale...".

Sa sipër, në rastet kur bashkëpunëtori që nuk ka cilësi të posaçme në raport me funksionarin shtetëror, kryen veprime të cilat janë relevante dhe thelbësore¹³ për kryerjen e veprës penale dhe ardhjen e pasojës dhe ai është i vetëdijshëm lidhur me cilësitë e veçanta që ka funksionari shtetëror, të cilat mundësojnë kryerjen e veprës penale, atëherë, në referim edhe të vendimit unifikues të sipërcituar, kualifikimi për bashkëpunëtorin pa cilësi të posaçme, do të bëhet sipas cilësimit që bëhet për subjektin që ka cilësitë e posaçme, pasi kjo veprë mbron më shumë marrëdhënien juridike të cenuar në rastin konkret nga veprimet, ose mosveprimet kriminale.

Përveç sa sipër, lidhur me veprimet e kundërligjshme mes shtetasve Ergys Agasi, Ermal Beqiri, Andis Papa, Gëzim Hoxha dhe Rogers Rryta, gjykata vlerëson se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se këta shtetas kanë kryer veprime që konfigurohen në figurën e veprës penale "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", e kryer në bashkëpunim të posaçëm, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 287, 28/4 dhe 334, pika 1 të K.Penal.

Vepra penale e "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287 të K.Penal, nga ana objektive, kryhet nëpërmjet njëres prej formave të parashikuara në

¹³ Konkurimi i personit të tretë që jep një kontribut thelbësor në lidhje me autorët e domosdoshëm të veprës penale, pranohet në veprat penale të korrupsionit, qëndrim ky i mbajtur në disa raste nga praktika gjyqësore italiane. (vendimi nr. 26740, 18 shtatorit 2020, Gjykata e Kasacionit, Seksioni VI). Në vendimin nr. 33435, 4 mars 2006, Gjykata e Kasacionit, Seksioni VI, ka arsyetuar ndër të tjera, se "Në veprën penale të korrupsionit, ku ka konkurim të domosdoshëm të personave dhe ka strukturë bilaterale, është i mundur bashkëpunimi i personave të tretë, si në rastin kur kontributi bëhet në formën e përcaktimit ose të sugjerimit të bërë njërit apo tjetrit prej autorëve të domosdoshëm, ashtu edhe në rastin kur rezulton një veprimtari ndërmjetësi që synon krijimin e lidhjes midis autorëve të domosdoshëm të veprës penale".

shkronjat a)¹⁴, b)¹⁵, c)¹⁶, ç)¹⁷, d)¹⁸ dhe dh)¹⁹ të nenit 287 të Kodit Penal, të cilat japin saktësisht edhe kuptimin e secilës formë të kryerjes së veprës duke identifikuar edhe qëllimin. Që të ekzistojë kjo veprë duhet që, midis veprimeve të autorit të veprës penale, të cilat konsistojnë në ndërmarrjen e veprimeve që vënë pastrimin e produktit të veprës penale, dhe pasojës apo mundësisë së ardhjes së saj, pra pastrimi i produktit të veprës penale, duhet të ekzistojë lidhja shkakësore, çka nënkupton që realizimi i pastrimit të produktit të veprës penale pasojë të vijë ekskluzivisht nga veprimet e autorit të veprës penale shkak. Në këtë drejtim, edhe midis produktit të veprës penale ose veprimtarisë kriminale burim nga e cila krijohet produkti dhe veprës penale të pastrimit të këtij produkti, duhet të ekzistojë lidhje shkakësore ekskluzive dhe e domosdoshme pasi për ekzistencën e veprës të pastrimit të produkteve të veprës penale, duhet që pasuria e krijuar apo vlera monetare që ka shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, të jetë rrjedhojë e përfitimave të ardhura nga aktiviteti kriminal. Ekzistenca e figurës së veprës penale të pastrimit të produkteve, nuk kushtëzohet nga fakti që për veprën mëmë (vepra penale nga e cila vjen produkti) nuk është filluar një çështje penale apo nuk është dhënë një vendim penal i formës së prerë, pasi sipas formulimit të dispozitës, në përputhje edhe me instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme²⁰, mjafton që

¹⁴ Në gërmën "a" parashikohet se pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, bëhet nëpërmjet: "këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale. Gjykata çmon se, pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale është ndryshimi, këtimi në një gjë tjetër; zëvendësimi ose transferimi i një të drejte nga një person në tjetrin; transfertat elektronike të parave nga një llogari bankare në një tjetër janë të përfshira gjithashtu në këtë proces; konvertimi dhe transferimi i pronës me qëllim pastrimit i cili kryhet në mënyrë të fshehtë apo që fsheh origjinën e saj të paligjshme apo për të ndihmuar çdo person i cili është i përfshirë në kryerjen e një veprë penale. Transferimi është i definuar si kalimi i parave nga një pikë në një tjetër. Një kuptim tjetër është kalimi i remitancave nga një llogari në një tjetër në emër të të njëjtit person ose të personave të tjerë. Qëllimi i sjelljes së tillë është për të transformuar një pjesë të pronës në një tjetër, me synim për ta bërë atë legjitime, në mënyrë që prona e paligjshme të fillojë të bëhet e ligjshme. Ligji nuk duket se kushton mënyrën në të cilën pasuritë këmbehen ose transferohen. Sigurisht që çdo lloj transaksioni financiar, si blerja e një çeku të arkëtueshëm, këmbimi i një çeku me një tjetër monedhë ose blerja e mallrave janë në përputhje me këtë përkufizim. Gjithashtu, edhe një transaksion jofinanciar si lëvizja apo dorëzimi i parave nga një person tek personi tjetër janë në përputhje me këtë përcaktim".

¹⁵ Në gërmën "b" parashikohet se pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, bëhet nëpërmjet: "fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale. Po t'i referohemi Konventës së Vjenës 1988 (Neni 3/1) dhe Konventës së Palermos 2000 (Neni 6/2) vetëfshehja nuk dënohet, por dënohet veprimi i mëvonshëm i fshehjes".

¹⁶ Në gërmën "c" parashikohet se pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, bëhet nëpërmjet: "fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale. Ndodhur në këto kushte, me qëllim zbatimin korrekt të kësaj dispozite, Gjykata rast pas rasti do t'i referohet termave ligjore "pronësi", "posedim" dhe "përdorim" sipas kuptimit që i ka dhënë Kushtetuta, Kodi Civil dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Gjykatës së Lartë".

¹⁷ Në gërmën "ç" parashikohet se pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, bëhet nëpërmjet: "kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shpangjen nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave. Gjykata çmon se, kjo është një dispozitë blankete. Ndodhur në këto kushte, për të përcaktuar se kush janë ato veprimet ose transaksione që duhen raportuar duhet t'i referohemi Ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" i ndryshuar".

¹⁸ Në gërmën "d" parashikohet se pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, bëhet nëpërmjet: "investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale".

¹⁹ Në gërmën "dh" parashikohet se pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, bëhet nëpërmjet: "këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër".

²⁰ (i) Konventa e Kombeve të Bashkuara "Kundër trafikut të paligjshëm të drogave të paligjshme dhe të lëndëve psikotrope", ratifikuar me ligjin nr. 8723, datë 26.12.2000, e cila parashikon masa të qarta kundër trafikimit të narkotikëve, me norma të posaçme për sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale. Edhe pse termi pastrim parash nuk përmendet shprehimisht, kjo konventë elaboron konceptin e pastrimit të parave dhe i bën thirrje palëve të marrin masa për

në përkrah të asaj vepre penale të pastrimit të parave, të provohet objektivisht se produkti rrjedh nga një vepër penale. Pra, pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale është një operacion që synon dhe realizon konvertimin dhe transferimin e pronës/pasurisë/produktit, ndryshimin, kthimin në një gjë tjetër, zëvendësimin ose transferimin e një të drejte nga një person në tjetrin, kryer në mënyrë të fshehtë apo në mënyrë të dukshme por duke fshehur origjinën e saj të paligjshme me qëllim pastrimin e saj apo për të ndihmuar çdo person i cili është i përfshirë në kryerjen e një vepre penale. Ligji, nëpërmjet formave të kryerjes së kësaj vepre, nuk ka kufizuar mënyrën në të cilën pasuritë këmbehen ose transferohen pasi paratë pastrohen në mënyra të ndryshme, si depozita në institucione financiare, transfera bankare, investime, politika obligacionesh apo figuracionesh, nëpërmjet veprimtarisë së bizneseve fasade (fiktive), nëpërmjet tregtimit, transaksione offshore, etj.

Në fakt, diskutimi që mund të lind në këtë pikë është nëse vepra penale e "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", parashikuar nga neni 258 të K.Penal, mund të jetë figurë vepre mëmë për të qenë përpara veprës penale të pastrimit të parave. Pranohet gjerësisht se që të jemi para veprës penale të pastrimit të parave, do të duhet të ketë një lidhje shkakësore, me përfitimet e ardhura nga aktiviteti kriminal. Po ashtu pranohet se, vepra penale e shkeljes së barazisë së pjesëmarrjes në tendera apo ankande publike është një vepër formale për nga natyra e saj. Në rast se nën petkun e kësaj vepre, ka veprime të tjera të kundërligjshme, që sjellin pasoja të ndryshme, dëmtim të buxhetit të shtetit, përfitimet të paligjshme, praktika të ushtrimit të ndikimit apo korruptive, atëherë kualifikimi i veprimeve të kundërligjshme duhet bërë pasur në vëmendje këto vepra penale, vepra këto që shërbejnë si vepra penale mëmë për figurën e veprës penale të pastrimit të parave.

Ndaj përsa pranon organi i akuzës dhe përsa rezulton në mënyrë të logjikshme nga aktet e administruara, skema e ngritur nga grupi i strukturuar në këtë rast ka për qëllim final shtënien në dorë të fondeve të shtetit, të ligjëruar nën petkun e procedurave të prokurimit. Këto veprime përbëjnë vepra më të rënda se ajo e shkeljes së barazisë në tendera dhe organi procedues do të duhet të ketë në konsideratë gjatë vijimit të hetimit, kualifikimin e faktit tipik të rezultuar, apo që do të rezultojë në dinamikë.

Megjithatë, përsa parashikon ligji dhe i kërkohet kësaj gjykate, brenda kompetencave ligjore të njohura nga ligji, gjykata vlerëson se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për të gjitha veprat penale për të cilat është regjistruar emri i personave nën hetim, në regjistrin e njoftimit të veprave penale.

kriminalizimin e saj. Por, ajo është e kufizuar vetëm në spektrin e veprave penale në fushën e narkotikëve. (ii) Konventa e Kombeve të Bashkuara "Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar", ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002, e cila mbulon një spektër më të gjerë të kriminalitetit dhe mbart detyrime efektive në luftën kundër pastrimit të parave. (iii) Konventa e Këshillit të Evropës "Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit", ratifikuar me ligjin nr. 8646, datë 20.7.2000, e cila rregullon në mënyrë të qartë pastrimin e parave, duke i kërkuar palëve marrjen e masave për kriminalizimin e kësaj sjelljeje. (iv) Konventa e Këshillit të Evropës "Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit", ratifikuar me ligjin nr. 9646, datë 27.11.2006, e cila rregullon në mënyrë më të plotë pastrimin e parave, duke patur një fokus të veçantë edhe në financimin e terrorizmit, si një veprimtari e lidhur ngushtësisht më të parën. (v) Rekomandimet e FATF (Task Force e Veprimit Financiar), të cilat janë baza e luftës kundër pastrimit të parave e më shumë se 130 shteteve, përfshi edhe e Shqipërisë, dhe ka shërbyer për përafrimin e legjislacionin shqiptar në përputhje me këto rekomandime. (vi) Raportet e MONEYVAL (Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit), i cili është një organizëm monitorues i Këshillit të Evropës në luftën kundër pastrimit të parave, dhe shërben nëpërmjet elaborimit të standardeve në këtë fushë dhe vlerësimit të përputhshmërisë së masave të marra nga shtetet anëtare.

Sa sipër, konkludohet duke pasur parasysh se sipas dispozitave përkatëse të K.Pr.Penale, në rastin e caktimit të masave të sigurimit, gjykata nuk mund të bëjë analizën e provave, por duhet të respektojë rigorozisht kërkesën e nenit 228 të K.Pr.Penale, sipas të cilit askush nuk mund t'i nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova. Është e kuptueshme që, brenda afatit që duhet t'i paraqitet nga prokurori gjykatës kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj një personi, provat e marra nuk janë të avancuara por është e domosdoshme që, për të vendosur masën e sigurimit, ato të jenë të mjaftueshme për të pasur një dyshim të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale prej tij. Në këtë aspekt, baza kryesore është ekzistenca e veprës penale me të gjithë elementet e saj pra, ekzistenca e faktit kriminal pa të cilin, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

Në këtë fazë të gjykimit të çështjes, detyrim i gjykatës nuk është analiza e provave rreth fajësisë së personave nën hetim për të gjitha episodet sikurse më sipër është cituar, por të analizojë që dyshimet e arsyeshme të jenë të bazuara në prova. Në dosjen tashmë gjyqësore janë të administruara prova të tilla të sipërcituara që tregojnë të dhëna se personat nën hetim kanë kryer veprat penale respektive.

Gjithashtu, në këtë fazë të gjykimit nuk mund të bëhet analiza e anës subjektive të veprës penale për personat e dyshuar që i kanë kryer veprat penale të sipërcituara, pasi një gjë e tillë jo vetëm vjen ndesh me kërkesat e ligjit procedural penal por edhe me praktikën shumë vjeçare në këtë fushë²¹.

Në vijim, Gjykata konstaton faktin se veprat penale për të cilat dyshohen personat nën hetim *Ergys Agasi, Ermal Beqiri, Mirlinda Karçanaj, Hava Delibash, Erjon Ismaili, Andis Papa, Gëzim Hoxha dhe Rogers Rryta*, janë ato të parashikuara nga nenet 110, 170/b, 258, 287, 333/a të K.Penal (*Theksojmë se secili person nën hetim për veprat atribuuar atij dhe jo për të gjitha veprat në tërësi*). Nuk rezulton që këto vepra penale të jenë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale pasi personat të cilët dyshohen se kanë kryer këto vepra penale i kanë kryer ato në vitin 2025 dhe më parë, si dhe nuk rezulton që këto vepra të jenë amnistuar.

Në vështrim të kushtit të tretë, Gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat këta shtetas nuk mund të merren si të pandehur apo që të mund të dënohen, pasi personat nën hetim kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç, pasi vepra penale për të cilën ata dyshohen se kanë kryer janë krime (*personat nën hetim rezultojnë të jenë të gjithë mbi moshën e kërkuar nga ligji penal*). Nuk rezulton që personat nën hetim *Ergys Agasi, Ermal Beqiri, Mirlinda Karçanaj, Hava Delibashi, Erjon Ismaili, Andis Papa, Gëzim Hoxha dhe Rogers Rryta*, të jenë të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tyre mendore, gjithashtu Gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprës penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit, Gjykata duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë më konkretisht:

²¹ Vendimi nr. 99, datë 26.07.2005 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- *ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;*
- *largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;*
- *rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.*

Në mhështetje të sa më sipër, Gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masave të sigurimit ndaj personave nën hetim *Ergys Agasi, Ermal Beqiri, Mirlinda Karçanaj, Hava Delibashi, Erjon Ismaili, Andis Papa, Gëzim Hoxha dhe Rogers Rryta*, është i nevojshëm pasi:

Në vlerësim të Gjykatës, ekziston rreziku, që për shkak të rrethanave të faktit sesi janë kryer veprat penale objekt hetimi në kuadër të procedimit penal nr. 20/1 të vitit 2025 të Prokurorisë së Posaçme ekziston rreziku që këta shtetas të vijonte të kryejnë veprat penale të të njëjtit lloj, apo të ngjashme, kjo për shtetasit që dyshohet se e kanë kryer veprën penale në formacionin e posaçëm, atë të grupit të strukturuar kriminal dhe veprat e dyshuara për nga natyra, duke vlerësuar edhe cilësitë e secilit person në këtë rast, ta bëjnë këtë rrezik eminent. Gjithashtu, pasur në konsideratë mënyrën e kryerjes së veprës penale, shtrirjen e saj në kohë, akuzat në ngarkim të të personave nën hetim, mënyrën sesi ata kanë vepruar, pasur në konsideratë e provat mbledhura dhe deklaratimet e tyre deri më tani, që çdo gjë ka funksionuar sipas ligjit, gjykata vlerëson se ekziston rreziku i ikjes, me qëllim shmangien e përgjegjësisë penale. Gjithashtu, në këtë rast ekziston rreziku i marrjes së provave, për të gjithë personat nën hetim, duke qenë se prokuroria edhe pse ka kryer së fundmi veprime të hapura në kuadër të hetimit të kësaj çështje penale, ende janë për t'u pyetur shumë shtetas të tjerë që mund të kenë dijeni për veprën penale, e duke pasur në konsideratë sjelljet e z. Agasi, z. Beqiri dhe z. Ismaili (*pozicionin dhe funksionin e këtij shtetasi-zv.drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë*), në raport me viktimën z. Meçe, rreziku është mëse evident dhe prezent. Po ashtu, znj. Karçanaj dhe znj. Delibashi janë në pozita drejtuese në institucionin e AKSHI-t, konkretisht Drejtoresha e Përgjithshme dhe Zv.Drejtoresha e Përgjithshme, kështu që jo vetëm në raport me personat që do të pyeten, por duke pasur parasysh edhe dokumentet apo aktet e tjera që mund të sekuestrohen pranë këtij institucioni, apo edhe në institucione të tjera, që lidhen me procedurat e prokurimit të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, AKSHI, gjykata vlerëson se masat e sigurimit janë të nevojshme dhe domosdoshme në këtë rast, pasi ka rrezik të marrjes dhe të vërtetësisë së provës në këtë rast.

Për caktimin e masave të sigurimit, Gjykata përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Këto kriteret përcaktojnë llojin e masës së sigurimit që duhet të marrë gjykata për rastet konkrete që ka në shqyrtim. *Kriteri i parë* është përshtatshmëria e masës së sigurimit me shkallën e nevojave të sigurimit që kërkohen në rastin konkret, pra sa më e madhe të jetë nevoja e sigurimit aq më e rëndë duhet të jetë masa e sigurimit që caktohet. *Kriteri i dytë* është ruajtja e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së sigurimit, duke mbajtur parasysh dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga K.Penal. *Kriteri i tretë*: Kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete.

Në më sipër, Gjykata emron se:

- Masa e sigurimit "*arrest në burg*" parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale e kërkuar nga organi i akuzës në rastin objekt gjykimi ndaj personave nën hetim: Ergys Agasi dhe Ermal Beqiri;
- Masa e sigurimit "*arrest në shtëpi*", parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale, e kërkuar nga organi i akuzës në rastin objekt gjykimi ndaj personave nën hetim: Mirlinda Karçanaj dhe Hava Delibashi;
- Masa e sigurimit ndaluese "*Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik*", dhe masa e sigurimit shtrënguese "*Ndalim i daljes jashtë shtetit*", parashikuar nga nenet 242 dhe 233 të K.Pr.Penale, e kërkuar nga organi i akuzës për rastin objekt gjykimi ndaj personit nën hetim Erjon Ismaili;
- Masa e sigurimit "*Ndalim i daljes jashtë shtetit*", parashikuar nga neni 233 të K.Pr.Penale, e kërkuar nga organi i akuzës në rastin objekt gjykimi ndaj personave nën hetim: Andis Papa, Gëzim Hoxha dhe Rogers Rryta, janë të përshtatshme dhe të drejta pasi:

Me masat e kërkuara ndaj z. Agasi dhe z. Beqiri, gjykata mban në konsideratë rrezikshmërinë e veprave penale për të cilat dyshohen këta shtetas, vepra me rrezikshmëri të konsiderueshme shoqërore, llojin e veprave të kryera, pozicionin dhe rolin e tyre në këtë veprimtari të kundërligjshme. Po ashtu gjykata mban në konsideratë rolin e tyre si drejtues dhe organizatorë në këtë veprime të kryera. Po ashtu, këta shtetas konsiderohen me rrezikshmëri shoqërore, pasur në konsideratë mënyrën e të vepruarit të tyre, ku dyshohet të kenë kryer edhe rrëmbimin e z. Meçe me qëllim arritjen e qëllimeve të tyre për përfitimin e fondeve publike. Të dy këta shtetas rezultojnë me hyrje -dalje të shumta nga territori shqiptar. Z. Beqiri rezulton të ketë në pronësi mjete të transportit ujqor dhe ajror, gjë që mund të lehtësojnë mënyrën e largimit të tij nga Shqipëria. Nga të dhënat e administruara deri më tani ky shtetas rezulton të ketë investuar apo bërë transferta monetare edhe jashtë Shqipërisë, ka një shoqëri tregtare në Turqi dhe ka qenë në planifikim të një investimi në Maltë, të dhëna këto që tregojnë se ky shtetas mund të largohet dhe të vazhdojë jetën në mënyrë të pavarur jashtë vendit, por duke vijuar ndikimin në Shqipëri po të kemi parasysh interesat e tij të drejtpërdrejta apo të tërthorta në disa shoqëri tregtare në vendin tonë.

Në lidhje me znj. Karçanaj dhe znj. Delibashi, gjykata mban në konsideratë veprat penale të dyshuara të kryera nga ana e tyre. Në kuadër të rrezikshmërisë së veprës penale dhe të personit, gjykata ka parasysh pozicionin e tyre drejtues në institucionin e rëndësishëm të AKSHI-t dhe të faktit se znj. Karçanaj ka rreth 12 vjet drejtuese e këtij institucioni. Ky institucion ka rëndësi të veçantë për vendin, pasi në zbatim të misionit të tij, ka përgjegjësi si ofrues shërbimesh, si krijues e administruues i infrastrukturave të shërbimeve, sistemeve, portaleve, shërbimeve të besuara dhe regjistrave, si kontribues në hartimin e politikave e të planeve të veprimit në fushën TIK, si dhe detyra të tjera sipas përcaktimeve të ligjit, duke patur mundësi për akses informacioni dhe dokumentacioni në shumë organe qeveritare, madje edhe në zona apo instanca që kanë të bëjnë me të dhënat personale të shtetasve, sigurinë kombëtare e më gjerë.

Në lidhje me masat e sigurimit të kërkuara ndaj z. Ismaili, gjykata mban në konsideratë funksionin e tij të rëndësishëm në një institucion shumë të rëndësishëm në vend, që ka për qëllimin ruajtjen e rendit dhe të sigurisë, garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe z. Ismaili ka vepruar edhe në kundërshtim me këto vlera dhe detyrime që ka policia e shtetit. Veprimet e tij të kundërligjshme lidhen si me veprimet në dëm të shëndetit të qytetarëve por edhe të interesave ekonomikë të shtetasve apo subjekteve tregtare.

Përsa i përket Papa, z. Hoxha dhe z. Rryta, gjykata mban në konsideratë veprimet e kryera nga ana tyre, veprat penale për të cilat janë nën akuzë, që janë vepra me rrezikshmëri të konsiderueshme shoqërore. Këta shtetas rezultojnë të kenë dhënë deklarime, që në fakt e kanë ndihmuar organin procedues në zbardhjen e fakteve të kundërligjshme, ndaj edhe kjo rrethanë vlerësohet dhe mbahet në konsideratë nga ana e gjykatës. Duke vlerësuar rolin e tyre në këtë veprimtari të kundërligjshme, të paktën përsa rezulton deri më tani, ata konsiderohen persona me rrezikshmëri të ulët shoqërore, ndërsa kanë interesa të lidhura fort me Shqipërinë, duke qenë se janë ortakë të shoqërive tregtare që operojnë në vendin tonë.

Sa më sipër Gjykata, në vështirim të neneve 228, 229, 233, 242, 237, 238 dhe 245 të K.Pr.Penale, çmon se kërkesa e Prokurorisë së Posaçme për caktimin si masë sigurimi ndaj personave nën hetim:

-Ergys Agasi dhe Ermal Beqiri, atë të "*Arrestit në burg*", parashikuar nga neni 238 të Kodit të Procedurës Penale;

-Mirlinda Karçanaj dhe Hava Delibashi, atë të "*Arrestit në shtëpi*", parashikuar nga neni 237 të Kodit të Procedurës Penale;

-Erjon Ismaili, ato të "*Pezullimit të ushtrimit të një detyre a shërbimi publik*" dhe "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*", parashikuar nga neni 242 dhe 233 të Kodit të Procedurës Penale;

-Andis Papa, Gëzim Hoxha dhe Rogers Rryta, atë të "*Ndalimit të daljes jashtë shtetit*", parashikuar nga neni 233 të Kodit të Procedurës Penale, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale respektive, është e mbështetur në prova dhe në ligj, bazuar kjo në parimin e proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë së kufizimit të lirisë së personit, sanksionuar nga neni 5 të KEDNJ-së, si dhe parë në raport me nenet 17 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me personin nën hetim Mirlinda Karçanaj, duke qenë se gjykata vendosi caktimin e masës së sigurimit të "*arrestit në shtëpi*", parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale, Gjykata vendos urdhërimin e personit nën hetim Mirlinda Karçanaj që të mos largohet nga banesa e saj në: Rruga "Kavajës", Pallati nr. 3, Hyrja 4, Ap 44, Tiranë.

Lidhur me personin nën hetim Hava Delibashi, duke qenë se gjykata vendosi caktimin e masës së sigurimit të "*arrestit në shtëpi*", parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale, Gjykata vendos urdhërimin e personit nën hetim Hava Delibashi që të mos largohet nga banesa e saj në: Rruga "Komuna Parisit", pranë "Ola Fast", pallati "Erald", k.9, ap 22, Tiranë.

Në lidhje me personin nën hetim, shtetasin Erjon Ismaili, duke qenë se gjykata vendosi ndaj tij caktimin e dy masave të sigurimit personale, një me natyrë shtrënguese dhe tjetra me natyrë ndaluese, gjykata urdhëron:

- Urdhërohet personi nën hetim Erjon Ismaili të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e gjykatës, në referim të nenit 233, pika 1 të K.Pr.Penale "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*".
- Ndalohet përdorimi i pasaportës dhe dokumenteve të tjerë identifikues të vlefshme për daljen jashtë shtetit, për personin nën hetim Erjon Ismaili.

Në zbatim të masës së sigurimit ndaluese "*Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik*", parashikuar nga neni 242 të K.Pr.Penale, gjykata urdhëron pezullimin plotësisht të veprimtarive që lidhen me qenien e Erjon Ismailit si funksionar në Policinë e Shtetit.

Lidhur me personat nën hetim **Andis Papa**, **Gëzim Hoxha** dhe **Rogers Rryta**, duke qenë se gjykata vendosi ndaj tyre caktimin e masës së sigurimit shtrënguese të "*Ndalimit të daljes jashtë shtetit*", parashikuar nga neni 233 të K.Pr.Penale, gjykata urdhëron edhe si më poshtë vijon:

- Urdhërohet personi nën hetim **Andis Papa** të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e gjykatës, në referim të nenit 233, pika 1 të K.Pr.Penale "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*".
- Ndalohet përdorimi i pasaportës dhe dokumenteve të tjerë identifikues të vlefshme për daljen jashtë shtetit, për personin nën hetim **Andis Papa**.
- Urdhërohet personi nën hetim **Gëzim Hoxha** të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e gjykatës, në referim të nenit 233, pika 1 të K.Pr.Penale "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*".
- Ndalohet përdorimi i pasaportës dhe dokumenteve të tjerë identifikues të vlefshme për daljen jashtë shtetit, për personin nën hetim **Gëzim Hoxha**.
- Urdhërohet personi nën hetim **Rogers Rryta** të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e gjykatës, në referim të nenit 233, pika 1 të K.Pr.Penale "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*".
- Ndalohet përdorimi i pasaportës dhe dokumenteve të tjerë identifikues të vlefshme për daljen jashtë shtetit, për personin nën hetim **Rogers Rryta**.

Për ekzekutimin e masave të sigurimit ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 (pesë) ditëve, nga njoftimi i vendimit të gjykatës.

IV. Konkluzioni

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të neneve 228, 229, 230, 233, 242, 237, 238, 244 dhe 245 të K.Pr.Penale

VENDOSI:

I. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

1. Caktimin e masës së sigurimit personal "*Arrest në burg*", e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Ergys Agasi** i biri i Bardhyl dhe Besa, i datëlindjes 22.03.1987, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i martuar, me numër personal I70322075Q, me adresë banimi: Rruga "Abaz Çelkupa", pallati nr. 28, Durrës dhe pranë "Panto Resort", banesë 2-katëshe, Tiranë;, i dyshuar për kryerjen e veprave penale "*Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës*", "*Heqja*

paligjshme e lirisë", "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike" e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit atë të grupit të strukturuar kriminal dhe "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" të parashikuara nga nenet 110, 170/b e 28/4, 258, 287 dhe 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

2. Caktimin e masës së sigurimit personal "Arrest në burg", e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasit nën hetim Ermal Beqiri i biri i Nexhmi dhe Mihal, i datëlindjes 23.01.1982, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, beqar, me numër personal I20123025V, me adresë banimi: Rruga "Hoxha Tasim" pallati 113, Hyrja, Tiranë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale "Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës", "Heqja e paligjshme e lirisë", "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike" e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit atë të grupit të strukturuar kriminal dhe "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" të parashikuara nga nenet 110, 170/b e 28/4, 258, 287 dhe 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

3. Caktimin e masës së sigurimit personal "Arrest në shtëpi", e parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasit nën hetim Mirlinda Karçanaj, e bija e Agim dhe Gjinovefa, e datëlindjes 29.06.1973, me kombësi shqiptare dhe shtetësi shqiptare, e martuar, me numër personal H35629039A, me adresë banimi: Rruga "Kavajës", Pallati nr. 3, Hyrja 4, Ap 44, Tiranë, e dyshuar për kryerjen e veprave penale "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike" e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit atë të grupit të strukturuar kriminal dhe "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", të parashikuara nga nenet 258 dhe 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

3.1. Urdhërimin e personit nën hetim Mirlinda Karçanaj që të mos largohet nga banesa e saj në: Rruga "Kavajës", Pallati nr. 3, Hyrja 4, Ap 44, Tiranë.

4. Caktimin e masës së sigurimit personal "Arrest në shtëpi", e parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasit nën hetim Hava Delibashi, e bija e Novruz dhe Shpresa, e datëlindjes 17.01.1986, e lindur në Berat, dhe banuese në Tiranë, rruga "Komuna Parisit", pranë "Ola Fast", pallati "Erald", k.9, ap 22 arsimi i lartë, gjëndja familjare beqare, e padënuar më parë, me profesion juriste, me Nr.personal I65117057T, e dyshuar për kryerjen e veprave penale "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike" e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit atë të grupit të strukturuar kriminal dhe "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", të parashikuara nga nenet 258 dhe 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

4.1. Urdhërimin e personit nën hetim Hava Delibashi që të mos largohet nga banesa e saj në: Rruga "Komuna Parisit", pranë "Ola Fast", pallati "Erald", k.9, ap 22, Tiranë.

5. Caktimin e masës së sigurimit personal "*Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik*" dhe "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*", të parashikuara nga nenet 242 dhe 233 të Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasit nën hetim Erjon Ismaili, i biri i Luftir dhe Lulzime, i datëlindjes 11.10.1979, i lindur në Këlcyrë, Përmet, me shtetësi shqiptare, i martuar me fëmijë, me adresë banimi rruga "Konferenca e Pezës", nd. 12, H.2, ap.18, i me nr.personal: H91011016N, i dyshuar për kryerjen e veprave penale "*Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës*" e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit atë të grupit të strukturuar kriminal dhe "*Grupi i strukturuar kriminal*", "*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*" të parashikuara nga nenet 170/b e 28/4 dhe 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

5.1. Urdhërohet personi nën hetim Erjon Ismaili të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e gjykatës, në referim të nenit 233, pika 1 të K.Pr.Penale "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*".

5.2. Ndalohet përdorimi i pasaportës dhe dokumenteve të tjerë identifikues të vlefshme për daljen jashtë shtetit, për personin nën hetim Erjon Ismaili.

5.3. Në zbatim të masës së sigurimit ndaluese "*Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik*", parashikuar nga neni 242 të K.Pr.Penale, gjykata urdhëron pezullimin plotësisht të veprimtarive që lidhen me qenien e Erjon Ismailit si funksionar në Policinë e Shtetit.

6. Caktimin e masës së sigurimit personal "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*", të parashikuar nga neni 233 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasit nën hetim Andis Papa i biri i Spiro dhe Kristina, i datëlindjes 17.02.1975, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i martuar, me numër personal H50217056C, me adresë banimi: rruga "Brigada e VIII", pallati nr. 8 hyrja 1 Tiranë, i dyshuar për kryerjen e veprës penale "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*" e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit atë të grupit të strukturuar kriminal "*Grupi i strukturuar kriminal*" dhe "*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", të parashikuara nga nenet 287 dhe 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

6.1. Urdhërohet personi nën hetim Andis Papa të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e gjykatës, në referim të nenit 233, pika 1 të K.Pr.Penale "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*".

6.2. Ndalohet përdorimi i pasaportës dhe dokumenteve të tjerë identifikues të vlefshme për daljen jashtë shtetit, për personin nën hetim Andis Papa.

7. Caktimin e masës së sigurimit personal "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*", të parashikuar nga neni 233 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasit nën hetim Gëzim Hoxha i biri i Brahim dhe Xhefe, i datëlindjes 06.03.1978, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i martuar, me numër personal H80306088N, me adresë banimi: rruga "Alla", pallati nr. 4, hyrja 7, ap 17, Farkë, Tiranë, i dyshuar për kryerjen e veprës penale "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*" e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit atë të grupit të strukturuar kriminal "*Grupi i strukturuar kriminal*" dhe "*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", të parashikuara nga nenet 287 dhe 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

7.1. Urdhërohet personi nën hetim **Gëzim Hoxha** të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e gjykatës, në referim të nenit 233, pika 1 të K.Pr.Penale "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*".

7.2. Ndalohet përdorimi i pasaportës dhe dokumenteve të tjerë identifikues të vlefshme për daljen jashtë shtetit, për personin nën hetim **Gëzim Hoxha**.

8. Caktimin e masës së sigurimit personal "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*", të parashikuar nga neni 233 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Rogers Rryta** i biri i Bedriut dhe i Meliha, i datëlindjes 03.03.1987, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i martuar, me numër personal I70303061U, me adresë banimi: Rruga "Fatmir Haxhiu", pallati te ETC, kati 11/4, Tiranë., i dyshuar për kryerjen e veprës penale "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*" e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit atë të grupit të strukturuar kriminal "*Grupi i strukturuar kriminal*" dhe "*Kryerja e veprime penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", të parashikuara nga nenet 287 dhe 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

8.1. Urdhërohet personi nën hetim **Rogers Rryta** të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e gjykatës, në referim të nenit 233, pika 1 të K.Pr.Penale "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*".

8.2. Ndalohet përdorimi i pasaportës dhe dokumenteve të tjerë identifikues të vlefshme për daljen jashtë shtetit, për personin nën hetim **Rogers Rryta**.

II. Për ekzekutimin e masave të sigurimit ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit.

III. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 (pesë) ditëve, nga njoftimi i vendimit të gjykatës.

U shpall në Tiranë, sot më datë 15.12.2025!

